9
197
monumentet

monumentet



DO NOT
COPY

Çmimi 10 lekë

I
M
K

05
MON

9, 1975

DO NOT COPY

Kopertina e parë:
Tavan i gdhendur në dru – Berat, banesa e Bizbiqëve.

MINISTRIA E ARËSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

9, 1975

INST. MON. KULTURËS
BIBLIOTEKA
Nr. INV. 3664

KOLEGJUMI I REDAKSISË

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
pranë Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës

Adresa e Redaksisë: Rruga Alqi Kondi nr. 7

Tirazhi: 1500 kopje

Formati 70 x 100/12

Stash: 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik Shtypshkronja «Mihal Duri», Tiranë –

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

ARTIKUJ

Gjerak KARAISKAJ

Apollon BAÇE

— Kalaja e Durrësit dhe sistemi i fortifikimit përreth në kohën e vonë antike **5**

Neritan ÇEKA

— Ndërtimet sepulkrale të qyteteve ilire. **35**

Lazër PAPAJANI

— Kalaja e Peqinit **55**

Aleksandër MEKSI

— Dy kisha bizantine në rreth të Gjirokastrës **77**

Emin RIZA

— Studim për restaurimin e një banese me çardak në qytetin e Krujës **107**

Burhan STRAZIMIRI

— Arkitektura dhe restaurimi i banesës Bizbiqëve **127**

MATERIALE DHE KUMTESA

Emin RIZA

— Banesa popullore në Kurveleshin e Sipërm **141**

Fatos TARTARI

— Gjurmë ndërtimesh në kënetën e Durrësit **161**

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERS

Page

ARTICLES

Gjerak KARAISKAJ

Apollon BAÇE

– La forteresse de Durres et les autres fortifications environnantes pendant la basse antiquité 5

Neritan ÇEKA

– Les constructions sépulcrales des cités illyriennes 35

Lazër PAPAJANI

– La forteresse de Peqin 55

Aleksandër MEKSI

– Deux églises byzantines du district de Gjirokastra 77

Emin RIZA

– Etude concernant la restauration d'une maison à tchardak dans la ville de Kruja 107

Burhan STRAZIMIRI

– Architecture et restauration de l'habitation des Bizbiq 127

MATERIAUX ET COMMUNICATIONS

Emin RIZA

– L'habitation populaire dans le haut Kurvelesh 141

Fatos TARTARI

– Traces de constructions dans le marais de Durres 161

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ Apollon BAÇE

KALAJA E DURRËSIT DHE FORTIFIKIMET PËRRETH NË ANTIKITETIN E VONË

DO NOT COPY

Në antikitetin e vonë qyteti i Durrësit, mbrohej nga mure dhe kulla të fuqishme, të cilat përbënë bazën e fortifikimeve edhe gjatë mesjetës së hershme e të mesme deri në pushtimin turk. Jo vetëm kaq, por edhe hinterlandi i gjerë i këtij qyteti të rëndësishëm të perandorisë bizantine, ishte mbushur me kështjella më të vogla, të cilat e qarkonin atë nga ana e tokës, dhe zinin pika të rëndësishme strategjike, kryesisht në zotërimin e rrugëve që të çonin në Durrës ose shtigjeve që të lidhnin me zonën fushore rreth tij. (Tab. I). Të tilla janë kalaja e Turës, Ndroqit, Lalmit, Petrelës, Dorëzit, Vilës (Persqopit), Dajtit dhe Tujanit. Krahas tyre në territorin e afërt gjenden edhe disa kështjella të tjera, të cilat mund të mos lidhen drejtpërsëdrejti me sistemin e fortifikimit të Durrësit për shkak të largësisë së tyre të madhe. Por, dy prej tyre, Laçi dhe Daula, janë të vetmet kështjella në veri të Durrësit, ndërsa ajo e Shëngjinit, megjithëse e vendosur në thellësi të zonës malore të Dajtit, kontrollon një rrugë të rëndësishme natyrore që kalon nëpër Qafën e Priskës dhe zbret në fushën e Tiranës, nga ku në disa drejtime mund të shkohet për në Durrës.

I pari që hodhi mendimin se Durrësi mbrohej nga një sistem kalash asteroide, duke u nisur kryesisht nga burimet e shkruara, ishte M. Shuflai[1]). Njëkohësisht nuk kanë munguar edhe studimet e veçanta të arkitekturës dhe historisë së këtyre fortifikimeve, kryesisht për kalanë e Durrësit.

Duke filluar që nga Qiriakua i Ankonës (shek. XV), i cili u mjaftua me mbledhjen dhe botimin e disa mbishkrimeve, deri tek studjuesi më i vonë K. Zheku, që trajtoi monogramet e tullat e fortifikimeve të vona antike të Durrësit, një varg studjuesish u kushtuan monumenteve të këtij qyteti, mureve rrethuese apo shtrirjes së tij në kohë, një sërë studimesh[2]); Gjithashtu për fortifikimet rreth Durrësit na kanë lënë shënime të vlefshme për kështjellën e Laçit[3]), Daulës[4]), Ndroqit[5]), Dajtit[6]) dhe Dorëzit[7]) një varg autorësh të tjerë.

Me gjithë këto studime të veçanta, nuk kemi akoma një panoramë të qartë të kalasë së Durrësit lidhur me sistemin e tij mbrojtës ndaj hinterlandit, kështu ndodh që jo rallë disa studjues t'i atribuojnë këtij sistemi të plotësuar në shek. VI, jo vetëm kështjella që lindën për herë të parë në mesjetë, si Kepi Rodonit dhe Kruja,

1) M. Suflay – **Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters, Wien** und Leipzig, 1924.
2) Cyriakus Ankonitanus, **Epigramata per Illyricum reperta,** 21; L. Heuzey – H. Daumet, **Mision archéologique de Macédoine,** L. Rey, **Les Remparts de Durazzo,** Albanie, 1925, 33-48. C. Praschniker – A. Schober, **Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien 1919, 32-46.
A. Schober, Zur **Topographie von Dyrrachium,** Jahreshefte des Österreichischen Archâologischen Institutes, Band XXIII, Wien, 1926, 231-240.
V. Toçi, **Të dhëna mbi topografinë dhe elementin ilir të Dyrrahit, në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike,** Konf. I Albanologjike, Tiranë 1965.
K. Zheku, **Zbulime epigrafike në muret rrethuese të kalasë së Durrësit,** «Monumentet», 3, 35-47.
3) C. Praschniker – A. Shober – **vep. cit.** 85.
4) L. Bajo, **Kalaja e Sebastjes dhe Daulës.,** Konf. II e Studimeve Albanologjike Tiranë 1969, 311-314.
5) Gj. Frashëri, **Kalaja e Ndroqit,** Monumentet, 4, 185.
6) N. Ceka, **Kalaja e Dajtit,** B.U.SH, Ser. shk. shoq., 1960, 2, 236-243.
7) H. Ceka, **Zbulimi i një qyteti antik në rrethin e Tiranës,** B.I.SH., 1951, 86-89.

por edhe të tilla të ndërtuara më vonë nga pushtuesit turq[8]). Nga ana tjetër, fortifikime të periudhës së vonë antike që nuk ruajnë gjurmë më të vona përfshihen në sistemet e fortifikimeve të mesjetës[9]).

Duke u bazuar në vrojtimet në terren, ky shkrim synon të japë një përshkrim më të plotë të arkitekturës së fortifikimit të Durrësit, të bëjë të njohura kala të reja, duke diferencuar njëkohësisht fortifikimet e periudhës së vonë antike nga ato mesjetare, dhe të nxjerrë në pah synimet që kanë udhëhequr ndërtuesit për krijimin e një sistemi mbrojtës përreth Durrësit.

KALAJA E DURRËSIT

Studimi i parë qi u kushton vëmendje të veçantë fortifikimeve të qytetit të Durrësit, është ai i Hezei-Domesë[10]). Shumë gjurmë të këtyre ndërtimeve, tani të zhdukura, nuk mund të ndiqen pa përshkrimet dhe planimetritë e dhëna prej tyre. L. Rey[11]), më vonë, e plotësoi këtë studim në drejtim të një vrojtimi më të hollësishëm të mureve mbrojtës që ruheshin akoma në kohën e tij, dhe, së fundi, nëpërmjet interpretimit të monogrameve. K. Zheku vërtetoi mendimin e shprehur edhe më parë që muret egzistuese të Durrësit, të ndërtuar me tulla i përkasin periudhës së Perandorit bizantin me origjinë Durrësake, Anastas I (491-518). Studjuesit e tjerë janë marrë vetëm pjesërisht me problemin e fortifikimeve[12]).

Duke pasur parasysh rëndësinë që paraqet studimi i këtyre ndërtimeve për historinë e qytetit dhe arkitekturën ushtarake në përgjithësi, menduam t'i trajtojmë më gjerë dhe më me hollësi traktet që ruhen akoma prej tyre.

GJENDJA E KALASË SË VONË ANTIKE TË DURRËSIT NË VITIN 1861 DHE DEGRADIMI I SAJ NË KOHË

Në kohën e Hezeit ruheshin akoma gjurmët e «kalasë së madhe bizantine», siç e quan ai. Ajo formonte një lloj trapezi ose katërkëndëshi të çrregullt. (fig. 1). Faqja veriperëndimore niste nga «lartësia 98» dhe përfundonte tek pjerrësia e fundit e kodrës «Stani», me një gjatësi të përgjithshme prej 700 m. Hezej shkruan se kjo është një nga pjesët më të forta të rrethimit dhe ruan ende mbeturina të rëndësishme muresh dhe kullash prej tulle. Prej këtej muri shkonte përqark pjerrësisë së kodrës «Stani» dhe zbriste në fushë, duke u drejtuar përmes kullotave të kënetës, drejt bregut të detit. Kjo linjë përbënte faqen veriore me gjatësi 700 m, që, siç shprehet Hezej, «ishte patjetër pjesa më e dobët dhe më e arritshme e fortifikimeve». Në atë kohë ajo paraqiste themele në nivel të tokës, por gjurmët e ruajtura e lejuan studjuesin, të dallonte vendosjen e disa kullave katërkëndëshe dhe të një qosheje të dalur që mbronte njërën nga portat kryesore.

Faqja e tretë juglindore, që vazhdon në drejtimin e detit, ndiqte lakoren e lehtë të bregut dhe nuk linte jashtë veçse një rrip të ngushtë rëre, hyrja e të cilit qe mbyllur nga mure të tërthorta. Gjurmët e kësaj ane të rrethimit ruheshin në nivelin e themeleve dhe ishte e vështirë të ndiqeshin. Ky mur deri te «bastioni i madh», i ndërtuar në buzë të detit, arrinte një gjatësi prej 800 m., ndërsa muri i fundit jugperëndimor kishte një gjatësi të përgjithshme prej jo më pak se 1100 m.

Në përshkrimin e tij Hezej bën fjalë për tri rrethime të Durrësit. Por në të nuk del e qartë ç'kuptonte ai me rrethim të parë, territorin e përfshirë nga kalaja e sotme, apo akropolin e vjetër që shtrihej rreth lartësisë «98» dhe që rrethonte një sipërfaqe trekëndëshe të mbrojtur mirë nga natyra, të ndarë prej pjesës tjetër të qytetit nga një hendek shumë i gjerë.

Me rrethim të dytë Hezej kuptonte muret rrethuese që u përshkruan më sipër. Veç këtyre, në veri të këtij rrethimi Hezej pati dalluar një mur tjetër pa shënja kullash, gjurmët e të cilit humbisnin në drejtim të kodrave perëndimore. Këtë mur ai e quan rrethim të tretë.

Në kohën e vizitës së Prashnikerit, në periudhën e Luftës së Parë Botërore, nga muri që shkonte prej lartësisë «98», në drejtim të lindjes, deri në citadelën e sotme, nuk kishte mbetur asnjë gjurmë. Muri verior që kalonte prapa lartësisë «98» deri në fshatin Stani, dallohej akoma qartë, ndonëse rrafsh me tokën, ndërsa muri i pjesës veriore dhe lindore, të cilin Hezej e kishte parë me të gjitha hollësitë, ishte zhdukur ndërmjet shtëpive të «Exo-Bazarit», vetëm bastioni i madh i qoshes, pranë detit, ishte në këmbë[13]). (fig. 2). Ky i fundit u rrëzua në prag të vizitës së L. Reit. Në kohën e këtij të fundit ruheshin akoma pjesërisht muret nga veriu dhe vetëm pak gjurmë nga muri verilindor dhe juglindor (fig 3). Kulla «E», u gjet e rrënuar, ndërsa kthesa e murit në veri të kullës «F» e ruajtur akoma në kohën e L. Reit, nuk egziston më.

8) Shih për këtë D. Komata, **Petrela – një parafortesë e Krujës në luftërat e Skënderbeut,** Konf. II e studimeve Albanologjike, Tiranë 1969, 307-309.
9) L. Bajo, **vep. cit.,** 311-314.
10) L. Heuzey – H. Daumet, **vep. cit.,** 349-392.
11) L. Rey, – **vep. cit.,** 33-48.
12) Shih shënimin 2.
13) C. Praschniker – A. Schober, **Vep. cit.,** 32.

FOTOKOPI

DO NOT COPY



Fig. 1

Sot nga muret e vona antike të Durrësit ruhet një trakt me katër kulla, në anën jugperëndimore, një trakt i shkëputur nga muri juglindor, paralel me bregun e detit, dhe fare pak gjurmë në rrafsh me tokën, prej murit që kthente nga veriperëndimi dhe atij në drejtim të veriut. (fig. 3).

PËRSHKRIMI I FORTIFIKIMIT NË GJENDJEN E SOTME

Muri jugëperëndimor, për aq sa ruhet sot, i përket rrethimit të dytë, në qoftë se do të mbajmë për rrethim të parë ndarjen e akropolit që shtrihej rreth lartësisë «98». Ai ka një gjatësi të ruajtur 490 m. Në përgjithësi muri ruhet deri në nivelin e shtegut të kalimit që ndodhet mesatarisht 9 m. nga tabani, ndërsa trashësia e tij është 3.5 m. Mendojmë se para murit ka pasur një hendek. Përveç faktit se kalatë e kësaj periudhe pajiseshin me ndërtime të tilla mbrojtëse, në këtë supozim na shtyn dhe fakti që niveli i terrenit para murit të kalasë paraqitet pak më i ulët.

Muri është ndërtuar krejtësisht prej tullash të lidhura me shtresa të trasha llaçi. Ato kanë përmasa rreth 30 x 36 x 4.5-5 cm., ndërsa në qemeret 30 x 40 x 5. Trashësia e fugës horizontale, më e madhe se e tullave, arrin në 6-8 cm. Llaçi ka si mbushës zhavor të imtë dhe copëra tullash me granula deri në 3-4 cm, të vendosura rrallë.

Themelet janë ndërtuar me gurë. Në vendet e pjerrëta ato ndjekin terrenin në formë të shkallëzuar dhe janë 15 cm më të gjera se sa muri (Fig. 5).

Pjesa e sipërme e konstruksioneve të vjetra të murit është mjaft e rrënuar. Mbi të ruhen kryesisht vetëm bedena me frengji që i përkasin periudhës mesjetare. Por disa gjurmë të ruajtura mbi murin në jug të kullës «D» dhe midis kullave «D» dhe «E» (fig. 3) tregojnë



Fig. 2

se muri i bedenave të kohës në shqyrtim kishte trashësinë e një tulle, 35 cm., dhe përforcohej nga mbrenda prej një sërë pilastrash të vendosura 1.90 m larg njëra tjetrës, me seksion 35 x 30 cm.

Muri juglindor ruhet në pak gjurmë. Një trakt 24 m i gjatë dhe 2,5 m i lartë ndodhet 80 m në lindje të kullës «A», i futur në murin e pasëm të «Shtëpisë së Pionierit» (fig. 3, a). Muri mund të ndiqet më tej në formë gjurmësh të izoluara të rrafshuara me tokën, prapa Bankës së Shtetit (b), ku ai kthen në drejtim të veriperëndimit. Pas shkollës 8 Vjeçare «16 Tetori» takohen sërishmi gjurmët e fundit të këtij muri (ç), të cilat dëshmojnë për një kthesë tjetër në drejtim të veriut. Këto gjurmë janë hedhur në pjesën më të madhe edhe në skicën planimetrike të L. Reit[14]). Traktet e mësipërm janë ndërtuar me të njëjtën teknikë me murin jugë-perëndimor. Përjashtim bën vetëm trakti pranë Shtëpisë së Pionierit, ku dallohen substruksione me një teknikë pak më të ndryshme (fig. 4). Këto substruksjone që ndodhen në skajin perëndimor të këtij trakti, përbëhen nga një fragment qemeri porte dhe një pjesë muri mbi të që vazhdon dhe në drejtim të lindjes. Trashësia e fugës horizontale, ndryshe nga ndërtimet e tjera, është më e ngushtë se ajo e tullës (trashësija e fugës 3 cm, e tullave 5 cm.). Po kështu ndryshon dhe përbërja e llaçit, ai nuk është i përzier me copëra tullash por vetëm me zhavor, me një përdorim në sasi më të madhe të gëlqeres. Në krahun e majtë të qemerit ruhen gjurmët e disa shkallëve, që të ngjisnin në mur, ose në katin e sipërm të ndonjë kulle. Shkallët me gjerësi 1 m janë mbështetur në anën e mbrendshme të murit të kurtinës. Nën murin e shkallëve dallohen gjurmët e një qemeri me lartësi harku 0,30 m. Teknika e ndërtimit të shkallëve është e njëllojtë me atë të mureve të tjera të kësaj periudhe. Është e vështirë të përcaktohet nëse këtu ka pasur një portë, apo këto konstruksione i përkisnin një kulle. Është për tu vënë re vetëm fakti që në kullat e tjera shkallët drejtohen nga porta e kullës për në mur, ndërsa këtu ndodh e kundërta.



Fig. 3

14) L. Rey, **Vep. Cit,** 34.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 4

Një gjurmë tjetër muri 4 m e gjatë u zbulua gjatë hapjes së themeleve të një banese rreth 100 m në jug të Muzeut të Luftës Nacionalçlirimtare. Ashtu si dhe muret e tjera të përshkruara më sipër, ai ishte ndërtuar krejtësisht me tulla të lidhura me shtresa të trasha llaçi. Ky trakt i përket «rrethimit të dytë» të përshkruar nga Hezej[15]).

KULLAT

Nga periudha e vonë antike ruhen katër kulla në murin jugperëndimor («B» «C» «D» «E») prej tyre tri ndodhen në gjendje të mirë, ndërsa kulla e katërt e rrënuar.

Kullat janë vendosur në largësi 61 – 64 m në terren të sheshtë, ndërsa në terrenet e pjerrët distanca midis tyre zmadhohet. Kështu gjatë murit në veri të kullës «E», i cili ka një gjatësi prej 177 m, nuk ndodhet asnjë kullë. Të gjitha kullat kanë forma pesëkëndëshe me dy brinjët perpendikulare me kurtinat.

Kulla «B» (Fig. 6, Tab II.) me trashësi muresh 3 m, ruhet në lartësinë 14 m. Dy muret që takojnë kurtinat janë veriori 4.30 m. dhe jugori 4.90 m, ndërsa muret që bashkohen me kënd të mprehtë, kanë një gjatësi prej



Fig. 5



15) L. Hezej – H. Daumet, **Vep. Cit.**, 14.

10,9 m. Nga gjurmët e ruajtura kuptojmë që kati II ndahej prej të parit me dysheme druri. Trarët e dyshemesë, siç kuptohet nga foletë e tyre vendoseshin perpendikular me murin e rrethimit në një largësi 0.60 m nga njeri tjetri. Vetë foletë kanë seksion 0.32 x 0.22 m, gjë që na shtyn të mendojmë se trarët vendoseshin të puthitur në çift (0.16 x 0,22 m). Foletë gjenden në nivelin e poshtëm të frengjive të katit të dytë, mbi një dhëmbëzim të dy faqeve ballore të kullës, i cili ka një gjerësi 0,40 m në vendin e bashkimit dhe arrin gradualisht në zero, në skajet e bashkimit të këtyre mureve me muret perpendikulare me kurtinat. Kjo kullë ka qenë përshtatur në banesë prej kohësh, kështu që mund të vrojtohet mirë vetëm ambienti i katit të dytë, që zinte gjithë sipërfaqen e kullës i pajisur me 7 frengji. Duke filluar nga niveli i dyshemesë të këtij kati, kulmi i kullës pritet tërthor për të krijuar mundësinë e hapjes së frengjisë ballore, e cila shërbente për të kontrolluar pjesën përpara kullës që nuk vrojtohej nga frengjitë e tjera. Frengjitë e kësaj kulle ashtu si dhe të kullave të tjera (fig. 7, 8) kanë lartësi 2,15 m dhe gjerësi 1,55 m. Ato janë mbuluar me qemerë cilindrikë me trashësi 0,40 m të përbërë nga një rresht tullash me përmasa 40 x 30 x 5,5 cm. Frengjitë janë mbyllur në ballë me një mur 48 cm të trashë, duke lënë në mes një hapësirë drite 0,64 m. Ajo fillon 0,60 m mbi tabanin e frengjisë dhe vazhdon deri në nivelin e poshtëm të harkut.

Të gjitha frengjitë e kulmeve nëpër kulla janë mbyllur më vonë, në periudhën mesjetare, me mur, ndërsa frengjitë anësore kanë vazhduar të përdoren në gjendjen fillestare. Mbi nivelin e thembrave të harkut të frengjive, nga ana e mbrapme e kullës, dallohen thembrat e një harku me gjerësi 0,65 m, që u përket konstruksioneve të vjetra. Nga ana tjetër, të dy muret anësore të kullës, ruajnë gjurmët e qemerit që mbulonte hapësirën midis tyre (fig. 22). Thembra e këtij qemeri fillon në lartësi 1,25 m. Duke marë parasysh se qemeri ka pasur formë cilindrike me diametër 9,80 m, kyçi i tij do të qe 6,15 m. mbi nivelin e dyshemesë së katit të dytë dhe 4 m mbi nivelin e frengjive të këtii kati, duke paraqitur vend të miaftë dhe për një kat të tretë.

Kulla; «C» (tab. II, fig. 9) ruhet më keq nga kullat «B» dhe «D». Në mesjetë gjysma jugore e kësaj kulle ka qenë rrënuar deri në nivelin e tokës, për këtë arsye kjo pjesë u plotësua. Ky rindërtim prishi simetrinë e kullës, pasi muri mesjetar nuk u mbështet mbi pjesën e vjetër, por u spostua nga ana e brendshme e saj. Nga ana e mbrapme e kullës, në veri të hyrjes së saj, da-



Fig. 7

DO NOT COPY

DO NOT COPY

llohen gjurmët e një palë shkallëve të periudhës së vonë antike, të cilat dalin 1,30 m jashtë murit të kurtinës.

Duke qenë më pak e ruajtur se kullat e tjera, kulla «C» nuk na jep ndonjë element të rëndësishëm arkitektonik, që do të na shërbente për të bërë rikonstruksionin e kullave në përgjithësi.

Kulla «D» (tab. II, fig. 10) është një nga kullat më të ruajtura. Deri në nivelin e sipërm të dritareve ajo ka një lartësi prej 13 m. Nga forma planimetrike dhe elementet arkitektonike ajo nuk ndryshon prej kullave të tjera. Muret anësore kanë një trashësi prej rreth 3 m, ndërsa muri i mbrapëm 2,10 m. Në gjendjen ekzistuese dallojmë dy kate. Në katin e poshtëm, që shërbente si depo, hyhet nëpërmjet një porte të hapur nga ana e mbrapme, me gjerësi 1,50 m. dhe lartësi 3,40 m, të mbuluar me qemer tullash me lartësi 0.70 m (fig. 11). Në këtë kat krijohej një ambient 5 këndësh, pa ndriçim, me përmasa 9,78 x 6,95 m dhe lartësi 9,80 m. Mbi këtë nivel vendosej dyshemeja e katit të dytë. Për të kursyer materialin, faqja e pasme e ambientit të poshtëm nuk përbëhet nga një mur i plotë. Për këtë qëllim është ndërtuar një hark i madh me bazë 6.80 m, i mbështetur në dy pilastra masive (1,50 x 1,50 m) (fig. 12) që dalin nga qoshet e kullës. Kyçi i harkut arrin në nivelin e dyshemesë së katit të dytë. Muri që mbyll hapësirën e harkut, ndryshe nga muret e tiera, nuk është ndërtuar krejtësisht me tulla, por me teknikën «opus mixtum»[16]).

Qenia e shkallëve për ngjitje në shtegun e kalimit mbi mur, giithnjë në afërsi të kullave, tregon se kati II i tyre komunikonte nëpërmjet një porte me shteaun. Në kullën «D» shkallët janë vendosur në të maitë të hvries. Ato kanë një gjerësi 1,20 m dhe futen brenda trashësisë së murit.

Një pjesë e murit të vietër nga ana iugore i cili ruhet në një lartësi prei 0.40 m mbi nivelin e katit të dytë, si dhe gjurma e një frengjie mbi frenajinë e këtij kati, dëshmojnë për praninë e katit të tretë.

Gjatë një sondazhi të bërë në këtë kullë, doli themeli i ndërtuar me muraturë guri, ashtu si dhe në kurtinat.

Në faqen veriore të kësaj kulle L. Rey pat dalluar një kryq katin të mbuluar me hark, punuar në relief me tulla[17]). Përveç kryqit të përmendur në faqen veriperëndimore të kullës, midis frenajive, ndodhen dy kryqe të tiera identike me të parin. Kryqe të formave të ngjashme janë stampuar dhe në tullat e murit rrethues[18]). Në faqen jugperëndimore të kësaj kulle, midis dy har-



Fig. 8



Fig. 9

16) Duke filluar nga kyçi i harkut, kemi raportin e mëposhtëm midis muraturës me tulla dhe me gurë: mur guri me lartësi 0,90 m, 9 rreshta tulla; mur guri me lartësi 1,10 m, 6 rreshta tulla, mur guri me lartësi 0,95 m dhe pjesa që mbetet krejtësisht me tulla. Nën çdo brez tullash vërehet një shtresë e trashë llaçi që shërbente për nivelimin e murit.

17) L. Rey – **Vep. cit.** 39.

18) K. Zheku **Vep. cit.** 39.



Fig. 10

qeve të frengjive gjendet një dekoracion që paraqet në mënyrë skematike një degë ulliri[19]).

Kulla «E» (fig. 14) ndodhet 68 m larg kullës «D». Prej saj ruhet një pjesë e murit të prapëm dhe e mureve anësore që lidhen me kurtinën. Në këtë dallohet një element që nuk ruhet në kullat e tjera. Muri i prapëm del në formë dhëmbëzimi 0,40 m nga kurtina dhe, me sa duket, shërbente për të zgjeruar shtegun e kalimit në nivelin e hyrjes së katit të dytë.

Tani, pas një analize më të hollësishme të konstruksioneve të mbetura nga ndërtimet e Anastasit I, jemi në gjendje të bëjmë rikonstruksionin e një kulle të kësaj periudhe (fig. 13). Kullat kishin një lartësi prej rreth 18 m dhe ndaheshin në tri kate. Kati I me lartësi më se dy herë më të madhe nga të tjerët, shërbente si depo, ai ishte i verbër kundrejt ambientit të jashtëm dhe komunikonte me territorin brenda kalasë nëpërmjet një hyrjeje të hapur në murin fundor. Kati II, i përbërë nga një ambient i vetëm i pajisur me frengji, ndahej nga i pari me dysheme druri, në të njëjtën mënyrë ndahej edhe kati III. Ky i fundit mbulohej nga një qemer cilindrik dhe një trung konik, mbi të cilët mbështetej platforma e kullës e rrethuar me bedenë. Kati II komunikonte direkt me murin nëpërmjet një hyrje nga ana e prapme, ndërsa lidhja e brendshme midis kateve dhe platformës realizohej me shkallë druri.

HYRJET

Në murin jugperëndimor ndodhen dy hyrje, njëra midis kullave «A» dhe «B», ndërsa tjetra midis kullave «D» dhe «E» (fig. 15). Që të dyja hyrjet janë vendosur pothuajse në mesin e kurtinave, midis kullave përkatëse. Hyrjen «1», që ndodhet 26,40 m në veri të kullës «A», L. Rey nuk e pat vënë re. Ai flet për një hyrje që duhet të ekzistonte në të çarën e murit pranë kullës «C», 1 a (Fig. 10), por këtu nuk dallohet asnjë gjurmë pature ose qemeri. Gjithashtu ekzistenca e hyrjes «1» bën të panevojshme një hyrje tjetër kaq afër. Në këtë rast kemi të bëjmë me një çarje të mëvonshme të kurtinës për të plotësuar nevojat e qytetit të ri.

Hyrja 1 ka gjerësi 2,80 m. Nga ana e jashtme në periudhën e mesjetës ajo ajo është mbyllur nga një mur, por nga ana e brendshme e kurtinës dallohen mirë konstruksionet e vjetra të saj. Mbi nivelin e terrenit të brendshëm, më të lartë se i jashtmi, dallohet pjesa e sipërme e harkut me tulla, që ka një lartësi 0,75 m. Trashësia e llaçit midis tullave është 7 cm në pjesën e sipërme të harkut dhe 4 cm në pjesën e poshtme, ndërsa vetë tullat kanë një trashësi prej 5 cm.

Hyrja 2 (fig. 15) që pret kurtinën me një kënd rreth 60°, ka një gjerësi prej 3,70 m. Përmasat më të mëdha se ato të hyrjes 1, tregojnë se kjo ka qenë hyrja kryesore në këtë anë të fortifikimit. Hyrja është mbuluar me një qemer tullash me trashësi 0,95 m, tullat e të cilit janë vendosur në mënyrë të tillë që të alternojnë fugat e tyre. Muri i portës del në anën e brendshme të kurtinës, duke krijuar në të dy anët një dhëmbëzim prej 0,18 m. Niveli i terrenit në këtë vend është ngritur mjaft që nga koha e ndërtimit, kështu që në gjendjen e sotme ajo ka një lartësi prej vetëm 3 m.

L. Rei harkun e shkarkimit të murit të pasëm të kullës «F», e cila ka qenë rrënuar që në kohën e vizitës së tij, e merr për një hyrje të kalasë. Por gjurmët e mureve anësorë të kullës si dhe prania e këtij konstruksioni në tërë kullat e tjera dëshmojnë se në këtë vënd ka patur një kullë.

19) Një shenjë e tillë është stampuar dhe në një tullë të traktit të shek. VI në kalanë e Kaninë (A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Kaninës**, Monumentet 7-8, 36).

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12

FORTIFIKIMET RRETH DURRËSIT[20])

Muri i Portës. Rreth 7 km në veri të qytetit të Durrësit, në vendin e quajtur «Porto romano», ruhen ende sot mbetjet e një muri që mbyllte dikur rripin e ngushtë të tokës, ndërmjet detit dhe kënetës, Hezei i përmënd shkurt këto ndërtime, duke vënë në dukje se muret mbyllin istmin që kishte një gjatësi jo më tepër se 200 m. dhe se sistemi i tyre me breza tullash paraqiste një ngjashmëri të madhe me pjesët më të rregullta dhe më të vjetra të rrethojës së madhe të Durrësit. Një përshkrim pak më të plotë të këtyre mureve e kemi nga Prashnikeri dhe Shoberi[21]). Sipas tyre muri verior që mbyllte ngushticën, ishte i pajisur me kulla këndrejtë të vendosura në largësi të barabarta, ndërsa prej këndit perëndimor të tij një mur tjetër ndiqte konturin e kodrës nga ana e detit deri në lartësinë 80 m[22]). Sipas tyre «këto gërmadha i përkisnin sistemit të fortifikimit të perandorit Anastas I dhe qenë pikërisht pjesa e jashtme e rrethimit me tri rradhë muresh». Që nga koha e vizitës së Prashnikerit gjendja e këtyre fortifikimeve ka ndryshuar mjaft. Në ngushticën që ndan detin prej kënetës ruhet vetëm një trakt rreth 60 m i gjatë dhe një kullë katërkëndëshe (tab. III). Harku i portës, që përshkon murin, është rrëzuar, ndërsa muri që i ngjitej kodrës deri në lartësinë 80 është zhdukur thuajse krejtësisht. Prej tij ruhen disa gjurmë të vogla që dëshmojnë se edhe në këtë anë ka patur një mur mbrojtës. Në vitin 1970 në murin e «portës» u kryen disa punime që konsistonin në konsolidimin e murit dhe në një vlerësim më të mirë arkitektonik të tij[23]). Në saje të tyre u bë i mundshëm studimi më i plotë i teknikës së ndërtimit dhe i elementeve arkitektonike që ruheshin akoma në këto mure.

Muri që mbyllte ngushticën ndërmjet detit dhe kënetës është ndërtuar me teknikën «Opus mixtum». Ai ka një gjerësi prej 1,75 m. që përshkohet tejpërtej nga breza tullash prej katër rreshtash (Fig. 16). Brezat kanë lartësi 35 cm dhe janë të vendosur larg njeri tjetrit 60 — 70 cm. Tullat me përmasa rreth 37 x 29 x 5 cm

20) Prej këtyre fortifikimeve kështjellat e Lalmit, Petrelës, Vilës dhe Dajtit janë parë prej të dy autorëve, e Ndroqit, Dorzit, Shëngjinit, Tujanit dhe Laçit prej A. Baçes e Daulës dhe kalaja e Portës prej Gj. Karaiskaj.
21) C. Praschniker — A. Schober — **Vep. cit.** 32-46.
22) **Po aty,** 46.
23) Punimet e konsolidimit dhe pastrimit u drejtuan prej Gj. Karaiskajt.

DO NOT COPY



Fig. 13



Fig. 14

janë vendosur në brez në formë të alternuar, duke treguar në anën e jashtme të brezit, sipas radhës, gjerësinë ose gjatësinë e tyre. Në mjaft prej tullave të gjetura gjatë pastrimit, vihen re shenja me gishta, ndërsa tek të tjerat shkronja Φ e stampuar në relief; vlen të theksojmë se në këto tulla nuk u gjet asnjë nga monogramet e zbuluara në kalanë e Durrësit. Trashësia e fugës së llaçit midis tullave është 5-7 cm.; po kështu në rreshtin e fundit të brezit me tulla është vendosur një shtresë llaçi 5 cm e trashë. Llaçi ka ngjyrë të bardhë dhe është përzier me zhavor të trashë. Gjatë brezave me tulla hetohen disa vrima me seksion katërkëndësh 9 x 18 cm. që përshkojnë gjithë trashësinë e murit. Vrimat e një brezi nuk përkojnë me ato të brezit tjetër për të qenë gjurmë të skelerisë, prandaj destinacioni më i mundëshëm i tyre është kullimi i ujërave nga pjesa e brendëshme e kalasë, ku terreni është më i ngritur. Brezat me tulla ndërpriten në largësi të caktuara. Brezi pasues vendoset nën të parin, duke pasur të përbashkët me të një rresht tullash, ose vendoset rreth 7 cm larg tij. Për të dy rastet dy rreshtat e jashtëm të brezave që takohen zgjaten më tepër, duke e kaluar pak pikën e takimit (tab. III).

Muratura e gurtë midis brezave në faqet e mureve përbëhet nga gurë kave me përmasa mesatare, të vendosur në mënyrë të çrregullt, ndërsa brendësia e murit nga gurë të thyer më të vegjël, të lidhur me llaç të bollshëm. Nga ana e jashtëme fugat e brezave me tulla ashtu dhe ato midis gurëve, janë rrafshuar me kujdes për të krijuar një sipërfaqe të rrafshtë të murit, duke lënë të dukshme vetëm pjesët qendrore të gurëve. Kjo teknikë nuk ruhet më tek muri që ka qenë i ekspozuar për një kohë të gjatë ndaj faktorëve atmosferikë, por tek faqet e jashtme të kullës së porsa zbuluar (fig. 17, 18).

Gjatë një sondazhi në thellësinë 2,20 m doli themeli, i cili ka të njëjtën trashësi me murin. Nga ana tjetër sondazhi vërtetoi se fortifikimi i përket vetëm një faze ndërtimi (Tab. III).

E vetmja kullë me një lartësi të ruajtur prej 4 m ka formë katërkëndëshe (fig. 17, tab. III). Ajo del nga kurtina 5,95 m. dhe ka një gjerësi prej 6,15 m. Muret e saj të ndërtuara me të njëjtën teknikë si edhe kurtina kanë një trashësi prej 1,25 m, më të vogël se trashësia e kurtinës. Qoshet e kullës dhe vendet e bashkimit me kurtinën janë ndërtuar krejtësisht me tulla, ndërsa pjesa tjetër e mureve me muraturë të përzierë (opus mixtum). Kati I i saj nuk komunikon me ambientin e jashtëm, ndërsa në katin e dytë të çonte një hyrje që hapej nga ana e prapme e kullës mbi shtegun e kalimit. Hyrja ka një gjerësi prej 1.70 m dhe është e mbuluar me një qemer të përbërë nga tri harqe koncentrike 0,30 m. të larta, prej tullash me format 30 x 36 x 5 cm. Harku i sipërm del pak përpara, duke krijuar një dhëmbëzim, ndërsa dy të tjerat janë të vendosura në të njëjtin rrafsh (Tab. III).

Në shtegun e kalimit të çojnë dy palë shkallë të mbështetura në faqen e pasme të kullës. Shkallët dalin jashtë kurtinës dhe kanë një gjerësi prej 1 m. Këmbët e shkallës të veshura me tulla janë 0,30 m, të larta dhe 0,26 m, të gjera (Fig. 19).

Hyrja e kështjellës, «Porta», prej së cilës ka marrë emrin krejt fortifikimi, ndodhet në perëndim të kullës. Deri kohët e fundit aty kalonte rruga që lidhte Durrësin

DO NOT COPY

me zonat bregdetare në veri të tij, gjurmët e së cilës dallohen mjaft qartë edhe sot. Portës i mungon qemeri, por prej saj ruhen të dy paturat, që lejojnë të masish gjerësinë prej 3,80 m. Nga brenda portës në të dy anët e saj dallohen gjurmët e dy mureve që i mbështeten kurtinës, të ngjashme me muret e shkallëve të kullës së përshkruar më sipër. Duket se ata i përkisnin dy palë shkallëve që të ngjisnin në shtegun e kalimit mbi mur, mbi harkun e portës. Ato shërbenin për ngjitje në shteg, por duke i dhënë prioritet hyrjes.

Muri perëndimor, i cili i ngjitej kodrës deri në lartësinë 80, siç thamë edhe më parë, është zhdukur pothuajse krejtësisht. Nga disa gjurmë të pakta mund të kuptohet se në kuotën më të lartë të kodrës gjendej një farë akropoli me sipërfaqe trekëndëshe. Në murin e tij lindor ruhen gjurmët e hyrjes dhe prej këtej muri vazhdonte akoma në drejtim të jugut. Kjo mund të vërtetohet nga disa mbeturina muresh të rëna nga kodra në bregun e detit, ndërsa një pjesë ka mbetur në gjysmën e lartësisë së kodrës. Në brendësi të këtyre mureve janë futur në mënyrë të çrregullt fragmente tullash me përmasa 33 x 4 cm, 25 x 4 cm etj. që, siç duket, janë marrë nga ndërtime të vjetra.[24])

Akoma më në jugë të lartësisë 80 ndodhet një qafë e ulët shumë e përshtatshme për kalim, ku për çudi aty nuk konstatohen gjurmë muri, por ka mjaft mundësi që ato të jenë zhdukur.

Kalaja e Ndroqit[25]) ndodhet mbi një kodër me lartësi 387 m (fig. 20) që ngrihet mbi luginën e Erzenit rreth 16 km në juglindje të qytetit të Durrësit. Kodra bie me shpate të pjerrëta dhe përfundon në pjesën e sipërme me një platformë me 300 m gjatësi dhe 150 m gjerësi, në të cilën gjendet një kala mesjetare. Nën muret mesjetare, në anën verilindore ruhen gjurmë muresh të periudhës së vonë antike. Muret janë 1,80 m, të gjera, dhe janë ndërtuar me gurë të madhësisë mesatare, të vendosur deri diku në rreshta horizontalë, të cilët lidhen me llaç gëlqereje të përzier me pluhur të imët tullash, teknikë karakteristike për periudhën e vonë antike (fig. 21). Ky datim mbështetet edhe nga fragmentet e qeramikës të gjetur në sipërfaqen e kalasë.

Kalaja e Lalmit ose e **Bixhit**[26]) ndodhet në një kodër piramidale rreth 100 m. të lartë, 2 km në perëndim të Kombinatit të Tekstileve «Stalin». Pjesa e ngjitshme më lehtë është nga lindja, ku gjarpëron edhe rruga që të çon në majë. Kodra dominon në një bërryl të krijuar



Fig. 15

nga lumi i Erzenit, kështu që prej saj mund të kontrollohen të dy drejtimet e rrugës që vijnë nga Petrela nëpërmjet luginës së Erzenit dhe nga fusha e Tiranës. Më tej të dy rrugët të bashkuara në një të vetme, vazhdojnë po gjatë luginës së Erzenit për në Ndroq dhe Durrës.

Sipërfaqja e krijuar mbi majën e kodrës ka formën e një elipsi me gjatësi 100 m dhe gjerësi 50 m, me orientim veri-jug. Ky territor rrethohej nga një mur, prej të cilit kanë mbetur vetëm disa trakte të shkëputura në anën lindore me një gjatësi të përgjithshme prej 25 m si dhe një gjurmë muri në anën perëndimore të kodrës. Gjurmët e një kulle katërkëndëshe hetohen gjithashtu në anën lindore, prej së cilës ruhet vetëm një trakt i faqes ballore që del 3,7 m nga kurtina.

24) Ekzistencën e një vendbanimi më të vjetër në këtë zonë e vërteton edhe gjetja sporadike e tjegullave helenistike brenda territorit të kalasë. Gjithashtu rreth 70 m, në veri të murit mbrojtës, në një prerje të tokës, në thellësi 1,5 m., dallohet qartë një shtresë kulturale helenistike me fragmente enësh dhe tjegullash. Po kështu nga ana perëndimore, brenda në det janë gjetur tjegulla helenistike; kaliptere me kurriz të mprehtë me gjatësi 74 cm., gjerësi 15 dhe 17 cm, dhe lartësi 8 cm.
25) Gj. Frashëri **«Kalaja e Ndroqit»**. Monumentet 4, 185.
26) A. Baçe – Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Lalmit,** Bashkimi, 5-XII-1970.

DO NOT COPY



Fig. 16

Kurtina ka një trashësi prej 1,5 m, të njëjtë me themelin e ndërtuar pa shkallëzime. Muret janë ndërtuar me gurë gëlqerorë kave, të lidhur me llaç të fortë të përzier me guralecë të vegjël, ndërsa brendësia e murit përbëhet nga gurë të thyer, të zhytur pa kriter në llaç të bollshëm. Faqet anësore janë ndërtuar me gurë mesatarë dhe të vegjël të vendosur në rreshta. Në çdo dy rreshta gurësh nivelimi është bërë me kujdes, nëpërmjet përdorimit të gurëve më të hollë. Fugat e llaçit janë të trasha, 3 cm e më tepër dhe i rrethojnë gurët nga të gjitha anët. Në mure janë futur në mënyrë të çrregullt edhe copëra tullash si material i ripërdorur, i marrë nga një vëndbanim ekzistues.

Shtresa kulturore, e cila lidhet me murin përbëhet prej qeramike ndërtimi, tjegullash dhe tullash të periudhës së vonë antike. Në territorin e kalasë mundëm të gjejmë gjithashtu edhe fragmente enësh, megjithëse në numër më të pakët. Ndër tjegullat hetohen vizatime të bëra me dy ose tre gishta në trajtë vizash të përkulura dhe sinusoidale.

Një gjetje tjetër me rëndësi që vërteton se kodra ka filluar të banohet së paku qysh nga shekujt e parë të erës së re, është një mbishkrim varri që i dedikohet një skllaveje të liruar[28]).

Nga materialet arkeologjike dhe gjurmët e fortifikimeve të konstatuara në këtë kodër, mund të përfun-

28) Mbishkrimi është gdhendur mbi një gur gëlqeror me përmasa 55,8 x 34,8 cm, të qarkuar nga një kornizë dyfishe. Në pjesën e përparme guri është punuar me kujdes, ndërsa nga prapa dhe anët është lënë i papunuar, me sa duket ai ishte i destinuar të inkastrohej në murin që i përkiste konstruksionit të varrit. Mbishkrimi ka gjithsejt tetë rreshta, të punuar me kujdes nga një dorë e stërvitur. Lartësia e tyre është 4 cm, ndërsa largësija midis rreshtave 1 – 1,5 cm.

D. M. S.
F O R T V N
A T E : F I R M I
L I B : Q. V. A.

L X I. P. G A V
I N I A . C V P I
T A. N V T R I C
B. M.

Sipas H. Cekës transkriptimi i tij është:
D (iis) M (anibus) S (acrum)
Fortunat(a) e Firmi lib (ertae) q (uae) v (ixit) a (nnos)
LXI. P. Gavinia Cupita nutric(ae)
B(ene) M(erentae)

DO NOT COPY

dojmë se kemi të bëjmë me një vendbanim të krijuar në fillim të erës sonë. Jetën më intensive ai e pati gjatë të kohës së vonë antike, gjë që vërtetohet nga mbizotërimi i materialit arkeologjik të kësaj periudhe. Në këtë kohë u ndërtuan edhe muret mbrojtëse. Fugat e trasha të llaçit, si dhe materialet e ripërdorura në mure, na shtyjnë ta datojmë këtë fortifikim në shekullin VI.

Kalaja e Dorzit[29]) kurorëzon kodrën shkëmbore të Dorëzit 479 m. të lartë nga niveli i detit (fig. 23). Kodra qarkohet në jugë dhe veri prej përrenjve të Fiollit dhe Trezës, luginat e të cilëve paraqesin dhe rrugët më të përshtatshme të komunikimit me luginën e Pezës. Ndërtuesit e fortifikimit që i kanë shfrytëzuar mjaft mirë veçoritë mbrojtëse të terrenit, kanë qarkuar me mur vetëm anën lindore dhe jugore, duke ia lënë anët veriore dhe perëndimore mbrojtjes natyrore. Në këtë mënyrë rrethohet një sipërfaqe rreth 100 x 60 m.

Kodra në anën veriore, është më e lartë, nga perëndimi rrëzohet përreth 100 m mbi luginën e Trezës, ndërsa në drejtim të jugut zbret me pjerrësi rreth 40°. Vetëm në anën lindore ajo bashkohet me një qafë të ulët me kodrën fqinje.

Në muret rrethuese të kështjellës vihen re 4 faza, prej të cilave faza e parë i përket periudhës I të hekurit, ndërsa faza e fundit antikitetit të vonë, prej kësaj të fundit ruhet një trakt rreth 1,80 m i lartë e rreth 6 m i gjatë. Muri 2,20 m i gjerë është ndërtuar me gurë kave me përmasa mesatare, të lidhur me një llaç të fortë në ngjyrë të bardhë në krem me mbushës të imët. Muratura e pareteve është e çrregullt, ndërsa bërthama është punuar me gurë të vegjël, ku shihen dhe solenë të periudhës romake (fig. 24).

Në mbrendi të rrethimit gjenden pirgje gurësh të rrëzuar, të përzier me tjegulla të vona, antike, mbeturina të shtëpive të banimit. Pirgje të tilla që gjenden dhe në faqen jugperëndimore, rreth 50 m jashtë mureve të kalasë, dëshmojnë praninë e banesave dhe jashtë mureve rrethuese.

Kalaja e Dorzit, e ndërtuar në periudhën I të hekurit, në antikitetin e vonë kontrollonte rrugën që të nxirrte prej luginës së Pezës në Peqin, duke u bërë një hallkë e sistemit mbrojtës të Durrësit.

Kështjella e Petrelës[30]) ndodhet mbi një kodër shkëmbore në juglindje të fushës së Tiranës, atje ku lumi i Erzenit, pasi del nga depresioni i Kërrabës, kthen në drejtim të lindjes. Kalaja kontrollon një pikë nevralgjike komunikacioni, pasi aty kryqëzohen rruga që vjen nga Kruja nëpër fushën e Tiranës dhe rruga që vjen nga Durrësi, nëpërmjet rrjedhës së Erzenit, me rrugën për në Elbasan nëpërmjet Qafës së Kërrabës.

Periudhës së vonë antike në këtë kala i përket një kullë e rrumbullakët, e ndërtuar me muraturë tulle, (fig. 25) dikur me lartësi të plotë rreth 20 m. Kulla ndahej në 3 kate, prej tyre kati i parë shfrytëzohet për sterë, ndërsa kati II dhe III shërbenin si ambiente luftimi.

Në katin e dytë, i cili ruhet akoma, ndodhen tri frengji që të kujtojnë frengjitë e kullave të Durrësit.



Fig. 17



Fig. 18

29) Kalaja është vizituar për herë të parë prej H. Cekës, i cili përshkruan muret antike (**vep. cit.** 86, 89). Për periudhën e vonë antike A. Baçe, **Kalaja e Dorzit,** material në arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës.

30) Më gjerë shih A. Baçe – Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Petrelës,** Monumentet 5-6, 139, 160.

INST. MON. KULTURËS
BIBLIOTEKA
Nr. INV. 3664



Fig. 19



Fig. 20

Kjo kullë datohet në shekullin IV-VI, me gjasi më të madhe në shekullin VI.

Kalaja e Vilës gjendet në malin me të njejtin emër, i cili ndahet prej shkëmbit të Petrelës nga një qafë e lartë që krijon në vetvete dhe një shesh të përshtatshëm për banim. Ai sundon mbi Petrelën por nuk e ka aq të afërt kontrollin e rrugëve dhe sidomos luginën e Erzenit sa kjo e fundit. Mbi malin e Vilës përveç mureve rrethuese të një qyteti antik, «Kalasë së Persqopit», ruhen edhe gjurmët e një fortifikimi të vonë antik. Muri fillon rreth 100 m. në veriperëndim të kuotës më të lartë të kodrës, duke mbyllur një kreshtë të ngushtë shkëmbore. Prej këtej muri zbret gjatë faqes verilindore, duke ndërprerë vijat rrushkulluese dhe zgjeron sipërfaqen e rrethuar nga qyteti antik. Faqja jugperëndimore më e pjerrët dhe shkëmbore është lënë pjesërisht e pafortifikuar, ndoshta duke ia lënë mbrojtjen rrethimit antik.

Muri i periudhës së vonë antike ruhet vende-vende deri në 1,5 m lartësi dhe është 1,40 m i gjerë. Ai është ndërtuar me gurë të thyer të përmasave mesatare dhe të vegjël, të lidhur në të thatë, por vihen re dhe blloqe drejtëkëndëshe të marra nga muri antik. Ndërsa në përgjithësi gurët kanë përmasa që nuk i kalojnë 30 x 25 cm, me afrimin në lartësinë e kodrës vërehet përdorimi i gurëve me përmasa më të mëdha, rreth 100 x 50 cm. Gjatë gjithë gjatësisë së murit nuk vërehet asnjë gjurmë kulle. Këto veçori i gjejmë edhe në disa fortifikime të tjera të periudhës së vonë antike, si në kalanë mbi «Shkëmbin Mbret» në rrethin e Elbasanit, kalanë e Borshit, kalanë e Mbjeshovës dhe atë të Laçit[31]). Për një datim jo më të vonë se shekulli IV të fortifikimit dëshmon dhe mungesa e materialit arkeologjik pas kësaj periudhe në kalanë e Persqopit dhe sidomos e monedhave. Prej tyre më të vonat datohen në shekullin III-IV të erës sonë[32]). Fortifikimi duhet të ketë shërbyer si vend strehimi dhe për popullsinë që banonte në zonën përreth Petrelës. Jeta në këtë zonë, veç gjetjes së materialit qeramik dhe varreve të periudhës së vonë antike, dëshmohet prej një ujësjellësi që e sillte ujin nga burimet e Malit të Vilës (Fig. 26). Gjurmët e këtij ujësjellësi ndiqen të fragmentuara gjatë gjysmës së lartësisë së faqes verilindore të Malit të Vilës[33]).

Kalaja e Shëngjinit ndodhet në afërsi të fshatit Shëngjin, në anën lindore të vargut të Dajtit (Fig. 27, 28). Në këtë vend rrjedhja e sipërme e Erzenit, që paraqet një rrugë natyrore për në Qafën e Priskës ngushtohet tepër midis dy shkëmbinjve të lartë. Kalaja është ndërtuar në një pllajë të vogël malore, 200 m të gjatë dhe 50 m të gjerë mbi këtë ngushticë. Pllaja ka një shtrirje në drejtim të jugperëndimit, ku bashkohet me një qafë me malin. Në drejtim të veriut dhe perëndimit, ajo bie rreth 300 m thikë mbi lumin, ndërsa nga lindja ka një pjerrësi mbi 50°. Prej pllajës shikimit i hapet një horizont i gjerë mbi luginën e Erzenit.

DO NOT COPY

tësorë me drejtim veri – jug. Por ka mundësi që dy muret e brendshme të kenë shërbyer si mure taracimi pasi terreni është mjaft i pjerrët. Në brendësi të rrethimit shihen dhe gjurmë banesash me mure 0,8 m të gjera dhe një sterë uji me diametër 3 m. Gjurmë kullash nuk mundëm të hetojmë për shkak të rrënimit thuajse të plotë të murit, që ka ndodhur kryesisht nga cilësia e keqe e muraturës me gurë mesatarë kavoje dhe llaç të dobët gëlqeror.

Në mbrendi të rrethimit gjendet qeramikë ndërtimi e periudhës së vonë antike, kryesisht solenë me buzë të përkulura, në të cilët janë hequr me gisht shenja në trajtën e shkronjës α.

Teknika e ndërtimit dhe qeramika e datojnë fortifikimin në shekujt e IV-VI.

Kalaja e Laçit[37]). Laçi gjendet në shpatin perëndimor të kodrave të vargut bregdetar Lezhë-Krujë, 7 km larg grykës së Matit. Vendi ka rëndësi strategjike, pasi kontrollon mjaft mirë rrugën prej Shkodre në Durrës dhe, nga ana tjetër, këtu degëzohet një rrugë karvanesh për në Burrel. Rëndësia strategjike e kësaj pike është vlerësuar qysh në periudhën helenistike, kështu në kodrën e Kolikut, rreth 50 m të lartë gjendet një fortifikim i vogël rreth 60 – 80 m. i kësaj periudhe.

Vazhdimësinë e jetës në periudhën romake e dëshmon dhe ruajtja e emërit Laç (Latium) si dhe varret e zbuluara nga Sh. Gjeçovi[38]), ndërsa nga antikiteti i vonë ruhen gjurmët e një kështjelle. Ajo ndodhet mbi një kodër të lartë, e cila nga perëndimi bie me pjerrësi mjaft të madhe dhe pa asnjë ndalim drejt fushës, po kjo pjerrësi ruhet edhe në anën veriore e lindore. Nga jugu kodra bashkohet me një qafë të ulët me vazhdimin jugor të vargut, i cili e lidh me një pllajë të gjerë, ku kalon dhe rruga Laç – Daul – Burrel, gjurmë të vjetra të së cilës, të shtruara me gurë të mëdhenj të papunuar, ruhen në mjaft vende. Kështjella prej vendasve thirret e Gjormit ose e Sebastjes.

Kështjella ka formën e një pesëkëndëshi të çrregullt që u përshtatet kontureve të pjesës së sipërme të kodrës (fig. 30). Në anën juglindore, në drejtim të qafës prej ku është më i mundëshëm sulmi, ndodhen dy kullat e vetme të fortifikimit. Në këtë anë muri ka një gjerësi rreth 2 m., ndërsa në pjesët e tjera më të mbrojtura nga natyra, gjerësia e tij lëviz nga 1,35 m – 1,50 m. Muret që ruhen në 0,5 – 3 m lartësi, bashkohen në qoshet me kënde të mprehta. Në anën perëndimore të rrethimit gjenden dy kontraforta me përmasa 0,8 x 0,7 m që nuk takohen në vende të tjera të murit rrethues. Kullat kanë formë drejtëkëndëshe, prej tyre kulla «C»



Fig. 25



Fig. 26

37) C. Praschniker A. Schober (Vep. cit., 85), japin planimetrinë dhe përshkrimin e shkurtër të kështjellës, por e quajnë atë në mënyrë të papërcaktuar mesjetare. L. Bajo vep. cit. 311 e daton në mesjetën e mesme dhe e lidh me veprimtarinë e Skënderbeut.
38) Inventari i varreve është botuar tek Traeger, Zeitschrift für Ethnologie, XXXIII, 1901, 51, F. Nopscha, W. M. B. H. XII, 1912, 188.

FOR NOT COPY



Fig. 27



Fig. 28

që ruhet më mirë deri në lartësinë 3 m, ka përmasa 6,6 x 5 m, dhe trashësi muresh 1,30 m, ndërsa kulla «D» 6,4 x 5,2 m, por kësaj të fundit i mungon muri ballor. Muret e kalasë ruhen më mirë në anën perëndimore dhe më keq në verilindje. Ato janë ndërtuar me gurë të vegjël, të nxjerrë në vend, të lidhur me llaç gëlqereje me mbushës të imët. Në faqet e jashtme të mureve gurët nuk janë puthisur mirë, fugat janë mjaft të gjera dhe midis tyre janë futur copra të vogla guri. Në brendi të murit gurët janë vendosur pa rregull të zhytur në llaç të bollshëm.

Në brendi të fortifikimit ruhen gjurmë muresh banesash, ndërsa një ndërtim katërkëndësh në anën lindore duket se i përket një sterre. Në territorin e kalasë gjetëm gjurmë zgjyre, si dhe një fragment qeramike me kanelyra të shpeshta dhe të ngushta, karakteristike për shekullin VI[39]). Nga të dhënat e mësipërme mendojmë se kalaja i përket periudhës së vonë antike.

Kalaja e Daules, ndodhet në zonën malore në lindje të Laçit pranë fshatit me të njejtin emër, në një kreshtë, që shkëputet prej vargut. Kreshta përfundon me një majë shkëmbore rreth 400 – 500 m të gjatë në drejtim tërthor me luginën e Hurdhazës. Mbi këtë majë ndodhen rrënojat e kalasë. Vetë pozicioni që zë kalaja, të lë përshtypjen që ajo është ndërtuar për të kontrolluar dhe bllokuar luginën. E vetmja rrugë që të çon për në kala, ndodhet nga ana e fshatit dhe kalon nëpër kreshtën e sipërpërmendur. Rruga vijon horizontale deri pranë kalasë, pastaj ajo ngjitet lehtë në majën e shkëmbit që ka një disnivel të vogël nga rruga. Kjo është pjesa më pak e mbrojtur e kalasë, ndërsa nga anët e tjera kodra bie me faqe të thikta shkëmbore ose me pjerrësi të madhe. Rreth 300 m larg kodrës së kalasë rruga bllokohet nga një mur guri pa llaç, hyrjen e të cilit nuk e gjetëm dot për shkak të rrënimeve. Kodra përfundon me një syprinë me përmasa rreth 30 x 40 m, konturet e çrregullta të së cilës rrethohen nga muret mbrojtëse (Fig. 31). Muret zakonisht ndjekin linja të drejta që bashkohen me kënde të mprehta, duke zëvendësuar në një farë mënyre kullat. Vetëm në anën veriore ndodhet një mur i harkuar për të kapur më mirë konturet natyrore të terrenit.

Kalaja ka vetëm një kullë të rrumbullakët me diametër të jashtëm 7 m dhe trashësi muresh 2 m, të vendosur nga ana jugore pikërisht në vendin, ku ngjitet rruga që të çon në kala. Rëndësia që i është vënë mbrojtjes së kësaj pike të dobët, duket dhe nga vetë muret e trasha të kullës, të cilat arrijnë dyfishin e mureve rrethuese. Muret rrethuese nuk kanë kudo të njëjtën trashësi, pranë kullës nga ana perëndimore, ku te

39) Qeramikë të tillë kemi gjetur në Elbasan (Gj. Karaiskaj **Të dhëna të reja për datimin e kalasë së Elbasanit,** Monumentet, 3, 1972, 148), në Paleokastër, (A. Baçe **Rezultatet e gërmimeve në vitin 1974 në kalanë e Paleokastrës,** Buletin Arkeologjik Tiranë, 1974, (në shtyp)

DO NOT COPY

rreni vazhdon të favorizojë një ngjitje të lehtë, ato janë 1,20 m të gjera, në vazhdim ato zbresin në 1 m, deri sa arrijnë në anën lindore, që është shkëmbore dhe mjaft e pjerrët, në gjerësinë prej 0,70 – 0,80 m. Në afërsi të kullës, po nga ana lindore, një pjesë me gjatësi prej rreth 20 m, buzë një shkëmbi të thikët, është lënë e pambrojtur nga muret.

Kalaja ka patur një hyrje në skajin veriperëndimor. Ajo krijohet nga ekstremi i murit perëndimor dhe dalja përpara e murit verior, por gjurmët e plota të konstruksionit të hyrjes nuk ruhen. Për të shkuar në të, sulmuesit i duhej të kalonte pranë kullës së rrumbullakët dhe për një largësi prej 25 m bri murit perëndimor, nën goditjet e vazhdueshme të mbrojtësve, duke u ekspozuar atyre krahun e djathtë të pambrojtur.

Muret ruhen në lartësi rreth 1 m, ndërsa tek kulla ato arrijnë në 2 m. Ato janë ndërtuar me gurë pllocakë me trashësi 5-10 cm, të vendosur horizontalisht e të lidhur me llaç mjaft të fortë. Kalaja ka vetëm një periudhë ndërtimi, që tregon se i ka shërbyer vetëm një epoke të caktuar.

Burimet historike nuk bëjnë fjalë për kalanë e Daules; vetëm në listën e Prokopit pranë Durrësit shënohet edhe Aliula si një nga kalatë e ndërtuara prej Justinianit në Epirin e Ri, që mund të jetë një trajtë e shtrembëruar e emërit të sotëm të saj. Përmasat e vogla të kalasë tregojnë për një fortesë garnizoni, me një funksion të caktuar që ishte kontrolli i luginës së Hurdhazës, nga mund të sigurohej një dalje për në fushën e Thumanës, prej malësisë të Krujës, si edhe lidhja me luginën e Matit në Skurraj.

PËRFUNDIME

Si nga madhësia, konstruksioni dhe teknika e ndërtimit kalaja e Durrësit predominon mbi gjithë fortifikimet përreth. Është e qartë se kemi të bëjmë me një fortifikim të një rëndësie të veçantë për perandorinë bizantine, të porositur nga vetë perandori Anastas I (491-518). Ajo qëndron bri veprave ushtarake më të rëndësishme dhe më të përkryera të kohës, që tregon për nivelin e lartë dhe njohjen e kërkesave të artit ushtarak prej ndërtuesve të saj.

Ndërtimet e periudhës së Anastasit zenë një vëllim të madh në fortifikimet e Durrësit, jo vetëm duke gjykuar nga muri jugperëndimor me një gjatësi prej rreth 500 m, që ruhet pothuajse i plotë dhe i përket krejtësisht kësaj periudhe, por dhe duke u bazuar në përshkrimet dhe skicën planimetrike të Hezei – Domesë, në përshkrimet e Prashniker-Shoberit, si dhe në traktin e zbuluar pranë Muzeut të Luftës N. Çl. Lind pyetja



Fig. 29

se ku duhen kërkuar muret më të hershme të kalasë së Durrësit, që i përkasin gjithashtu periudhës së vonë antike apo romake? Nga burimet historike mësojmë që Durrësi ka qënë i fortifikuar edhe më parë. Kështu Malhu na njofton se mbreti i gotëve Teodoriku u gjend para mureve të këtij qyteti me ushtrinë e tij në vitin 479[40]. Mund të themi se ndërtimet mbrojtëse të kësaj periudhe ishin në gjendje të dobët, ngaqë pak vite më vonë iu bë një rikonstruksion i plotë mureve rrethuese të qytetit, veprimtari që mund të jetë bërë më e nevojshme edhe nga pasojat e shkatërrimeve që sollën gotët. E vetmja gjurmë e ndërtimeve më të hershme është ajo që ruhet në murin jugor të kalasë pranë shtëpisë së Pionierit (shih Planimetrinë, 1). Teknika e ndërtimit me fuga më të ngushta se sa trashësia e tullës i përgjigjet fare mirë karakterit të ndërtimeve mbrojtëse të shek. III-IV të erës sonë, periudhë kur u rrethuan me mure mbrojtëse edhe qytete të tjerë të rëndësishme të perandorisë për t'i shpëtuar valës së dyndjes së popujve. Në qoftë se këto ndërtime i përkasin shek. III ose fillimit të shek. IV, ishin pa dyshim edhe pasojat e tërmetit katastrofal të vitit 345 që e detyruan perandorin Anastas të merrte masat e mësipërme.

Fortifikimet rreth Durrësit mund t'i ndajmë sipas funksionit në mure barrjere (Muri i Portës), kulla vrojtimi (Petrelë) dhe kështjella.

Muri i Portës u ndërtua për të mbrojtur qytetin e Durrësit prej një sulmi të mundshëm nga veriu, duke shfrytëzuar në këtë rast dhuntitë e terrenit, afërsinë e detit me kënetën e Durrësit, ashtu siç duhet të ketë qënë fortifikuar nga ana jugore edhe zona e urës së Dajlanit, ku vetëm një rrip i ngushtë toke ndante detin nga kënetа. Në rast se nuk do të mbyllej rripi i ngushtë i tokës në veri të Durrësit, armiku mund të ndodhej

40) Malhi, **Byzantica**, 407.

Pdf10pk



Fig. 30



Fig. 31

papritur përballë mureve më të arritshme të Durrësit që shtriheshin në zonën fushore, në veri të lagjes «Exo-Bazari». Një shembull identik fortifikimi në vendin tonë kemi murin e «Demës» në Butrint, i cili gjithashtu mbyllte ripin e ngushtë të tokës midis detit Jon dhe Liqenit të Butrintit. Të një karakteri të ngjashëm qenë dhe muret që u ndërtuan në këtë periudhë historike për të mbyllur Termopilet, Istmin e Korinthit etj.

«Muri i Portës» është mbajtur nga Hezei – Dome, Prashniker-Shober dhe studjues të tjerë si ndërtim i periudhës së Perandorit Anastas, por duke u nisur në teknikën e ndërtimit, në ndryshimin e konstruksioneve të kullave dhe në mosgjetjen e të njëjtave monograme, K. Zheku arriti në përfundimin e drejtë, që ky mur nuk është i njëkohëshëm me muret e tjera të Durrësit[41]). Për këtë arsye tri rrethimet e Durrësit të përfunduara nga Anastas I kanë qenë më afër këtij qyteti, kështu rrethimin e parë që formonte akropolin, duhet ta kërkojmë rreth lartësisë 80. Rrethimi i dytë përbënte kalanë e madhe katërkëndëshe, ndërsa i treti murin pa kulla në veri të Durrësit, që e cilëson të tillë edhe Hezei. Me përjashtim të kullës së Petrelës që kishte një karakter thjesht strategjik për vrojtimin e rrugës që dilte nga qafa e Kërrabës, fortifikimet e tjera në pjesën më të madhe ishin njëkohësisht edhe vendbanime. Planimetritë janë të thjeshta dhe ndjekin zakonisht konturet natyrore të terrenit, kullat përdoren rrallë në anët më pak të mbrojtura. Në kalanë e Laçit, Daulës dhe deri diku të Shëngjinit, megjithëse muret ndjekin formën e terrenit, ato bashkohen me këndë dhe tentohet për kurtina të drejta, atje ku terreni e lejon. Po t'i shohim në pikpamje strategjike fortifikimet rreth Durrësit, do të vërejmë se ato janë vendosur kryesisht në pika strategjike që zotëronin rrugët kryesore për në Durrës. Prej tyre një kujdes i veçantë iu kushtua mbrojtjes së degëzimit të rrugës Egnatia që kalonte nëpërmjet Qafës së Kërrabës dhe luginës së Erzenit. Aty janë grumbulluar edhe pjesa më e madhe fortifikimeve (kalaja e Vilës, kulla e Petrelës, Kalaja e Lalmit dhe e Ndroqit). Po ta ndjekim këtë rrugë në drejtim të Skampinit (Elbasani), që ishte në atë kohë një qytet i fortifikuar, do të kemi dhe dy fortifikime të tjera «Kalanë e Bodinit» dhe Kullën e Gracenit[42]), e para ndodhet mbi një kodër që zotëron në malësinë e Kërrabës, në perëndim të kullës së Gracenit ndërsa kjo e fundit mbi majën më të lartë të vargmalit të Kërrabës dhe kontrollonte së afërmi rrugën që kalonte në shpatin perëndimor. Është për të shënuar

41) K. Zheku, **Vep. cit.** 42.
42) N. Ceka, **Fortifikimet e vona antike...**, 74

DO NOT COPY

se deri më sot asnjë fortifikim nuk është zbuluar përgjatë rrugës Egnatia nga Skampini për në Dyrrah që kalonte gjatë bregut të detit. Nga kjo kuptojmë që degëzimi i Egnatias nëpër Qafën e Krrabës ishte në këtë periudhë më i përdorur, dhe se nga ky drejtim prite-shin lëvizjet e fiseve barbare. Për t'u bindur për këtë, mjafton të kujtojmë që nëpër këtë rrugë kaluan në vitin 479 ushtritë Gote me Teodorikun në krye, për pushtimin e Durrësit, ndërsa në mesjetë Aleks Komneni, për t'i shpëtuar ndjekjes së Normandëve. Po të shohim vendosjen e fortifikimeve në vazhdim të rrugës Egnatia nga Skampini në drejtim të perëndimit, do të konstatojmë se ato janë vendosur rreth këtij të fundit dhe pranë kryqëzimit të rrugëve në fushën e Domosdovës, ndërsa që nga Xhyra deri tek ura e Haxhi Beqarit rruga mbeti pak e fortifikuar[43]). I vetmi fortifikim në fshatin Dardhë që ndodhet gjatë kësaj rruge, është në të vërtetë një kullë vrojtimi[44]). Nga kjo vendosje do të bindemi që edhe «kulla e Gracenit» dhe «Kalaja e Bodinit» përfshihen në sistemin mbrojtës të Durrësit.

Fortifikimet e tjera janë vendosur pjesërisht përgjatë vargmalit Dajt-Krujë. Shëngjini dhe kalaja e Dajtit kontrollonin daljen nëpërmjet «Qafës Priskës», ndërsa kalaja e Tujanit bllokonte rrugën që kalonte nëpër «Shkallën e Tujanit» në veri të Malit të Dajtit.

Në jug ndodhej kalaja e Turrës, e cila ngrihej mbi një kodër bregdetare midis Durrësit dhe derdhjes së Shkumbinit, prej saj ruhen fare pak gjurmë por mjaft fragmente qeramike të gjetura aty i përkasin antikitetit të vonë, ndërsa nga veriu Laçi dhe Daula.

Siç shihet, qendra e gravitetit bie në Jug-lindje të Durrësit ndërsa veriu që drejtimi më pak i rrezikshëm siç plotësojnë edhe burimet historike. Rruga Egnatia dhe degëzimi i saj për në Qafën e Krrabës kanë qenë gjithmonë edhe burim rreziqesh për Durrësin. Nuk mund të pretendohet akoma se janë zbuluar të gjitha fortifikimet që mbronin Durrësin, hallka të një sistemi mbrojtës, të cilat, siç mësojmë nga vepra e Prokopit «Mbi ndërtimet», ishin një karakteristikë e veprimtarisë ndërtuese të Justinianit.

POOR COPY

43) N. Ceka — **Fortifikimet e vona antike. . . .**
44) Gj. Karaiskaj **Kështjella e Dardhës,** arkivi i I.M.K. Një kullë rrethore e vetmuar në këtë kala është konsideruar si sterë nga N. Ceka (Fortifikimet rreth Skampinit).

TAB. I



DO NOT COPY

KALAJA E DURRESIT

Kulla B



Planimetria e katit II

Kulla C



Planimetria e katit I

kulla D



Planimetria e katit II



Prerje A-A e kullës D

0 5M

DO NOT COPY

DO NOT COPY



PLANIMETRIA E KULLËS



HYRJA E KULLES - QEMERI



SONDAZHI

Gjerak KARAISKAJ
Apolon BAÇE

DO NOT COPY

LA FORTERESSE DE DURRES ET LES AUTRES FORTIFICATIONS ENVIRONNANTES PENDANT LA BASSE ANTIQUITE

RESUME

Pendant la basse antiquité la ville de Durres était protégée par de puissantes murailles et tours, et ces mêmes ouvrages ont continué de constituer la base des fortifications de cette cité pendant la période s'étendant depuis le haut et mi-moyen âge jusqu'à l'occupation turque. Par ailleurs, le vaste hinterland de cette importante cité de l'empire byzantin était commandé par de petites forteresses, l'entourant sous la forme d'un anneau du côté de la mer et occupant d'importants points stratégiques de manière à contrôler surtout les routes conduisant à Durrës ou les sentiers qui la reliaient à la zone plate environnante. Mentionnons de leur nombre les forteresses de Ture, Ndroq, Lalm, Petrele, Dorez, Petrele-Persqop, Dajt et Tujan. Il y avait en plus dans le territoire environnant d'autres forteresses, qui, cependant, ne font pas directement part du système de fortifications de Durres, du fait qu'elles se trouvaient à une distance éloignée. Mais deux d'entre elles les forteresses de Laç et Daula) sont les seules se dressant au nord de Durres, alors que la forteresse de Shengjin, qui, bien que construite en profondeur de la zone montagneuse du Dajt, domine une importante voie de communication naturelle qui, après avoir traversé le col de Priske, descend dans la plaine de Tirana, d'où l'on peut rejoindre Durres en plusieurs directions.

LA FORTERESSE DE DURRES

L. Heyzey-H. Daumet sont parmi les premiers auteurs ayant consacré une attention particulière aux ouvrages de fortification de la ville de Durres. Maintes traces de ces constructions n'existant plus, il est impossible maintenant de les suivre sans les descriptions et la planimétrie des autres précités L. Rey, plus tard, complète l'ouvrage de ces prédesseurs, en nous laissant une description plus minutieuse des murs d'enceinte qui existaient encore à son époque.

En ce qui concerne les murailles de la basse antiquité, de nos jours sont conservés à Durres un trait de mur à quatre tours, dans la partie sud-ouest, un autre trait détaché du mur sud-est, disposé parallèlement à la côte et quelques traces rasant le sol du mur en direction nord-ouest et de celui en direction nord. Le mur sud-ouest, dans sa longueur actuelle, est long de 490 m. En général, il est conservé jusqu'au niveau du sentier de passage qui se trouve en moyenne à 9 m. du soubassement, tandis que son épaisseur est de 3,5 m. Il y a lieu de supposer que par devant le mur se trouvait un fossé, et cela du fait que le niveau du sol face à la muraille de la forteresse est légèrement moins élevé.

Ce mur est entièrement construit de briques liées entre elles par des couches épaisses de mortier. Quant à la dimension des briques, elle est environ de 30 x 36 x 4,5-5 cm; alors que les briques de la ceinture ont une dimension de 30 x 30 x 5. Le plus grand joint horizontal des briques a une épaisseur variant de 6 à 8 cm. Le mortier comporte du gravier et de rares morceaux de briques d'une dimension de 3 à 4 cm. Les fondations de ce mur sont en pierres. Elles suivent, dans les endroits escarpés, la configuration du terrain et sont disposées par degrés, étant cependant 15 cm plus larges que le mur.

Les traces existantes montrent que les merlons ont une épaisseur de 35 cm, égale à celle d'une brique, et sont renforcés de l'intérieur par une série de pilastres disposées à une distance de 1.90 m. l'une de l'autre. Ces pilastres également présentent en profil une dimension égale à celle d'une brique de 35 x 30 cm.

En ce qui concerne le mur sud-est, il n'en existe actuellement qu'un nombre restreint de traces à 80 m. à l'est de la tour «A». On y relève le long d'un petit trait des sustructions d'une technique quelque peu différente, notamment un fragment d'embrasure d'une porte et une partie de mur le surmontant et qui se prolonge en direction est. L'épaisseur du joint horizontal, à la différence des autres constructions, est inférieure à celle de la brique (épaisseur du joint 3 cm, épaisseur de la brique 5 cm). De même le mortier ne renferme pas des morceaux de brique mais rien que du gravier, mélangé abondamment à de la chaux. Sur le côté gauche de l'embrasure sont conservées les traces de quelques degrés d'escalier, servant à monter au mur ou à l'étage d'une tour.

Les tours. Le mur sud-ouest comporte quatre tours («B», «C», «D», «E») se rattachant à la basse antiquité, dont trois en bon état et le quatrième en ruines. Ces tours se dressent à une distance variant de 61 à 64 m. l'une de l'autre sur un terrain plat, mais en présence d'un terrain escarpé cette distance s'accroît. Ainsi, le long du mur au nord de la tour «E», long de 177 m., il n'y a aucune tour. Toutes les tours sont à cinq angles et de deux leurs côtés sont disposés perpendiculairement aux courtines.

La tour «B», dont les murs ont une épaisseur de 3 m., est conservée actuellement jusqu'à une hauteur de 14 m. En ce qui concerne les deux murs touchant les courtines, le mur septentrional est long de 4.30 m. et celui méridional de 4.90 m., tandis que les murs se réunissant à angle aigu ont une longueur de 10,9 m. Les traces conservées montrent que le deuxième étage était séparé du premier par un plancher en bois. Les poutres du plancher, comme cela se voit des trous pratiqués à leur intention, étaient disposées perpendiculairement au mur d'enceinte à une distance de 0.60 m. l'une de l'autre. Les trous mêmes ont une section de 0,32 x 0,22 cm, ce qui nous induit à penser que les poutres étaient au nombre de deux et disposées d'une manière contiguë. La pièce du deuxième étage, couvrant toute la surface de la tour, était dotée de 7 meurtrières. Le comble de la tour est coupé transversalement depuis le niveau du plancher de cet étage, et cela pour permettre l'ouverture de la meurtrière frontale qui contrôlait la partie antérieure de la tour que l'on ne pouvait observer des autres meurtrières. Celles-ci sont hautes 2,15 m. et larges 1.55 m. et couvertes de voûtes cylindriques. Les meurtrières sont en partie, fermées frontalement par un mur d'une épaisseur de 48 cm, en y laissant cependant une ouverture de lumière de 0,64 m. Au-dessus des socs de l'arc des meutrières, du côté postérieur de la tour, on relève les socs d'un arc dont la largeur est de 0,65 m. De l'autre côté, les deux murs latéraux de la tour conservent encore les traces de la voûte qui couvrait l'espace libre entre eux. Le soc de cette meurtrière commence à une hauteur de 1,25 m. Etant donné que la voûte était de forme cylindrique et avait un diamètre de 9,80 m., il en ressort que sa clef devait se trouver à 6.15 m. au-dessus du niveau du plancher du deuxième étage et à 4 m. au-dessus du niveau des meurtrières de cet étage, laissant de la sorte une surface relativement grande pour le troisième étage aussi.

Quant à la tour «C», conservée dans un état plus mauvais que les autres tours, elle ne comporte aucun élément architectonique d'importance.

La tour «D» est haute 13 m. jusqu'au niveau supérieur des meurtrières. On y accède à son étage inférieur, qui servait de dépôt, par une porte aménagée dans sa partie postérieure. Ce dépôt manquait d'illumination; elle était haute 9,80 m. et ses dimensions étaient de 9,78 x 6,95 m. C'est au-dessus de ce niveau que se trouvait le plancher du deuxième étage. Le parement postérieur de la pièce d'en bas ne représente pas un mur complet, et cela dans le but d'économiser les matériaux de construction. C'est à cette intention qu'on a construit un grand arc, dont la base a une dimension de 6,80 m. et repose sur deux pilastres massifs débordant les angles de la tour. Le mur fermant l'ouverture de l'arc, à la différence des autres murs, n'est pas entièrement en briques mais construit selon la technique de l'«opus mixtum».

La présence des escaliers servant à monter au sentier de passage au-dessus du mur, toujours à proximité des murailles, montre que leur deuxième étage communiquait à travers une porte avec le sentier en question. Dans la tour «D», les escaliers sont aménagés sur le côté gauche de l'entrée. Larges de 1,20 m., ils s'enfoncent dans l'épaisseur du mur.

Une partie de l'ancien mur est encore conservée sur le côté méridional jusqu'à 0,40 m. au-dessus du niveau du deuxième étage, il en est de même des traces d'une meurtrière disposée au-dessus de la meurtrière de cet étage. Ce qui montre qu'il doit y avoir eu un troisième étage. En témoignent les esquisses de Heyzey reproduisant une tour à deux rangées de meurtrières, soit à trois étages, tour qui n'est autre que celle que nous sommes en train d'examiner. Les faces de celle-ci comportent, entre les meurtrières, trois croix latines couvertes par un arc et travaillées en relief avec des briques. Ces croix ressemblent à celles figurant sur les briques mises au jour dans le mur d'enceinte. Par ailleurs, les faces de cette tour comportent des décorations reproduisant de manière schématique une branche d'olivier, que l'on retrouve également sur une brique du VIe siècle découverte dans la forteresse de Kanine.

La tour «E» se trouve à 68 m. de la tour «D»; elle ne comprend aujourd'hui qu'une seule partie de son mur postérieur et de ses murs latéraux qui se rattachent à la courtine. A ce qu'il semble, elle doit avoir été haute de m. et à trois étages. Le premier, couvrant une surface deux fois plus grande que les autres étages, servait de dépôt; il ne communiquait pas avec l'extérieur, mais avec la partie intérieure de la forteresse à travers une entrée aménagée dans le mur terminal. Le deuxième étage, comportant une seule pièce à meurtrières, était séparé du premier par un plancher en bois, comme l'était aussi le troisième étage. Celui-ci était couvert par une voûte cylindrique et par un tronc conique, sur lesquels reposaient la plate-forme de la tour entourée de bastions. Le deuxième étage communiquait directement avec la muraille à travers une entrée postérieure, tandis que la communication intérieure entre les étages et la plate-forme était assurée par des escaliers en bois.

Les entrées. — Le mur sud-ouest comporte deux entrées.

L'entrée 1 est large de 2,80 m. et couvert par un arc dont la hauteur atteint 0.75 m. En ce qui concerne l'entrée 2, qui coupe la courtine en formant un angle de 60° environ, elle est large de 3,70 m. et couverte par une ceinture de briques dont la largeur est de 0,95 m. Ses dimensions étant plus grandes que celle de l'entrée 1, elle a du être l'entrée principale de ce côté des fortifications.

La muraille de Porto. — A 7 km environ au nord de Durres, l'on peut voir encore les restes d'une muraille qui clôturait naguère l'étroite bande de terre s'étendant entre la mer et le marais. Cette muraille est construite selon la technique de l'«Opus mixtum». Les murs, d'une largeur de 1,75 m., sont traversés de part en part par une bande de briques à quatre rangées. Les bandes,

DO NOT COPY

DO NOT COPY

hautes de 35 cm, sont disposées à une distance de 60 à 70 cm l'une de l'autre. Les briques, d'une dimension 37 x 29 x 5 cm environ, sont placées dans la bande alternativement, de manière à montrer sur la face extérieure de la bande leur largeur ou leur longueur. Quant à l'épaisseur du joint de mortier reliant les briques, elle varie de 5 à 7 cm.

Les parements des murs entre les bandes de briques sont construits de pierres de carrière, de dimensions moyennes et disposées d'une manière irrégulière, tandis qu'à l'intérieur du mur les pierres sont plus petites et liées abondamment avec du mortier. Du côté extérieur, les joints des bandes de briques ainsi que les joints reliant les pierres sont soigneusement aplanis, de manière à rendre le mur uni et ne mettre en évidence que les parties centrales des pierres.

A la suite d'un sondage effectué à une profondeur de 2,20 m, on a mis au jour le soubassement dont l'épaisseur était égale à celle du mur. Ce sondage a par ailleur démontré que cette fortification se rattache à une seule phase de construction.

La seule tour ayant actuellement une hauteur de 4 m. est de forme rectangulaire (5,95 x 6,15 m). Ses murs ont une épaisseur qui est de 1,25 m. plus petite que celle de la courtine. Les angles des tours et les points de jonction à la courtine sont construits entièrement de pierres, tandis que le reste du mur selon la technique de l'opus mixtum. Son premier étage ne communique avec l'extérieur. Une entrée, aménagée dans la partie postérieure de la tour au-dessus du sentier de passage, conduit à son deuxième étage. Cette entrée, large de 1.70 m., est couverte par un cintre comportant trois arcs concentriques.

Deux paires d'escaliers, reposant sur la face postérieure de la tour, conduisent au sentier de passage. Ces escaliers sont larges de 1 m. et débordent la courtine.

L'entrée de la forteresse, large de 3.80 m., se trouve à l'ouest de la tour. Le linteau y manque mais l'on peut encore voir les deux encadrements intérieurs de la porte. A l'intérieur, des deux côtés de la porte apparaissent les restes de deux paires d'escaliers servant à monter au sentier de passage disposé sur le mur, au-dessus de l'arc de la porte.

La présence d'un nombre réduit de traces à la cote plus élevée de la colline (80 m.), nous induit à penser qu'un acropole à surface triangulaire doit avoir existé en ces lieux. Son mur oriental, qui conserve encore les traces de l'entrée, se prolongeait en direction sud.

LES FORTIFICATIONS AUX ENVIRONS DE DURRES

La forteresse de Ndroq. Elle se dresse sur une colline surplombant la vallée de l'Erzen, à environ 16 km au sud-est de la ville de Durres. Sur la plate-forme de cette colline s'érige une forteresse moyenageuse, conservant encore des restes de murs attribués à la basse antiquité. Larges de 1,80 m., ces murs sont en pierres de dimension moyenne placées presque en rangées horizontales et liées avec du mortier de chaux mélangé à de la poudre de tuiles. Il s'agit là d'une technique caractérisant la basse antiquité. Cette datation est confirmée également par des fragments de céramique découverts sur l'emplacement de la dite forteresse.

La forteresse de Lalm s'érige sur une colline pyramidale, haute de 100 m environ, surplombant une des méandres du fleuve Erzen. De par sa position elle est en mesure de contrôler dans les deux sens la route venant de Petrele, à travers la vallée de l'Erzen et la plaine de Tirana, et se dirigeant ensuite vers Ndroq et Durres.

La surface ceinte a la forme d'un ellipse, dont la longueur est de 100 m. et la largeur de 50 m. Les courtines, larges de 1,5 m., étaient renforcées, comme l'indiquent les traces existantes, par des tours rectangulaires. L'intérieur du mur comporte des pierres cassées enfoncées dans du mortier abondant; tandis que les parements sont construits de pierres, ayant des dimensions moyennes et petites et placées en rangées, qui sont nivelées à chaque deux rangées avec des pierres moins épaisses.

La couche culturelle relative au mur comporte de la céramique de construction, des briques, des tuiles et des fragments de récipients appartenant à la basse antiquité.

La forteresse de Dorzë s'érige au somment d'une colline élevée couverte de calcaires. Ses constructeurs l'ont ceint de murs seulement du côté oriental et méridional, les deux autres directions jouissant d'une défense naturelle. Les dimensions de la surface ceinte sont de 100 x 60 m. environ.

Les murailles comportent quatre phases de construction, dont la dernière se rattachant à la basse antiquité. Le mur large de 2,20 m. est en pierres de carrière, ayant des dimensions moyennes et liées avec du mortier solide. La maçonnerie des parements est irrégulière, tandis que le noyau est travaillé avec de petites pierres où l'on relève aussi des solènes de la période romaine.

A l'intérieur des murailles et sur leur face sud-ouest, à 50 m. environ hors des murs de la forteresse, se trouvent des amas de pierres écroulés mélangés à des tubles appartenant à la basse antiquité, ce qui témoigne la présence d'habitation même hors des murs d'enceinte.

La forteresse de Petrele se dresse sur une colline calcarée. Elle contrôle un point névralgique de communication, du fait que c'est ici que s'entrecroisent la route venant de Kruje à travers la plaine de Tirana et la route venant de Durres le long du cours de l'Erzen avec la route se dirigeant vers Elbasan à travers le col de Krrabe.

A la basse antiquité se rattache une tour ronde en maçonnerie de briques, dont la hauteur originale était de 20 m. Elle était à trois étages, dont la première servait de citerne et les deux autres comme pièces destinées aux combattants. Elle est attribuée aux IVe-VIe siècles, mais plus probablement au VIe.

La forteresse de Vile. Ici, en dehors des murs d'enceinte d'une cité antique, la «Forteresse de Presqop», sont encore conservées les traces d'une fortifications se rattachant à la basse antiquité, ce qui élargit la surface ceinte de la cité antique.

Le mur se rapportant à la basse antiquité est large de 1,40 m. Sa maçonnerie est en pierres cassées, de dimensions

moyennes et petites et liées à sec, mais l'on relève aussi des blocs de pierres à angle droit prélevés du mur ancien. En faveur d'une datation de cette fortification non plus lointaine que le IVe siècle témoigne l'absence de matériel archéologique successive à cette période. Elle a dû servir aussi de centre d'hébergement pour la population habitant dans les environs de Petrele. En dehors de la céramique et des tombeaux se rapportant à la basse antiquité, dans cette zone on a mis au jour les traces d'un aqueduc captant les eaux de la source qui jaillisait au mont de Vile.

La forteresse de Shengjin se dresse à proximité du village de même nom et se situe sur le côté oriental de la chaîne de montagnes du Dajti, en un endroit où le cours supérieur du fleuve Erzen, qui représente une route naturelle avec le col de Priske, se retrécit entre deux roches élevées.

De forme planimétrique presque rectangulaire, cette forteresse s'étend sur une dimension de 100 x 40 m. Sur le côté méridional, face au col qui le relie à la montagne, se dresse un mur dont la partie centrale est munie d'une tour.

Ce mur longe le versant oriental, tandis que du côté septentrional l'on relève les traces d'un acropole en maçonnerie à sec. Du côté occidental le terrain étant très escarpé, il n'est pas ceint. Larges de 1.60 m., les murs sont en pierres plates calcaires et liées avec du mortier à chaux blanche mélangée à du sable fluviatil. Ils sont placés en rangeés presque horizontales. On relève la même technique quant à la disposition des couches de pierres à l'intérieur du mur. Dans la partie intérieure de la zone fortifiée s'étendent des amas de pierres écroulées, qui, vraisemblablement, appartenaient aux maisons n'existant plus. Quant à la céramique découverte ici, elle n'est représentée que par des tuiles solènes attribuées aux IVe-VIe siècle de notre ère.

La forteresse de Dajti. Elle se dresse à une altitude de 1200 m. au-dessus du niveau de la mer, surveillant de la sorte l'horizon jusqu'à la mer. Ses murailles cernent le contour naturel, créant de la sorte une fortification de forme triangulaire, et couvrent un périmètre de 550 m. environ. Le mur septentrional de cette fortification, qui est plus élevé que les autres et séparé par un autre mur transversal, constitue une sorte de petit acropole. Les tours de forme courbée concernent seulement l'angle méridional et le côté septentrional avant la courbure du mur.

Les murs de la forteresse ont une épaisseur de 2,30 m. sur les côtés moins protégés du terrain, exemple le côté occidental, plus se retrécissent jusqu'à 1,40 m. sur les côtés abrités. Les parements des murs sont construits de manière irrégulière et liés avec du mortier de chaux mélangé à du gravier, tandis que leur noyau avec des pierres de la même dimension liées avec peu de mortier. La technique de construction, la céramique et les monnaies indiquent que nous sommes en présence d'une construction relative au VIe siècle.

La forteresse de Tujan. Elle surmonte une colline élevée de forme conique, située à proximité du village de Tujan. De par sa position, elle est en mesure de bien contrôler le col de Tujan, un important couloir de communication à travers lequel passe la route traditionnelle menant à Diber. Les constructeurs, utilisant les traits défensifs du terrain, n'ont pas cerné le côté oriental. Ainsi, la forteresse en question a la forme d'un rectangle séparé en trois parties par des murs latéraux. Le terrain étant assez escarpé, il semble que deux murs intérieurs ont servi de murs de terrassement. A l'intérieur du mur d'enceinte l'on relève des traces d'habitation et d'une citerne de diamètre de 3 m. Les murailles étant complètement en ruines, il est difficile de savoir s'il y a eu des tours.

Dans la partie intérieure du mur d'enceinte ont été mis au jour de la céramique de construction attribuée aux IVe-VIe siècles.

La forteresse de Laç. Laç se situe à 7 km des gorges du fleuve Mat. Elle occupe une importante position stratégique qui contrôle assez bien la route reliant Shkoder à Durres. La forteresse de même nom se dresse sur une colline élevée et a la forme d'un pentagone irrégulier s'adaptant aux contours de la partie supérieure de cette colline. Le côté sud-est, en direction du col, qui est la partie la plus vulnérable, est muni de deux tours qui sont les seules de la fortification. Ici le mur est large de 2m. environ, tandis que dans les parties les plus protégées de par la nature du terrain sa largeur varie de 1,35 à 1,50 m.

Les murs de la forteresse sont construits de petites pierres extraites sur place et liées avec du mortier de chaux. Les pierres du parement ne se rejoignent pas bien, les joints sont assez épais et remplis de débris de pierres. La maçonnerie de la partie intérieure du mur est constituée de pierres disposées irrégulièrement et liées avec du mortier abondant.

Dans la partie intérieure de la fortification l'on a relevé des traces de murs d'habitations, alors que les restes d'une construction quadrangulaire située sur le côté orientale semblent appartenir à une citerne. Dans le territoire même de la forteresse de Laç ont été identifiées des traces de suie et de cérémique appartenant aux IVe-VIe siècles.

La forteresse de Daulë se dresse sur la sommité d'une colline calcarée longue de 400-500 m. environ. L'unique chemin d'accès à la forteresse est fermé à environ 300 m. de celle-ci par un mur de pierres à sec. Cette colline aboutit à une zone plate dont les dimensions sont approximativement de 30 x 40 m., Ses contours irréguliers sont cernés par des murs de défense.

Cette forteresse est munie d'une seule tour ronde, dont le diamètre extérieur est de 7 m. et l'épaisseur des murs de 2 m.. Les murs en question longent la partie méridionale. Quant aux murs d'enceinte, ils n'ont pas partout la même épaisseur; ils sont larges de 1,20 m. à proximité de la tour, sur le côté occidental, où le terrain est légèrement en montée, puis leur épaisseur descend d'abord à 1 m. et enfin à 0,70-0,80 m. sur le côté oriental qui est rocheux et assez escarpé.

Les murs sont construits de pierres de forme plate disposées horizontalement et liées avec du mortier assez solide. Cette forteresse se rattache à une seule période construction, ce qui signifie qu'elle a été employée au cours d'une seule période de temps.

NO COPY

CONCLUSIONS

La forteresse de Durres se distingue nettement des autres fortifications se dressant dans les alentours de cette ville aussi bien par ses dimensions que par sa technique de construction. Il est évident que nous avons affaire à une fortification très importante pour l'empire byzantin qui a été mise en place sur ordre de l'empereur même Anastase I (491-518). Elle fait part du nombre des ouvrages militaires les plus importants et les plus parfaits de l'époque, ce qui montre le niveau élevé et la connaissance des exigences de l'art militaire de la part de ses bâtisseurs.

Les constructions mises en place pendant le règne d'Anastase occupent une place de relief dans les fortifications de Durres. Mais les sources historiques indiquent que la ville de Durres avait été fortifiée antérieurement. Ainsi Malhi rapporte que Théodoric, roi des Goths, vint à se trouver avec son armée devant les murs de cette ville en l'an 479. Il convient de souligner que les ouvrages défensifs de cette période n'étant pas assez solides, quelques années plus tard les murs d'enceinte de la ville ont été reconstruits complètement, surtout en raison des dégats causés par les Goths. Les seules traces de constructions parmi les plus anciennes sont celles conservées dans le mur méridional de la forteresse (voir Planimétrie 1). La technique de construction à joints moins épais que l'épaisseur même de la brique correspond parfaitement au caractère des ouvrages défensifs des IIIe-IVe siècles de notre ère. Il s'agit de la période de temps lorsque d'autres importants villes d'empire furent ceintes de murailles en vue de faire face aux invasions de l'époque.

Les fortifications concernant les alentours de la ville de Durres peuvent se répartir selon leur fonction en murs de barrière (Le mur de Porto), en tours de guêt (Petrele) et en forteresses. Le mur de Porto a été construit pour défendre la ville de Durres d'une eventuelle attaque du côté septentrional, en tirant parti des avantages du terrain, de la proximité de la mer du marais de Durres; il semble que cette fortification se présentait de la même manière du côté méridional, à proximité du pont de Dajlan, où une bande étroite de terre séparait la mer du marais. Si cette langue de terre n'était pas fermée au nord de la ville de Durres, l'ennemi pouvait y apparaître soudainement devant les murs s'étendant dans la zone plate.

En dehors de la forteresse de Petrele, qui avait un caractère exclusivement stratégique pour contrôler la route venant du col de Krrabe, les autres fortifications étaient aussi employées, dans leur grande majorité, comme centres d'habitation. Les planimétries sont simples et suivent généralement les contours naturels du terrain, les côtés moins protégés étant rarement flanqués de tours. En ce qui concerne les forteresses de Laç, de Daule et jusqu'à un certain point la forteresse de Shengjin, bien que les murs suivent la forme du terrain, ceux-ci se rejoignent en formant des angles et l'on a même tenté de construire des courtines droites là où le terrain permettait une telle chose. Considérées sous l'angle de la stratégie, les fortifications s'étendant aux alentours de Durres se dressent surtout en des points stratégiques dominant les principales routes conduisant à Durres. Une importance particulière acquiert dans ce contexte la défense de l'embranchement de la voie Egnatia, traversant le col de Krrabe et la vallée du fleuve Erzen. C'est dans cette zone que s'érigent aussi le plus grand nombre de fortifications (la forteresse de Vile, la forteresse de Petrele, la citadelle de Lalm et celle de Ndroq).

Il convient de souligner que jusqu'à ce jour on n'a pas mis au jour une seule fortification le long de la voie Egnatia, depuis Scampinu jusqu'à Dyrrach, côtoyant le bord de la mer. Il en résulte que l'embranchement de la voie Egnatia à travers le col de Krrabe était à l'époque la route la plus utilisée et la direction par laquelle pouvait apparaître les peuplades barbares. La meilleure preuve en cette direction est le fait qu'en l'an 479 les armées de Théodoric empruntèrent précisément cette route dans occupation de Durres.

Les autres fortifications sont disposées en partie le long de la chaîne de montagnes Dajt-Kruje, les forteresses de Shengjin et de Dajt controlent la sortie du col de Priske et la forteresse de Tujan ferme la route qui traversait, au nord du mont Dajt, le col de Tujan.

En direction sud, la forteresse de Turre se dresse sur la sommité d'une colline côtière entre Durres et l'embouchure du fleuve Shkumbin. On y conserve actuellement un petit nombre de fragments de céramique appartenant à la basse antiquité. En direction nord ce sont les forteresses de Laç et de Daule.

Comme on voit le centre de gravité passe au sud-est de Durres, tandis que la partie nord représente la direction la moins vulnérable comme l'attestent les sources historiques. La voie Egnatia et son embranchement à travers le col de Krrabe ont de tout temps constitué un danger pour la ville de Durres. On ne peut nullement prétendre d'avoir mis à jour toutes les fortifications du système défensif de Durres, qui, comme l'indique Procope dans son ouvrage «Sur les constructions», constituent une caractéristique de Justinien dans ce domaine d'activité.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Neritan CEKA

NDËRTIMET SEPULKRALE TË QYTETEVE ILIRE

DO NOT COPY

Në arkitekturën qytetare ilire ndërtimet sepulkrale përbëjnë një nga gjinitë më karakteristike. Në literaturën arkeologjike ky tip monumentesh është prekur shkarazi[1]) dhe megjithëse janë përmendur pothuaj të gjitha rastet e njohura deri më sot, mungon ende një botim i plotë i tyre. Kjo ka ndodhur edhe për faktin se janë të rallë ekzemplarët e gërmuar plotësisht dhe, nga ana tjetër, vetëm pak prej tyre kanë dhënë objekte që ndihmojnë në datim. Paraqitja e tërë materialit për këtë arësye është e domosdoshme dhe jep mundësi të bëjmë njëkohësisht një përpjekje për të përcaktuar vendin e ndërtimeve sepulkrale në kuadrin e fondit arkitektural ilir, si dhe për të shfrytëzuar të dhënat e deritanishme për tipizimin dhe datimin e këtyre monumenteve.

Duke e përqendruar vështrimin vetëm tek ato varre që përmbajnë elemente ndërtimore, jemi kufizuar të hapemi në një fushë mjaft të gjerë, ku mund të përfshiheshin edhe varret me konstruksione të thjeshta. Një kufi të dytë përbën edhe territori gjeografik mbi të cilin hidhet ky vështrim, në përputhje me shtrirjen e kulturës qytetare ilire[2]). Gjithashtu janë lënë jashtë edhe varret shkëmbore të cilat i kemi trajtuar gjerësisht në një punim të mëparshëm[3]).

Rastet e njohura të ndërtimeve sepulkrale na japin mundësi të bëjmë një klasifikim paraprak të tyre. Tipi më i thjeshtë arkitektonik është ai me një ambient të vetëm, të ndërtuar me tulla apo me blloqe guri. Tipi i dytë, që ka përveç kësaj edhe një paradhomë, është ndeshur deri më sot i punuar vetëm me blloqe guri. Për sa i përket formës arkitektonike, e cila përcaktohet tek ata kryesisht nga mënyra e mbulesës, kemi një numër më të madh zgjidhjesh. Tek tipi i parë është përdorur mbulimi me pllaka të vendosura horizontalisht, ose në formë çatie, mbulimi me qemer të rremë (gjithnjë prej tullash) dhe me qemer të vërtetë (prej blloqesh guri). Tipi i dytë ka gjithmonë mbulesë me qemer të vërtetë.

Të dy tipet kanë një përhapje të caktuar gjeografike në një territor që shtrihet në veri deri tek lumi Erzen, ndërsa nga jugu në kufirin antik të Ilirisë. Pjesa më e madhe e tyre gjendet në luginën e Vjosës, veçanërisht në Amantia. Për këtë arsye është më lehtë të krijohet një tablo më e qartë për ndërtimet sepulkrale ilire, po të nisemi nga nekropoli i këtij qyteti.

AMANTIA

Ky qytet na ka dhënë deri më sot numrin më të madh të ndërtimeve sepulkrale. Ato ndeshen në grupe të vendosura në anë të rrugëve kryesore që të çonin dikur nga ana perëndimore për në qytet. Shumica e tyre është dëmtuar rëndë pas grabitjes dhe na jep vetëm elemente të planimetrisë dhe formës arkitektonike. Megjithatë edhe në gjendjen e sotme, duke u mbështetur kryesisht në vrojtimet e monumenteve mbi sipërfaqn e tokës, mund të konstatohet se tipi zotërues është ai i varrit me dy ambiente të mbuluara me qemer të vërtetë. Më rrallë ndeshet edhe tipi i dytë, vetëm me një ambient.

Për sa i përket grupimit të varreve, ai nuk përpu-

1) K. Patsch, **Sandschak Berat in Albanien,** Wien, 1904, col. 33-34 F. Prendi, Dh. Budina, **Kalaja e Irmajt,** «BSHSH» 4, 1963, 13; S. Anamali, **Amantia,** «Iliria» 2, 1972, 95; N. Ceka, **La ville Illyrienne de la Basse-Selcë,** «Iliria», 2, 1972, 187-192.
2) N. Ceka, **Tipare të kulturës aytetare në Ilirinë e Jugut,** «Studime Historike», 2, 1975, f. 167.
3) N. Ceka, **La ville Illyrienne...,** 176-187.



Fig. 1

DO NOT COPY

thet me atë të tipeve, mbasi në të njëjtin grup zakonisht hasen të dy tipet. Grupi më i madh është ai i anës VP në vendin e quajtur Qafa e Varreve, ku ka mbi 20 varre të rreshtuara anës rrugës që ngjitej gjatë një kurrizi kodre për në qytet. Erozioni dhe faktorët e tjerë dëmtues pothuaj nuk kanë lënë asnjë ndërtim të qartë dhe e gjithë kjo pjesë e nekropolit monumental paraqitet sot si një masë e çrregullt blloqesh. Dallohet një numër i konsiderueshëm gurësh qemeri, ndërsa **in situ** ndeshën një qoshe varri me tri radhë blloqesh, të vendosura mbi një zokol prej një rreshti gurësh. Tipike është lartësia e vogël e rreshtave (0.30 m) dhe gjatësia e madhe e gurëve (0.90 m.). Nga brenda ishin ruajtur ende blloqet e sofatit, ku vendoseshin urnat me hirin e të vdekurve.

Gjatë tërë anës P të quajtur Vërri, atje ku shpati i pjerrët i kodrës së qytetit antik lidhet me kurrize brigjesh që ndajnë lugina të vogla (fig. 1), gjenden të veçuar varre të tjera monumentale. Kryesisht ata janë të tipit me dy dhoma të mbuluara me qemer.

Grupi i dytë i madh i varreve monumentale gjëndet në anën JP në vendin e quajtur Vrakal. Këtu ndeshen të dy tipet e varreve, jo aq dendur sa në anën VP nga që kanë qënë vendosur së bashku me varret e zakonshme.

Një grup i vogël, i përbërë vetëm nga tre varre, ndodhet në fillim të faqes jugore, në vendin e quajtur Varri i Çifutit.

Gjatë vizitës së tij, K. Paçi vrojtoi njërin prej varreve të vendosur në vendin e quajtur Kishë. Ai na përshkruan një ndërtim katërkëndësh 5.90 x 3.90 m, prej dy ambientesh (tab. I, 2) nga të cilat njeri (2.78 x 2.75 m) është dhoma e varrimit dhe tjetri paradhoma[4]). Kishte një hyrje të vetme dhe një derë të brendshme për të komunikuar të dy ambientet. Mbulimi bëhej me qemer cilindrik që mbyllej në lartësinë 1.90 m. K. Paçi ka vënë re edhe një mur të dytë në anën e jashtme të dhomës së varrimit, funksioni i të cilit mbetet i paqartë. Duke konstatuar edhe varre të tjera të këtij tipi ai vë re se midis tyre kishte një largësi prej 15 hapash, që i korespondon gjerësisë së një rruge.

Një varr tjetër monumental na kumtohet nga S. Anamali[5]). Me sa del nga përshkrimi i shkurtër, ai ka formë katërkëndëshe, vetëm me një kthinë të mbuluar me qemer. Punimi i trashë i faqes së jashtme të gurë-

4) C. Patsch, vep. cit. col. 33-34 fig. 11
5) S. Anamali, art. i cit. f. 95.

ve dëshmonte se varri ka qenë vendosur brenda në tokë.

Nga të dhënat e autorëve të mësipërm, nuk mund të krijohet ende një tablo e qartë e ndërtimeve të karakterit sepulkral në Amantie. Për këtë arsye është e nevojshme që atij t'i shtohet edhe materiali i ri, i mbledhur nga vrojtimet sistematike në terren.

Varri 1 (tab. II, 1) gjendet në grupin e Qafës së Vrakalit, në faqen e kodrës të gërryer thellë nga erozioni (fig. 2). Kjo gjë ka bërë të zbulohet varri në tërë planimetrinë e vet. Forma e tij është katërkëndëshe 5.60 x 3.80 m, me dhomën katrore të varrimit dhe paradhomën të ndara nga një mur tërthor me të njëjtën gjerësi sa të mureve anësore (0.45 m). Të dy ambientet komunikojnë me një derë të gjerë 0.80 m, përballë hyrjes kryesore të monumentit. Në anët e dhomës së varrimit ruhen sofate prej blloqesh me gjerësi 0.45 dhe 0.55 m.

Muret janë ndërtuar me blloqe konglomerate katërkëndëshe, me faqe të punuara rrafsh me çukitje. Në brinjët anësore vihen re fuga të pjerrëta. Rreshtat janë paralelë, me ndonjë shkallëzim të vogël (fig. 3). Rreshti i bazës ka lartësi 0.49 m dhe gurë të gjatë deri 1.26 m, ai mbi të ka lartësi 0,53 m dhe gjatësi gurësh deri 0,98 m. Qemeri që fillonte në rreshtin e tretë, nuk ruhet **in situ,** por ka në rrënojë disa blloqe që tregojnë formën cilindrike të tij.

Varri 2. Ndodhet mbi një kurriz kodre në vendin e quajtur Lëmi i Daliut në Vërri (fig. 4). Ka formën e katërkëndëshit të zgjatur 9.20 x 4.20 m (tab. II, 2). Përbëhet nga dy ambiente, nga të cilat i pari është një kthinë fare e ngushtë me gjerësi 0.60 m. Hyrja me



Fig. 2



Fig. 3

gjerësi 0.98 m është zhvendosur nga e majta. Ajo mbulohej dikur me një arkitra të gjatë, i cili është rrëzuar aty afër. Nga hyrja për në ambientin e dytë, që është tepër i përzgjatur, dallohet vetëm një arkitra i madh. Pranë tij ruhet **in situ** njëri prej gurëve të qemerit (fig. 5), që ka pasur formë cilindrike.

Blloqet janë në përgjithësi gëlqerorë, me faqe të punuar rrafsh. Në fugaturat anësore ndeshen shpesh vija të pjerrëta.

Krahas varrit të përshkruar nga K. Paçi, dy monumentet e mësipërme janë të vetmet që ruhen, të paktën në planimetri, në nekropolin e Amanties. Të tjerat siç, thamë edhe më lart, vetëm mund të konstatohen ngc gërmadhat në Qafën e Varreve apo në Vërri.

Varri 3. (tab. II, 3). Është i tipit me një ambient dhe gjendet në vendin e quajtur Lugu i Gjovasos, ku njihet nga vendasit me emrin Varri i Çifutit. Vetë ambienti i varrimit është inkuadruar në një ndërtim katërkëndësh në formë platforme 8.37 x 2.55 m, të vendosur në pjerrësinë e një bregu (fig. 6). Për këtë arsye ai ngrihej mbi sipërfaqen e tokës me tri anë, ndërsa ana e katërt mbështetej në faqen e kodrinës[6]). Fasada e monumentit ka pasur lartësinë 2.15 m. In situ ruhen dy rreshtat e bazës dhe një rresht kornizë me lartësi 0.38 m, që krijon një kontrast të thjeshtë hije-drite me pjesën e thelluar në formë strehe (tab. II, 3, b, c). Ky element mungon në anët e ngushta të platformës. Mbi kornizë ngrihej një rresht orthostatësh me lartësi 1.10 m, prej të cilit ka mbetur në vend vetëm një gur në brinjën JP të monumentit (tab. II, 3 d). Gurët konglomeratë dhe gëlqerorë solidë janë punuar në forma katërkëndëshe me

6) Varri dallohej në sipërfaqen e tokës dhe u pastrua gjatë ekspeditës konservuese-restauruese të vitit 1974.

BOTIMI



Fig. 4

faqe të rrafshta. Në anën JP pothuaj të gjithë gurët kanë të punuar nga një deltë në reljef (tab. II, 3 d), shenjë që ndeshet zakonisht në monumente kulti[7]). Deri në lartësinë e orthostateve platforma rrafshohej



Fig. 5

nga brenda me blloqe, duke fshehur edhe ambientin e varrimit të vendosur në anën VL të saj. Ambienti (fig. 7) ka formë katërkëndëshe 2.30 x 1.10 m me lartësi 1.07 m. Dyshemeja është shtruar me pllaka shtufi, ndërsa mbulimi është bërë në lartësinë e kornizës me pllaka të mëdha guri me lartësi 0.33 m.

Aty pranë gjenden edhe dy ndërtime të tjera të të njëjtit tip.

Varri Nr. 4 (tab. II. 4). Është gjithashtu një platformë 7.60 x 5.80 m e vendosur rëzë një bregu tek Qafa e Vrakalit (fig. 8). Mbi rreshtin e bazës vjen një kornizë me lartësi 0.35 m, që del me një sipërfaqe konvekse 0.15 m nga rreshti i tretë, i cili përfaqësohet nga orthostatë (tab. II, 4 b). Këta kanë lartësi 0.90 m, gjatësi 0.90 m dhe trashësi 0.36 m. Në platformë ka pasur më tepër se një varr. Ruhet kapaku i njerit prej tyre, i punuar njëlloj si ata të sarkofagëve (tab. II, 4 c). Gurët janë trajtuar në forma katërkëndëshe me faqe të rrafshta. Njëlloj si në varrin nr. 3 janë bërë delta në reljev në faqet e gurëve.

GJIRI I VLORËS

Në një zonë të kufizuar që përfshin vetëm brigjet e Gjirit të Vlorës, është ndeshur një tip interesant varri, i cili nga përmasat përbën një ndërtim të thjeshtë, por nga konstruksioni i mbulesës mund të rreshtohet në tipin arkitektonik që po trajtojmë.

Varri nr. 1 (tab. V, 1). U gërmua në fshatin Radhimë[8]), pranë një vendbanimi antik me karakter fshatar. Varri ishte vendosur në shpatin e kodrës, ku përveç tij u hetuan varre të tjera të po atij tipi, si dhe të tilla të ndërtuara me tjegulla.

Varri përfaqësohet nga një ambient katërkëndësh 2.50 x 1.10 m prej gjysma tullash 0.38 x 0.38 x 0.08 m, të lidhura me llaç. Paretet anësore kanë lartësi 0.58 m, ndërsa në anët e ngushta ngrihen edhe pesë radhë të shkallëzuara në formë frontonesh (tab. V, 1 b). Në shkallëzimet orientohen rreshtat e një qemeri të rremë prej tullash të plota, të lidhura me llaç. Vetë qemeri nuk përbën një bllok të plotë mbi varrin, por shkallëzohet nga lart për të kursyer materialin (tab. V, 1 a).

Në varr ishte varrosur një person i vetëm, që nga inventari kuptohet se ishte grua. Ai përbëhej nga një piksidë, në kapakun e së cilës që aplikuar reljefi i një satiri, një kalpidë, një kandil, një varëse prej pete ari me figurën e një erosi etj. Mbi varr ishte vendosur një

7) Këtu janë padyshim shenja apotropeike dhe nuk kanë të bëjnë me funksione praktike (siç është ngritja e gurit). Në vënde të tjera ndeshen në tempullin e Dobrës, tempullin e vogël në Butrint, në një kamare dhe në një bazament portiku në Apolloni, pranë hyrjeve kryesore në murin rrethues në Klos dhe Irmaj etj.

8) Gërmimi u krye në vitin 1964 nga autori (shih raportin përkatës në arkivin e Sektorit të Arkeologjisë të Institutit të Historisë).

DO NOT COPY



Fig. 6

amforë që përmbante eshtrat e një kafshe. Objektet janë tipike për gjysmën e dytë të shek. III p.e.sonë.

Varri 2 (tab. V, 2). U ndesh rastësisht gjatë hapjes së një rruge në pikën nr. 1 të Jonufrit. Dhomëza ka formë katërkëndëshe me përmasa 2.40 x 0.90 m. Mbi muret anësore me lartësi 0.50 m ngrihet qemeri i rremë prej tullash të plota 0.38 x 0.38 x 0.08 m, të lidhura me llaç të dobët, me gëlqere dhe pak rërë. Qemeri formohet prej nëntë rradhë tullash dhe mbyllet në një lartësi 0.70 m. nga paretet anësore. Nga jashtë volumi i qemerit vjen duke u ngushtuar.

Në varr ishte vendosur një person me kokën nga lindja. Inventari kishte humbur, me përjashtim të një kandili që u gjet në drejtim të baçinit dhe pjesëve të një skifosi kantaroid (tab. III, 4). Jashtë varrit, në këndin V.P. u gjet një amforë. Objektet janë tipike për gjysmën e II të shek. II p.e.sonë.

Varri 3 (tab. V, 3). U hap gjatë punimit të tokës në fshatin Dukat i Ri. Dhomëza ka formë katërkëndëshi 2 m x 0.68 m, me lartësi të pareteve 0.50 m. Qemeri i rremë është krijuar me tulla, njëlloj si në dy varret e mësipërme, dhe përbëhet nga gjashtë rreshta. Varri është orientuar L –P. Inventari i varrit kishte humbur.

Në zonën e Dukatit dhe Tragjasit hetuam edhe gjurmë të tjera varresh të këtij tipi.

MATOHASANAJ

Varri 1 (tab. IV, 1). Ndodhet në njërin prej shesheve të vegjël, në perëndim të të cilave ngrihet faqja e pjerrët e lartësisë së kalasë së Matohasanajt. Një varr tjetër me arkë prej pllakash guri dëshmon se vendi ka shërbyer si nekropol.

Nga një çarje e qemerit hyhet në dhomën e varrimit, që ka formë katërkëndëshe 2.30 x 1.40 m me orientim V –J. Muratura përbëhet nga blloqe katërkëndëshe gëlqerorë të gjatë, me lartësi të vogël (0.24 x 0.33 m). Rreshtat janë të rregullta dhe paralele. Faqja e gurëve është punuar me fryrje, ndërsa brinjët anësore janë lënë disa herë të pjerrëta (tab. III, 1 b). Nga këto veçori muratura është e ngjashme me periudhën e fundit të ndërtimit të kalasë së Matohasanajt.

Varri mbulohet me qemer të vërtetë cilindrik, të ndërtuar me gurë të gjatë smerçi. Punimi i faqeve është i sheshtë.



Fig. 7



Fig. 8

DO NOT COPY

Hyrja e varrit gjendet në anën J, në kënd të ballit të ngushtë të dhomës. Gjerësia e saj është 0.68 m, por lartësia e saj, ashtu si e dhomës, nuk mund të matet me saktësi për shkak të mbushjeve. Hyrja dhe një korridor me të njëjtën gjerësi që e paraprin atë, janë mbuluar me pllaka guri, por nuk kuptohet gjatësia e këtij të fundit për shkak të shembjes.

Varri Nr. 2 (tab. IV, 2). Është zbuluar rastësisht gjatë punimeve bujqësore në një arë poshtë rrugës automobilistike, rreth 2 km në veri të kalasë. Ka formën e një dhome katërkëndëshe 2.70 x 1.82 të mbuluar me qemer cilindrik (tab. IV, 2, a). Muratura është ndërtuar me gurë smërçi katërkëndësh dhe rallë gëlqerorë. Blloqet janë të mëdha (0.70 – 1.50 m) të vendosura në rreshta izodomikë (lartësi 0.60 x 0.67 m). Qemeri është ndërtuar krejtësisht me gurë smërçi dhe i mbulon anët e ngushta (tab. IV, 2, b). Dhoma është suvatuar me llaç gëlqereje me përzierje të shumtë rëre, mbi të cilin është kaluar një cipë e hollë boje të bardhë.

Hyrja ndodhet në anën L, e spostuar në këndin e ballit. Shembja e pllakave që e mbulonin korridorin nuk lejon të ndiqet drejtimi i tij, por vihet re qartë se nuk ka pasur paradhomë dhe hyrja në varr bëhej drejtpërdrejtë nga korridori.

Në varr u gjet një arkë mermeri katërkëndëshe (tab. IV, 2, c). Është punuar në dy pjesë në formën e një godine monumentale. Pjesa e poshtme është punuar thjeshtë dhe vetëm gjatë buzës është kaluar një kornizë me dhëmbëza. Kapaku ka formën e çatisë me dy frontone me akrotere palmetash dhe nga një rozetë në mes. Nuk mungon edhe paraqitja e tjegullave solene, të mbuluara me kalyptere.

BYLIS

Varri Nr. 1 (tab. III, 3). Gjatë punimeve të çlirimit nga dherat e portës IV, u vu re një ndërtim i vogël katërkëndësh në L të saj. Pas pastrimit doli në dukje një varr monumental, i gdhëndur pjesërisht në gur dhe pjesërisht me muraturë blloqesh katërkëndëshe (fig. 9). Planimetria që ruhet plotësisht, është katërkëndëshe 1.90 x 2 m, me një hyrje të vendosur tek këndi VL i dhomës, së cilës i paraprin një korridor i shkurtër me gjatësi 0,74 m (tab. IV 3, a). Ruhet në krahun e majtë të korridorit kanali vertikal i derës që tregon se pllaka monolite ulej nga lart, për tu mbuluar me gurët e fasadës. Muratura ruhet në një rresht të vetëm dhe konstruksioni mund të kuptohet vetëm nga foleja e harkut të qemerit, që është punuar në shkëmb në thellësi 0.10 – 0.20 m (tab. III, 3 b). Ajo fillon 0.92 m nga dyshemeja dhe mbyllet me hark të plotë në lartësinë 1.84 m, që shënon edhe lartësinë e dikurshme të qemerit. Blloqet katërkëndëshe kanë qenë latuar vetëm nga brenda, duke lënë jashtë një sipërfaqe të trashë, që fshihej nën mbulesën e dheut. Nga brenda varri ishte i suvatuar me llaç me shumë gëlqere dhe mbushës prej zhavori të imët e grimca të shumta tjegullash.

Dyshemeja e varrit është gdhendur tërësisht në shkëmb. Pjesa J e saj ka qenë veçuar nga një paret i ulët, prej të cilit ruhet **in situ** një bllok me gjerësi 0.30 m. Ndërmjet tij dhe murit krijohej një hapësirë prej 0.57 m, ku vendoseshin dhuratat. Një ndarje të tillë e gjejmë edhe në varret me qemer të Selcës dhe Persqopit.

KLOS

Varri Nr. 1. (tab. VI, 1). Është i vendosur në nekropolin e qytetit ilir, ndërmjet varreve të zakonshme L. Papajani[9]) na e përshkruan si një ndërtim katërkëndësh 2.40 x 3.45 prej dy ambientesh të ndërtuara në mënyrë të ndryshme. Dhoma është ndërtuar me gurë gëlqerorë të punuar në formë katërkëndëshe me faqe të sheshtë nga brenda. Mbi muret anësore, që kanë lartësi 1 m, të përbërë nga tri blloqe, ngrihej mbulesa prej pllakash guri të vendosura në formë çatie dyujëse. Gjatësia e pllakave është 1.86 m, ndërsa dy anët e ngushta mbylleshin me gurë trekëndësh në formë frontoni. Paradhoma me sa duket është shtuar më vonë. Muratura e saj është bërë me gurë të mëdhenj të papunuar, mbi të cilët ngrihej një qemer prej tullash sektoriale, nga të cilat u gjetën në vend pak copë.

SELCA E POSHTME

Varri Nr. 4 (tab. I, 1). Përbën një ekzemplar të veçantë në rreshtin e varreve monumentale të këtij qyteti ilir, që karakterizohen nga punimi në shkëmb. Ai është i vendosur në anën e VL të qytetit, rreth 40 m. poshtë brezit shkëmbor, ku janë gdhendur varret e tjera.

Varri ka formën katërkëndëshe 4.25 x 2.50 m dhe mbulohet me një qemer cilindrik që mbyllet në lartësinë 2.40 m nga dyshemeja (fig. 10). Muret e tij janë ndërtuar me blloqe ranore, të punuara në forma katërkëndëshe. Ato ngrihen mbi një platformë blloqesh që përbën njëkohësisht dyshemenë e godinës. Mbi rreshtin e parë vjen një radhë orthostatësh, mbi të cilat mbështetet qemeri.

Një mur i brendshëm e ndante godinën në dy pjesë, në një paradhomë 1.80 x 1.20 m. dhe në dhomën

9) L. Papajani, **Gërmimet arkeologjike të vitit 1974 në kodrën e fshatit Klos»,** Buletin Arkeologjik», 1975, 43.

FOTOCOPY



Fig. 9

e varrimit, në formë katrore 1.80 x 1.80 m (tab. I, 1, a). Muri ndarës ngrihet mbi lartësinë e qemerit, duke e ndarë këtë në dy pjesë dhe ka nga të dy anët nga një prag harkor, që shërbente si mbështetje orientuese për gurët e qemereve. Në prag i njëjtë është gdhendur edhe në murin fundor të dhomës së varrimit.

Qemeri ruhej i dëmtuar, vetëm mbi dhomën e varrimit (tab. I, 1, c). Pjesa e sipërme e gurëve të tij është lënë e papunuar, meqë i gjithë ndërtimi ishte parashikuar të mbulohej nga dheu. Megjithëse forca shtytëse e qemerit do të shkarkohej në këtë mënyrë në tokë, gurët e qemerit, si dhe ato të mureve anësore, janë lidhur në drejtim horizontal me kllapa hekuri dhe plumb.

Hyrja për në paradhomë është 0.85 m e gjerë dhe mbyllej me një derë dyflegërshe guri. Është ruajtur vetëm njëra, me faqe të punuar thjeshtë (tab. I, 1 d). Fleta ka qenë llogaritur për të lëvizur mbi gondën, vendi i së cilës përfaqësohet nga një thellim katërkëndësh pas pragut, në dyshemenë e paradhomës. Për këtë, njëri krah i fletës është trajtuar me profil të rrumbullakët dhe në qoshet gjenden thellimet, ku inkastroheshin boshtet.

Hyrja e dhomës së varrimit është katërkëndëshe 1.60 x 0.96 m. Ruhet vetëm njera nga të dy fletët e derës, me përmasa 162 x 0.43 m. Ajo është një pllakë monolite ranore, e punuar në trajtat e një dere druri (tab. I, 1 d). Kjo përshtypje krijohet nga diazomat (ndarjet) dhe nga imitimi i kokëve të gozhdëve, të vendosura në dy rreshta horizontalë në anët dhe në një rresht në mesin e fletës. Të dy fletët fiksoheshin me plumb prapa pragut dhe në piatabandë, ku ruhen gropat për vendosjen e kllapave. Në krahun e djathtë të hyrjes, pas vendosjes së derës, mbetej një hapësirë vertikale 0,18 m e gjerë, së cilës i korrespondon një e ngritur në prag. Kjo hapësirë drite, që nuk lejon kalimin e njeriut, përdorej me sa duket për vendosjen e objekteve gjatë ceremonive.

Tri anët e dyshemesë së dhomës zihen nga një prag i ulët i krijuar nga tri pllaka pothuaj të njëllojta, me përmasa 1.30 x 0.45 m.

Në buzë të tyre kalon një kornizë që mbështetet në këmbë kafshe të punuara skematikisht. Duke lënë të theksuar kornizën, ngriheshin mbi prag tre gurë katërkëndësh me lartësi 0.34 m. Prej tyre ruhet vetëm njëri, i cili ka në anë reljefin skematik të një këmbe shtrati. Në gjerësinë prej 0.30 m dhe gjatësinë 1.30 m gurët ishin të pa përshtatshëm për vendosjen e trupave dhe varrimi ka qenë bërë me urna që futeshin në hapësirat e krijuara midis këtyre gurëve dhe pareteve të dhomës.

Gjatë pastrimit të varrit nuk u gjetën objekte që kishin të bënin me inventarin e tij, pasi ai ka qenë grabitur që në kohën antike dhe më pas është përdorur për strehim.

KALAJA E PËRSQOPIT

Varri Nr. 1. (tab. V, 1). Është i vetmi varr monumental i zbuluar në këtë qendër ilire, i cili shënon njëkohësisht kufirin më verior të përhapjes së këtij tipi arkitektonik. Ai gjendet në anën V të kodrës, mbi të cilën



Fig. 10

DO NOT COPY

ngrihen muret e qytezës ilire, rreth 100 m nën një kullë të ruajtur të kësaj ane. Gjatë restaurimit (krahaso tab. V, 2 dhe 3) u arrit të ngriheshin muret anësore dhe një pjesë e qemerit.

Varri ka formë katërkëndëshe 4 x 3.60 m, me një ndarje të brendshëme në dy ambiente (tab. V, 1 b). Ambienti i parë, që ishte paradhoma e varrit, paraqitet si një kthinë e ngushtë 2.65 x 0.80 m dhe pjesa kryesore e ndërtimit zihet nga dhoma e varrimit që ka përmasa 2.65 x 2 m.

Muret janë ndërtuar me gurë të mëdhenj katërkëndësh, me faqe të sheshtë. Trashësia e tyre është e ndryshme dhe ana e jashtme është lënë e papunuar, meqë ndërtimi mbulohej me dhe (tab. V, 2). Mbylljа nga sipër e varrit ka qenë bërë në lartësinë 2.60 m me qemer cilindrik, i cili fillon mbi rreshtin e dytë (tab. V 1 a). Qemeri është lidhur organikisht me muret transversale dhe i mbulon ato. Dyshemeja e varrit është e shtruar me rrasa. Faqet e brendshëme të tij janë suvatuar me llaç, me grimca tjegullash, duke mbuluar kështu edhe trajtimin jo fort të kujdesshëm të formave të gurëve.

Hyrjet e paradhomës dhe të dhomës qëndrojnë ballë njëra tjetrës pothuaj në aksin e godinës. E para është më e gjerë (0.90 m) dhe i ka paturat për vendosjen e një dere monolite nga jashtë, për të formuar kështu një tërësi me faqen e jashtme të varrit. Hyrja e dhomës është më e ngushtë (0.60 m) dhe i ka paturat e derës nga brenda, duke vënë në dukje kuadratin e saj. Pesha e derës rëndonte këtu jo në dysheme si në hyrjen e jashtme, por mbi një prag të krijuar nga një gur, që është shkallëzuar nga ana e brendshëme. Paturat janë thelluar me vija të pjerrëta në gurët anësorë për ta kapur më mirë derën, e cila përveç kësaj lidhej edhe me plumb. Shenjat e një lidhjeje të tillë dallohen në pjesën horizontale të paturave, në lartësinë e pragut.

Varrimi ka qenë bërë me vendosje urnash. Këtë e tregojnë dy gropa katërkëndëshe me përmasa 0.50 x 0.25 dhe 0.85 x 0.45 m. të formuara në qoshen P dhe J të dhomës (tab. V, 3). Në muret anësore dallohen shenjat, ku mbështeteshin gurët që mbulonin të dy gropat.

Gjatë pastrimit të varrit nuk u gjet asnjë objekt që mund të ndihmonte për datimin e tij.

* * *

Ekzemplarët që përshkruam më lart, janë më të ruajturit dhe më përfaqësuesit e kësaj kategorie monumentesh që njihen sot në qendrat qytetare ilire. Pjesa tjetër, përderisa mungojnë gërmimet arkeologjike, na jep vetëm të dhëna të veçanta, në bazë të të cilave mund të krijojmë një mendim më të gjerë për tipet.

Në fillim të artikullit bëmë një ndarje skematike të ndërtimeve sepulkrale në bazë të tipit arkitektonik, që na shërben për një orientim të përgjithshëm gjatë përshkrimit të tyre. Tani që kemi përshkruar me hollësi ekzemplarët e ndryshëm, mund të themi se më përcaktues për klasifikimin e tyre është forma arkitektonike sesa tipi planimetrik. Mbi këtë bazë mund të veçojmë ndërtime që mbulohen me qemer të vërtetë cilindrik, të tillë me qemer të rremë dhe së fundi varre me mbulesë prej pllakash.

Në grupin e parë ndeshen dy variante që dallohen nga planimetria, por që kanë një lidhje të qartë gjenetike. I pari me dy ambiente (paradhomë dhe dhomë varrimi), përfaqësohet nga varret 1-2 të Amanties nga ai Nr. 4 i Selcës dhe nga varri i Persqopit. Varianti i dytë përfshin dy varret e Matohasanajt, disa ekzemplarë të pasqaruar plotësisht nga Amantia, dhe varrin 1 të Bylisit. Me përjashtim të rastit të Selcës dhe Persqopit, të gjitha monumentet e këtij tipi gjenden në luginën e mesme të Vjosës, kryesisht në bregun e majtë të lumit. Megjithatë, edhe ekzemplarët e shkëputur gjeografikisht, qëndrojnë brenda tipit arkitektonik. Ky i fundit, në variantin e parë, karakterizohet nga përmasat modeste të planimetrisë katërkëndëshe, brinja e gjatë e së cilës lëviz rreth 4-5 m, ndërsa e shkurtëra 2.50-3.80 m. Bën përjashtim varri Nr. 2 i Amanties, madhësia e të cilit përcaktohet nga brinja e gjatë. Në të gjitha rastet për gjerësinë është patur parasysh hapësira e qemerit, e cila lëviz nga 1.80 në 2.90. Vendosja e monumenteve është bërë në përgjithësi pranë mureve të qyteteve, gjithmonë gjatë rrugëve kryesore që të shpinin atje. Hyrja gjendet zakonisht drejt lindjes me devijime nga VL ose JL.

Muratura është gjithnjë me blloqe katërkëndëshe, me faqe të sheshtë. Në Persqop dhe në Selcë faqja e jashtme është lënë e papunuar, gjë që dëshmon për groposjen e tyre në tokë, por pa përdorur tuma. Në Amantie, përkundrazi, faqja e jashtme është e punuar dhe monumentet duken qartë se kanë qenë mbi sipërfaqen e tokës.

Vendin kryesor në volumin e godinës e zinte dhoma, e cila në përgjithësi është me planimetri katrore. Në varrin 2 të Amanties dhe në atë të Persqopit vemë re një ngushtim të theksuar të paradhomës saqë ajo pothuaj e humb funksionin si e tillë.

Gjerësia e mureve formohet përherë nga një bllok i vetëm dhe lëviz nga 0.35 në 0.65 m. Për gjerësitë e vogla (Selcë, Amantia) qëndrueshmëria e murit është siguruar duke bërë edhe lidhjen me pllaka hekuri dhe plumb të gurëve në drejtim horizontal. Në rastet që njo-

DO NOT COPY

him shtroja është bërë me gurë të gdhendur (Selcë) ose me pllaka guri të çrregullta (Persqop).

Mbulimi i këtyre varreve është bërë me qemer të vërtetë cilindrik. Në rastet kur monumenti ishte nën tokë, shtytja e tij përballohej nga masa e dheut, por për shkak se ekzemplarët e Amanties nuk ruhen të plotë, e kemi të vështirë të përcaktojmë zgjidhjen statike të qemereve të tyre. Në varret e Amanties dhe në Përsqop qemeri ka të njejtën lartësi në të dy ambientet dhe mbulon edhe murin ndarës të tyre, si dhe muret e ngushtë të varrit. Në Selcë qemeri ndahet në dy pjesë nga ngritja mbi të e murit ndarës të ambienteve. Të tri muret tërthore kanë pasur gdhendje harkore për të orientuar mbështetjen e qemerit dhe për t'u lidhur më mirë me të. Të dy hyrjet gjenden përballë njëra tjetrës dhe kanë gjerësi rreth 1 m. Mënyrën e mbylljes së tyre e kemi të qartë nga varri i Selcës, ku dyert janë dykanatëshe dhe lidheshin te pragu dhe piatabanda me kllapa hekuri dhe plumb. Ndërsa dera e jashtme vendosej nga jashtë, e brendshmja i ka paturat nga brenda dhomës. Varrimi në të gjitha rastet bëhej me urna, që vendoseshin brenda në sofatet e krijuar të dhomës në krahun e majtë të hyrjes (Persqop), apo në të tri anët (Selcë, Amantie). Për këtë qëllim lihej një hapësirë e ngushtë midis sofatit dhe murit, ku vendosej urna. Këto hapësira në Persqop duket qartë se mbuloheshin me rrasa guri.

Varianti tjetër, dmth me një ambient të mbuluar me qemer, duket qartë se ka një lidhje organike me të parin. Nga pikëpamja e formës arkitektonike nuk kemi ndryshim, sepse përdoret i njejti qemer cilindrik. Planimetria është më e thjeshtë me që nuk ka paradhomën, e cila zëvendësohet me një korridor të ngushtë dhe të shkurtër, në të cilin vendosej hyrja. Ky korridor mbulohet vetëm me pllaka guri. Mungesa e paradhomës dhe përmasat më të vogla e kanë bërë ndërtuesin të vendosë hyrjen në anën e dhomës. Në Bylis vëmë re të njëjtin sofat si tek varret me dy ambiente, ndërsa në Matohasanaj, ku sofati mungon, gjejmë të përdorur arkën e hirit.

Varret e variantit të dytë na japin edhe disa pika për një datim më të vonë në krahasim me ato të variantit të parë. Urna e gjetur në varrin 2 të Matohasanajt dëshmon për një punë të vonë[10]). Në përgjithësi varrimi me arka hiri hyn në Iliri që nga shek. II dhe bëhet tipik për shek. I. p.e.sonë[11]). Edhe varri 1, i vendosur pranë murit rrethues, karakterizohet nga një teknikë ndërtimi e ngjajshme me fazën më të vonë të këtij muri, e cila i korrespondon materialeve më të vona të qytezës, që datohen në shek. II-I p.e.sonë.

Gjatë pastrimit të varrit të Bylisit u gjetën disa fragmente nga enët që përmbante dikur varri. Forma të përcaktuara japin fragmentet e një qypi të madh guzhine me prag për kapakun në buzë, të një hidrie me grykë të hapur dhe të një tasi (tab. IV, 3, c). Format janë tipike për shek. II-I p.e.sonë.

Përsa i përket tipit me dy ndarje, ende nuk mund të shtojmë të dhëna të plota për një datim të saktë, pranë daj mbetemi në përfundimin se ai futet si tip në Ilirinë e Jugut nga gjysma e dytë e shek. IV p.e.sonë[12]).

Origjina e këtij tipi arkitektonik mund të diskutohet pa u shkëputur nga ajo e qemerit të vërtetë, i cili përbën tiparin e tij kryesor. Nuk është pa rëndësi edhe forma planimetrike me variantet e saj.

Pa u futur në diskutimin e mirëfilltë për qemerin, mund të shënojmë se kjo formë arkitektonike filloi të përdoret në Ilirinë e Jugut që nga fundi i shek. IV p.e. sonë, ndërkohë kur në Maqedoni është përdorur që në fillim të këtij shekulli[13]). Sidoqoftë koha e përhapjes së kësaj forme është fundi i shek. IV[14]) dhe qendra ballkanike e rezatimit është Maqedonia.

E njejta gjë mund të thuhet edhe për tipin arkitektonik të varrit me qemer. Rastet e njohura jashtë vendit tonë janë kryesisht nga Maqedonia, megjithëse shtrirja e tyre arrin Rusinë Jugore, në lindje, dhe Etrurinë, në perëndim[15]).

Pjesa më e madhe e varreve me qemer cilindrik është zbuluar në Maqedoninë Perëndimore, ku zotëron varianti me dy kthina. Ajo që i dallon ata nga varret ilire të të njejtit tip, është kryesisht realizimi me përmasa të mëdha, trajtimi arkitektonik i fasadave dhe mbulimi me tuma. Siç e kemi vënë në dukje një herë

10) Një kapak urne të gjetur në Ploçë, mjaft të ngjashëm nga trajtimi i «çatisë» me urnën e Matohasanajt e ka botuar K. Paçi, **vep. cit,** fig. 35.

11) N. Ceka **Vendbanimi i hapur pranë qytezës ilire të Belshit,** «Buletini Arkeologjik», 4, 1974, 60.

12) N. Ceka **La ville illyrienne,** f. 191-192.

13) Th. Macridy, **Un tumulus macédonien a Langaza** «Jahrb, des kais deutsch. Arch. Inst.». XXVI, 1911, f. 214, A. Orlandos, **Materiaux de construction,** II, Paris, 1968, f. 248-252 që ka mbledhur pjesën më të madhe të rasteve të përdorimit të qemerit në Greqi dhe krahinat kufitare antike, mendon se qemeri u fut në Greqi nga Lindja pas pushtimeve të Aleksandrit (f. 249).

14) Po në këtë kohë qemeri cilindrik duket në Rusinë Jugore (Pantikape, Olvia).

15) A. Akerstrom, **Studien ûber die etruskischen Gräber,** 172.

Do not copy

tjetër[16]), më afër tyre qëndron varri më i hershëm shkëmbor në Selcën e Poshtëme (tab. I, 3), qoftë për tipin planimetrik, për trajtimin në formë qemeri të tavanit, fasadën e stilit jonik, e deri në mënyrën e varrimit mbi sofatet e vendosur anës dhomës. Fundi i shek. IV dhe shek. III p.e.sonë është koha kur varret me qemer të ndërtuar me blloqe gurësh bëhen të zakonshëm në qendrat ilire të jugut. Ato zhvillohen në një rrugë të pavarur dhe dallohen nga varret maqedone të së njëjtës kohë[17]) nga përmasat e vogla dhe trajtimi i thjeshtë. Në ndryshim nga Maqedonia ku ato u përdorën kryesisht për elitën e klasës skllavopronare dhe gjenden pranë rezidencave mbretërore, në Iliri ato i takojnë një shtrese më të gjerë të klasës skllavopronare të qyteteve, gjë që kuptohet nga numri i madh i ekzemplarëve dhe vendosja midis varreve të thjeshta në Amantia. Për këtë arsye mund të themi se ky tip varri u bë një element përbërës i arkitekturës qytetare ilire. Gjithashtu harku dhe qemeri nuk mbetën forma të ndërtimeve sepulkrale, por janë përdorur në portat e qytetit në Amantia dhe në godinat e këtij qyteti[18]).

Ky tip arkitektonik pasi formohet plotësisht njeh edhe një evolucion të brendshëm duke kaluar në tipin me një ambient, që siç e pamë është më i vonë. Pavarësisht se një gjë e tillë duket se ndodh edhe në Maqedoni (Karica, Malatheria[19]), ne nuk njohim një lidhje të drejtpërdrejtë, sepse në Iliri kjo kryhet në mënyrë graduale. Tek varri i Bylisit shohim të zhduket paradhoma dhe hyrja zhvendoset nga e djathta me një korridor të shkurtër. Njëkohësisht vetë dhoma ruan sofatet si element me rëndësi i ritit të varrimit. Në varret e Matohasanajt, si një fazë e dytë, zhduket edhe sofati, duke i lënë vendin arkave të hirit. Gjatë këtij evolucioni, tipi merr një formë e cila vetëm në dukje u ngjan varreve më të vona të Maqedonisë, të cilat e kanë hyrjen në mes të ambientit dhe janë pa sofate.

Në kuadrin e këtij tipi është konceptuar nga ndërtuesit ilirë edhe varri i Klosit. Ndryshon vetëm mënyra e mbulimit me qemer diedër të krijuar nga mbështetja e pllakave. Si formë planimetrike ai rreshtohet në tipin me dy ambiente (në qoftë se janë të sigurta mbeturinat e paradhomës). Sidoqoftë trajtimi i pjesës qendrore dhe veçanërisht mbulimi me pllaka në formë çatie nuk gjen paralele në arkitekturën ilire të kohës[20]). Nga ana tjetër ky tip varri njihet gjerësisht në Rusinë Jugore (Olbia), që nga shek. IV p.e.sonë[21]), por nuk mungon dhe në Greqi dhe Italinë e Jugut[22]). Përderisa në vendin tonë kemi një ekzemplar të vetëm që lidhet me një farë mënyre me tipin e parë të varreve, ende nuk mund t'i japim atij një vend të veçantë. Materialet e zbuluara në të (tab. VI, 2), nuk shkojnë më herët se shek. II p.e.s.

Tipi i dytë ai me qemer të rremë, megjithëse përfaqësohet nga një numër i madh ekzemplarësh, ka një shtrirje gjeografike mjaft të kufizuar. Ai është konstatuar deri sot vetëm në zonën e ngushtë të Gjirit të Vlorës.

Për sa i përket pjesës së poshtme, dhomës me tulla, ajo njihet në pak raste si ndërtim sepulkral në Apolloni dhe Belsh[23]). Por ajo që i tipizon varret e Gjirit të Vlorës është qemeri i rremë, prandaj nuk mund të vendosim lidhje të drejtpërdrejtë të tyre me ato të Apollonisë. Një paralelizëm të largët si vend, por të afërt si mënyrë ndërtimi e gjejmë tek një varr i fundit të shek. IV – fillimi i shek. III p.e.sonë, nga rrethet e qytetit Sevtopol në Trakë. Megjithëse qemeri i këtij varri është i njejtë në parim, ai është ndërtuar me tulla në formë trapezoide të pregatitura për këtë qëllim dhe ka në prerje formë pyke. Natyrisht ne nuk shohim këtu asnjë lidhje origjine por vetëm rrugë të ngjashme në përdorimin e formave arkitektonike nga mjeshtrit ilirë dhe trakë.

Tipi i tretë i ndërtimeve sepulkrale të qyteteve ilire, ai me ambient katërkëndësh të mbuluar me pllaka dhe të vendosur brenda një platforme, është zbuluar deri më sot vetëm në Amantia. Jashtë Ilirisë nuk njohim ndonjë ndërtim të ngjashëm dhe ka shumë mundësi që ai të jetë një krijim origjinal i mjeshtërve ilirë.

Të tria tipet e ndërtimeve sepulkrale që ndryshojnë nga forma dhe materiali i përdorur, kanë të për-

16) N. Ceka, La ville illyrienne.. f. 191-192.

17) Psh. Nga varri i Nausës, shih K. Rhumnopolos, **A new monumental chamber tomb with paintings of the hellenistic period near Lefkada** A.A.A. VI, 1973, 88-93.

18) Një pjesë harku nga një godinë publike e ka botuar K. Patç. **vep. cit.** fig. 23.

19) A. Orlandos, **vep. cit.** tab. I, 12, 14, Të dy datohen në fund të shek. III p.e.sonë.

20) I vetmi rast që mund të referohemi për krahasim është përdorimi i harkut mbështetës në frengjitë e kullës së Vagalatit. Shih Dh. Budina; **Harta arkeologjike e bregdetit Jon dhe pellgut të Delvinës,** «Iliria», I, 1971, fig. 28.

21) M. Paravic – Peshikan, **Nekropol olvii elénistiçeskovo vremeni,** 44-45.

22) A. Orlandos, **vep. cit.** f. 231-232.

23) S. Anamali. **Të dhëna mbi elementin ilir në qytetet antike Epidamn dhe Apolloni,** B.SH.SH. I. 1956, 21. A. Mano, **Nekropoli i Apollonisë, Tuma 1** «Iliria» I, 125, N. Ceka **Vendbanimi i hapur...** 58.

DOKTORSKI

bashkët jo vetëm destinacionin por edhe karakterin, në kuptimin e gjerë të fjalës. Ato i bashkon fakti se janë ndërtime me karakter qytetar, duke patur parasysh ndeshjen e tyre kryesisht në nekropolet e qendrave qytetare. Tipet më të zhvilluara nga pikëpamja arkitektonike, me qemer cilindrik dhe ai me platformë, i përkasin padyshim shtresës skllavopronare të qyteteve. Ato dalin si ndërtime në fund të shek. IV p.e.sonë, krahas krijimit të qyteteve dhe zhduken në shek. I p.e.sonë, kur qytetet ilire ishin në një rënie të vazhdueshme. Gjatë kësaj kohe ato pësojnë një evolucion që prek kryesisht tipin planimetrik dhe pjesët që kishin të bënin me ritin e varrimit. Si pasojë e përpunimit të tipeve ata shkëputen gjithmonë e më shumë nga prototipet, ndonjeri prej të cilëve (varri me dy ambiente me qemer) u huazua drejtpërdrejtë nga popujt fqinjë. Me interes është të theksojmë zhvillimin paralel të tipeve dhe formave arkitektonike të varreve me qemer në Ilirinë e Jugut dhe vendet e tjera të kohës helenistike (Maqedoni, Trakë, Propontide, Greqi etj.), që pat si pasojë krijimin e disa varianteve me veçori të theksuara lokale. Për këtë arsye mund të themi se ndërtimet sepulkrale përbëjnë një kategori të veçantë në arkitekturën ilire që dallohet për tipare karakteristike të lindura gjatë zhvillimit të pavarur lokal, disa herë mbi bazën e prototipeve me karakter të përgjithshëm helenistik.

DO NOT COPY



a



b



3

1



c



d



2

DO NOT COPY


1
2
B
a
A
0 1 2 m
3
A - A'
b
B - B'
c
0 50 100 cm
d
a
A
A
4
A - A'
0 1 2 m
b
0 30 60 cm
c
0 50 100 cm

DO NOT COPY













DO NOT COPY



















DO NOT COPY

TAB. V



1a







1b







DO NOT COPY

DO NOT COPY







1

PREMJA A-A





3

VARR ME DY AMBJENTE ME QEMER

VARR ME NJE AMBJENT ME QEMER

VARR ME PLATFORMË

VARR ME ÇATI PLLAKASH

VARR ME QEMER TE RREME

Neritan CEKA

DO NOT COPY

LES CONSTRUCTIONS SEPULCRALES DES CITES ILLYRIENNES

RESUME

Les constructions sépulcrales constituent un des éléments le plus caractéristique de l'architecture urbaine illyrienne. Ce type de monuments a été à peine abordé dans la littérature archéologique et bien que tous les cas connus y soient mentionnés, on ne dispose pas encore d'une publication les reproduisant complètement. Ceci est dû aussi au fait que les exemplaires entièrement déterrées sont plutôt rares et qu'un nombre très restreint d'entre eux sont utiles à la datation. Il est donc indispensable d'exposer tout ce matériel dans son ensemble, ce qui nous permettra dans le même temps de faire un effort en vue de déterminer la place des constructions sépulcrales, dans le contexte du fond architectural illyrien, et de tirer partie des données actuelles pour la typisation et la datation de ces monuments.

Le critère le plus approprié pour une classification typologique des constructions sépulcrales illyriennes est représenté plutôt par leur forme architectonique que par leur type planimétrique. C'est à partir de ce critère que nous avons pu distinguer des constructions couvertes d'un véritable cintre cylindrique, d'autres à faux cintres et d'autres encore représentant des tombeaux à couverture horizontale de plaques.

Dans le premier groupe l'on relève deux variantes se distinguant par la planimétrie mais ayant dans le même temps des liens génétiques assez évidents entre elles. La première variante comporte deux pièces (le vestibule et la chambre funéraire), elle est représentée par les tombeaux 1-2 d'Amantie, par le tombeau Nº 4 de Selce et par le tombeau de Persqop. Quant à la deuxième variante, elle comporte les deux tombeaux de Matohasanaj, certains exemplaires non encore complètement définis d'Amanatie et le tombeau 1 de Bylis. A l'exception des tombeaux de Selce et de Persqop, tous les autres monuments de ce même type se situent dans la vallée du cours moyen de la Vjose, principalement sur sa rive gauche. Malgré ce fait, même les exemplaires dispersés au point de vue géographique, se rattachent au type architectonique. Celui-ci se caractérise, dans la première variante, par des dimensions modestes de la planimétrie rectangulaire, dont le côté long varie de 4 à 5 m. et le côté court de 2.50 à 3.80 m. Exception le tombeau d'Amantie, dont la dimension est déterminée par son côté long. En ce qui concerne la largeur, dans tous les cas nous avons pris en considération l'ouverture du cintre qui varie de 1.80 à 2.90 m. Les tombeaux se situent généralement au pied des murs entourant la cité, toujours à proximité des principales voies d'accès. Leur entrée se trouve en général en direction est, avec des déviations vers le N.E. ou le S.E.

Les murs comportent toujours des blocs de pierre quadrangulaires à parements unis. Leur surface apparente, à Persqop et à Selce n'est pas travaillé ce qui montre qu'ils ont été enterrés avant d'être employés dans le tumulus. Par contre, à Amantie, leur parement est travaillé ce qui prouve on ne peut mieux que les monuments se trouvaient à la surface du sol.

La plus grande partie du volume de l'édifice revient à une chambre, en général de planimétrie carrée. Dans le tombeau 2 d'Amantie et dans celui de Persqop, le vestibule se retrécit au point qu'il perd sa fonction en tant que tel.

La largeur des murs est constitué par un seul bloc de pierre dont les dimensions varient de 0.35 à 0.65 m. En cas de largeur minimale (Selce, Amantie), la stabilité du mur est assurée en liant horizontalement les blocs de pierres avec des plaques de fer et de plomb. A Selce par exemple, la couche comporte des pierres taillées et à Persqop des plaques de pierre irrégulières.

Ces tombeaux sont couverts par une voûte vraiment cylindrique. En cas de monuments souterrains, la pression est contrecarrée per la masse de terre, mais étant donné que les exemplaires d'Amantie ne sont pas conservés entièrement il est difficile de définir la solution statique de leurs voûtes. L'inhumation avait lieu en général dans des urnes, qui sont disposées à l'intérieur des banquettes aménagées dans la chambre située sur le côté gauche de l'entrée (Persqop) ou sur ses trois côtés (Selce, Amantie). C'est à cette intention qu'on laissait un espace étroit entre la banquette et le mur pour y déposer l'urne. Ces espaces se voient clairement à Persqop, parce qu'ils étaient couverts par des blocs de pierre.

La deuxième variante, une chambre couverte de cintre, montre également qu'elle avait des liens organiques avec la première variante. Aucune différence quant à sa forme architectonique, car nous sommes en présence de la même voûte cylindrique. Sa planimétrie est plus simple du fait qu'elle manque du vestibule, qui a cédé sa place à un couloir étroit et peu long où a été aménagé l'entrée. Ce couloir est couvert seulement de plaques de pierre. L'absence du vestibule et les dimensions plus réduites ont contraint le constructeur à aménager l'entrée du côté de la chambre. A Bylis les tombeaux à deux chambres ont la même banquette, tandis qu'à Matohasanaj, où la banquette manque, nous avons relevé l'urne des cendres.

DO NOT COPY

Les tombeaux de la deuxième variante offrent des points de référence pour une datation plus récente par rapport à ceux de la première variante. L'urne trouvée dans le tombeau 2 à Matohasanaj témoigne d'une facture plus récente. En général l'inhumation à urne a été introduite en Illyrie dès le IIe siècle et devient typique pendant le Ier siècle a.n.è.

Pendant les travaux de déblayage effectués dans le tombeau de Bylis ont été mis à jour des fragments de vases. Leurs formes sont typiques des siècles II-I av.n.è.

En ce qui concerne le tombeau à deux chambres, pour le moment nous ne sommes pas en mesure d'avancer une datation exacte, malgré cela ce type de tombeau a été introduit en Illyrie du sud vers la deuxième moitié du IVe siècle av.n.è.

L'origine de ce type architectonique ne peut être examinée sans le détacher de celle du véritable cintre, qui en constitue le trait essentiel. La forme planimétrique et ses différentes variantes revêtent également de l'importance.

La grande majorité des tombeaux à cintre cylindrique a été mise à jour en Macédoine occidentale, où prédomine la variante à deux chambres. Ils se distinguent des tombeaux illyriens de même type par les dimensions qui sont plus grandes, par le traitement architectonique des facades et l'inhumation à tumulus. Le tombeau plus ancien rupestre de Selce e Poshtme est plus proche des tombeaux macédoniens, soit pour ce qui regarde son type planimétrique, le traitement du plafond en forme de voûte, sa façade de style ionien que le mode d'inhumation sur des banquettes disposées le long des murs latéraux de la chambre funéraire. C'est pendant la période fin IVe-IIIe siècle que les tombeaux à voûte en blocs de pierre deviennent, dans les agglomérations urbaines de l'Illyrie du sud, un usage habituel. Mais ils connaissent un développement indépendant et se distinguent des tombeaux macédoniens quant à leurs dimensions qui sont plus petites et à leur traitement plus simple. A la différence de la Macédoine, où ces tombeaux appartiennent principalement à l'élite de la classe esclavagiste urbaine et se situent à proximité des résidences royales, en Illyrie ils appartiennent à une couche plus vaste de la classe esclavagiste citadine. En témoigne le grand nombre d'exemplaires et leur présence parmi des tombeaux ordinaires à Amantie. C'est pourquoi nous est-il permis d'affirmer que ce type de tombeau est devenu une composante de l'architecture citadine illyrienne. L'arc et la voûte sont passés ainsi du domaine des constructions sépulcrales à celui des constructions urbaines: exemple les portes d'Amantie et les édifices de cette cité.

Ce type architectonique, après son élaboration intégrale, connaît également avec le temps une évolution intérieure, qui n'est autre que le type à une seule chambre funéraire. Bien que ce phénomène soit commun à la Macédoine aussi (Carica, Malathria), nous n'y voyons cependant aucune liaison directe parce qu'en Illyrie il s'est développe graduellement. Au cours de son évolution le type illyrien acquiert une forme qui seulement en apparence ressemble à celle des tombeaux plus récents macédoniens, dépourvus de banquettes et dont l'entrée est aménagée au milieu de la chambre funéraire.

C'est dans le contexte de ce type également que les constructeurs illyriens ont conçu le tombeau de Klos. Il s'agit là d'un type de tombeau largement répandu dans la Russie méridionale (Olbia) dès le IVe siècle av. n.è., mais que l'on a également identifié en Grèce et dans l'Italie du sud.

Etant donné qu'il n'existe chez nous qu'un seul exemplaire se rattachant plus ou moins au premier type de tombeaux, il n'est pas aisé de nous prononcer sur la place qu'il occupe dans notre classification des constructions sépulcrales.

Le deuxième type de tombeaux, celui à faux cintre, bien qu'il soit représenté par un grand nombre d'exemplaires, connaît une extension géographique beaucoup plus limitée. Il a été individualisé à ce jour dans une zone relativement étroite, celle du Golfe de Vlore.

En ce qui concerne la partie inférieure, soit la chambre en briques, on la rencontre rarement comme construction sépulcrale à Apollonie et Belsh. Le faux cintre étant une caractéristique typique des tombeaux du Golfe de Vlore, nous ne sommes pas en mesure d'établir des rapports directs entre ceux-ci et les tombeaux d'Apollonie. Malgré cela il existe un parallélisme lointain comme emplacement, mais proche comme mode de construction, entre les tombeaux du Golfe de Vlore et le tombeau situé dans les environs de la ville de Sevtopol en Thrace et appartenant à la période fin IVe siècle-début IIIe siècle av.n.è. Evidemment, il ne s'agit pas là d'une liaison d'origine, mais seulement de voies semblables dans l'emploi des formes architectoniques par les maîtres illyriens et thraces.

Quant au troisième type de construction sépulcrale, celui à chambre rectangulaire couverte de plaques et installée dans une plate-forme, il n'en existe qu'un seul exemplaire à Amantie. A ce que nous sachions ce type de tombeau n'est pas connu hors d'Illyrie et il est fort probable qu'il soit une création originale des maîtres illyriens.

Ces trois types de constructions sépulcrales, qui se différencient par la forme et les matériaux employés, ont en commun non seulement la destination mais encore le caractère. Ils appartiennent à la classe esclavagiste citadine et ont vu le jour vers la fin du IVe siècle av.n.è., de pair à la fondation des villes, et sont disparus au Ier siècle av.n.è., alors que les cités illyriennes étaient en plein déclin.

C'est au cours de cette période que ces trois types de constructions sépulcrales subissent une évolution qui en affecte principalement la planimétrie et les éléments se rattachant au rite funèbre. Par suite de leur élaboration, ils se détachent toujours plus de leurs prototypes et élargissent leur extension géographique au point d'être directement empruntés (le tombeau à deux chambres à cintre) par les peuplades voisines. Il est intéressant de relever le développement parallèle des types et des formes architectoniques de tombeaux à cintre en Illyrie du Sud et dans d'autres pays du monde hellénistique (Macédoine, Thrace, Propotyde, Grèce, etc.), ce qui a entrainé la création de variantes ayant des traits locaux bien distincts. Il nous appartient donc d'affirmer que les constructions sépulcrales constituent une catégorie à soi dans l'architecture l'illyrienne, catégorie se distinguant par des traits particuliers qui ont vu le jour pendant leur développement local indépendant sur la base des prototypes à caractère plus général hellénistique.

DO NOT COPY

një kornizë tullash të vendosura për së gjati në një sipërfaqe me murin.

Sot muret kanë një lartësi mesatare prej 3.5 – 4 m, deri në lartësinë e trapit. Vetëm në murin A, pranë kullës Nr. 2, në një distancë prej gati 8 m ruhet lartësia më e madhe e tij. Pikërisht këtu mund të dallojmë disa bedenë, që në periudhat e mëvonshme kanë pësuar ndryshime (Tab. II, a, b). Në mes të kësaj ane ndodhet dhe një kullë katërkëndëshe, e dalë nga muri 1 m, dhe me ballë të gjerë 9.30 m Tab. I, 1).

Periudhës së parë të ndërtimit i takon dhe e tërë kulla e rrumbullakët Nr. 1. Kulla ka një diametër të brendshëm 5.40 m, dhe lartësi të dukshme të mureve nga brenda jo më tepër se 2.5 m. Mbi murin e kullës gjëndet një trap i ngushtë 0.55 m, ndërsa mbi parapetin 0.85 m të gjerë duken shenjat e anës së djathtë të një frengjie. Hyrja e kullës sot nuk ruhet. Në vend të saj në mur ka mbetur një zgavër e madhe (Tab. II, d).



Fig. 1

Brenda kalasë kullat e rrumbullakëta nuk e ruajnë formën e tyre të harkuar, por kalojnë në faqe të drejta. (Fig. 4. Tab. I, 1, 2, 3), në të cilat ndodhen edhe portat e tyre. Në gjëndje të mirë ruhet porta e katit të parë e kullës Nr. 2. Shpatullat e saja, janë të ndërtuara me gurë dhe me tulla ndërsa pjesa e sipërme mbyllet me një hark, prej tre gurësh të harkuar në formë segmenti, mbi të cilin janë vendosur horizontalisht copa tullash të lidhura me një shtresë të trashë llaçi. Mbi to ndodhet harku i shkarkimit i ndërtuar me tulla që vazhdon në të gjithë gjatësinë e korridorit të portës (Tab. II, e).

Korridori prapa portës është i vogël me gjatësi 1.30 m. dhe gjerësi 1.10 m. Muret anësore janë të ndërtuara vetëm me gurë, ndërsa qemeri me tulla. Dyshemeja shkon duke zbritur drejt portës së ambientit. E ngjashme me këtë është edhe porta e katit të parë në kullën Nr. 3 (Fig. 5). Në këtë rast harku me tulla, ndryshe nga ai i kullës Nr. 2, është i kufizuar nga sipër me një kornizë tullash të vendosura në mënyrë horizontale, të cilat në kulmin e harkut përfundojnë me majë. Llaçi në fugatura ka trashësinë e vetë tullës, 4-5 cm. Harku prej guri sot është i rrëzuar së bashku me mbushjen ndërmjet tyre, por në të dyja anët e portës, në llaç kanë mbetur gjurmët e gurëve dhe gjurmët e mbushjes midis dy harqeve, të cilat vërtetojnë ngjashmërinë e këtij harku me atë të kullës Nr. 2. Pjesa tjetër që ndodhet prapa portës është plotësisht e ngjashme me atë të kullës Nr. 2.

Po kësaj periudhe ndërtimi i përket edhe porta e katit të sipërm në kullën Nr. 3 (Tab. I, 4), që ndodhet në të njëjtën faqe muri dhe mbi portën e katit të parë. Për të shkuar në katin e sipërm kalohet nëpërmjet shkallëve që ndodhen në faqen e murit C dhe trapit para portës.

Porta si bordurën ashtu dhe harkun i ka të ndërtuara me tulla. E ngjashme me këtë ka qenë edhe ajo e katit të sipërm në kullën Nr. 2, prej së cilës sot kanë mbetur vetëm disa pjesë të harkut.

Në kullat Nr. 2 dhe 3 në anën e jashtme të kalasë prej periudhës së parë të ndërtimit ka mbetur bazamenti i rrumbullakët dhe pjesë të mureve të kullave që lidhen me muret rrethuese. Në kullën Nr. 3 ruhet faqja e kullës që lidhet me murin D, dhe në kullën Nr. 2 dy faqet e saj që lidhen me murin A dhe B, të cilat e ruajnë formën e harkuar të kullës së rrumbullakët (Tab. IV, 1, Tab. V a). Në faqen e kullës Nr. 2 që lidhet me murin A, në pjesën e ndërtuar në periudhën e parë, dallohet një frengji në formë të një të çare vertikale, e cila lidhet me katin e parë të saj (Tab. III, a, b). Gjithashtu në murin e kësaj periudhe dallojmë njërin krah të një frengjie në formë dritareje. Prej saj ka mbetur një qoshe dhe një pjesë e harkut (Tab. III, a, b).

Kulla në qoshen perëndimore të kalasë u zbulua gjatë një sondazhi në vitin 1966. Gjatë tij përveç themeleve të kullës së rrumbullakët doli edhe themeli i murit rrethues të rrëzuar, që i takojnë periudhës së parë të ndërtimit.

Duke u mbështetur në karakteristikat e ndërtimit dhe në gjurmët që kemi mundur të dallojmë, mund të bëjmë një rikonstruksion të periudhës së parë të kalasë.

Forma më e vjetër e kalasë ka qenë katërkëndëshe këndrejtë me nga një kullë të rrumbullakët në të katër qoshet dhe një kullë në formë katërkëndëshi këndrejt

DOKTORI

në faqen e murit A (Tab. I. 1). Kalaja komunikonte nëpërmjet një hyrjeje të vetme që ndodhet në murin C. Mbi mur, nga brenda kalasë, ndodhet trapi për qëndrimin dhe lëvizjen e luftëtarëve, ndërsa në gjysmën tjetër të trashësisë së murit ngrihej parapeti 1 m i lartë, mbi të cilin ngriheshin bedenat me lartësi 1.10 m dhe me hapësira ndërmjet njëri-tjetrit prej 0.75-0.80 m. (Tab. II, b). Kullat kanë qenë me dy kate. Kati i poshtëm ndahej në dy pjesë, në një depo jo më të lartë se 1.40 — — 1.50 dhe në një ambient tjetër me dysheme druri, me lartësi afërsisht 2.50 m. që fillonte në lartësinë e hyrjes. Këtij kati i takon edhe frengjia në formën e një të çare vertikale që kemi përmëndur për kullën Nr. 2 (Tab. III, a, b).

Edhe kati i sipërm ka qenë shtruar me dysheme dërrase në lartësinë e trapit që ndodhet në muret rrethuese dhe në kullën e rrumbullakët. Duke u nisur nga gjurmët e frengjive që ndodhen në kullën e rrumbullakët dhe në atë Nr. 2, mund të themi se frengjitë e katit të dytë të kullave kanë qenë në formë dritareje të mbuluara nga sipër me hark tullash me ngushtim nga brenda jashtë. Në lidhje me vendosjen dhe numurin e tyre nuk mund të themi gjë me saktësi, por, duke u nisur nga gjurma që shohim në kullën e rrumbullakët, mund të mendojmë se ato kanë qenë tri, një në mes dhe dy anash. (Tab. II, d. Tab. III, b).



Fig. 2

Muret e kullave kanë qenë gati 1 m më të larta se ato të rrethimit. Si portat e katit të poshtëm të kullave Nr. 2 dhe Nr. 3, kanë qenë edhe ato të dy kullave të tjera të qosheve. Ndërsa porta e vetme e periudhës së parë për katin e sipërm, ka mbetur vetëm në kullën Nr. 3. (Tab. I, 4).

Periudha e dytë. Kësaj periudhe ndërtimi i takojnë dy grupet e ambienteve a dhe b, të mbështetura në murin A, xhamia e ndërtuar mbi grupin b të ambienteve, porta e vogël e hapur në kullën katërkëndëshe, si edhe ambientet c dhe d. (Tab. I, 2).

Muret e kësaj periudhe janë të ndërtuara me gurë lumi në shumë raste të gdhendur. Ndryshe nga periudha e parë, llaçi nuk rrethon gurët në formë kornize. Gjithashtu kuptohet që muratura e këtyre ndërtimeve nuk është e lidhur, por vetëm mbështetet në ato të periudhës së parë.

Grupi a ka tetë ambiente të ngushta, disa prej të cilave komunikojnë me njeri-tjetrin nëpërmjet disa hyrjeve të vogla.Me anë të ambientit të parë kalohet në kullën Nr. 1 (Tab. I, 2, a). Grupi b i ambienteve mbështetet në anën e brendshme të kullës katërkëndëshe. Në këtë periudhë mbi këto ambiente dhe mbi kullën katërkëndëshe ndërtohet një xhami e vogël pa minare. Xhamia është ndërtuar kryesisht për të kryer ritet fetare ushtarët që jetonin në kala. Me sa duket, në këtë periudhë nuk ka pasur xhami tjetër jashtë kalasë, prandaj, u hap një portë e vogël në murin e kullës katërkëndëshe, e cila bënte të mundshëm komunikimin e banorëve jashtë kalasë me xhaminë (Tab. I, 2 b).

Porta ishte ndërtuar gati 1.50 m nga sipërfaqja e tokës me qëllim që të mos pengohej nga galeritë, të cilat po për këtë qëllim ishin ndërtuar pak më poshtë nga ato të grupit të I. Porta me qemer guri është e vogël, 1,90 m e lartë dhe 1 m e gjerë.

Në grupin c janë dy ambiente me përmasa të ndryshme. Ambienti i parë lidhet me oborrin e kalasë me dy hyrje, ndërsa ambienti i dytë komunikon me oborrin nëpërmjet ambientit të parë. Të dyja ambientet janë mbuluar me qemer guri, ku shikohen edhe sot gjurmët e armaturës prej dërrase që janë përdorur për ndërtimin e tyre. Për mbështetjen e qemerit në krahun e majtë është ndërtuar një mur që i vishet murit të kalasë (Tab. I, 2, c, Tab. II, c).

Në këtë periudhë u rrethua me mur një namazgja në anë jugperëndimore të kalasë, duke përfshirë kullën e qoshes perëndimore, të gjithë oborrin para murit C dhe portën e kalasë.

Periudha e tretë. Gjatë kësaj periudhe janë bërë punime të rëndësishme, të cilat e kanë ndryshuar pamjen e kalasë nga periudha e parë dhe e dytë. Kësaj periudhe i takojnë pjesa më e madhe e ndërtimeve brenda dhe jashtë kullave. Nr. 2 dhe 3, tërësisht kullat Nr. 4, 5, 6 dhe disa meremetime të vogla në murin rrethues (Tab. I, 3).

PHOTOCOPY

Kati i parë në kullat Nr. 2 dhe 3 është në formë rrethi me një diametër të brendshëm prej 3.85 m. Në rast se e krahasojmë me atë të kullës së rrumbullakët me diametër 5.35 m të periudhës së parë, do të kemi një diferencë prej 1.50 m, që tregon se ish kullës së rrumbullakët i është veshur nga brenda një mur i ri me trashësi 0.60 – 0.75 m, mbi të cilin mbështetet kubeja e ndërtuar me gurë të vendosur në formën e rrathëve koncentrikë. Mendimin se muri që vesh nga brenda kullën është i një periudhe të mëvonshme, na e vërteton edhe teknika, e cila nuk është e ngjashme me atë të periudhës së parë, si dhe fakti që ky mur në hyrjen e katit të parë është i shkëputur nga ai i korridorit që kemi përmendur më sipër, duke dalë si mur më vete, i palidhur, me një trashësi prej 0.65-0.70 m.

Dyshemet e këtyre dy kullave (në kullat Nr. 2 dhe 3) janë 1.40 m. më poshtë se niveli i hyrjes. Në këtë lartësi në murin e kullës janë zgavrat e trarëve ku mbështetej dyshemeja e katit të parë. Pjesa nën dysheme, me lartësi 1.40 m, ka qenë përdorur si depo ose sterrë. Sot dallohen aty dy shtresa suvaje izoluese që mbulojnë si dyshemenë, edhe muret anësore të saj (Tab. V, d).

Në të dy krahët e hyrjes, në katin e parë, në kullën, Nr. 2 ka nga një frengji, që ka mbetur nga periudha e parë, ndërsa në kullën Nr. 3 kjo frengji gjendet vetëm në anën e djathtë të hyrjes (Tab. V, a). Ky ambient nuk është përdorur për luftim, mbasi një ose dy frengji të vogla janë të pamjaftueshme për këtë qëllim. Në këtë periudhë ambientet janë përdorur si depo ose për të banuar ushtarët dhe frengjitë kanë shërbyer për ajrosjen e tyre.

Punime të kësaj periudhe në katin e dytë gjënden vetëm në kullën Nr. 2 që nga brenda ka pak a shumë formën e një tetëkëndëshi. Kulla ka një hyrje 0.76 m të gjerë dhe 1.60 m të lartë, që mbulohej dikur me një hark të madh guri. Në të dyja anët e saj ndodhet nga një frengji e vogël me tri vende për vendosjen e pushkëve, që përfundojnë jashtë me të çara të holla vertikale.

Përballë hyrjes kulla ka një frengji të vogël topi. Në të dyja anët e saj dhe ndërmjet dy frengjive për pushkë, që përmëndëm më sipër, shihen gjurmët e dy frengjive të tjera të njëllojta me të parën, që është e plotë (Tab. IV, 1, a, Tab. VI, b). Gjurmët e tyre shihen edhe jashtë kullës. Frengjia është e lartë 0,73 m, e gjerë 0.54 m dhe sipër e mbuluar me hark guri (Tab. IV, 3).

Deri në lartësinë 1.45 m kulla ka qenë e suvatuar. Edhe dyshemeja e saj është shtruar me një suva të kuqe, e cila ngrihet 0.10 m, e lartë në faqen e murit në formë kornize. Një kornizë tjetër, po nga kjo suva, 0.08 m. e trashë gjendet edhe rreth dritares së frengjisë së topit (Fig. 6).

Në pjesën e brendshme të kësaj kulle, në lartësinë



Fig. 3

1.45 m nga dyshemeja, është një trap që ka qenë i shtruar me rrasa guri. Gjerësia e tij prej 1 m është e mjaftueshme për qarkullimin dhe monevrimin e luftëtarëve, gjithashtu lartësia jo e madhe e tij nga dyshemeja dhe fakti që është i shtruar me rrasa, tregojnë se kulla nuk ka pasur kat të tretë. Parapeti pranë tij ka dhjetë frengji, me anën e të cilëve kontrollohet i gjithë vendi para kullës. Në këtë mënyrë kati i dytë i kësaj kulle ka dy nivele luftimi, ai në pjesën e poshtme me tri frengji topash dhe dy pushkësh me nga tri vende dhe niveli i dytë, mbi trap, vetëm për pushkë. (Tab. IV, 1, 2, Tab. VI, b).

Kulla ka qenë e mbuluar me çati. Një kanal, që sot dallohet mjaft mirë në krahun e majtë të hyrjes, përshkon murin e periudhës së tretë me tuba balte të pjekur dhe, me sa duket ky e dërgonte ujin e çatisë në

DO NOT COPY



Fig. 4

pjesën e poshtme të kullës, për të cilën kemi thënë se mund të ishte edhe sterrë.

Gjatë kësaj periudhe ndryshime themelore kanë pësuar edhe nga jashtë kullat Nr. 2 dhe 3. Duke u veshur me mure të reja, faqet e të cilave shkojnë duke u ngushtuar nga poshtë lart e kështu kulla merr pak a shumë formën e një piramide të cunguar, nga forma e rrumbullakët e periudhës së parë, ato kalojnë në formën e një tetëkëndëshi.

Muret e të dyja kullave, me përjashtim të dy faqeve që lidhen me muret rrethuese A dhe B për kullën Nr. 2 dhe të faqes që lidhet me murin D për kullën Nr. 3 janë të ndërtuara me gurë lumi të gdhendura mirë dhe të vendosur në rreshta paralelë, ndërsa gurët që formojnë qoshet ku bashkohen faqet e kullave, janë të gdhendura me daltë.

Në këtë periudhë kullës katërkëndëshe të periudhës së parë, në portën e vogël të hapur në periudhën e dytë iu mbështet një kullë e madhe me gjashtë faqe, Nr. 4 (Tab. I, 3). Muret e saj janë ndërtuar me të njëjtën teknikë ndërtimi të mureve të kullave të tjera.

Kulla është me dy kate. Kati i parë ka tri ambiente me lartësi 2 m dhe gjerësi 1.75-1.80 m të mbuluara me qemer guri (Tab. VI, d). Të tri ambientet e tij kanë bodrume me thellësi 1,40 m nga dyshemeja me dërrasa. Bodrumet, si dyshemetë edhe muret anësore i kanë të suvatuara mirë me llaç izolues, prandaj mund të mendojmë që janë përdorur si depo apo sterra uji.

Qyteti në këtë kohë, me sa duket, ishte zgjeruar në pjesën veriore dhe verilindore të kalasë, ku terreni është më i sheshtë dhe më i gjerë. Një gjë të tillë e dëshmon edhe ndërtimi i tri xhamive dhe i një teqeje në këtë anë. Prandaj hapja e një porte të vogël u bë pikërisht në murin A, ndërmjet kullës Nr. 1 dhe asaj Nr. 4, për të pasur lehtësi komunikimi me qytetin (Tab. I. 3, e).

E periudhës III është edhe kulla Nr. 6, në mes të gjatësisë së faqes B që ka formën e një piramide të cunguar me bazë në formë pesëkëndëshi, e mbështetur në murin rrethues. Për ndërtimin e saj është prishur nga periudha e parë e ndërtimeve njëri krah i shkallëve për të hipur në trapin e murit B dhe vendpushimi i tyre (Tab. I, 3, 6). Nga brenda kulla ka formën e një gjysmërrethi me dy radhë frengjish, radha e parë e të cilave është prishur, ndërsa e dyta ka gjashtë frengji pushkësh, mjaft lart nga dyshemeja, të vendosura në mënyrë alternative një me dy vende dhe një me një vend. (Tab. VI, C).

Kjo, përveç funksionit si kullë, luante njëkohësisht edhe rolin e një kontraforte për këtë faqe muri, që kishte filluar të anohej nga jashtë qysh para ndërtimit të saj.

Në këtë periudhë u ndërtua edhe një hark i madh në murin A, ndërmjet kullës Nr. 2 dhe Nr. 4. Qëllimi i parë i ndërtimit të tij ka qenë arsyeja dekorative, mëvonë në këtë vend është ndërtuar një kullë e ngjashme me atë në faqen B. Harku në këtë kohë ka shërbyer si hyrje e kësaj kulle (Tab. I, 3, 5,). Gjurmët e një harku tjetër të madh, që është shembur, dallohen edhe në hyrjen e katit të dytë të kullës Nr. 2.

Po në këtë periudhë u bë meremetimi i murit rrethues ndërmjet harkut të madh dhe kullës Nr. 4 dhe mbyllja e hapësirave ndërmjet bedenave në krahun tjetër të harkut, duke ndërtuar në njërën hapësirë një



Fig. 5

DO NOT COPY



Fig. 6

frengji topi dhe në të tjerat frengji pushke. (Tab. II, a, Tab. IV, 1, C). Po kështu në murin B, pranë kullës Nr. 2, në hapësirën midis dy bedenave u ndërtua një frengji topi, prej së cilës sot kanë mbetur vetëm disa gjurmë në mur. (Frengjitë e topave të kësaj periudhe kanë të njëjtin ndërtim e madhësi si të frengjisë në kullën Nr. 2 (Tab. IV, 3).

Periudha e katërt. Në ndërtimet e kalasë dallojmë edhe një periudhë të katërt, e cila si kohë nuk duhet të jetë larg me ndërtimet e periudhës së tretë. Këtu bëjnë në pjesë dy frengji të mëdha topash në kullën Nr. 2, që janë ndërtuar duke prishur dy frengjitë e vogla, gjurmët e të cilave kanë mbetur në anë të atyre të ndërtuara rishtas. Gjithashtu edhe muri i ndërtuar rishtas me zgjerimin e tyre ka mbetur i pasuvatuar, ndryshe nga pjesa tjetër. Ndërtimi i frengjisë së madhe në krahun e djathtë të hyrjes ka prishur njëkohësisht edhe një nga tri vendet për pushkë të frengjisë së këtij krahu (Tab. IV, 1, b, Tab. VI, b).

Në ndërtimin e këtyre kanë ndjekur tipin e frengjive që prishen, por të rejat janë më të mëdha (më të larta dhe më të gjata). Frengjia e tretë që nuk prishet, adaptohet në frengji për pushkë (Tab. IV, 1, a, Tab. III, c).

Të kësaj periudhe janë tri frengjitë e topave dhe ato për pushkë në kullën Nr. 3 (Tab. VI, a). Këto janë të ngjashme me ato të kullës Nr. 2, me të vetmin ndryshim se pjesën e brendshme, ku vendoset topi, e kanë më të madhe se pjesën e jashtme (Tab. V, b).

Në lartësinë 2.40 m nga dyshemeja mbi murin ku ndodhen frengjitë, është një trap jo i rregullt, i pamjaftueshëm për qëndrimin e luftëtarëve, por ai ka shërbyer për mbështetjen e dyshemesë. Kështu që kulla Nr. 3 ka pasur tri kate. Kati i dytë me të tretin komunikonte me shkallë druri brenda kullës. Në parapetin e katit të tretë, që nuk duhet të ketë qenë mjaft i lartë kanë mbetur sot disa frengji pushke (Tab. V, c,).

Me anë të këtyre dy rreshtave frengjish kontrollohet më së miri vendi para kullës, si edhe ai para mureve D dhe C.

Kjo kullë, së bashku me kullën e qoshes v.p. që sot nuk ruhet, e kryenin mjaft mirë funksionin e mbrojtjes së portës që ndodhet në mes të gjatësisë së murit C. Këtë funksion e lehtësonte njëkohësisht edhe terreni i pjerrët si edhe muri i namazgjahut, që krijon një farë mbrojtjeje. Kjo është arsyeja që kulla e rrumbullakët, mbasi u shemb, nuk u rindërtua më, por u ndërtua një kullë e vogël (Nr. 7) pranë saj, në murin B, e cila është nga ndërtimet e fundit. Kulla është me bazë katrore. Deri në nivelin që ajo ruhet, është e mbushur me mur. Me sa duket, vetëm në pjesën e sipërme do të ketë qenë e rrethuar me mure dhe me bedena (Fig. 7. Tab. I, 7).

Problemi i datimit të kalasë. Problemi i datimit të periudhës së parë paraqet vështirësi, mbasi nga dokumentat mund të përcaktojmë me afërsi vetëm periudhat e mëvonshme të ndërtimit. I vetmi burim, ku mund të mbështetemi, është përshkrimi i udhëtarit turk Evlija Çelebiut, i cili, që të merret si i saktë, ka nevojë të mbështetet edhe nga argumente të tjera. Një nga këto është ngjashmëria e saj me kala të tjera, ku të dhënat për datimin e tyre janë më të sakta.

Ashtu si kalaja në Prezë, edhe kalaja e Peqinit është ndërtuar kryesisht për funksion kontrolli. Ajo mbikqyrte lëvizjen në rrugën që kalonte pranë saj dhe ushtronte kontroll për mbledhjen e taksave popullsisë së kësaj zone të pasur bujqësore. Përveç këtij funksioni të përbashkët, këto dy kala kanë ngjashmëri edhe në teknikën e ndërtimit dhe në arkitekturën e tyre. Kështu p.sh. në të dyja vëmë re formën katërkëndëshe të planimetrisë me kulla të rrumbullakta në qoshet dhe vetëm një kullë katërkëndëshe me ballë të gjerë në mes të gjatësisë së një faqeje, si edhe teknikën e thjeshtë të muraturës, ku dallojmë futjen e gurit në një kornizë

DO NOT COPY



Fig. 7

llaçi. Në të dyja rastet vërejmë përdorimin së bashku të harqeve në formë të një segmenti rrethi me ato me majë të mprehët dhe shpesh kufizimin e tyre nga sipër me tulla. Në një rast të vetëm, në portën e katit të parë në kullën Nr. 3 të Peqinit, mund të mendohet, nga gjurmët që dallohen aty, që mbushja ndërmjet dy harqeve të jetë vendosur në mënyrë simetrike, ashtu si në portën e kullës Nr. 1 në kalanë e Prezës[9]). Ngjashmërinë, për sa u takon shkallëve me dy krahë, e vërejmë edhe në Kalanë e Gjon Boçarit në Tragjas, që datohet në sh. 14-15[10]).

Në regjistrimin e vitit 1431-32 Peqini figuron si një qendër e vogël me nëntë shtëpi me emrin Biklenet, në nahijen Markesh të vilajetit të Pavllo Kurtikut[11]). Në rast se kalaja do të ishte ndërtuar disa kohë para kësaj date, në vitet e regjistrimit ajo do të ishte një qendër me një numër më të madh familjesh.

Duke u nisur nga këto ngjashmëri në periudhat e para të ndërtimit në këto kala, si edhe nga mendimi i udhëtarit turk mbi ndërtimin e kalasë nga sulltani (emrin e të cilit nuk e jep), mund të themi se edhe kalaja e Peqinit është themeluar pak a shumë në të njëjtën kohë me atë të Prezës, në sh. 15, në periudhën pas vitit 1431-32.

Ndërsa periudha e dytë, që ka të bëjë me ndërtimin e ambienteve të xhamisë mbi ambientet e grupit b dhe murin e namazgjasë, i përket një periudhe më të vonë. Kjo periudhë duhet të jetë para vitit 1670, në të cilin kalaja u vizitua nga udhëtari turk Evlija Çelebiu. Në shënimet e tij kalaja përshkruhet në formë katrore, me nga një kullë në secilën qoshe, një xhami e vogël pa minare, gjurmët e së cilës kanë qenë deri vonë mbi grupin b të ambienteve, si dhe një portë e vogël nën xhami[12]). Sigurisht që në këtë rast, ai e ka fjalën për portën e vogël në kullën katërkëndëshe, mbasi porta e vogël është shumë larg nga xhamia, e cila në ato kohë nuk ka qenë hapur.

Me ndërtimin e kalasë, numri i shtëpive pranë saj fillon të shtohet, prandaj në periudhën e dytë të ndërtimeve në kala në kullën nën xhami hapet porta e vogël me qëllim që xhamia t'i shërbente edhe kësaj popullsie.

Ndryshe nga vendbanimi i vitit 1431-32, në kohën kur vizitohet nga Çelebiu, Peqini është kthyer në një qytet të vogël të rregullt i shtrirë rreth kalasë. Ai e përshkruan me një numër të madh shtëpish, dyqanesh, shkollash, dhe tri xhami me minare, gjurmët e të cilave janë dalluar deri vonë[13]).

Periudha e tretë ka të bëjë me kthimin e kullave Nr. 2 dhe 3 nga të rrumbullakëta në poligonale, me ndërtimin e frengjive të topave si edhe me ndërtimin e kullës Nr. 4, 5 dhe 6, që u takon viteve 1770.

Në këtë kohë krahina dhe kalaja e Peqinit ishte shndërruar në shesh betejash ndërmjet Bushatllinjve të Shkodrës dhe Ahmet Kurt Pashës së Beratit për sundimin e mukatasë së Durrësit.

Kalaja, duke qenë në kufi të këtyre dy pashallëqeve të mëdha dhe nga politika përça e sundo e Portës së Lartë, shpeshherë mbas përpjekjesh të armatosura kalonte nga ndikimi i Bushatllinjve në atë të sundimtarëve të Beratit dhe anasjelltas. Në vitin 1775 njerëzit e Ahmet Kurt Pashës së Beratit marrin në duart

9) **L. Papajani, Kalaja e Prezës.** Monumentet Nr. 7-8, 167-181.
10) **A. Baçe.** Material në arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës, Tiranë.
11) **H. Inalcik. Suret-i defter-i soncak-i Arvanid.** Ankara 1954. T. 204, E. Çelebi emrin e vjetër të vendit e jep në formën Beklejen.
12) **Evlija Çelebi.** Po aty. «Kjo kështjellë ndodhet në një shesh në breg të Shkumbinit dhe ka formën katrore me një perimetër pesqind hapash, hendek s'ka por në katër anët ka katër kulla të rrepta si katër besnikë. Ana jugore është një kodrinë e lehtë ana veriore ka një portë që komunikon me Varoshin e Peqinit, muret e kësaj kështjelle janë 12 m të larta. Brenda rri dizdari dhe 20 ushtarë. Ka 5 topa, ka 30 shtëpi të vogla të mbuluara me tjegulla. Përmbi portë ka një xhami të vogël pa minare. Më të majtë të kështjellës ngjitur me mur ka një namazgja». f. 92.
13) **Evlija Çelebi** Po aty, «Varoshi i Peqinit ka zënë anën lindore, veriore e perëndimore të kështjellës dhe ka 400 shtëpi të mira.... Ky Varosh ka 7 lagje, 4 xhami me tjegulla, tri nga këto janë me minare të larta qagjir e të hijshme, njera e ka minaren të ulët». f. 93-96.

DO NOT COPY

e tyre sundimin e kalasë dhe të krahinës pranë[14]). Në muajin prill të këtij viti muret e saj mundën t'u bënin ballë topave të ulqinakëve që sollën Bushatllinjtë nga Durrësi. Mbas 8 muajsh, në dhjetor po të këtij viti (1775), sundimtari i saj nuk mundi t'i qëndronte zjarrit të fortë të artilerisë së Bushatllinjve, prandaj u largua fshehurazi[15]). Përveç këtyre ka pasur raste që kalaja ishte e detyruar t'u bënte ballë edhe rrethimeve të gjata, si është rasti i vitit 1785, kur kalaja qëndroi gjashtë muaj e rrethuar[16]).

Për t'u qëndruar këtyre rrethimeve të gjata dhe goditjeve të herëmbashershme të kundërshtarëve, kalaja ka pasur nevojë edhe për rindërtime, të cilat kryheshin në periudhat e qeta. Kulla Nr. 2 dhe Nr. 3 me planimetri në formë rrethi, me sa duket, kanë qenë vazhdimisht nën zjarrin e artilerisë dhe të sulmeve të kundërshtarit, mbasi para tyre shtrihet një terren i sheshtë, prandaj janë dëmtuar ose shembur krejtësisht. Në këtë periudhë me ngjarje të rëndësishme u bë rindërtimi i dy kullave, duke u kthyer nga baza rrethore në poligonale. Ndërsa ana jugperëndimore nuk paraqiste rrezik, mbasi vendi para saj ishte i thyer dhe muri i namazgjasë, krijonte një farë mbrojtje. Prandaj edhe kulla në qoshen perëndimore nuk u rindërtua mbas prishjes së saj. Përveç këtyre dy rindërtimeve në këtë periudhë kalasë iu shtuan edhe tri kulla të tjera në faqen e murit A (kulla Nr. 4 dhe 5) dhe në faqen B (kulla Nr. 6). Ndërtimi i tyre ka rëndësi jo vetëm se u shtuan grykat e zjarrit që u jepnin më tepër mundësi mbrojtësve të kontrollonin dhe të mbronin muret e saj, por edhe nga ana konstruktive, se ato formonin disa kontraforte të sigurta për muret rrethuese të kalasë. Nga teknika e ndërtimit këto kulla janë të ngjashme me disa kulla në Kalanë e Beratit[17]), të Shkodrës dhe Tepelenës[18]) që janë pak a shumë ndërtime të kësaj kohe që njihen si punime të kohës së Ali Pashë Tepelenës.

Këto rindërtime janë bërë në periudha të gjata qetësie. Një periudhë e tillë ka qenë edhe ajo ndërmjet viteve 1775 dhe 1785 që është një periudhë 10 vjeçare më se e mjaftueshme për rindërtimet e nevojshme në kala. Periudha e katërt e ndërtimit që shihet në zgjerimin e frengjive të topave në kullën Nr. 2 dhe Nr. 3, si edhe ndërtimi i një kulle të vogël me bazë katërkëndëshe në faqen e murit B, janë punime që nuk duhet të jenë të largëta në kohë me ato të periudhës së tretë.

Punimet restauruese. Kalaja e Peqinit, pasi e humbi funksionin si kala, është përdorur për një kohë të gjatë për banim dhe më tej u braktis. Gjatë kësaj periudhe, përveç ndryshimeve ajo ka pësuar edhe dëme të tjera të rënda. Kështu oborri i saj sidomos nga rrënimet e ndërtesave që kanë shërbyer për banim kohët e fundit, është mbushur gati 0.60-0.70 m me gurë dhe dhera.

Në vitin 1966 në kala u kryen për herë të parë punime pastrimi konservimi dhe restaurimi. Punimet e pastrimit kishin për qëllim të sistemonin oborrin, ambjentet e ndryshme, kullat dhe pjesën e jashtme nga gurët dhe dherat e grumbulluara prej vitesh. Kështu vendi para kullës Nr. 2, si edhe ai ndërmjet saj dhe kullës Nr. 6, u zbankua në thellësinë 1 – 1.30 m.

Punimet e konservimit dhe të konsolidimit u përqendruan kryesisht në muret rrethuese. Në pjesë të veçanta të tij si në murin D, pranë shkallëve, muri ishte dëmtuar duke krijuar zgavra të mëdha (Tab. VII, 1, 2). Në vende të tjera nga faqja e murit kishin rënë gurët duke zbuluar kështu muraturën e pjesës së brendshme (Tab. VII, 3, 4). Gjendja e krijuar paraqiste rrezik, prandaj ishte e nevojshme të merreshin disa masa konsoliduese për të mënjanuar dëmtimet e mëtejshme. Dëme edhe më të rënda kishin pësuar frengjitë në kullën Nr. 2 (Tab. VII, 5) dhe Nr. 3. Në mënyrë të veçantë në kullën Nr. 3 të tria frengjitë e topave, së bashku me ato të pushkëve që kanë pranë, ishin shndëruar në zgavra (Tab. VIII, 1, Tab. IX, 1), por me pastrimin e kullave nga brenda gjurmët e frengjive të dëmtuara u sqaruan deri në një farë mase dhe, duke u mbështetur edhe në gjurmët e frengjive të tjera dhe në ngjashmëritë ndërmjet tyre, u grumbulluan të dhënat e mjaftueshme për restaurimin e tyre[19]). Mbas restaurimit frengjitë si ato të topave, ashtu edhe ato të pushkëve në të dyja kullat u kthyen në gjendjen e tyre fillestare. Po kështu u krye restaurimi edhe në frengjitë e pushkëve në pjesën e sipërme të kullave (Tab. VII, 6, Tab. VIII, 2, 3, 5, Tab. IX, 2). Po në kullën Nr. 3 u kryen punime në portën e katit të dytë, ndërsa pjesa e dëmtuar e harkut u plotësua me tulla (Tab. I, 4).

Në ambientet e grupit të parë muret ndarës u ngritën deri në një farë lartësie njëkohësisht edhe qemeret e tyre u plotësuan pjesërisht (Tab. IX, 3, 4). Ndërsa në ato të grupit të dytë u kryen punime vetëm në pjesën e

14) S.N. Naçi, Po aty f. 107.
15) S.N. Naçi. Po aty f. 170.
16) S.N. Naçi po aty f. 164.
17) **A. Baçe.** Qyteti fortifikuar i Beratit. Monumentet, 1971 2, fq. 43-58.
18) **S. Bejko,** Kalaja e Tepelenës. Monumentet, 1971, 2, fq. 103-110.
19) Projekti i restaurimit është pregatitur nga K. Zheku, Fotografitë janë pregatitur nga K. Zheku dhe R. Veseli, Skicat nga A. Drazhi, F. Guralumi dhe P. Katroshi.

FOR NOT COPY

jashtme, në muret rrethuese të ambienteve (Tab. IX, 5, 6).

Përveç këtyre punimeve në kala u kryen edhe punime të tjera si plotësimi i disa bazamakëve të shkallëve, plotësimi i pjesëve të murit rrethues dhe kullave si dhe frengjive të tjera. Në kullën Nr. 4 ndërhyrjet qenë më të mëdha, po kështu edhe në kullën Nr. 6, e cila gjatë kohës kur kalaja përdorej për banim, ishte transformuar në furrë. Ajo u kthye në gjendjen fillestare, duke i restauruar të gjitha frengjitë.

Porta e vogël, në murin A, në pjesën e sipërme ka qenë mbyllur me arkitra druri, i cili me kalimin e kohës është kalbur dhe ka rënë bashkë me një pjesë të murit që ngrihej mbi të. Në të u vendos një arkitra i ri me dërrasa të trasha lisi, mbi të cilin u ngrit muri, që mbylli zgavrën e krijuar mbi portë. Porta në murin D, e hapur 30 vjetët e fundit, u mbyll me një mur të hollë. E vetmja hyrje për të komunikuar me kalanë, u la porta e vogël, tek e cila sot është vendosur një kanatë hekuri.

Gjatë restaurimit është pasur parasysh që ndërhyrjet të bëhen vetëm atëhere kur gjurmët qenë të qarta dhe nuk krijojnë dyshime. Gjithashtu me muraturën e re jemi munduar të imitojmë muraturën e periudhës përkatëse.

Punimet e kryera gjatë këtij viti i mënjanuan dëmtimet e mëtejshme të frengjive, të kullave dhe të muraturës në përgjithësi. Në këtë mënyrë ajo u kthye në një objekt të vizitueshëm.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



1



2



3



4



5



a

PLANIMETRIA E KULLES Nº1



d

0 1 2 3 4 5 m



b

0 1 2 3 4 m.

HYRJA NE KULLEN Nº2 NGA GALERIA Nº III



c

0 1 2 3 4 5 m



e

0 as 1 2m

DO NOT COPY





RIKOSTRUKSJON I FRENGJISE





DO NOT COPY

DO NOT COPY

PLANIMETRIA E KULLES Nº 2 - KATI II



1

PLANIMETRIA E PJESES SE SIPERME - KULLA Nº 2



2

F R E N G J I A



PLANIMETRIA



PAMJE NGA BRENDA



PREMJA A-A



PAMJE NGA JASHTE



3

DO NOT COPY

PLANIMETRIA KULLES Nr3
KATI I



PLANIMETRIA KULLES Nr3 KATI III



PLANIMETRIA KULLES Nr3 KATI II



PREMJA A - A



HAPJA E KULLES Nº3



a

HAPJA E KULLES Nº2



b

0 1 2 3 4m

PLANIMETRIA KULLES Nº6



0 1 2 3m

c



d

0 1 2 3 4 5m

DO NOT COPY



1



2



3



4



5



6

DO NOT COPY



1



2



3



4



5

DO NOT COPY













DO NOT COPY

Lazer **PAPAJANI**

DO NOT COPY

LA FORTERESSE DE PEQIN

RESUME

Depuis l'antiquité la vallée du Shkumbin était traversée par une route reliant la zone côtière aux zones profondes, route dénommée pendant la période romaine Via Egnatia. Sur le côté droit de cette vallée, à 30 km à l'ouest d'Elbasan, se situe la ville de Peqin en plein centre de laquelle se dresse une petite forteresse.

Le seul auteur qui l'ait décrite est le voyageur turc du XVIIe siècle Evliya Celebi. Même les données historiques et les sources écrites à ce sujet sont fort peu nombreuses. Cette forteresse est mentionnée seulement dans certaines lettres du consul de Durres datant des années 1775-79-85, ainsi que dans les notes de Kostandin Beratasi.

Conservée dans un bon état, elle a la forme d'un rectangle (tab. I) de dimensions variant de 57 à 51 m. orienté en direction NO-SE. Chacune de ses trois angles est flanquée d'une tour, tandis que le tour du quatrième angle n'est pas conservée à l'heure actuelle. En dehors des murailles se dressent quatre autres tours.

Cete forteresse est munie de deux entrées, l'une en face de l'autre. Les murs sont pourvus d'escaliers servant à monter au sentier de passage, à travers lequel a lieu également la communication avec le deuxième étage des tours.

Au mur A sont appuyés deux groupes de pièces couvertes de cintres, dont le premier (a) comporte 8 pièces et le deuxième (b) quatre.

Selon les traditions orales, il y avait tout récemment encore dans la cour de la forteresse des habitations et une petite mosquée dépourvue de minaret.

En raison de son existence s'étendant sur une période de temps plus ou moins longue et de son utilisation ininterrompue, cette forteresse a subi maintes modifications. La technique de construction et les traces que l'on relève sur les murs permettent d'avancer l'idée que nous sommes en présence de quatre principales périodes de construction.

La première période. (tab. I-1) A cette période se rattachent les murs d'enceinte, la tour ronde Nº 1, ainsi que certaines parties des tours Nº 2 et Nº 3.

Les murs de cette période sont surtout construits de pierres fluviatiles de dimension moyenne; l'emploi de morceaux de briques et de grosses pierres en rangées droites est plutôt rare. Le parement des pierres seulement est équarri et elles sont liées avec une grande quantité de mortier. Le mortier débordant le parement de la pierre a été aplatie et aménagée avec une truelle de maçon, de manière à créer une encadrement autour de la pierre. Le mur est renforcé par des bandes de poutres épaisses à section circulaire.

Quant à leurs fondations, elles ne sont pas plus profondes que 0,50 m. On a relevé même une fondation reposant sur une couche de briques appartenant aux Ier-IIIe siècles de notre ère.

Les tours rondes ne conservent pas leur forme arquée dans la partie intérieure de la forteresse, mais se caractérisent par des parements droits dans lesquels sont pratiqués les ouvertures des portes couvertes de cintres en briques.

Des tours Nº 2 et Nº 3 sont conservés actuellement, dans la partie extérieure de la forteresse, que le soubassement rond et les murs de la première période de construction se reliant aux murs d'enceinte.

En nous fondant sur les caractéristiques de construction et les traces relevées sur place, il est possible de procéder à une reconstruction de la première période de cette forteresse.

Sa forme initiale était celle d'une rectangle flanqué d'une tour ronde à chacun de ses angles et d'une tour rectangulaire dans le parement du mur A (Tab. I, 1). Le seul accès à la forteresse était l'entrée aménagée dans le mur C. Au-dessus du mur, dans la partie intérieure de la forteresse, se trouve la bretèche pour le stationnement et le mouvement des combattants, tandis que sur l'autre moitié de l'épaisseur du mur s'élevait un parapet haut de 1 m., qui était à son tour surmonté par des bastions hauts de 1.10 m. et disposés à 0.75-0.80 m. l'un de l'autre.

Les tours sont à deux étages, celui au rez-de-chaussée est séparé en deux parties, soit un dépôt non plus haut que 1.40-1.50 m. et un autre dépôt, commençant au niveau de l'entrée et revêtu d'un plancher en bois, et dont la hauteur est près de 2.50 m. C'est à cette étage que se rapporte aussi la meurtrière en forme de fente verticale de la tour Nº 2.

La deuxième période. A cette période de construction se rattachent les deux groupes de pièces a et b appuyées au mur A, la mosquée sans minaret se dressant au-dessus du groupe b, la petite porte percée dans la tours rectangulaire, ainsi que les pièces C et D.

Les murs de cette période sont en pierres fluviatiles, souvent travaillées. A la différence de la première période, le mortier n'encadre pas les pierres. Inutile de relever que la maçonnerie de ces constructions s'appuient sur celle de la première période. C'est pendant cette période que le «namazgjah», situé sur le côté sud-ouest de la forteresse, a été cerné d'un mur englobant aussi la tour de l'angle occidental, toute la cour par devant le mur C et la porte de la forteresse.

La troisième période. A cette période se rapportent la plus grande partie des constructions mises en place dans la partie intérieure et extérieure des tours Nº 2 et Nº 3, les tours Nº 4, 5, 6 et les réparations moins importantes du mur d'enceinte (Tab. I, 3).

Au premier étage des tours Nº 2 et 3, dans sa partie intérieure, a été ajouté un mur nouveau dont l'épaisseur varie de 0.60 à 0.75 m. et sur lequel s'appuie une coupole en pierres disposées sous forme d'anneaux concentriques.

Le deuxième étage de la tour Nº 2 comporte seulement des travaux de cette période. Sur les deux côtés de son entrée ont été aménagées des petites meurtrières à trois fentes pour tirer avec un fusil sur les assaillants. Face à l'entrée, la tour en question est munie d'une petite meurtrière à canon conservée dans un état satisfaisant; de même, sur ses deux côtés, l'on relève les traces de deux autres meurtrières identiques à la précédente (Tab, V,I,a Tab. VI, b).

Dans la partie intérieure de cette tour, à 1.45 m. du niveau du plancher, se trouve un sentier ce qui montre que cette tour n'avait pas un troisième étage. Des traces de tubes en céramique pour le déversement des eaux prouvent que la tour en question était couverte d'un toit.

Au cours de cette période les tours Nº 2 et 3 ont subi à l'extérieur des modifications importantes. En les revêtant de murs nouveaux, dont les parements allaient se retrécissant de bas en haut, ces tours ont pris la forme d'une pyramide tronquée à base octogonale.

C'est au cours de cette période qu'à la tour quadrangulaire de la première période, qui avait été munie d'une porte pendant la deuxième période, fut appuyée une grande tour à six faces (la tour Nº 4) (Tab. I, 3).

La quatrième période. Les constructions se rapportant à cette période ne sont pas lointaines dans le temps de celles de la troisième période. Y font part deux grandes meurtrières à canon de la tour Nº 2, ainsi que trois meurtrières à canon et fusil de la tour Nº 3 (Tab. VI, a). Cette tour était à trois étages, le deuxième étage communiquant avec le troisième par un escalier en bois aménagé dans la partie intérieure de la tour.

La datation de la forteresse de Peqin

La forteresse de Peqin, comme la forteresse de Preze, a été mise en place en vue de remplir des fonctions de contrôle. En plus ces deux forteresses se ressemblent quant à leur technique de construction et leur architecture. Dans les deux cas l'on relève l'emploi simultané des arcs en plein cintre et des arcs en ogive. Quant aux escaliers à deux rampes, on les retouve aussi dans la forteresse de Gjon Boçari à Tragjas, une construction attribuée aux XIVe-XVe siècles.

Selon l'enregistrement de l'an 1431-32, Peqin figure comme une petite agglomération ayant neuf maisons et portant le nom de Biklenet. Si notre monument avait été construit quelque temps avant cette date, soit pendant les années de l'enregistrement, il aurait du représenter une agglomération comportant un bon nombre de familles. Sur la base des ressemblances se rapportant aux premières périodes de construction dans ces forteresses, ainsi que sur les points de vue avancés par Evliya Celebi, selon lesquels la forteresse de Peqin a été construite par les Turcs, il ressort que celle-ci aussi a une date de construction plus ou moins proche de celle de Preze, soit le XVe siècle, mais une période postérieure à l'année d'enregistrement 1431-32. En ce qui concerne la deuxième période de construction, celle-ci, doit précéder l'an 1670, date à laquelle notre monument a été visité par le voyageur turc Evliya Celebi. A la différence de l'agglomération de l'an 1431-32, au temps de Celebi Peqin s'est transformée en une petite ville s'étendant autour de la forteresse. Selon le voyageur turc, Peqin disposait à son époque nombre de maisons, de magasins, d'écoles et trois mosquées munies de minarets.

Les tours de la troisième période, quant à leur technique de construction, ressemblent à certaines tours de la forteresse de Berat, de Shkoder et de Tepelene, qui constituent des constructions se rapportant plus ou moins, à la même période de temps, soit à la période de la domination d'Ali Pasha Tepelene. C'est au cours de cette période que la région de Peqin et sa forteresse furent transformées en des champs de bataille entre les Bushatlli de Shkoder, d'une part, et Ahmet Kurt Pasha de Berat, de l'autre, en lutte pour se rendre maître de Durres. Les reconstructions se rapportent à de longues périodes d'accalmie, comme le fut celle allant de 1775 à 1785. Quant aux constructions de la quatrième période, elles sont relativement proches de celles de la troisième période.

Les travaux de restauration

Le terrain environnant la forteresse de Peqin, celle-ci ayant perdu sa fonction originale, a été destiné pour une période de temps pour la construction de sérails puis abandonné complètement. En dehors des modifications apportées dans un but dé-

DOKTORI

terminé, cette forteresse a subi d'autres endommagements assez graves.

C'est en 1966 que l'on a effectué pour la première fois dans la forteresse des travaux de déblayage, de conservation et de restauration. Les travaux de déblayage poursuivaient le but de nettoyer et d'aménager la cour, les différentes pièces, les tours et en partie le territoire environnant la forteresse, ainsi que le terrain par devant les murs.

Les travaux de conservation et de consolidation (tab. VII, VIII, IX) ont été centrés surtout autour des murs d'enceinte, et cela du fait que différentes parties de ce mur comportaient de profondes crevasses. Il fallait donc agir d'urgence et adopter des mesures pour consolider le mur d'enceinte. Des dommages encore plus graves présentaient les meurtrières des tours Nº 2 et 3. Après leur restauration, les meurtrières à canon et à fusil de ces tours regagnèrent leur état initial. Furent aussi restaurées les meurtrières à fusil aménagées dans la partie supérieure des tours. Ces travaux ont concerné aussi la porte du deuxième étage. Dans les pièces du premier groupe, il a été procédé à la reconstruction des murs de cloison jusqu'à un certain niveau tout en réparant partiellement leurs cintres. En ce qui concerne les éléments du deuxième groupe, on a effectué des travaux dans la partie extérieure seulement, dans les murs cernant les pièces.

Ces travaux, dans leur ensemble, ont évité l'ultérieur endommagement de ce monument et ont fait de la forteresse de Peqin un ouvrage méritant d'être visitée.

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DY KISHA BIZANTINE NË RRETH TË GJIROKASTRËS

Në këtë shkrim do të trajtojmë dy kisha të tipit kryq i brëndashkruar me kupol me mbështetje të lira në rrethin e Gjirokastrës[1]), Shën Mërinë e Peshkopisë së Sipërme dhe Shën Mërinë e Labovës së Kryqit. Studimi i përbashkët i këtyre dy monumenteve të rëndësishme për arkitekturën bizantine të vëndit tonë paraqet interes sepse ata përbëjnë hallkat e fillimit dhe mbarimit të zhvillimit, që kishat e këtij tipi kanë pësuar në kohë. Këta dy monumente kanë qenë studjuar dhe më parë nga Evangjelidhis dhe Versaqis, por studimet e tyre të kryera mjaft kohë më parë janë të përgjithëshme, çka e bën të domosdoshme studimin e tyre të imët për t'ju dhënë, për vetë vlerat që paraqesin, vëndin që meritojnë ndër monumentet e arkitekturës bizantine të vëndit tonë.

* *
*

Kisha e Shën Mërisë së Peshkopisë së Sipërme ndodhet 15' në jugë të fshatit, e izoluar mbi një breg të kodrave që nga fusha shkojnë drejt malit të Buretos. Kjo kishë ka qënë selia e dikurshme e peshkopatës së Drinopojës. Prej saj ka marë emrin dhe vetë fshati ndërsa emri i peshkopatës vjen nga qyteti antik dhe mesjetar i Adrianopojës që ka qënë shtrirë ndërmjet Teqes së Melanit dhe Sofratikës[2]).

Kisha është e tipit kryq i brëndashkruar me kupol mbi tambur me katër mbështetje të brëndëshme. Mbështetjet janë pilastra me forma të çrregullta nga shtesat dhe mbi to, nëpërmjet një sistemi harqesh mbajtëse, ngrihen tamburi me kupolën. Forma e kryqit, e krijuar në brëndësi prej qemereve, del në çati, duke pasur të qartë krahët veriorë dhe jugorë, ndërsa dy të tjerët janë nën të njëjtën çati me ambientet anësorë. Në vëndtakimin e krahëve të kryqit, mbi një bazament kuadratik, ngrihet tamburi cilindrik me kupolën.

Kisha përbëhet nga naosi dhe ambienti i alltarit (fig. 1). Hyrja e vetme për në naos është në anën perëndimore, ku ndodhet dhe një portik i vogël (fig. 2). Portiku mbështetet mbi murin e kishës dhe në dy kollona mbi bazamente guri në anën perëndimore. Mbi kolonat dhe murin e kishës ngrihen tre harqe me gurë, mbi të cilët ngrihet një kësulë sferike mbuluar me çati piramidale. Shpatullat e portës janë prej gurësh të punuar, ndërsa arkitrau është prej guri njëcopësh. Nga porta me një këmbë shkallë zbritet në dyshemenë e naosit. Naosi përbëhet nga vëllimi nën kupolën, krahët veriorë dhe jugorë të kryqit dhe ambientet këndorë veriperëndimorë dhe jugperëndimorë.

Ky monument paraqitet sot i transformuar, me dritare gati krejt të murosura dhe me shtesa të mëvonshme si brenda ashtu edhe në anën e jashtëme. Në anën jugore kishës i është shtuar një ambient tjetër (edhe ky i transformuar më vonë), drejtkëndësh në plan, i gjatë dhe i ngushtë dhe me pjesën qëndrore më të lartë, ndërsa pjesët e tjera nën të njëjtën çati me kishën. Shtesat e brendëshme janë sidomos pranë pilastrave, mbi të cilat ngrihen harqe të reja përforcuese për harqet mbajtëse veriore dhe perëndimore të kupolës. Shte-

1) Rilevim i autorit, S. Dashit, V. Shtyllës, R. Aliajt, fotografitë të H. Çollakut vizatimet të S. Dashit.
2) A. Baçe. **Vështrim mbi qëndrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër)** Monumentet 4, 1972, 112-113, 119.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 1

sa të tilla ka edhe në ambientin këndor perëndimor. Po kështu një mur i ri përforcues është në anën perëndimore të këtij ambienti.

Për të qenë të saktë, është e nevojshme të themi se pilastrat janë të tillë, në se do të vrojtonim planimetrinë me fazat e ndërtimit, sepse në të vërtetë — në ndërtimin vëllimor e struktural ato janë perde muri me kalime të mbuluara me hark. Më i vogël dhe i ulët kalimi nga bema për në protezis dhe diakonikon, më i gjerë e më i lartë kalimi nga krahu perëndimor në ambientet këndore përkatëse. Në këtë mënyrë të katër ambientet këndore janë relativisht të shkëputura si në aspektin funksional ashtu edhe në atë hapësiror, nga hapësira qendrore, nën kupol dhe krahët e kryqit. Këto të fundit janë mbuluar si zakonisht me qemere cilindrike, në vëndtakimin e të cilave nëpërmjet trekëndë-

DO NOT COPY



Fig. 2

shave sferikë ngrihet tamburi me kupolën mbi të. Po me qemere cilindrike janë mbuluar edhe të katër ambientet këndore, të cilat janë në nivel më të ulët se qemeret e krahëve të kryqit. Këto qemere dalin dy nga dy në krahët veriorë dhe jugorë të kryqit.

Siç e pamë, ambienti i alltarit përbëhet nga bema, protezisi dhe diakonikoni. Bema, për shkak të komunikimeve të vogla me këto të fundit, përbën deri në një farë mase një ambient të vetëm. Ajo sot ndahet nga naosi prej një ikonostasi të pikturuar me afreske nga ana e naosit. Ky mur i shtuar më vonë[3]) shërben në të njejtën kohë edhe si përforcim për harkun mbajtës të kupolës sepse shkon deri tek ai. Përpara këtij muri ndodhet ikonostasi i ri prej druri. Si shpatulla të portës, nëpërmjet secilës bema komunikon me naosin, janë dy shtylla mundet të ikonostasit të vjetër. Në absidën gjysëm rrethore duke filluar nga dyshemeja kemi tre shkallë në mes, të cilave është një fron i gurtë (Tab. I, 1, Tab. II). Kemi të bëjmë me fronin e peshkopit dhe vëndet e ndënjes së shërbenjësve të tjerë.

Në mes të bemës është tryeza e alltarit e përbërë nga një pllakë e gdhëndur në sipërfaqe që mbështetet mbi një bllok muri. Në dysheme është një fragment pllake me dy fole, mundet për mbështetje të kollonave të ndonjë tryeze apo baldakini.

Nga bema, nëpërmjet dy hapsirave të ngushta dhe të ulta që përmëndëm më lart, kalohet respektivisht në protezis dhe diakonikon me planimetri drejtkëndëshe e mbuluar me qemer. Ato kanë në anën lindore nga një absidë gjysëm rrethore me dritare të vogël dyshe sot të murosur. Nga ato vetëm ajo e protezisit ruan akoma kollonën. Absidat nuk shkojnë deri në tokë ato

3) Simbas mbishkrimit, pikturimi është bërë në vitin 1511 shih: Th. Popa, **Mbishkrimet e kishave të Shqipërisë si burime historike** në BUSHT SH SH, 1958, 1, 224. F. Versaqis mendon se ky mur, të cilin ai gabimisht e vë në tërë zonën e ambientit të altarit, është pjesë e vjetër e kishës. Shih **Arkeologjiki Efimeridha** Athinë 1916, 114-117.

mbarojnë në formë sofaje duke patur të murosura pllaka të tjera të gdhëndura në sipërfaqe nga ikonostasi i dikurshëm i kishës. Ndërsa diakonikoni është i hapur ndaj naosit në tërë gjerësinë e tij, protezis ka një mbyllje me një portë në mes, që duket se është vënë për përforcim.

Me sa kuptohet nga mënyra me të cilën janë vënë përforcimet në anën e jashtëme dhe në brendësi, kisha do të ketë pësuar dëmtime në muret dhe strukturat mbi to si pasojë e ndonjë shkarje të terrenit. Një mur mbajtës është në tërë faqen veriore të kishës deri tek dritarja e krahut të kryqit në pjesën e tij më të lartë. Pilastra dhe harqe mbi to ka në krahun verior të kryqit, ku dalin ambientet këndore verilindore dhe veriperëndimore, duket për të përforcuar mbështetjen e qemerit të krahut të kryqit, si edhe një mur masiv pranë murit perëndimor të ambientit këndor. Po kështu përforcime me hark mbi pilastra janë bërë nën harqet mbajtëse veriore dhe perëndimore të kupolës (Tab. I, 4). Kuptohet që tërë këto përforcime janë vendosur pa marrë parasysh vlerat e kishës dhe kanë zënë në një farë mase brendësinë. Duhet thënë se këto masa nuk kanë prekur strukturat e monumentit, dhe në një kohë të dytë mund të zëvendësohen, duke i rikthyer monumentit tërësisht pamjen e tij të dikurshme në brëndësi.

Nga muret e jashtme, veriori dhe jugori janë të fshehur, i pari nën murin mbajtës ndërsa i dyti nga ambjenti shtesë (Tab. III). Të vetmet pjesë që kanë mbetur në dukje, janë frontonet e krahëve të kryqit. Ai nga jugu është i ndërtuar vetëm me gurë, me një dritare dyshe, të mbuluar me harqe mbi një kolonë të shkurtër me kapitel guri. Frontoni përfundon me një kornizë me një rresht tullash të vendosura në formë dhëmbë sharre. Frontoni nga veriu ka gjithashtu një dritare dy she, ndërsa korniza e vjetër nuk ruhet.

Fasada perëndimore (Tab. IV) ruan gjurmë të rindërtimeve të ndryshme, kështu që është e vështirë të përcaktohen pjesët e vjetra dhe radha e mbivënieve. Në të dy anët e portikut në qendër të këtij muri dallohen dy fuga vertikale të mbuluara në mënyrë të çrregullt me llaç që përfundojnë në mbulesën e qemerit të krahut të kryqit.

Harku në dukje i qemerit është i ndërtuar me gurë çmërsi që alternohen me dy tulla. Muret anash fugave janë ndërtuar kryesisht me gurë duke patur jo kudo edhe tulla ndërmjet tyre. Këto fuga janë të dallueshme dhe në pjesën e brëndshme ku muri vende-vende formon një dhëmb (Tab. 1, 2). Duke vrojtuar mbështetje në mure të portikut, shohim se ato janë të lidhura me të dhe pjesë përbërëse të tij. Një gjë e tillë dhe fugat e mësipërme na shtyjnë të mendojmë se gjithë mbushja nën qemerin e krahut perëndimor të kryqit duhet të jetë rindërtuar kur është ndërtuar portiku përpara portës. Në rast të tillë edhe muri i vjetër ka qenë mur mbushës dhe, duke parë mënyrën me të cilën janë ndërtuar qemeri dhe muret që mbajnë atë me gurë dhe tulla, mendojmë që kjo mbushje ka qenë sadopak më brenda sipërfaqes së murit perëndimor të kishës. Mbetet për të provuar këtë në një të ardhme nëpërmjet sondazhit në pjesën e poshtme të murit dhe themelit.

Duke vërejtur muraturën, sidomos pjesën në jug të harkut qendror, dallojmë qartë teknikën e ndërtimit të murit të vjetër, që është me gurë, duke patur rallë copa tullash apo tjegullash, të cilat në mjaft vende janë të vendosura edhe vertikalisht. Rreth 1 m nga thembra e harkut, menjëherë nën rasat e gurit të çatisë, ndodhen dy gurë njëri mbi tjetrin që formojnë një fugë vertikale, tej së cilës muri ndërron pamjen (Tab. 1, 3). Kjo gjë tregon se këta gurë janë të qoshes së shpatullës jugore të krahut të kryqit, të mbuluar nga mbushja e vonë e ambientit këndor jugperëndimor, e cila është lidhur me pjesën e vjetër nëpërmjet futjes së gurëve në të. Një gjë e tillë nuk vërehet në anën veriore, ku muri është i meremetuar. Korniza mbi frontonin e krahut të kryqit nuk ruhet, me përjashtim të rrafshimit me gurë e tulla, mbi të cilin vendoseshin tullat e kornizës. Më e qartë është kjo në anën jugore, ku rrasat janë vendosur direkt mbi të, ndërsa në anën veriore ka mbushje me muraturë me gurë të vendosur pjertas. Çatia me rrasa guri vazhdon me të njëjtën pjerrësi deri në muret veriore dhe jugore.

Pjesët e tjera të mureve janë me gjurmë meremetimesh të ndryshme, me fuga vertikale që mund të jenë edhe dritare, sqarimi i formës së të cilave mund të bëhet vetëm mbas sondazheve. Një portë e murosur është në pjesën që i takon ambjentit këndor veriperëndimor. Gjithashtu një kontërforcë është në qoshen veriore, ndërsa pjesë muresh të një ambienti të vonë në anën jugore.

Ana lindore e kishës është më pak e transformuar se të tjerat dhe më e zbukuruar se ato (Tab. IV, Tab. V, 1). Pjesën qendrore dhe më të madhen e saj e zë absida kryesore që së bashku me krahun lindor të kryqit, del ndaj faqes lindore duke u theksuar në këtë mënyrë edhe më tepër. Në qendër të absidës është një dritare treshe. Ajo mbulohet me tri harqe tullash që mbështeten në muret dhe dy kolona drejtkëndëshe guri me kapitel guri trung piramide. Mbi harqet me tulla të vendosura në mënyrë radiale ka një rresht tullash në formë dhëmbësh sharre brenda një rreshti tullash përgjatë harkut. Sot të tri dritaret janë të murosura në rrafshin e kolonave duke pasur për ndriçim dy hapësira mjaft të vogla. Në të dy anët e dritares treshe janë dy nike me nga një dritare të ngushtë në mes (Tab. I, 5). Nga shqyrtimi i tyre dhe në anën e brendshme, rezulton të jenë dritare të murosura në pjesën e sipërme.

DOKTORSKY

ndërsa nike në pjesën e poshtme. Ato mbulohen me hark prej gurësh, mbi të cilin kemi një hark tullash radiale e një rresht dhëmbësh sharre që duket si vazhdim i atij të dritares treshe. Në mes të gjithë këtyre harqeve ka harqe të tjera prej tullash të rrethuara dhe ata me dhëmbë sharre tullash. Mbi dy qendroret ka një tjetër, në fushën që formohet ndërmjet tij dhe atyre mbi niket ka nga një kryq të formuar prej tullash.

Dy absidat anësore janë thuajse gjysmrrethore, sepse, i ngjiten trupit të krahut të kryqit. Edhe ato mbulohen me rrasa guri, por nuk kanë ndonjë gjurmë kornize. Dritaret e dikurshme dyshe sot janë të transformuara. Ajo e absidës nga jugu ka një dritare të mbuluar me hark tullash edhe të murosur me një hapësirë të vogël në mes. Ajo e absidës nga veriu ka dy dritare të ngushta dhe ruan të murosur (shihet vetëm nga ana e brendshme) kolonën e dikurshme. Mbi secilën nga absidat duken fugat e pjerrëta të murit të vjetër të ambienteve këndore, mbi të cilat janë ngritur më vonë mure mbushëse për të vazhduar çatia e krahut të kryqit deri në anët jugore e veriore të kishës. Muratura e faqes lindore është kryesisht prej gurësh por nuk mungojnë edhe copërat e tullave.

Tamburi është i ulët dhe përfundon me një kornizë të dyfishtë tullash të drejta dhe në formë dhëmbësh sharre, që ruhet relativisht mirë (Tab. V, 2). Katër dritare dyshe janë sipas katër pikave të horizontit. Ato mbulohen me harqe prej tullash radiale që mbështeten në qendër në një kolonë me kapitel guri (fig. 3). Rreth harqeve kalojnë dy radhë tjegullash, të cilat vazhdojnë në tërë sipërfaqen e tamburit, nga dritarja në dritare. Tamburi është i ndërtuar me gurë të mëdhenj çmërsi. Një rresht tullash të holluara nëpërmjet gdhendjes kalon edhe në pjesën e sipërme, mbi të cilin ka dy radhë gurësh çmërsi, ndër të cilët ka edhe copa tjegullash e tullash. Ndërtimi thuajse vetëm me gurë i tamburit shton edhe më tepër pamjen e tij të rëndë dhe primitive.

Ambienti i ri që i është shtuar kishës, është në plan, drejtkëndësh me brinjë të gjata sa ajo e kishës, brinjët jugore dhe veriore. Ky ambient i shtuar lidhet me kishën nëpërmjet një dere që duket se është hapur më vonë. Ambienti përbëhet prej tri vëllimesh, dy anësorët më të ulët dhe mbuluar me qemer cilindrik me formuese lindje-perëndim, ndërsa qendrori më i lartë e mbuluar me qemer cilindrik me formuese veri-jug. Pjesa qendrore del dhe mbi çati njëlloj si krahët e kryqit dhe mbulohet me çati dyujëse duke patur një fronton në anën jugore.

Sot ky ambient lidhet vetëm me kishën. Por më parë ai ka patur tri hyrje, nga një të vogël në anët lindore dhe perëndimore dhe një, më e madhja, në anën jugore. Kjo e fundit, sot e murosur, zë tërë daljen e vë-



Fig. 3

llimit qendror në këtë anë. Ndërsa për atë nga lindja jemi të qartë, sepse muri lindor është i tëri i një dore me muret e tjera, të ambientit shtesë, hyrja nga perëndimi ka shumë ngjasë të jetë e re, sepse muri në këtë anë duhet t'i përkasë ndonjë meremetimi. Kjo pjesë e murit është ndërtuar me gurë si dhe muri i ri në pjesën e ambientit këndor jugperëndimor, në kontaktin me të cilin ruhet një fragment i vjetër me kluasonazh.

Teknika e ndërtimit të mureve të shtesës është kluasonazhë me nga një rresht tullash horizontale dhe dy ose tre tulla vertikale (Tab. V, 3). Në pjesën e poshtme të murit janë vendosur gurë të mëdhenj të skuadruar me shumë gjasë të periudhës antike (Tab. V, 4). Sipas vendasve, të tillë gurë ndodheshin deri vonë me shumicë rrëzë kodrës së kishës. Faqja lindore ka në mes hyrjen e murosur, të mbuluar me hark tullash të vendosura sipas rrezeve, të rrethuar me tulla për gjatë harkut. Pjesa e poshtme e murit deri afër lartësisë së kryqit të harkut është me kluasonazhë. Mbi hark janë dy rozeta tulle, anash të cilave kemi një radhë tullash të vendo-

DO NOT COPY

sura sipas brinjëve dhe diagonaleve të katrorit. Mbi to ka një ose dy radhë tullash dhe pastaj vazhdon një fushë e tërë tullash të vendosura sipas vijave që ndërpriten 45º ndaj horizontit (Tab. V, 5). Në këtë mënyrë formohet një rrjet katrorësh që kanë tulla sipas diagonaleve horizontale[4]). Duke vrojtuar anët e kësaj fushe nga jugu dhe veriu, do të dallojmë se ky mur i vjetër nuk shkon deri në anë të mureve të ambientit, duke patur mbushje më të vonë tamam në këto pjesë, çka do të thotë se pjesa e sipërme ka qenë më e ngushtë. Kjo duket edhe po të shohim faqen jugore, ku pjesa e sipërme në fjalë është jo me kluasonazhë, por muraturë e çrregullt me gurë. Duke u nisur nga pjesët e vjetra dhe të reja, rezulton që pjesët anësore të ambientit shtesë të kenë qënë mbuluar me çati dyujëse, me flegrën nga jugu më të madhe, sepse kulmi i çatisë nuk është në qendër por i zhvendosur nga veriu. Fuga e pjerrët e murit të vjetër dhe atij të ri duket qartë.

Muret e mbulesës së pjesës qendrore mbi çati janë me kluasonazhë pak a shumë të çrregullt (Tab. V, 6) me tulla në vend të gurëve dhe tri e deri katër tulla vertikale. Hyrja jugore ka qenë e mbuluar me hark tullash, vazhdimi i qemerit të brendshëm.

Duke patur të qartë si formën e dikurshme të kishës, ashtu edhe atë të ambientit shtesë mendojmë se kjo shtesë është bërë kur kisha ruante akoma format e vjetra, sepse është realizuar në një farë mase në mënyrë të rregullt dhe duke respektuar ndërtimin bazë. Me sa mund të kuptohet nga forma e tij e parë, ky ambient duhet të ketë luajtur për kishën rolin e një narteksi të hapur, ndërsa në gjëndjen e sotme rolin e një ambienti ndihmës. Ky ambient është mbyllur vonë, duke patur meremetime të mureve si dhe ndryshimin e formës së çatisë, e cila unifikohet me çatinë e re të kishës.

Nga studimi i monumentit rezulton se kemi të bëjmë me një kishë të tipit kryq i brendashkruar me kupol mbi tambur të tipit provincial, të cilit i përmbahet tërësisht në planimetrinë dhe ndërtimin vëllimor e strukturor. Në aspektin e jashtëm, në dekorin minimal format dhe proporcionet e tamburit dhe frontoneve vërehet qartë se kemi të bëjmë me një ndërtim të hershëm. Vetëm fasada lindore dekorohet gjerësisht me tulla, ndërsa në të tjerat tulla përdoret shumë pak. Mungon gjithashtu kluasonazhi, i cili që nga fundi i sh. XI e më vonë bëhet teknik e rëndonte në provincat. Po për këtë flasin tamburi i ulët dhe kornizat e drejta. Në planimetri e në ndërtimin e brendshëm shohim përdorimin e pilastrave, të cilët siç pamë janë thuajse mure. Në këtë mënyrë në brendësi ruhen akoma, nëpërmjet shmangjes së ambienteve këndor nga pjesa qendrore me kupol, elemente të ndërtimit bazilikal.

Hapësira e brendshme është tipike bizantine me tipare primitive që theksohen nëpërmjet numurit të pakët të dritareve dhe madhësisë së tyre, kupolës së ulët dhe në përgjithësi mbizotërimit të akseve horizontale ndaj vertikalit. Sigurisht që monumenti do të fitonte së tepërmi me largimin e shtesave sidomos në brendësi, zbulimit të pikturës murale të vjetër që ka shumë mundësi të ruhet sado e fragmentuar. Së fundi, me interes paraqitet dhe ikonostasi, nga i cili siç përmëndëm, ruhen disa pllaka dhe dy kolona të murosura.

Udhëtari anglez Holend që e vizitoi monumentin në vitin 1812 lexoi në muret e tij një mbishkrim sipas të cilit, përsa arriti të kuptonte ai, rezultonte se kisha është ndërtuar nga perandori bizantin Manuel Komneni[5]), që sundoi në vitet 1143-1180. Ky mbishkrim sot nuk ruhet, mundet të jetë i mbuluar nga ngjyrosja e re e mureve. Në të tilla rrethana, ne mendojmë se është e domosdoshme ta verifikojmë atë, duke shqyrtuar çka ofron monumenti, gjë që do të vlejë për pranimin apo jo të këtij datimi tradicional. Duke u nisur nga planimetria që akoma nuk ka të plota tiparet e tipit kryq i brendashkruar me kupol, që e shohim në formën e pilastrave që janë më tepër vazhdim muresh se sa pilastra të lira; nga proporcionet që vërehen në lartësitë e vogla ndaj përmasave në plan sidomos tek tamburi si dhe nga mungesa e kluasonazhit, mendojmë se monumenti duhet të jetë ndërtuar në periudhën që shkon nga fundi i sh. XI në mesin e sh. XII, çka e bën të besueshme të dhënën e Holendit. Për këtë mendojmë se do të japin një ndihmë dhe studimet e mëtejshme lidhur me hyrjen e tipit në këto zona dhe fillimin e përdorimit të kluasonazhit.

Përsa i përket ambientit shtesë, ai i takon periudhës para pushtimit turk dhe, duke u nisur nga teknika e ndërtimit kluasonazh me shumë tulla vertikale dhe dekori në murin lindor, mendojmë se ai është ndërtuar gjatë sh. XIII-XIV.

* *
*

Kisha e Shën Mërisë së Labovës së Kryqit ndodhet në mes të fshatit, e rrethuar nga një oborr dhe me volumin e saj në ngjyrë të kuqe në sfondin e një selvie

4) Një dekor të përafërt me tulla sipas diagonaleve vertikale, kemi në kishën e Shën Theodhorës në Arte, shih A. Orlandos. **Agjia Theodhora tis Artis** në Arheion Vizantion Mnimeion Elladhaos B' 1936, 1, fig 5; 13. Po aty gjejmë dhe rozetën.

5) Holland H. **Travels in the Ionian Isles, Albania, Thesaly and Macedonia During the Years 1812-1913,** London 1815, 481.

Document Copy

shekullore dominon zotëron fshatin, sidomos kur e shohim prej së largu.

Në pamjen e jashtme monumenti ka format e kishave të tipit kryq të brendashkruar të variantit provincial, ndërsa në brendësi nuk kemi të bëjmë me këtë tip, sepse hapësira qendrore me kupol mbi katër pilastra, ndahet nga krahët e kryqit me tre arkada dy katëshe prej dy kolonash. Në këtë mënyrë, studimi i monumentit paraqet interes të veçantë për këtë zhvillim të mëtejshëm të tipit dhe për lidhjen e tij me monumente të tjera të përafërta të Konstantinopolit dhe të provincave.

Sot kisha paraqitet e transformuar nga meremetimet dhe shtesat e ndryshme që i janë bërë sidomos në anët jugore dhe perëndimore (fig. 4), të cilat duke mos marë parasysh vlerat e saj, kanë bërë që të humbasë mjaft nga pamja e dikurshme.

Në anën perëndimore, ku është dhe hyrja e vetme e kishës, ngrihet një portik me një arkadë (fig. 5) prej 8 harqesh që mbështeten në dy pilastra anësorë dhe 7 kolona të vendosura mbi një mur të ulët që ndërpritet vetëm për të lejuar kalimin për në kishë. Nëpërmjet një dere të ulët, të mbuluar me hark hyet në narteksin e vonë mbuluar me qemere. Njëri, me formuese lindje perëndim, është në pjesën qendrore që lidh portën e narteksit me të kishës. Tjetri me formuese jugë veri mbulon gati tërë narteksin. Qemeri i parë ndërpret tërthorazi këtë qemer gjatësor dhe është në nivel më të lartë. Një gjë e tillë me sa kuptohet, është bërë që porta e kishës të mos mbulohet nga qemeri gjatësor. Narteksi i vonë në përgjithësi është i errët dhe ndriçohet vetëm nga dy dritare të ngushta. Siç do të shohim, ndërtimi i tij është bërë më tepër për arsye konstruktive sesa për arsye funksionale.

Nga narteksi me tre këmbë shkallë (Tab. VI) hyhet



Fig. 4

DO NOT COPY



Fig. 5

DO NOT COPY

në kishë që përbëhet nga hapësira qendrore nën kupol, nga ambienti altarit, dy pjesët mbrapa arkadave në veri dhe në jug të hapësirës qendrore dhe nga pjesa e përparme, që në një kohë të vonë është bërë me dy kate, e cila deri në një farë mase luan sot rolin e një narteksi ndaj hapësirës nën kupol. Hapësira qendrore nën kupol ka në qoshet e saj katër pilastra të formave të ndryshme, mbi të cilat ngrihen harqet mbajtëse të kupolës. Arkadat që përmendëm shkojnë lart, deri në harkun mbajtës të kupolës dhe qemerin e krahut të kryqit.

Arkada jugore (fig. 6) përbëhet në pjesën e poshtme nga tri harqe thuajse të barabarta që mbarojnë në të njëjtin nivel dhe që mbështeten tek jastëku mbi kapitel nëpërmjet një këmbëze harku. Të dy kapitelet janë të mveshura me stuko të ngjyrosura, duke krijuar forma të rregullta të kapitelit korintik me gjethe akanthi të mprehta. Nga vrojtimi rezultoi se ndonjë prej tyre është dëmtuar dhe plotësuar duke e imituar me stuko, në një kohë të vonë, kur janë bërë dhe një sërë korniza sh dhe dekore të tjera që veshin në nivele të ndryshme interierin e hapësirës qendrore nën kupol. Mbi kapitelet ka nga një jastëk guri që janë në formë trungu piramide të përmbysur, duke pasur pjesën e sipërme të gdhëndur në formë paralelopipedike. Tirante druri kalojnë mbi këto jastëkë. Kolonat e kësaj arkade janë një copë, mundet të marra nga ndërtime më të vjetra, dhe mbështeten mbi bazamente të larta e të ndryshme.

Kati i dytë i arkadës jugore përbëhet prej tri harqesh që janë në të njëjtën lartësi. Ato janë mbi kolona të ulëta, të cilat nga ana e tyre mbështeten mbi murin, me të cilin përfundojnë harqet e poshtme. Kapitelet e kësaj arkade janë në formë trungu piramide që zgjerohet vetëm pak në pjesën e sipërme, kështu që jastëku mbi ta për mbështetjen e harkut del së tepërmi ndaj kapitelit. Edhe këtu ka tirante druri që janë në fillimin e tri harqeve direkte mbi kapitelet. Një mur me trashësinë e harqeve ngrihet mbi ta deri në sipërfaqen e brendshme të harkut mbajtës të kupolës, i cili është më i gjërë se ky mur.

Arkada veriore ka disa ndryshime nga ajo jugore. Harku në lindje të arkadës së poshtme është më i ulët duke filluar drejtpërsëdrejti mbi jastëkun e kapitelit. A është kjo forma e dikurshme apo kemi të bëjmë me një merem etim nuk mundëm të dallojmë. Tirantet e kësaj

arkade, si dhe ato të së sipërmes, janë të prera. Kati i dytë i arkadës veriore ka të njëjtë me atë të arkadës jugore formën e kolonave dhe kapiteleve, por ka të ndryshme harqet. Dy të anës fillojnë drejtpërsëdrejti mbi kapitelet, ndërsa i mesit pak më lartë, duke mbaruar kështu në nivel më të lartë. Gjithashtu shënojmë se harku më nga lindja është i murosur sa gjerësia e murit të arkadës. Harku tjetër anësor shkon më brenda harkut mbajtës, çka tregon se arkada nuk bën pjesë në të njëjtën strukturë me harkun mbajtës të kupolës dhe se qemeri i krahut të kryqit është i ndarë nga ai.

Arkada perëndimore sot është mjaft e transformuar, në pjesën e poshtme pranë kolonave janë ndërtuar dy pilastra, të cilët murosin gati tërësisht edhe harqet anësore. Mbi këta dy pilastra dhe murin perëndimor ngrihen dy harqe (Tab. VII, 1), mbi të cilat muri mbaron horizontalisht në pjesën e sipërme. Mbi këto dy harqe ngrihen dy pilastra që mbajnë një hark, i cili është vendosur për të përforcuar qemerin e krahut perëndimor të kryqit, i cili duhet të kishte pësuar nga dëmtimi i kupolës, sepse dhe është shkëputur prej tij.

Mbrapa arkadës perëndimore, në një lartësi 2.30 m nga toka, në tërë gjerësinë e kishës është një tribunë me konstruksion druri, e cila ka parmak vetëm në pjesën e arkadës, ku dhe është e hapur ndaj naosit. Në të hipet me një shkallë druri të ngushtë dhe të pjerrët. Lëvizja në tribunë është deri në një farë mase e vështirësuar prej harqeve që përshkruam më sipër, dhe qëndrimi në të, në aspektin arkitektural, është pasiv ndaj hapësirës qendrore nën kupol dhe naosit në përgjithësi. Nga ambienti i tribunës me një portë të hapur tamam nën dritaren e frontonit të krahut perëndimor të kryqit kalohet në nën çatinë e narteksit. Kjo nënçati ka një dysheme të shtruar me rrasa guri.

Hapësirat mbrapa dy arkadeve të forta janë gati të njëllojta. Ato përbëhen nga vëllimi nën krahun e kryqit. Në gjendjen e sotme ato janë relativisht të errëta dhe marrin dritë nga dritare gjysmë të zëna në pjesën nën qemer (frontoni i krahut të kryqit) dhe nëpërmjet arkadës. Ambienti verior prapa arkadës lidhet në anën lindore me protezisin. Kalimi nga njëri tek tjetri bëhet nëpërmjet një hapësire të mbuluar me hark në nivel të ulët. Mbi harkun e parë ka një boshllëk të lartë të mbuluar dhe ai me hark. Në anën perëndimore kalimi i ngushtë është i mbuluar me harqe në dy nivele. Në nivel të ulët në pjesën nga perëndimi, në nivel të lartë në anën tjetër, duke formuar në këtë mënyrë një shkallëzim. Ambienti mbrapa arkadës jugore ndryshon vetëm në mbulimin e kalimit në pjesën perëndimore. Në nivel të



Fig. 6

ulët mbulohet kalimi, ndërsa nga ana e vëllimit mbrapa arkadës, kemi në pjesën e sipërme një boshllëk të ngushtë e të lartë të mbuluar me hark.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi nga një ikonostas druri të gdhendur në nivel të mirë artistik. Kjo pjesë e kishës mbulohet me qemer cilindrik, me formuese lindje perëndim në pjesën qendrore që i takon krahut të kryqit dhe me dy qemere me formuese veri-jug në nivel më të ulët, në pjesët anash tij.

Mbishkrimi që ka ikonostasi, mban datën 26 gusht 1805, kohë e përfundimit të gdhendjes së tij. Nga dera

6) Siç na thanë fshatarët, në këtë pjesë të kishës dikur ka qenë një klasë e shkollës dhe se çatia ka patur formë tjetër, duke qenë në nivel më të lartë. Edhe sot duken në murin verior gjurmë të një dritareje.

FOR NOT COPY

qendrore e ikonostasti hyet në bemën e lartë dhe të gjerë. Bema ndriçohet nga një dritare e dyfishtë. Ajo lidhet me protezisin dhe diakonikonin me kalime të ulëta e të ngushta që zënë tërë trashësinë e pilastrit, që mbulohen me qemere në dy nivele. Në nivel më të ulët në anët e bemës, në nivel më të lartë në anët e protezis dhe diakonikonit. Një veprim të tillë nuk e shpjegojmë dot.

Si protezisi ashtu dhe diakonikoni kanë nga një absidë të ngushtë dhe të lartë, që fillon jo menjëherë mbi dysheme. Në faqen veriore të protezisit ka një kamare në tërë trashësinë e murit, që nuk kuptohet nëse është hapur më vonë, e cila është e mbyllur në anën e jashtme nga shtesat që i janë bërë kishës. Gjithashtu një derë, me sa duket e hapur më vonë, sot mbrapa një strukture të drunjtë me një ikonë, lidhte kishën me qimiterin e shtuar në anën veriore[7]).

Edhe dy porta të tjera janë hapur më vonë, një në anën veriore dhe që lidh me ambientin e jashtëm, ndërsa tjetra në anën jugore, për të lidhur kishën me ambientin shtesë nga jugu. Ky ambient është i zgjatur në plan, dhe mbulohet me qemere cilindrike. Si dhe tek narteksi, kjo shtesë i ka të dy muret të reja dhe atë nga veriu mbështetur murit jugor të kishës. Kjo shtesë mund të jetë bërë për arsye konstruktive. Ajo përbëhet prej tri pjesësh. Dy anësoret janë të mbuluara me qemer cilindrik, me formuese lindje perëndim, ndërsa pjesa qendrore është në nivel më të lartë dhe me formuese veri-jug dhe shërben për lidhjen e kishës me ambientin e jashtëm, për çka ishte hapur jo vetëm porta e re në murin jugor të kishës, por dhe një portë në muret shtesë. Kjo portë e fundit në fillim është ngushtuar e më vonë është murosur përfundimisht. Në murin lindor të kësaj shtese janë dy nikje të harkuara, ndërsa një kamare është në anën veriore të këtyre nikjeve. Këto elemente na shtyjnë të mendojmë se kjo pjesë e ambientit do të ketë shërbyer si paraklis. Në anën perëndimore të tij ndodhet një mur, i cili përforcon qemerin, për të mbajtur mbi vete këmbanoren e vonë.

Studimi i monumentit është i pamundshëm pa njohjen edhe të pamjes të jashtme të tij. Sot ai i ofrohet shikimit të studjuesit në pamje krejt të ndryshme nga e dikurshmja, që bën mjaft të vështirë leximin e tij, si për shkak të shtesave ashtu edhe për shkak të meremetimeve të shumta dhe të pakujdesshme, të cilave u është nënshtruar kisha. Gjithashtu edhe mbushjet e terrenit që arrijnë deri në nivelin e dritareve në anën lindore kanë zvogëluar dukjen e kishës në këtë anë. Në pamjen e dikurshme është vetëm kupola. Nga muri jugor janë të vjetra vetëm pjesët në dukje të bazamentit të tamburit, nga muri perëndimor duket vetëm frontoni i krahut të kryqit dhe bazamenti i tamburit, nga ana veriore frontoni dhe pjesë të vetë murit, ndërsa në anën lindore ruhen vetëm fragmente të muraturës së dikurshme.

Tamburi cilindrik (Tab. VIII, 1) është i dekoruar i tëri me tulla. Ai përbëhet në sipërfaqen e jashtme prej dy brezash dekorativë të dallueshëm nga njëri-tjetri. Në anën e brëndshme, për sa dallohet në vrimat e skelave, muri rezulton të jetë i ndërtuar me tulla dhe gurë çmërsi. Brezi i poshtëm, që është dhe më i lartë, ka si elemente kryesore katër dritare që alternohen me katër nikje. Dritaret janë vendosur sipas pikave të horizontit. Ato janë dypjesëshe me nga një kolonë një copë guri në mes. Kolona në prerjen tërthore është e stërgjatur me anët e ngushta të rrumbullakosura pas një dhëmbëzimi (Tab. VIII, 2). Dallim bëjnë baza dhe kreu i kolonës që janë drejtkëndëshe. Kalimi nga trupi i kolonës për në pjesën e sipërme bëhet nëpërmjet një profili. Bazamenti i kolonës është në formë trungu piramide me përmasa pak më të mëdha se kolona, ndërsa kapiteli po trung piramide me brinjët e gjata sa trashësia e mureve të tamburit.

Shpatullat e dritareve janë prej dy radhësh të shkallëzuara prej tullash, nga të cilat e jashtmja më e gjerë se e brendshmja. Këto dy radhë tullash mbulojnë në formë harku secilën nga pjesët e dritares, duke u mbështetur mbi kapitelin me ndërmjetësinë e një këmbze harku po prej tullash. Duke qenë se kapiteli është i ngushtë, harqet që mbështeten në të, vijnë duke u ngushtuar, madje dy të mesit, pa arritur deri në mbështetje reduktohen, në një tullë të vendosur këlliç për së gjati. Shpatullat dhe harqet e shkallëzuara janë të rrethuara në anën e jashtme nga një shirit tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre brenda tullash të vendosura për së gjati.

Edhe niket ndërmjet dritareve janë me dy radhë harqesh të shkallëzuara që vazhdojnë dhe në shpatullat e tyre. Nikja është cilindrike me bazë gjysmë rrethore dhe mbulohet me konkë sferike në pjesën e sipërme. E gjithë nikja rrethohet me shirit tullash si edhe dritaret.

Pak mbi dritaret dhe niket ndodhet një shirit horizontal tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre, ndërmjet një rreshti tullash mbi të dhe dy rreshta nën të. Një shirit tjetër i tillë ndodhet nën nivelin e dritareve dhe nikjeve. Ky i fundit duket pjesërisht, sepse mbulohet nga çatia e sotme e bazamentit të tamburit.

Sipërfaqja e lirë ndërmjet dy shiritave me tulla të vendosura në formë dhëmbësh sharre, që përmendëm më lart dhe që kufizojnë brezin e poshtëm është e dekoruar e tëra me tulla. Dekori përbëhet prej brezash

7) Versaqis mendon gabimisht se kjo derë ishte e vjetër dhe ndodhej në mes të murit verior, shih: **Arheologjiki Efimeridha** 1916, 108 v.

ROTOGJY

tullash të ndara nga rreshta tullash. Secili brez ka për dekor tulla të plota veshëse të vendosura 45° ndaj horizontit me gjysma tullash në pjesët ndërmjet këndeve, tulla trekëndëshe të vogla dhe të mëdha të alternuara, tulla këlliç me fuga llaçi të trasha, dhe tulla ku janë gërvishur diagonalet. Vrima të skeleve janë në të dy rreshtat e tullave këlliç, në secilin nga intervalet ndërmjet nikeve dhe dritaret.

Brezi i dytë i tamburit është ndërmjet shiritit të sipërm me tulla dhe kornizës nën çati. Ky brez përbëhet prej rreshti tullash me veshëse të plota me brinjë 45° ndaj horizontit e tulla trekëndëshe me qoshe, prej rreshti tullash të vendosura këlliç që alternohen, me tulla trekëndëshe, me tulla të vendosura në formë kurriz peshku, tullash kuadratike dhe në një vend shirit tullash në formë dhëmbësh sharre. Nga këto vetëm rreshti me tulla klliç formon një rresht të plotë, të tjerët janë vazhdim i njëri-tjetrit, gjë që shpjegohet me punën e muratorëve të ndryshëm ose me kërkesa estetike. Edhe këtu si dhe në brezin e poshtëm, ndërmjet radhëve të ndryshme të dekorit ka rreshta tullash që shërbejnë për lidhjen e veshjes me bërthamën e murit.

Tamburi përfundon me një kornizë të dyfishtë prej tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre e tullash të drejta mbi to. Mbi të vjen çatia prej rrasash guri. Gjurmë në dukje të mbulesës së çatisë së dikurshme me tjegulla nuk ka. E vetmja dëshmi që na shtyn të mendojmë për këtë zgjidhje është prania e disa tjegullave solene, pak të kurbëta, që ruhen të përdorura në ndonjë vend ndërmjet rasave të mbulesës.

Pjesët në dukje të bazamentit të tamburit janë të dekoruara edhe ato me tulla. Dekori, si dhe tek tamburi, është me breza tullash të vendosura këlliç, me faqen në dukje, me tulla trekëndëshe të vendosura në mënyrë alternative, me tulla me faqe të plotë të vëna 45° e tulla trekëndëshe ndërmjet tyre. Ndërmjet brezave të mësipërme ka për lidhje gjithnjë dy radhë të drejta tullash. Vetëm në faqen perëndimore të dy pjesët e faqes së bazamentit janë të njëjta. Bazamenti i tamburit përfundon me një kornizë me një rresht dhëmbësh sharre, mbi të cilën vjen çatia me rrasa guri. Jo në të tëra anët korniza është horizontale. Si në anën lindore ashtu edhe atë jugore ajo vjen duke u ulur në mes. Deri në një farë mase kjo mund të shpjegohet me shmangien nga vertikaliteti që ka tamburi i kupolës, me prerje maksimale pikërisht në drejtim të juglindjes.

Frontoni i krahut perëndimor të kryqit ruhet në pamjen e dikurshme deri në prakun e dritares, ku arrin çatia e narteksit dhe portikut (Tab. VIII, 3, Tab. IX). Pjesën qendrore të frontonit e zë dritarja dyshe. Ajo ka një kolonë në mes me kapitel guri mbi të, dy radhë me tulla të shkallëzuara si tek dritaret e kupolës, formojnë si shpatullat ashtu edhe mbulesën me hark. I vetmi ndryshim qëndron në krijimin e një fushe ndërmjet dy harqeve, sepse harku i poshtëm fillon menjëherë mbi kapitel. Gjithashtu edhe forma e kapitelit ndryshon nga ajo e kapiteleve të tamburit. Këtu kapiteli ka faqet në dukje të kurbuara dhe si dekor nga një kryq në mes. Faqja e frontonit është e dekoruar me tulla të vendosura në radhë, si edhe tek tamburi e bazamenti i tij. Kemi radhë tullash trekëndëshe, tulla të plota të vëna 45° ndaj horizontit me tulla trekëndëshe në qoshet, tulla të plota me diagonalet të vizuara. Këto katër radhë arrijnë përafërsisht deri në nivelin e kapitelit të dritares dyshe. Ndërmjet tyre ka nga një rresht tullash të drejta për lidhje me murin. Pak mbi to fillon korniza e frontonit, e përbërë prej dy radhësh tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre e tullash të drejta mbi të. Nga to, rreshti i dytë dhëmbë sharre ruhet në mënyrë të fragmentuar. Korniza mbaron me majë të mprehtë në mes, ndërsa bazat e saj për një largësi të vogël janë horizontale. Nën kornizën ka një radhë tullash veshëse të plota, të vëna 45° ndaj kornizës me tulla trekëndëshe në qoshet. Fusha që mbetet në mes këtij rreshti, dritares dyshe, dhe rreshtave horizontalë që përshkruam më lartë është e mbushur edhe ajo me tulla të plota dhe trekëndëshe. Të vetmet pjesë boshe janë vrimat e skeleve, nga të dy anët e dritares. Me të njëjtën mënyrë janë dekoruar edhe faqet jugore e veriore të këtij krahu të kryqit.

Krahu verior i kryqit ruhet i dëmtuar me të çara të mbushura pa kujdes me llaç dhe me pjesë të meremetuara keq (Tab. VII, 2; Tab. X). Dritarja në mes të frontonit është murosur në pjesën më të madhe dhe transformuar duke i hequr pjesë të radhës së brendshme të shkallëzuar, për të krijuar dy dritare të vogla. Gjithashtu ruhet vetëm një rresht dhëmbë sharre nga të kornizës dhe është dëmtuar së tepërmi shpatulla lindore e frontonit, e cila është meremetuar keqaz. Edhe faqet anësore të krahut të kryqit janë të dëmtuara. Kështu faqja nga lindja ruan shumë pak gjurmë të dekorit të dikurshëm, ndërsa ajo nga perëndimi ruhet më mirë me dekor që është vazhdim i atij në fronton dhe me gjurmë të pjesshme të tullave në formë dhëmbësh sharre.

Nën dritaren e frontonit kemi dy radhë me tulla, i sipërmi me tulla trekëndëshe, i poshtmi me tulla të plota që alternohen me tulla këlliç. Më poshtë këtyre kemi vetëm muraturë me teknikën kluasonazh me një ose dy tulla horizontale. Ndërmjet gurëve ka tulla të vendosura vertikalisht, të cilat kanë anash copa tullash të vendosura pjerrtas. Kjo pjesë e poshtme e murit, që ruhet e dëmtuar, nuk është e të njëjtit nivel ekzekutimi si dhe pjesët e sipërme edhe tamburi i kupolës.

Në këtë mur verior, në pjesën në perëndim të krahut të kryqit që në interier i takon ambientit të mbuluar me qemere në qoshen veriperëndimore të naosit që sot

BOTIMI

DO NOT COPY

funksionon si narteks, kemi një dritare të mbuluar me hark tullash të vendosura në mënyrë radiale (Tab. VIII, 4). Çatia e kësaj pjese përbëhet prej dy flegrash, njera pranë krahut të kryqit, me derdhje uji nga veriu, ndërsa tjetra me derdhje uji nga perëndimi. Të dyja këto flegra ndahen me kallkan nga njëra tjetra që formohet ndërmjet tyre. Mbi dritaren kemi një zonë me tulla të plota të vendosura 45° ndaj horizontit, e cila shkon deri në kornizën e pjerët.

Pjesët e tjera të poshtme janë të mbuluara nga ndërtimet e vona si qimiteri, portiku dhe portën në këtë anë dhe një kontërforcë e ulët në qoshen verilindore të meremetuar pa kujdes. Ato që dallohen janë me kluasonazhin që përshkruam më lart[8]).

Akoma më e transformuar është ana lindore (Tab. IX). Ajo në pjesën e poshtme është e mbuluar nga dheratë, që janë në nivel më të lartë se dyshemeja e kishës. Sidoqoftë me lehtësi vrojtohen pjesët e reja nga të vjetrat. Kështu janë ribërë absidat si ajo qëndrore e madhe (Tab. VII, 3), ashtu edhe dy të tjerat anësore të vogla. Ato janë rindërtuar vetëm me mur guri. Nga ndërtimi i vjetër ruhet vetëm muri lindor që i takon ambientit të altarit, ndaj të cilit dalin absidat, i ndërtuar me breza të dekoruar në pjesën e sipërme dhe klausonazh si i mësipërmi në pjesën e poshtme. Ruhen gjithashtu edhe fillimet e absidave, çka tregon se të rejat ndjekin në planimetri të vjetrat.

Absida e madhe ka një dritare dyshe me kolonë guri në mes dhe mbuluar me harqe të dyfishta tullash. Mbi të është një pllakë guri, ku është gdhendur një kryq dhe data 1776, sigurisht viti i rindërtimit, si dhe emri Papa Zoto. Muratura e absidës mbaron me një kornizë prej tri radhësh gurësh më të vegjël, të vendosur në formë dhëmbësh sharre.

Të reja janë gjithashtu edhe qoshet e kësaj faqeje muri, si dhe pjesë mbi absidë që i takon krahut lindor të kryqit, duke u paraqitur kjo faqe thuajse e re.

Po kështu paraqitet ana jugore në të cilën kemi paraklisin e ri dhe këmbanoren. Krahu jugor i kryqit është i ri, i ndërtuar kryesisht me gurë duke patur me tulla vetëm dy radhë, një me tulla këlliç në nivelin e dritares, dhe një tjetër me tulla me faqe të plotë (Tab. VII, 4; Tab. X). Teknika e ndërtimit me gurë të rregullt e fuga llaçi të holla na duket vetëm deri në një farë mase e njëjtë me atë të absidës. Muratura e paraklisit është më e çrregullt, çka na shtyn të mendojmë për kohën më të vonë të këtij rindërtimi. Muret e tij në pjesën e poshtme përfundojnë me skarpat për të kontraforcuar qemeret e paraklisit, i cili ka të ngjarë të jetë ndërtuar për të mbajtur muret e kishës që duket se do të jenë pjerrur dhe çarë. Hyrja e paraklisit që sot është murosur ka patur formën e një portiku të mbuluar me qemer, harku në dukje i të cilit është me gurë e tulla të alternuara dhe rrethuar nga një rresht dhëmbësh sharre (Tab. VII, 6). Dritare të vogla si frëngji janë në murin jugor për të ndriçuar sadopak interierin.

Që ky paraklis është ndërtuar më vonë se narteksi në anën perëndimore bindemi po të shohim pjesën e sipërme të mureve të tyre që janë në kontakt, gjë që mund të shihet në ambientin nën çatinë e narteksit. Duke parë formën e murit të paraklisit në zonën e kontaktit me narteksin, rezultoi se narteksi është ndërtuar më përpara dhe se paraklisi i është mbështetur atij.

Mbi qemerin e paraklisit mbështetet këmbanorja që është ndërtuar në një kohë më të vonë se paraklisi dhe me muraturë mjaft të rregullt (Tab. VII, 5). Këmbanorja e ngushtë dhe e lartë ka dy kate me strukturë të njëjtë prej harqesh, i pari më i gjerë dhe harqe më të vogla. Në këtë kat del dhe dritarja e ambientit perëndimor të naosit, e cila është zgjeruar. Kati i dytë i ka harqet të punuar më mirë dhe të rrethuara me një rresht pllakash. Këmbanorja mbulohet me një çati piramide që fillon pas një kornize prej gurësh të nxjerrë ndaj faqeve të këmbanores.

Në muret e narteksit dhe të paraklisit është lidhur më vonë portiku me kolona dhe harqe që pamë më sipër, i cili mbulohet me çati druri, vazhdim i çatisë të pjesëve të tjera të kishës.

Vështrimi i shtesave në anën e jashtme na ndihmon për orientimin e kërkimeve në interier, ku para së gjithash duhet të sqarojmë formën e dikurshme të katër pilastrave nën kupol e pastaj shtesat e tjera. E vetmja mundësi që patëm, ishte dallimi i shtesave nga strukturat që ne menduam se ishin të vjetra, ose nëpërmjet fugave të suvasë, kur ishin të suvatuara, ose nëpërmjet teknikës së ndërtimit (ana e mbrapme e shtesave përpara protezis dhe diakonikoni). Kështu forma e pilastrave prapa ikonostasit rezulton të jetë në formë L-je dhe se shtesat që ndajnë protezis dhe diakonikonin nga naosi që mbarojnë sipër me hark, janë vendosur për të forcuar qemerin e ambienteve të mësipërme në pjesën që mbajnë shpatullat e krahëve të kryqit. Për të njëjtin funksion konstruktiv janë bërë edhe shtesat në anën tjetër të këtyre krahëve të kryqit, duke rezultuar pilastri i vjetër në formë T-je me krahë më të gjatë se atë nga ambienti qendror[9]).

Shtesat e pilastrave nga ana e ambientit qendror dallohen si nga fugat pak a shumë të qarta, ashtu edhe

8) Vërejmë këtu se ky kluasonazh është i vendosur pa rregullshmërinë rigoroze, me të cilën e jep Versaqis.

9) F. Versaqis **Po aty** nuk dallon pjesët shtesë të pilastrave nga pjesët e vjetra.

nga mos përputhja e tyre me faqet e pilastrit dhe fillimet e harqeve mbajtëse. Tabloja e krijuar në këtë mënyrë ka nevojë për tu sqaruar nëpërmjet sondazheve sepse mbetet për t'u përcaktuar mënyra, me të cilën harqet mbajtëse mbështeten në pilastrat. Pra kemi ndonjë pjesë në formë gjysmë kolone apo pilastri ndërmjet krahëve të pilastrit bazë, apo kemi gurë të nxjerrë konsol nga pilastri për mbështetjen e harqeve.

Shtesë për arsye konstruktive janë dhe pilastrat në arkadën perëndimore nën kupol bashkë me sistemin e harqeve të cilat i përshkruam më lart.

Për shkak të shmangies së vogël nga katrori të ambientit qendror nën kupol, harqet mbajtëse formojnë një drejtkëndësh me brinjën veri-jug pak më të madhe. Për këtë arsye tamburi në këto dy anë mbështetet mbi konsola të harkuara të nxjerra ndaj harqeve mbajtëse.

Mbas këtij trajtimi është e lehtë të rikonstruktojmë planimetrinë e kishës, si dhe fazat e ndryshme të rindërtimeve, të cilave u është nënshtruar ajo. Del menjëherë në dukje qartësia e organizimit planimetrik me ambientin qendror me kupol si bërthama qendrore e kishës dhe vazhdimësia e ambienteve mbrapa arkadave në protezis e diakonikon. Me interes është edhe lidhja e pjesës perëndimore të naosit, i cili rezulton si i veçuar prej tij. Kjo gjë nënvizohet edhe nga mbulesat me qemere, ndër të cilat dy anësorët në nivel më të ulët dhe i japin një aks gjatësor këtij ambienti, i cili rezulton të jetë si një endonarteks. Kjo është edhe arsyeja që mbas shtesave (pilastra dhe harqe), ky ambient u kthye në një narteks me tribuna.

Gjatë viteve 70 të shekullit XVIII, për shkak të dëmtimeve në strukturat mbajtëse të kishës janë rindërtuar absidat, janë bërë shtesat në interier dhe narteksi në anën perëndimore. Sot është e vështirë të përcaktohen dëmtimet që ka pësuar kisha dhe shkaqet e tyre, gjurmë të të cilat ruhen edhe sot. Të tilla janë prerja në drejtim jug-lindje e tamburit, deformimet në bazamentin e tij, të çarat në anën veriore. Mund të na ndihmojnë për këtë edhe pjesët e reja dhe shtesat, siç janë absidat e krahu jugor i kryqit, qoshet verilindore e juglindore të kishës, përforcimet në interier dhe shtesat pranë mureve.

Dëmtimet në absida dhe pjerrja e tamburit na shtyjnë të mendojmë për një cedim vertikal të pilastrit jugë lindor ose pjerrje të tij dhe ulje të harqeve nën ngarkesat e tamburit e të kupolës. Gjithashtu plasjet në anën veriore, ribërja e krahut jugor të kryqit tregojnë se ka pasur dhe dëmtime të strukturave me harqe e qemere, për shkak të kalbjes së brezave dhe tiranteve dhe uljes së kohezionit të muraturës, si pasojë e veprimit të agjentëve të ndryshëm dhe kohës. Nuk duket se ka munguar në këtë drejtim edhe ndonjë lëkundje tërmeti.

Në analizën që i bëmë më lartë elementeve të ndryshme arkitekturale dhe shtesave që ka pësuar monumenti në kohë, nxorëm dhe të dhëna për radhën e këtyre shtesave, që përbëjnë dhe fazat e rindërtimit të kishës. Kështu rindërtimi i parë është ai i vitit 1776, kohë në të cilën janë ribërë absidat e krahut jugor të kryqit dhe është shtuar narteksi. Më vonë është shtuar paraklisi në anën jugore, i cili i është mbështetur narteksit. Në një kohë më të vonë janë ndërtuar qimiteri dhe portiku perëndimor, lidhja në kohë e të cilëve nuk mund të përcaktohet, por që sigurisht duhet ti takojnë sh. XIX.

Kështu mundëm të përcaktojmë format fillestare të kishës dhe rindërtimet që për arsye të ndryshme i janë bërë asaj. Kjo bën të mundshme edhe gjykimin për vlerat e monumentit, madje dhe datimin e tij. Siç edhe pamë, kemi të bëjmë me një kishë të tipit kryq i brendashkruar vetëm në aspektin e jashtëm të tij, ndërsa në interier, për shkak të vendosjes së arkadave në anët perëndimore, veriore dhe jugore, ambienti qendror izolohet nga krahët e kryqit, duke krijuar një organizim planimetriko-volumor pak a shumë origjinal. Kështu shtrohet pyetja nëse kemi të bëjmë me një bazilikë trenefshe me kupol, duke i rezervuar pjesës perëndimore të naosit rolin e narteksit. Mendojmë se një gjë e tillë nuk do të ishte e drejtë. Për vetë madhësinë e tyre dhe gjerësinë e pakët ndaj ambientit qendror ato nuk mund të lozin rolin e një nefi anësor. Gjithashtu duhet të pranojmë se nga tipi monumenti në studim shmanget edhe për formën e «ambienteve këndore» të anës perëndimore, të cilat lidhen më tepër me krahun perëndimor të kryqit sesa me krahët e tjerë, me të cilët ndahen nga një hapësirë e ngushtë dhe e ulët.

Ne do ta shpjegonim këtë formë të veçantë me dy mundësi: së pari, me ndikime të drejtpërdrejta të tipeve të vjetra sh. VIII-IX të Selanikut (Sh. Sofia) dhe Konstandinopojës (Gjyl Xhami), tek të cilët kemi krijimin e hapësirës qendrore me kupol mbi katër pilastra, që nëpërmjet arkadave mbi kolona lidhet me galeritë që e rrethojnë nga të tri anët. Dallimi në planimetri qëndron në atë që protezis dhe diakonikoni janë në një aks me ambientet në veri e jugë të hapësirës qendrore. Dallimi në volumetri qëndron në atë që këtu ambientet anësore si krahë të kryqit ngrihen deri në nivelin e fillimit të tamburit. Së dyti si ndikime të përpjekjeve të njëjta që gjatë fundit të shk. XIII bëhen në Konstantinopojë (Sh. Andrea në Krisë, Shën Joan Pagëzori, Fetiie Xhami) për të krijuar kisha me hapësirë qendrore me kupol, me të çlirta në planimetri, por gjithnjë me galeri që e rrethojnë nga të tri anët[10]). Dallimi në ndërtimin volume-

10) Me këto dy grupe të tipit me galeri rrethuese e lidh dhe Sotiriu, Shih G. Sotiriu, **Kristianiqi qe Vizantini arkeologjia,** Athina 1942, A, 381.

BOTIM

trik të ambienteve anash hapësirave nën kupol, që shfaqet edhe në anën e jashtme, është me sa duket pasojë e zgjidhjes brenda formës tradicionale të kishës të tipit kryq i brendashkruar me kupol mbi tambur. Duhet të shënojmë se kjo zgjidhje është më se e arritur.

Nëse do shqyrtojmë vlerat arkitekturale të këtij monumenti, do të bindemi se kemi të bëjmë me një ndërtim të arritur me tërë karakteristikat e arkitekturës bizantine. Madhështia e tij vërehet që në kontaktin e parë me të, që nga rrugët që gjerpërojnë kodrave për t'ju afruar fshatit, ku mbi gjithçka vërehet në mes selvive kupola e tij madhështore. Kjo përshtypje mbetet dhe kur e sodisim atë nga brenda oborrit të kishës, e cila vizualisht fragmentohet në pak element: portiku elegant si tantellë mbi sfondin e errët të hijes, çatia gri në të kaltër prej rrasash guri me një fakturë mjaft interesante në sfondin e së cilës, panoramës së fshatit dhe qiellit të kaltër, vlerësohen së tepërmi krahu perëndimor i kryqit dhe kupola mbi tambur, e cila me përmasat e saj zotëron tërë ndërtesën. Impresioni është i tillë që as shtesat as dëmtimet dhe as të çarat e mureve, të cilët janë merremetuar keq, nuk mund ta zvogëlojnë ndjenjën e madhështisë, e cila tej gjurmëve të kohës ndihet më tepër. Kjo përshtypje bëhet akoma më e madhe mbas studimit, kur format e dikurshme dhe madhësia e vërtet e monumentit ndihen prapa mureve të reja e në vend të pjesëve të zëvendësuara. Gjithçka mbas një loje të çative të krahëve të kryqit, si në një piramidë kulminon me tamburin me kupol, i cili me përmasat, proporcionet e dritareve dhe nikjeve, dekorin keramoplastik sundon të tërën (fig. 7). Brezi i sipërm në dekor dhe korniza e rrafshët i japin pamje të rëndë tamburit, të cilin deri në një farë mase e pakësojnë ngjyra e tullave; format në të cilat janë vendosur dhe dritaret me nikje që alternohen të nënvizuara nga shiritat me dhëmbë sharre.

Në pjesët sot në dukje mund të vërehet vlera e madhe dekorative e tullave në vizatime nga më të ndryshmet që kontribuonte në piktoresken. Po kështu edhe pjesët e poshtëme të kishës me kluasonazhin e tyre karakteristik, ku prania e tullës është jo e vogël, nuk mbeten pas si nga ana koloristike ashtu edhe nga endja e muraturës. Pa këtë lloj kluasonazhi dekori kompleks prej tullash i pjesës së sipërme do ta shkëputse këtë prej «bazamentit», gjë që nxjerr në dukje aftësinë e ndërtuesve.

Gjithë ky impresion sikur venitet, kur futemi brenda në narteksin e errët e të ngushtë të shtuar gjatë



Fig. 7

DO NOT COPY

shek. XVIII. Mbasi futemi në kishë, nën dyshemenë e tribunave e prapa arkadës perëndimore, sot të transformuar, ky impresion mbetet, por mjafton të kalojmë këtë arkadë, do të shtangemi duke kaluar shikimin nga ikonostasi lart mbi kokën tonë, ku në një lartësi prej rreth 17 m. përfundon kupola. Ndjenja e të madhërishmes mbizotëron edhe pse brendësia sot është e gjymtuar, i mungojnë afresket e dikurshme, janë shtuar dekore në stuko dhe është lyer me një ngjyrë të ftohtë. Gjithçka flet për vlerat e padyshimta të monumentit. Dikur këto do të kenë qenë akoma më të dukshme, kur prapa arkadave jo gjithçka ishte e errët sa sot dhe muret ishin të rregullta. Hapësira e brendshme është tipike për arkitekturën bizantine. Dy elemente kontribuojnë më tepër se në kishat e tipit kryqi i brendashkruar. Madhësia, e cila shton vertikalitetin dhe shkallën e monumentit; arkadat, të cilat shtojnë ndjenjën e pafundësisë së hapësirës së brendshme, e cila bëhet në këtë rast edhe më dinamike. Kështu për vizitorin nga qëndra shikimi humbet në të tërë drejtimin mbrapa arkadave, të cilat dhe zvogëlojnë praninë e pakët të dritareve (një për çdo krah). Janë pikërisht arkadat ato që zvogëlojnë, jo në kurriz të monumentalitetit, staticitetin e hapësirës qendrore në kupol — aksin vertikal.

Duke gjykuar tërësisht vlerat arkitekturale të monumentit, si ato të brendësisë ashtu dhe ato të jashtmet, duke mos përjashtuar këtu dekorin keramoplastik, i cili është një element mjaft i rëndësishëm në formulimin e arkitekturës së jashtme, mendojmë se monumenti është një realizim i arritur dhe ruan vlera të dorës së parë.

Datimi i monumentit është i kushtëzuar nga mungesa e të dhënave epigrafike dhe burimore. Në këtë rast arkitektura mbetet si e vetmja mbështetje. Nëse do të niseshim nga ndërtimi planimetrik, gjejmë paralele, siç përmendëm dhe më lart, me kishat e Konstantinopojës, të cilat ndërtohen në fund të sh. XIII. Në drejtim të dekorit me tulla të plota (damier) gjejmë paralele me kishat e Kosturit (sh. XI), Shën Sofia e Ohrit (sh. XI), kishat e Artës (sh. XIII), Sotiriu, mendon se kisha duhet të jetë ndërtim i sh. XII-XIII[11]). Duke u nisur nga forma planimetrike dhe vëllimore (zgjidhja brenda tipit kryq i brendashkruar) dekori keramoplastik, format e zhvilluara dhe kupola e lartë mendojmë se kisha duhet të jetë ndërtuar në gjysmën e dytë të sh. XIII. Në të mirë të kësaj teze janë dhe dy faktorë. Së pari, se gjatë kësaj kohe ndërtohet në Despotatin e Epirit, në lidhje të njohura arkitekturale me kryeqytetin, disa kisha të rëndësishme dhe me zgjidhje të veçantë (Artë, Mesopotam) dhe së dyti se në gjysmën e dytë të sh. XI në Peshkopinë e sipërme, pak më në jug të Labovës së Kryqit, kisha e Shën Mërisë akoma nuk ka formën e mirëfilltë kryqi i brendashkruar. Shtojmë se me interes për studimet e ardhshme do të ishte edhe hetimi i shkaqeve të ndërtimit të kësaj kishe në këtë vend.

* *
*

Siç doli dhe nga studimi i këtyre dy monumenteve, rindërtimet dhe shtesat që u janë bërë nuk kanë marrë asnjëherë parasysh vlerat e tyre, por janë bërë ose për të mënjanuar dëmtimet ose për shtim ambientesh. Për një vlerësim më të mirë të tyre shkencor dhe estetik është e domosdoshme të ndërmerren punime restauruese, që duhet të pranojmë se janë jo të lehta. Për këtë në radhë të parë duhet të kryhen një sërë sondazhesh, të cilat krahas pranisë apo jo të pikturës murale do të sqarojnë përfundimisht shkaqet e dëmtimeve dhe do të na lejojnë të gjykojmë më mirë për madhësitë e përforcimit të monumentit dhe heqjeve të shtesave konstruktive në brendësi dhe në anën e jashtme. Megjithëkëtë mendojmë se është vendi të shprehim mendimin tonë lidhur me ndërhyrjet restauruese në këto dy monumente.

Për sa mund të gjykohet sot, kisha e Shën Mërisë së Peshkopisë paraqet një sërë avantazhesh për ndërhyrjet restauruese, nga që për mendimin tonë ambienti shtesë dhe portiku në hyrje duhen ruajtur për vlerat e tyre historike e estetike, ndërsa duhen hequr shtesat në çati dhe rikonstruktuar ajo në format e para. Për të çliruar dhe brendësinë nga përforcimet, do të duhet të përcaktohen më saktë shkaqet e dëmtimeve dhe mundësia reale e përforcimit të strukturave të vjetra si edhe rivendosja e tiranteve të reja të domosdoshme për përballimin e shtytjeve. Gjithashtu nëpërmjet ndërtimit të një muri mbajtës të terenit në anën veriore besojmë se do të jetë e mundur të hiqet kontërforca në anën veriore.

E njëjta gjë nuk mund të thuhet për kishën e Labovës së Kryqit, e cila ka një numër më të madh shtesash në anën e jashtme, nga të cilat për mendimin tonë me vlerë është vetëm portiku në anën perëndimore. Por, me përjashtim të qimiterit në anën veriore, të gjitha këto shtesa kanë karakter të qartë konstruktiv, kështu që gjykimi për heqjen e tyre mund të bëhet vetëm pas sondazheve të shumta për të studjuar gjendjen e strukturave (harqe, qemere, mure), të cilat për numrin e madh të përforcimeve në brendësi dhe në anën e jashtme, duhet të jenë të dëmtuara në mënyrë të ndjeshme. Një ndërhyrje restauruese duhej, pikërisht të riaftësonte në pikëpamje konstruktive këto elemente,

11) Sotiriu G., **Po aty.**

Pozitiv

duke rikrijuar kohezionin e tyre dhe nëpërmjet vendosjes së tiranteve, skemën konstruktive të dikurshme. Duke qenë se shtytjet vijnë nga kupola në pilastrat dhe prej tyre në muret anësore kryesisht në pjesët në drejtim të pilastrave, nëse masat e mësipërme do të jenë të pa mjaftueshme, heqja e përforcimeve në brendësi duhet të zevendësohet me përforcime të reja prej beton armeje që rrjedhimisht do të zënë më pak vend. Këto përforcime besojmë se janë më pak të ndieshme sesa kontërforcat në anët e jashtme.

Për sa i përket pjesëve të rindërtuara si apsidat dhe krahu jugor i kryqit, mendojmë se në fazën e parë të punimeve mund të mbeten dhe rikthimi i tyre në formën e vjetër, të vendoset më vonë.

* * *

Të dy monumentet që trajtuam deri tashti tregojnë qartë që dhe në këtë zonë kishat bizantine të tipit kryq i brëndashkruar me kupol ndoqën rrugën tradicionale të kalimit nga format jo të qarta të kryqit dhe thuajse bazilikale në ato të zhvilluara, mbi bazën e formës së mirëfilltë planimetrike të tipit. Madje në rastin e Labovës së Kryqit kemi të bëjmë me një monument më të zhvilluar se tipi dhe që tenton të përdori galerit rrethuese, por gjithnjë brenda formës tradicionale të tipit. Për këto arsye studimi i tyre i përbashkët paraqet interes të veçantë, aq më tepër kur nuk kemi të bëjmë me monumente të zakonshme.

DO NOT COPY


1


4


2


5


3

DO NOT COPY

TAB. II



Prerje gjatësore



Prerje tërthore

DO NOT COPY



Pamje nga jugu



Pamje nga veriu

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Pamje nga lindja

0 1 2 3



0 1 2 3

Pamje nga perëndimi













DO NOT COPY

DO NOT COPY



Prerje gjatësore



Prerje Përthore













DO NOT COPY









DO NOT COPY



Pamje nga lindja



Pamje nga perendimi

DO NOT COPY

TAB. X



Pamje nga veriu



Pamje nga jugu

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

DEUX EGLISES BYZANTINES DU DISTRICT DE GJIROKASTRA

RESUME

Cet article traite de deux églises, de forme croix inscrite à coupole sans appui, situées dans le district de Gjirokastra. Il s'agit précisément de l'église de Sainte-Marie de Peshkopi e Sipërme et de l'église Sainte-Marie de Labove e Kryqit.

L'église de Sainte-Marie de Peshkopi e Sipërme se trouve à 15 minutes de marche au sud du village de même nom. C'est la seule construction qui domine une des collines s'étendant de la plaine vers le mont Bureto. Elle était naguère le siège de l'évêché de Drinopoje. Elle a donné son nom au village, tandis que le nom de l'évêché dérive de celui de la ville ancienne et moyenâgeuse d'Andrinople, qui s'étendait autrefois entre le couvent des bektachis de Melan et le village de Sofratike.

Dans son aspect actuel, elle comporte des fenêtres presque complètement murées et des adjonctions récentes aussi bien à l'intérieur qu'à l'extérieur. Dans sa partie méridionale a été ajoutée une pièce, qui, plus tard, a également subi des transformations. Cette église appartient au type croix inscrite à coupole reposant sur un tambour ayant quatre appuis intérieurs. Les appuis sont représentés par des pilastres de forme irrégulière en raison des adjonctions et supportent à travers un système d'arcs de soutien le tambour et la coupole. La forme de la croix créée à l'intérieur par les cintres rejoint le toit, en laissant voir clairement les bras septentrional et méridional, tandis que les deux autres se trouvent sous le même toit avec les deux autres pièces. Au point de rencontre des bras de la croix se dresse un tambour cylindrique à coupole sur un soubassement quadratique. La toiture de l'église est constituée entièrement de plaques de pierres. La pièce ajoutée dans la partie sud est à angle droit sur le plan, long et étroit, avec sa partie centrale plus haute, tandis que les autres parties sont disposées sous le même toit que l'église.

Cette église comporte le naos et l'autel. La seule entrée au naos est aménagée sur le côté occidental, où se trouve aussi un petit portique. A l'intérieur de l'église ont été effectuées maintes adjonctions surtout en ce qui concerne les pilastres: les arcs de soutien nord et ouest de la coupole ont été renforcés par de nouveaux arcs. De telles adjonctions concernent aussi la pièce d'angle occidentale. Un nouveau mur de soutènement a été également aménagé sur le côté ouest de cette même pièce.

Il convient de souligner que les pilastres, selon la planimétrie correspondant aux différentes phases de construction, ne représentent en effet au point de vue du volume ou structural que des cloisons avec des passages couverts d'arcs. Ainsi les quatre pièces angulaires sont relativement séparées, aussi bien sous l'aspect fonctionnel que sous l'aspect de l'espace, du volume central disposé au-dessous de la coupole et des bras de la croix. Ceux-ci sont couverts comme d'habitude par des cintres cylindriques, dont le point de rencontre à travers des triangles sphériques est surmonté par le tambour à coupole. Les quatre pièces angulaires également sont couverts par des cintres cylindriques, disposés à un niveau moins élevé que les cintres des bras de la croix. Ces cintres rejoignent deux à deux les bras septentrional et méridional de la croix.

La nef est séparée du naos par un mur peint de fresques en l'an 1511 du côté du naos, qui a évidemment joué le rôle d'une iconostase. Ce mur de construction plus récente a du être vraisemblablement, ajouté pour renforcer l'arc de soutien de la coupole du fait qu'il le rejoint. Par devant ce mur se trouve la nouvelle iconostase en bois. La porte, mettant en communication la nef avec le naos, est soutenue par deux colonnes appartenant peut-être à l'ancienne iconostase.

En plein centre de la nef se trouve la table de l'autel représentée par une plaque de pierre taillée s'appuyant sur un bloc de mur. De telles plaques se trouvent également en d'autres parties de cette église. Sur le plancher il y a un fragment de plaque à deux orifices servant probablement d'appui aux colonnes de quelque table ou baldaquin.

En ce qui concerne les murs extérieurs, les murs septentrional et méridional sont masqués le premier par le mur de soutien qui le surmonte et le deuxième par la pièce ajoutée plus tard. Les seules parties apparentes sont les frontons des bras de la croix. Construits seulement en pierres, ils sont munis d'une fenêtre à deux vantaux et couverts par des arcs reposant sur une petite colonne à chapiteau de pierre. Les frontons se terminent par une corniche comportant une rangée de briques disposées à dents

de scie. Le mur occidental conserve maintes traces de nombreuses constructions qu'il est très difficile de déchiffrer. Ainsi, en partant des joints l'on comprend que le portique et son mur portant, aménagé dans la partie intérieure du bras de la croix, représente une reconstruction. Dans la partie supérieure du côté sud, on distingue le joint du bras de la croix actuellement couvert par un toit comme les autres pièces. De même, le côté est présente clairement les anciennes formes et l'on relève les adjonctions effectuées au-dessus des pièces angulaires. Il s'agit là de la partie la plus décorée de l'église. On relève sur le côté sud les traces d'une pièce ajoutée, qui a probablement servi de narthex. Ses portes sont murées, son mur ouest et sa couverture autrefois sous forme de croix à bras de dimensions inégales ont été transformés. Actuellement ce toit est unifié au toit même de l'église. Les murs de la pièce ajoutée sont en cloisonnage, avec deux-trois briques disposées verticalement, tandis que sa face orientale est agrémentée de décorations ressemblant à celles de l'église de Saint-Théodore à Narte. Ces données facilitent également la datation de cette pièce et montrent que nous sommes en présence d'un ouvrage ancien. La façade orientale seulement est décorée de briques, celles-ci étant employées rarement dans les autres façades. On relève également l'absence du cloisonnage, qui vers la fin du XIe siècle et plus tard était devenue une technique de construction habituelle dans les provinces. Le tambour est peu élevé et les corniches sont droites. La planimétrie et les constructions intérieures se caractérisent par l'usage des pilastres, qui représentent presque des murs séparant outre mesure la nef du prothésis et du diaconicon, d'une part, et le bras occidental des pièces angulaires de l'autre. C'est pourquoi à l'intérieur de cette église sont encore conservés des éléments du plan basilical, et cela grâce au fait que les pièces angulaires évitent la partie centrale à coupole.

Le voyageur anglais Holland, qui a visité ce monument en l'an 1812, a déchiffré sur ces murs une inscription selon laquelle il apparaît que l'église en question a été construite par l'empereur byzantin Emmanuel Comnène (1143-1180). Cette inscription n'éxiste plus de nos jours, il se peut qu'elle ait été récouverte par la peinture des murs. Dans ces conditions, il est indispensable de bien vérifier les divers éléments de ce monument offrant des arguments en faveur ou contre cette datation tradionnelle. En partant de la planimétrie qui ne présente pas entièrement les traits d'une église de type croix inscrite à coupole, comme le montre la forme des pilastres qui sont plutôt un prolongement de murs que de vrais pilastres sans appui, des proportions plus petites en hauteur par rapport aux dimensions sur le plan, surtout en ce qui concerne le tambour, ainsi que de l'absence du cloisonnage, il semble que ce monument a été construit pendant la période allant de la fin du XIe siècle jusqu'à la moitié du XIIe, ce qui rend plus vraisemblable les données fournies par Holland. En vue d'une datation plus exacte il importe, à notre sens, d'étudier plus à fond la période d'introduction de ce type d'église dans la dite zone et le commencement de l'utilisation du cloisonnage.

En ce qui concerne la pièce ajoutée, elle appartient à la période antérieure à l'occupation turque; partant de la technique de construction à cloisonnage avec plusieurs briques verticales et du décor du mur oriental, ils nous semble qu'elle a été construite pendant les XIIIe-XIVe siècles.

o o
o

L'église de Sainte-Marie de Labove e Kryqit se situe en plein centre du village de même nom et y occupe une position dominante, surtout quand on l'observe de loin. Elle est entourée par une cour et présente un volume de coloration rouge sur l'arrière-plan d'un cyprès séculaire.

De dehors ce monument a la forme d'une église du type croix inscrite de la variante provinciale, tandis qu'à l'intérieur elle s'éloigne de ce type du fait que l'espace central à coupole reposant sur quatre pilastres est séparé des bras de la croix par trois arcades à deux étages comportant deux colonnes. C'est porquoi l'étude de ce monument présente un intérêt particulier en ce qui concerne l'évolution de ce type et ses rapports avec les autres monuments proches de Constantinople et des provinces.

Actuellement cette église présente des modifications à la suite des réparations et des adjonctions effectuées, surtout sur ses côtés sud et ouest, sans tenir compte des valeurs qu'elle renfermait et en dégrandant lamentablement son aspect antérieur.

Sur le côté ouest, où est aménagée la seule entrée de l'église, se dresse un portique avec une arcade à 8 arcs reposant sur deux pilastres latéraux et 7 colonnes disposées au-dessus d'un mur peu élevé, qui est entrecoupé seulement pour laisser libre l'accès à l'église. C'est par une porte basse couverte d'un arc que l'on entre dans le narthex de construction plus récente, qui est surmonté de cintres.

C'est à travers le narthex à trois degrés d'escalier que l'on entre dans l'église, qui comporte l'espace central au-dessous de la coupole, la pièce de l'autel, les deux pièces derrière les arcades au nord et au sud de l'espace central et la pièce antérieure, qui plus tard a été reconstruite à deux étages, remplissant ainsi jusqu'à un certain point la fonction du narthex par rapport à l'espace se trouvant sous la coupole. L'espace central disposé sous la coupole est muni à ses angles par quatre pilastres de formes différentes, au-dessus desquels reposent les arcs de soutien de la coupole. Les arcades mentionnées plus haut rejoignent en hauteur l'arc de soutien de la coupole et le cintre du bras de la croix.

La planimétrie reproduit les sections et les façades dans leur forme antérieure, ainsi que les reconstructions enregistrées par cette église dans le temps. Cette répartition en différentes phases se fonde sur les résultats des sondages et des observations effectuées dans les murs soit à l'extérieur qu'à l'intérieur. Il a été ainsi possible de reproduire clairement l'aspects antérieur de cette église à croix inscrite de dehors, tandis que son intérieur présente un espace central séparé par des arcades ce qui signifie un éloignement du type. Il convient d'ajouter que la plus grande partie des reconstructions effectuées sont d'ordre technique et

DO NOT COPY

qu'une petite part d'entre elles seulement concernent des pièces auxiliaires, comme le paraclysis sur le côté sud et le cimetière sur le côté nord de l'église.

Pendant les années 70 du XVIIIe siècle, les structures de soutien de cette église ayant été endommagées, on a reconstruit les absides et efectué des adjonctions dans son intérieur et mis en place le narthex sur le côté occidental. Il est difficile actuellement de déterminer les endommagements enregistrés par cette église et les causes qui les ont provoqués, malgré les traces conservées encore de nos jours. Mentionnons entre autres l'inclinaison du tambour en direction sud-est, les déformations de son soubassement, les fissures sur le côté septentrional. Une importante contribution peuvent nous offrir dans cette direction les parties de construction plus récente et les adjonctions, comme les absides du bras méridional de la croix, les angles nord-est et sud-est de l'église, les renforcements effectués dans sa partie intérieure et les adjonctions faites aux murs.

L'analyse des différents éléments architecturaux et des adjonctions enregistrées par ce monument dans le temps, nous a permis d'établir l'ordre chronologique d'exécution de ces adjonctions, soit les différentes phases de reconstruction, La première reconstruction se rapporte à l'an 1776, période au cours de laquelle ont été mises en place les absides du bras méridional de la croix et a été ajouté le narthex. Plus tard a été construit le paraclysis sur le côté méridional en s'appuyant au narthex. Plus tard encore on a construit le cimetière et le portique occidental. Il s'agit en somme de constructions se rattachant, selon toute probabilité, au XIXe siècle.

C'est ainsi qu'il nous a été possible de déterminer les formes initiales de cette église et les reconstructions effectuées pour des motifs différents. C'est à partir de ces données que nous pouvons également juger de la valeur de ce monument, voir même procéder à sa datation. Comme nous venons de le dire, il s'agit là d'une église du type croix inscrite seulement quant à son aspect extérieur, tandis que l'intérieur de ce monument, en raison des arcades disposées dans les parties occidentales, septentrionales et méridionales, comporte une pièce centrale séparée des bras de la croix, créant de la sorte une organisation planimétrico-volumétrique plus ou moins originale. Aussi reste-t-il à savoir si nous avons affaire à une basilique à trois nefs avec chapelle, en réservant à la partie occidentale du naos la fonction du narthex. A notre sens, un tel jugement n'est pas juste. En raison même de leur dimension, et de leur largeur petite par rapport à la pièce centrale, ils n'ont pas pu évidemment exercer les fonctions d'une nef latérale. Il convient de relever également que ce monument diffère de son type par la forme même des «pièces angulaires» du côté occidental, se reliant plutôt au bras occidental de la croix qu'aux autres bras dont ils sont séparés par un espace étroit et peu élevé,

Cette forme particulière s'explique, à notre avis, de deux manières: premièrement, par suite de l'influence directe des anciens types des VIIIe-IXe siècles de Salonique (St. Sophie) et de Constantinople (Gül Cami), où la pièce centrale à coupole reposant sur quatre pilastres se relie, à travers des arcades s'appuyant sur des colonnes, aux galeries qui contournent ses églises de trois côtés. La différence sur le plan de la planimétrie consiste dans le fait que le prothésis et le diaconicon sont disposés sur le même axe tout comme les pièces situées au nord et au sud de la pièce centrale. La différence sur le plan du volume consiste dans le fait que les pièces latérales, en tant que bras de la croix, s'élèvent jusqu'au niveau initial du tambour. Deuxièmement, par suite de l'influence des efforts analogues entrepris à constantinople vers la fin du XVIIIe siècle (St. André à Krise, Saint-Jean Baptiste, Fetiye Cami) en vue de créer dans l'église une pièce centrale à coupole, ayant une planimétrie plus limpide mais toujours munie d'une galerie la contournant des trois côtés. La différence quant au changement du volume des pièces latérales disposées au-dessous de la coupole, qui se manifeste à l'extérieur aussi, représente, à ce qu'il semble, une solution dans le cadre même du type traditionnel d'église à croix inscrite à coupole surmontant le tambour. Il convient de souligner qu'il s'agit là d'une solution vraiment réussie.

Quant aux valeurs architecturales de ce monument, il suffit d'affirmer que nous sommes en présence d'une construction reproduisant à la perfection toutes les caractéristiques de l'architecture byzantine. Dans leur ensemble ces valeurs, à l'intérieur comme à l'extérieur, y compris le décor céramoplastique, en tant qu'élément très important de l'architecture extérieure, représentent une réalisation réussie sur tous les plans. Aussi l'église de Sainte Marie de Labove e Kryqit renferme-t-elle des éléments d'une très grande valeur.

La datation de ce monument est conditionne par l'absence de données épigraphiques et d'autres sources écrites. En conséquence nous ne disposons que les éléments architecturaux pour ce faire. Sur le plan de la planimétrie, on trouve des parallèles, comme indiqué plus haut, dans les églises de Constantinople édifiées vers la fin du XIIIe siècle. Quant à la décoration en briques à damier, les parallèles nous sont offerts par les églises de Kostur (XIe siècle), de Sainte Marie de Ohri (XIe siècle) et celles d'Arte (XIIIe siècle). Selon Sotiriu, notre monument date le XIIe-XIIIe siècle. Si l'on se fonde sur la forme planimétrique, sur la solution dans le cadre même du type d'église à croix inscrite et sur la décoration céramoplastique, ainsi que sur les formes plus évoluées et la coupole plus élevée, il nous semble que ce monument a du être construit dans la deuxième moitié du XIIIe siècle. Et cela pour les raisons suivantes: premièrement, parce qu'au cours de cette période dans le Despotat d'Epire, qui se trouvait en rapports architecturaux avec la métropole, ont été mises en place d'importantes églises se caractérisant par une solution particulière (Arte, Mésopotame) et, deuxièmement, parce que pendant la moitié du XIIe siècle à Peshkopi e Sipërme, un peu plus au sud de Labove e Kryqit, l'église de Sainte Marie n'avait pas encore la forme originale de croix inscrite. Les prochaines études dans cette direction doivent également s'employer à découvrir les motifs qui ont porté à la construction de ce monument en cet endroit.

POMOZ

DO NOT COPY

Emin RIZA

DO NOT COPY

STUDIM PËR RESTAURIMIN E NJË BANESE ME ÇARDAK NË QYTETIN E KRUJËS*)

Brenda mureve rrethues të kalasë së qytetit të Krujës shtrihet një lagje me tiparet karakteristike të qendrave qytetare të shek. XVIII-XIX. Në grumbullin piktoresk të këtyre ndërtimeve shquan për trajtimin dhe përmasat e saj një banesë me çardak të mbyllur, ngritur në pjesën qendrore të kalasë. Ajo nuk lidhet me banesat e ndërtuara në Krujë gjatë shekujve XVIII-XIX, të cilat janë në përgjithësi banesa të mbyllura me kat apo me gjysmëkat perpendikular. Kjo banesë është pjesë e një kompleksi banimi, i cili simbas gjurmëve që ruhen ende sot, përfshinte dhe një godinë të dytë më lart saj dhe disa ndërtime të tjera, nga rrënojat e të cilave është vështirë të përcaktosh funksionet që kanë pasur. Ky kompleks i përkiste familjes së njohur feudale të Toptanasve, duke qenë banesa e sipërme shtëpia e miqve, «selamllëku» (fig. 1), ndërsa e poshtmja, banesa me çardak të mbyllur, shtëpia e familjes, «haremllëku» (fig. 2). Shtëpia e miqve, sot është e rrënuar dhe prej saj ruhen vetëm një pjesë e mureve. Banesa me çardak të mbyllur në pragun e fillimit të punimeve të restaurimit ishte në gjendje mjaft të keqe (fig. 3). Ajo kishte pësuar një sërë ndryshimesh dhe shumë elemente konstruktive ishin në prag të degradimit, duke bërë kështu të domosdoshme ndërhyrjen për restaurimin e saj.



Fig. 1

Gjendja e banesës përpara ndërhyrjes restauruese

Banesa në shqyrtim gjatë kohës ka humbur muret rrethuese, të cilat, simbas gjurmëve duhet të kenë përfshirë një truall të gjerë. Sot përpara saj shtrihet një oborr i vogël, ndërsa porta e jashtme nga trajtimi i thjeshtë tregon se është e vonë dhe nuk lidhet me kohën e ndërtimit të vetë banesës.

Ndërtimi është dykatësh (Tab. I, II, III) me shtrirje sipërfaqësore thuajse të barabartë për të dy katet. Në planimetri banesa ka formën e shkronjës L. Katet ndërlidhen me shkallë të jashtme guri, të cilat dalin jashtë volumit të ndërtimit. Ato janë dyrampëshe, rampa e parë mbështetet mbi muraturë të plotë, ndërsa e dyta ngrihet mbi dy hapësira, mbuluar përkatësisht me qemer çerek dhe gjysmërrethor. Kati përdhe ka të vendosur në ndërlidhje të drejtpërdrejtë me hajatin katër ambiente.

*) Rilevimet janë të autorit dhe E. Harxhit, vizatimet të B. Penxhës dhe F. Zarshatit, fotot të R. Veselit dhe autorit. Projekti i restaurimit u hartua nga autori i artikullit i cili drejtoi dhe punimet.



Fig. 2

Ambienti Nr. 1 duket se është parashikuar për t'u kthyer më vonë në dhomë banimi, siç tregon vendi i oxhakut në faqen veriperëndimore dhe të gjashtë dritaret të ndërtuara çift në lartësi. Ai është pa tavan, i pa suvatuar dhe shtruar me kalldrëm. Ambienti Nr. 2, që komunikon me të parin, është krejt i pandriçuar. Ruheshin gjurmë të shkallëve, që ndërlidhnin këtë ambient me atë sipër tij. Ai duket se ka shërbyer si depo. Ambienti Nr. 3 ka qenë depozitë zahiresh, siç tregojnë çengelet në brezin e drurit në lartësi 1.5 m. nga shtresa, për të lidhur qypat. Ambienti Nr. 4, gjithashtu si i pari, është parashikuar për banim, pse aty gjejmë, në faqen jugperëndimore, vendin e oxhakut me dy kamaret e zakonshme dhe anash tyre 4 dritare dy nga dy mbi njëra-tjetrën.



Fig. 3

Shkallët e jashtme nëpërmjet një parahyrje të çojnë në çardakun, me të cilin ndërlidhen të gjithë ambientet e katit të dytë, me përjashtim të ambientit Nr. 10, i cili më vonë, është veçuar. Ambienti Nr. 6, nga vendi që zë dhe trajtimi i pasur dekorativ i brendësisë së tij, tregon qartë se është dhoma e mirë e banesës. Në kompozimin e saj ajo përsërit skemën e zakonshme të ambienteve të banimit të banesës qytetare shqiptare gjatë shek. XVIII-XIX. Në pjesën fundore është vendosur volumi karakteristik i ndarë në dy pjesë në lartësi (fig. 4). Në pjesën e poshtme, në qendër, është musandra, anash kamare e mbas tyre dyert, që prej dy parahyrjesh të çojnë respektivisht në çardak, në banjë dhe në ambientin Nr. 7. Mafili që shtrihet përtej sipërfaqes së musandrës është krejt i mbyllur, vetëm disa hapësira të vogla me xhama prej tij shohin në dhomë, ndërsa një dritare del në çardak. Shkallë të lehta druri ndërlidhin parahyrjen e djathtë me mafilin, i cili është me dysheme druri dhe tavan dërrase. Dritare, tetë të tilla, janë ndërtuar në ballin kundrejt mafilit. Ato janë vendosur në dy rreshta, të poshtmet më të mëdha kanë nga jashtë qepene me lëvizje vertikale, ndërsa nga brenda «persiane» të larta vetëm 50 cm, ndërsa të sipërmet janë prej skeleti allçie apo gëlqereje me copra xhamash. Kur qepenet janë të mbyllura dritaret e sipërme ndriçojnë ambientin, kur ata ngrihen, duke zënë boshllëkun ndërmjet dritareve fikse, ndriçimi i dhomës sigurohet nga dritaret e poshtme. Në faqen e jashtme ndërmjet dy radhëve të dritareve, është ndërtuar një strehë e dytë, «vetullorja» e dalë 70 cm. Faqja veriperëndimore e dhomës ka në qendër oxhakun ndërsa djathtas një dritare dhe simetrike me të një dollap muri. Sergjenet që përshkojnë të katër faqet e mureve i ndajnë ato në dy pjesë. Pjesa e sipërme duke përfshirë dhe mafilin, është e dekoruar me motive floreale. Tavani i punuar me dru (fig. 5) ka fushë tetë këndëshe rreth së cilës breza me nivele të ndryshme krijojnë thellimin karakteristik të këtij lloj tavani. Në qendër një rozetë më e thelluar se fusha e punuar pasurisht në reliev plotëson këtë vepër me shumë vlerë në llojin e saj. Të gjitha pjesët e drurit si musandra, dollapët dhe tavani janë të dekoruara me motive floreale. Kjo ornamentikë e pasur i jep brendësisë së këtij ambienti një ngrohtësi të madhe.

Ambienti Nr. 7 është një nga më interesantët e banesës. Mafili (fig. 6) i tij i hapur është me sipërfaqe relativisht e madhe, parmakët karakteristikë me rrjetë druri i japin atij pamjen e një ballkoni. Në pjesët e poshtë tij është vendosur një musandër dhe dera që të çon te parahyrja për në banjë, e cila e ndërlidh këtë ambient dhe me dhomën e miqve. Oxhaku, vendosur në faqen veriperëndimore, i shërben dhe banjës. Ndriçimi sigurohet me dritare të vendosura dy nga dy mbi

DO NOT COPY

njëra-tjetrën. Përbri këtij ambienti, në të djathtë të tij, është vendosur banja, një ndërtim interesant dhe relativisht i rrallë. Parahyrja e zakonshme e zhveshjes të çon në ambientin e banjës me planimetri mjaft afër katrorit, e mbuluar me kupol sferike, mbështetur mbi katër trompa. Dyshemeja e banjës, shtruar me pllaka guri, ngrihet mbi kolona prej të njëjtit material dhe lidhet me vatrën e oxhakut të ambientit përbri. Zjarri që ndizet në këtë oxhak ngroh shtresën e banjës, njëkohësisht dhe enën e ujit për larje, pranë së cilës ndodhet një tjetër më e vogël. Depoja furnizohej me ujë nga një tub qeramik, i cili të bën të mendosh për ekzistencën e ndonjë sistemi kanalizimesh për furnizim me ujë[1]). Muret anësore të banjës deri në lartësinë 115 cm. janë me boshllëqe, ku qarkullonte ajri i ngrohtë, i cili me anë të tri vrimave kalonte dhe në brendësi të ambientit të banjës.

Pranë ambientit Nr. 7 është vendosur një ambient i vogël, me ndriçim nga çardaku nëpërmjet 4 dritaresh të vendosura dy nga dy mbi njëra tjetrën. Të poshtmet



Fig. 4



Fig. 5

kanë nga jashtë kafaz druri, dërsa nga brenda kapakë, ndërsa të sipërmet janë fikse. Karakteristik për këtë ambient është oxhaku, me tamburin në formë gjysmë piramide (fig. 7). Vendi i këtij ambienti në kompozim të shtyn të mendosh se kjo është «shtëpia e zjarrit». Am-



Fig. 6

1) Gjatë punimeve të pastrimit, në xhaminë e kalasë u gjetën tuba të tillë.

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

DO NOT COPY

bienti Nr. 10 është krejtësisht i transformuar duke mos ruajtur thuajse asgjë origjinale.

Ambienti Nr. 5, zë krahun e majtë të çardakut. Ai është me përmasa relativisht të vogla dhe ndriçohet nga dritare, të vendosura në dy rreshta mbi njeri tjetrin. Të sipërmet fikse janë njëfishe ndryshe nga ato të dhomës së mirë. Mbi sergjenët që qarkojnë ambientin mbas një brezi të pastër, dy faqe, ajo verilindore dhe juglindore, janë të pikturuara duke paraqitur ornamente floreale (fig. 8), ansamble arkitektonike si dhe një skenë mundjeje. Ky ambient ka nyjen e vet sanitare që del jashtë konturit të planimetrisë.

Materialet dhe teknika e ndërtimit

Banesa është ndërtuar me mur guri, në katin përdhe dhe në pjesën më të madhe të katit të parë. Krahas tij, në këtë të fundit gjejmë dhe mure me skelet druri të teknikave të ndryshme. Muratura e gurit është ndërtuar me gurë kave e lidhur me llaç gëlqereje. Ajo lidhet me breza druri prej lisi rreth çdo 90 cm. Çdo kontur brezash formohet nga tre të tillë me dimensione 5-6 x 14-15 cm., që lidhen rreth çdo 120 cm, me binarë tërthorë 6 x 6 cm. Brezat e jashtëm futen në muraturë. Llaçi është përdorur në sasi të mëdha, saqë muratura nga jashtë ngjan thuajse si e suvatuar. Në katin e banuar takojmë tre teknika të ndryshme me skelet druri. Teknika e parë, shembulli i së cilës është balli i ambientit Nr. 5 (fig. 9/A) karakterizohet nga një sistem shtyllash që lidhen me binarë horizontalë, që përforcohen nga binarë vertikalë, të cilët kufizojnë horizontalisht dhe hapësirat e dritareve. Boshllëqet me forma të rregullta katërkëndëshe mbushen me gurë poroze prej çmersi dhe lidhen me llaç gëlqereje. Një strukturë më e rëndë prej skelet druri është ndërtuar në faqen e majtë të ambientit Nr. 9 (fig. 9/B). Skeleti prej katërkëndëshash që formohet nga shtylla dhe një tra rreth mesit të lartësisë, përforcohet me binarë të tjerë të vendosur pjerrtas, duke formuar hapësira në formë trekëndëshash të cilat janë mbushur me gurë smërçi dhe copa tjegullash. Teknika e tretë, zbatuar në ndarjen që kufizon ambientin Nr. 5 nga çardaku (fig. 9/C) është ajo me skelet prej binarësh vertikalë 7 x 8 cm., të vendosur rreth 70 cm. larg njëri-tjetrit e të veshur nga të dy anët me paretka. Të dy teknikat e para janë të njëkohshme dhe i përkasin kohës së ndërtimit të banesës, pse të dy muret, ku i takojmë, janë origjinale, ndërsa teknika e tretë është më e vonë. Çatia është ndërtuar me lëndë me sistem vendi, me nyje të kllaposura (fig. 10). Ngaqë distanca ndërmjet trarëve kryesorë të çatisë është rreth 130 cm., mbi ta janë vendosur arkareçe 6 x 8 çdo 70 cm., e mbi ta binarë 4 x 7 çdo 30 m. e pastaj petavrat e tje-

gullat. Dyshemetë e katit të banuar janë prej dërrasash të afruara. Ato mbështeten në trarët e dyshemeve nëpërmjet binarësh 8 x 6 cm. Suvatimet janë me llaç gëlqereje të lidhur me kashtë apo lesh ndërsa më vonë gjejmë suvatime thjesht me llaç gëlqereje. Qemeri është përdorur vetëm në konstruksionin e shkallëve. Qemeri kryesor gjysmë rrethor, përforcohet me tri tirante druri, të lidhura në të dy anët me brezat e drurit. Të gjitha dyert dhe dritaret mbulohen me arkitra druri. Dyert janë njëflegërshe (fig. 11) me përjashtim të asaj të ambientit Nr. 5.

Ndryshimet që ka pësuar banesa në kohë

Banesa ka pësuar një sërë ndryshimesh, që kanë prekur kompozimin planimetrik, si dhe elemente të veçanta arkitektonike dhe konstruktive. Në këto ndryshime mund të dallojmë tri momente kryesore: dy faza rindërtimi, që kanë cënuar kompozimin origjinal si dhe dëmtimin e rëndë të pjesës së djathtë të çardakut dhe faqes juglindore të dhomës së mirë. Pjesa më e madhe e ndryshimeve në ambiente të ndryshme lidhet në dy fazat e para, por disa prej tyre janë kryer në kohë të ndryshme nga këto faza. Faza e parë e rikonstruksionit lidhet me ndërtimin e ambientit Nr. 5 në një pjesë të sipërfaqes së çardakut dhe pikërisht në sipërfaqen që shërbente si qoshk. Argumentet që të çojnë në këtë pohim mund të grupohen si më poshtë:

1) Së pari vijnë në konsideratë disa karakteristika krejt të ndryshme të këtij ambienti në krahasim me ambientet e tjera, të cilat shpjegohen me sipërfaqen e kufizuar të qashkut. Kështu kësaj dhome i mungon kompleksi musandër-mafil, një element krejt i domosdoshëm për vetë karakterin e kësaj dhome. Ambienti sanitar është shtuar më vonë, siç tregon fuga në kontaktin me murin origjinal të banesës. Hyrja në të bëhet drejtpërdrejtë nga dhoma, zgjidhje kjo krejt e pazakontë, e bërë nga mungesa e sipërfaqes.

2) Në pjesën e sipërme të brendësisë, mbi sergjenet, një brez pikturash dekorojnë këtë ambient. Tematika e tyre si dhe skema kompozicionale e ornamenteve florealë është e ndryshme nga ajo e dekoracioneve murale të dhomës së mirë (fig. 4, 8), në anën tjetër niveli i tyre është dallueshëm më i dobët. Kjo lidhet me pikturimin me të vonë të këtij ambienti të sajuar në një pjesë të sipërfaqes së çardakut. Gjithashtu të bie në sy punimi i trashë i sergjeneve, trajtimi i ndryshëm i portës, që të çon në ambientet sanitare e aq më tepër i portës së ambientit, e cila është zgjidhur me dy kanate, pra ndryshe nga portat origjinale.

3) Konstruksioni i çatmasë, që e ndan këtë ambient nga çardaku, siç përshkruam është i ndryshëm nga ai i skeleteve prej druri origjinale (fig. 9/C). Të tërheq vëmendjen dhe përforcimi, me anë të një shtylle, që bie diku në mes të hajatit (fig. 12), i traut mbi të cilin ngrihet konstruksioni i skeletit ndarës. Si bazamenti i improvizuar, jasteku i drurit, i ndryshëm për nga trajtimi me ata origjinalët dhe pozicioni i kësaj shtylle në hajat, tregojnë qartë se ajo është vendosur më vonë për të sigu-



Fig. 9

DO NOT COPY



Fig. 10

ruar traun, të cilit iu shtua një peshë e re me ndërtimin e skeletit ndarës prej druri.

Pra, mund të përfundojmë se ambienti nr. 5 është i sajuar më vonë në sipërfaqen e qoshkut karakteristik të kësaj banese të tipit me çardak. Bindjen tonë se sipërfaqja që zë sot ambienti Nr. 5, ka qenë qoshk, e provon vendi që zë kjo sipërfaqe në kompozim, ngritja e kësaj më lart se pjesa tjetër e çardakut dhe së fundi ekzistenca e një sqolli në parahyrjen e vogël për në çardak, i cili i shërbente pikërisht këtij qoshku, kur ai gjatë stinëve të ngrohta bëhej praktikisht një ambient qëndrimi.

Në lidhje me qoshkun shtrohet së fundi dhe pyetja, nëse ka qenë i mbyllur apo jo në ballin e tij. Për mendimin tonë qoshku ka qënë i mbyllur që me ndërtimin e banesës, me ndarjen që ruhet akoma edhe sot. Mbyllja e pjesës tjetër të çardakut, me funksione kryesisht ndërlidhëse e përjashton mundësinë e lënies hapur të qoshkut, kurse ekzistenca e dy shtresave të suvasë në faqen e brendshme të konstruksionit mbyllës të qoshkut, e para rreth 2 cm trashësi me llaç gëlqereje, përzier me kashtë, ndërsa e dyta me trashësi rreth 1 cm. vetëm me gëlqere dhe gjurmët e pikturimit ndërmjet këtyre dy shtresave tregojnë se risuvatimi i kësaj faqeje lidhet me atë të krejt ambientit të krijuar në çardak, për të pikturuar brezin e sipërm të faqeve. Trajtimi arkitektonik i ballit të çardakut dhe qoshkut, si dhe uniteti i tyre me atë të pjesëve të tjera të pamjes kryesore të banesës flasin qartë jo vetëm për lashtësinë e tyre, por dhe e bëjnë të vështirë konsiderimin e tyre si improvizime të mëvonshme.

Faza e dytë e rikonstruksionit, është në fakt prishja e brendësisë së ambientit Nr. 10, dhe shtesa e një ambienti përbri tij. Më vonë u mbyll dhe ndërlidhja e tij me çardakun. Në gjendjen e sotme nuk ka mbetur thuajse asnjë gjurmë për të gjykuar mbi formulimin e brendshëm arkitektonik të këtij ambienti. Megjithatë është e qartë se ai ka pasur grupin karakteristik, musandër-mafil, për vetë karakterin e këtij ambienti, fakt që vërtetohet dhe nga të dhënat gojore. Dritaret e ballit për analogji me ambientet e tjera, kanë qenë sigurisht në dy breza paralelë në lartësi. Ekzistenca e dyshemesë mbi sipërfaqen e ambienteve sanitare që i shërbenin kësaj dhome dhe dy dritaret e vogla që ndriçojnë atë, tregojnë se mafili shtrihej dhe mbi këtë sipërfaqe.

Krahas këtyre dy rikonstruksioneve duhet të përmendim dëmtimin e rëndë që pësoi qjatë luftës Nacionalçlirimtare balli i çardakut, si dhe faqja juglindore e ambientit Nr. 6.

Së fundi mendojmë se nuk është krejt pa bazë, për të hedhur mendimin se banja është një shtesë e mëvonshme. Për këtë pohim mbështetemi në këto argumente:

1) Duken qartë gjurmët e dy dritareve të vendosura njera mbi tjetrën në krahun e majtë (e djathta e vrojtuesit) të oxhakut, e sipërmja është mbyllur ndërsa hapësira e së poshtmes bie në ambientin sanitar. Kjo shpjegohet me ndërtimin e banjës.

2) Muri i banjës është i shkëputur nga ai i banesës.

Por kjo mbetet një hipotezë, përderisa nuk ka të dhëna më të sigurta dhe kur argumenti i dytë, ndoshta, duhet shpjeguar si një rregullsi teknike për vetë strukturat e ndryshme të mureve të banjës nga ato të vetë banesës.

Krahas këtyre rikonstruksioneve dhe dëmtimeve, çdo ambient ka pësuar ndryshime të cilat po i rendisim radhazi:

Ambienti Nr. 1. Nuk ka pësuar ndonjë transformim me rëndësi. Dritaret e poshtme janë murosur, ndërsa njëra prej tyre ishte kthyer në derë, ndërsa dritaret e sipërme ishin mbyllur nga jashtë me çatma. Në dritaren e poshtme që sheh nga juglindja, duken gjurmët e kafazit të drurit që ka qenë vendosur në faqen e jashtme të tyre. Për analogji me dritaren e ambientit Nr. 3, si dhe ato të ambientit Nr. 7, të dy rreshtat e dritareve du-

DO NOT COPY

het të kenë pasur nga jashtë kafaz druri ndërsa nga brenda kapakë druri.

Ambienti Nr. 2. Janë prishur shkallët e drurit, që e lidhin këtë ambient me atë mbi të.

Ambienti Nr. 3. Nuk ka pësuar ndonjë ndryshim.

Ambienti Nr. 4. Është murosur dera origjinale, që e lidhte këtë ambient me hajatin, si dhe tri nga dritaret që dalin në hapësirën e hajatit. Dera dhe dritaret e hapura në faqet juglindore dhe verilindore janë të vona.

Çardaku. Siç përmendëm, gjatë fazës së parë të rikonstruksionit në të është ndërtuar ambienti Nr. 5. Ndërsa gjatë Luftës Nacionalçlirimtare është shkatërruar balli i tij (Tab. III, IV).

Ambienti Nr. 6. (Tab. V). Përveç dëmtimit të faqes juglindore, ky ambient ka pësuar një sërë ndryshimesh të tjera. Perdes, në të majtë të musandrës, e cila së pari ka qenë e thyer, ashtu si ajo në krahun e djathtë, siç tregojnë qartë gjurmët në tavanin e parahyrjes, i është bërë një zhvendosje përpara, për të krijuar mbas saj sipërfaqen e nevojshme për ndërtimin e shkallëve të shërbimit, që e ndërlidhin këtë ambient me atë nën të. Oxhaku i sotëm nuk është origjinal ai është rindërtuar në vitin 1961 simbas modelit të oxhakut të një banese tjetër[2]). Dritarja në të djathtë të oxhakut, sipas të dhënave gojore, ka qenë dollap muri si ai i krahut të majtë. Në faqen jugperëndimore në pjesën që i takon hapësirës mbas derës në të djathtë të musandrës, ka ekzistuar një derë që të çonte në ambientin sanitar, të ambientit, simbas rilevimit të vitit 1960.

Ambienti Nr. 7. (Tab. IV). Faqja verilindore ka të qarta shenjat e arkitrarëve prej druri dhe kontureve të katër dritareve, dy nga dy mbi njera tjetrën. Më vonë në këtë faqe është hapur në vendin e njerës dritare një derë. Tamburi i oxhakut gjithashtu është rindërtuar (fig. 13). Tamburi origjinal ka qenë njëlloj si ai i ambientit Nr. 9 (fig. 7). Për këtë dëshmojnë gjurmët e dy binarëve të prerë më vonë të cilët mbanin strukturën e tamburit. Largësia nga dyshemeja dhe ajo ndërmjet tyre është thuajse e barabartë me ato të të njëjtëve binarë të tamburit të ambientit Nr. 9. Më anë tjetër vetë forma e tamburit të sotëm dhe përdorimi në të i shinave e përforcojnë shumë këtë mendim.

Këto ishin transformimet që kishte pësuar banesa në kohë. Por duhet theksuar se dhe një pjesë e mirë e elementeve origjinale ekzistuese ishin në gjendje të keqe teknike. Suvatime të rrëzuara, dysheme të dëmtuara, dyer, dritare, kapakë druri dhe kafaze druri të degraduara, dritare me skelet allçie apo gëlqereje të dëmtuar rëndë, strehë e vetullore në prag të shkatërrimit etj.



Fig. 11



Fig. 12

2) Për model është marrë oxhaku i banesës së Belegut në Krujë, shpallur «monument kulture».

DO NOT COPY



Fig. 13

Restaurimi

Restaurimi i këtij monumenti, me vlerë të veçantë në gjininë e tij, shtronte disa probleme të karakterit të përgjithshëm metodik, zgjidhja e të cilave do të kushtëzonte hartimin e projektit të restaurimit.

Së pari shtrohej problemi nëse duhej të ruheshin apo jo shtesat e mëvonshme që kishin tjetërsuar strukturën kompozicionale të monumentit. Në lidhje me këtë u mbajt një qëndrim i dyfishtë. Kur këto shtesa kishin cënuar rëndë strukturën e banesës dhe në vetvete nuk ruanin ndonjë vlerë me rëndësi, ato do të hiqeshin duke çliruar dhe vlerësuar kështu monumentin. Kur shtesat ishin lidhur organikisht me banesën dhe ato kishin një domethënie dhe vlera në vetvete, atëherë ato do të ruheshin.

Së dyti, rindërtimi u pranua si një veprim i mundshëm dhe i dobishëm, vetëm në ato raste kur dëshmitë e gjendjes origjinale ishin të sigurta e të plota, qoftë për elemente të veçanta, ashtu dhe për pjesë të monumentit.

Mbi bazën e këtyre parimeve u vendos që ambienti shtuar përbri atij nr. 10 të hiqej, mbasi nuk lidhej aspak me strukturën e banesës dhe e dëmtonte rëndë atë, ndërsa u ruajt ambienti Nr. 5, pse nga ana funksionale ai cënonte pak formulimin fillestar të banesës, nga ana tjetër ai është një dëshmi me vlerë i tendencës së njohur për të ndërtuar në sipërfaqen e çardakut ambiente banimi. Por u vendos të hiqet pjesa e sipërme e ambientit të nyjes sanitare, shtuar gjatë sajimit të ambientit Nr. 5, duke ruajtur pjesën e poshtme të tij[3]).

Përsa i përket rikonstruksionit të disa pjesëve të transformuara simbas rastit u vendos të kryhej apo jo një veprim i tillë. Kështu duke gjetur një fotografi të pjesës qëndrore të çardakut, para shkatërrimit të tij, (fig. 14), u qartësua plotësisht dhe mjaft qartë, struktura mbyllëse e tij. Bazuar mbi këto dokumenta u vendos rikonstruksioni i ballit të çardakut, ndërsa meqë nuk ruhej asnjë dëshmi dokumentare, ambienti Nr. 10 u la në gjendjen mbas rikonstruksionit. Punimet restauruese prekën pak a shumë të gjitha ambientet, për ta bërë më lehtë të kapshme punën e kryer po paraqesim grafikisht, gjendjen e ambienteve kryesor para punimeve të restaurimit si dhe mbas kryerjes së tyre (Tab. IV, V). Me punimet restauruese, të kryera deri më sot, është realizuar thuajse plotësisht projekti i restaurimit. Mbetet akoma pa u realizuar rikonstruksioni i faqes juglindore të ambientit Nr. 6, ndërtimi i sqollit të çardakut dhe ndonjë punim i vogël.

* * *

Kompleksi prej dy banesash, asaj të miqve, sot të rrënuar dhe banesës që përbën objektin e këtij punimi, zë një vend të veçantë në trashëgiminë arkitektonike në lëmin e banesës popullore. Kjo shpjegohet jo vetëm me karakteristikat tipologjike të këtyre ndërtimeve, por dhe me trajtimin e disa elementeve të veçanta arkitektonike. Më anë tjetër jo pa rëndësi është fakti se këto ndërtime i përkasin familjes së feudalëve të mëdhenj, Toptanasve, duke na dhënë kështu një dëshmi të saktë mbi karakterin e banesës së këtyre shtresave të shoqërisë gjatë shek. XVIII. Për këto arsye po ndalemi mbi karakterizimin tipologjik të këtyre banesave, në veçantitë e tyre si dhe në vendin që zenë ato në banesën qytetare shqiptare të kohës.

3) Ky vendim mund të jetë i diskutueshëm, sepse deri sa u ruajt dhoma, mund të ruhej dhe ambienti sanitar që i shërbente atij. Por dëmi që binte ky volum i palidhur fare me banesën, na u duk më i madh sesa konsiderata e përmendur më lart, që na sugjeronte

DO NOT COPY

Banesa e miqve, është ndërtuar në vitin 1764[4]) duke qënë kështu një nga banesat e pakta që saktësisht datohen në shek. XVIII. Nga gjurmët që ruhen ende sot, si dhe nga disa fotografi në gjendjen e saj, para shkatërrimit (fig. 1) shohim se banesa kishte në plan formën e shkronjës U. Njëri krah të kujton fare qartë banesën tipike kruetane me gjysëmkat perpendikulare, në ballin e së cilës është ndërtuar qoshku karakteristik. Balli i pjesës qendrore duket qartë se është mbyllur vonë, ndofta gjatë shekullit tonë sic tregon karakteri i dritare në të dy katet. Ekzistenca e kolonave prej guri në ballin e katit përdhe si dhe e shkallëve origjinale dyfishe, ku ka qenë murosur mbishkrimi, na shtyjnë të mendojmë se kjo pjesë e banesës ka qënë e hapur, dmth në katin përdhe me harqe dhe mbi të me çardak. Duke mos pasur asnjë të dhënë për brendësinë e kësaj banese, nga jashtë të bie në sy dekorimi i ballit të dhomës me qoshk, me ornamente floreale (fig. 15).

Duke qenë banesa e miqve pjesë e kompleksit prej dy banesash, banesa me çardak të mbyllur, në lidhje të pandashme funksionale me të parën, s'ka se si të jetë ndërtuar më vonë se ajo, pra si kufi të sipërm për ndërtimin e saj duhet të pranojmë vitin 1764.

Banesa me çardak të mbyllur, në skemën e saj kompozicionale është e variantit me çardak në një krah. Vendi i çardakut, trajtimi dhe funksionet e pjesëve të veçanta të tij janë të njëllojta me banesat e po këtij varianti, ndërtuar në Berat, Shkodër dhe më pak në Elbasan, gjatë shek. XVIII deri aty rreth mesit të shekullit XIX. Dhe në banesën tonë pjesa e djathtë e çardakut ka funksione ndërlidhëse, ndërsa ajo e majta më e ngritur, është qoshku karakteristik. Por ajo që përbën veçantinë e këtij çardaku është fakti se ai nuk është i hapur por i mbyllur. Kjo mbyllje është realizuar me teknikën e njohur gjerësisht në banesat e Beratit e Gjirokastrës deri aty rreth çerekut të parë të shek. XIX me dy radhë dritaresh, të poshtmet me kafaz druri e kapakë, ndërsa të sipërmet me dritare fikse. Numri i madh i këtyre dritareve tregon qartë preokupimin për ta bërë sa më të ndriçuar çardakun. Shkaku i mbyllies së çardakut, i cili ka qenë i tillë që me ndërtimin e banesës, duhet shpjeguar vetëm me fanatizmin, duke qenë ky fenomen i theksuar në shtresat e feudalëve vendas. Më anë tjetër ky çardak për vetë pozitën shoqërore të përdoruesve të saj nuk bart funksionet e njohura të: përpunimit dhe tharjes së disa produkteve bujqësor, siç e vërteton dhe ndërtimi i tavanit në të. Pra, duke qënë vendi që zë çardaku në kompozim dhe trajtimi i tij krejt i njëllojtë me banesat e të njëjtit variant, e meqë mbyllja e tij nuk është bërë për arsye funksionale, kjo banesë duhet konsideruar e tipit me çardak e variantit me çardak në një krah. Në trashëgiminë e banesës sonë popullore mbyllja e çardakut me këtë formulim arkitektonik, e për më tepër ndërtimi i tij i tillë që me ngritjen e banesës rreth mesit të shekullit XVIII përbën një rast unikal, ndërmjet banesave që ruhen sot.



Fig. 14

Megjithëse në planin kompozicional banesa nuk ka asnjë tipar të veçantë, që ta dallojë nga banesat me çardak ndërtuar në qytete të tjerë, ajo shquan për disa karakteristika të veçanta në trajtimin e disa elementeve arkitektonike. Së pari të bie në sy përdorimi i gjerë i dritareve dyfishe në të gjitha ambientet e banuara apo që parashikohej të bëheshin të tilla. Një veçanti tjetër dalluese e kësaj banese është ndërtimi i oxhaqeve në dy ambiente të katit përdhe, gjë që presupozon se ato më vonë parashikohej të ktheheshin në ambiente të banuara, rast ky shumë i rrallë, mbasi përgjithësisht në banesat e këtij tipi kati përdhe është i pabanuar. Një element arkitektonik i veçantë e deri më sot unikal ndërmjet banesave që ruhen është «vetullorja», një strehë që përshkon pamjen krye-

4) H. Korbi, **Kruja**, «Leka», vj. V, nr. VI, Qershor 33, Shkodër.

PHOTOCOPY



Fig. 15



Fig. 16

sore mbi dritaret e rreshtit të poshtëm në katin e banuar. Funksioni i saj duket se është të mbrojë nga agjentët atmosferikë dritaret. Vetullore të tilla duket se janë njohur dhe në Berat (fig. 16), siç provon një gravur e shek. XIX, që paraqet një pamje të pjesshme të këtij qyteti. Ndërtimi i banjës është gjithashtu një rast relativisht i rrallë, që përbën një veçanti tjetër të kësaj banese, qoftë ajo dhe një ndërtim relativisht më i vonë. Së fundi për të treguar kujdesin e veçantë, me të cilën është punuar kjo banesë edhe nivelin e lartë, për kohën, të mjeshtrave po tërheqim vëmendjen në një sistem interesant kondrapeshash me të cilin janë lidhur qepenat prej druri me lëvizje vertikale të odës së miqve. Ky sistem e bën krejt të lehtë ngritjen sipër të qepenit me një zgjidhje, ku spikat një mjeshtri e hollë.

Datimi relativisht i hershëm i kësaj banese, rreth mesit të shek. XVIII e bën atë një pikë riferimi me rëndësi për tipologjinë dhe evolucionin e disa elementeve arkitektonike në banesën qytetare. Pikturimi i elementeve prej druri në tavane dhe musandër, kamare, dyer e dollapë të odës së miqve na përforcojnë mendimin se gdhëndjet në dru në banesat qytetare janë një fenomen më i vonë, që siç duket filluan të hyjnë gjërësisht nga çereku i fundit të shek. XVIII.

Një rëndësi të veçantë mer kjo banesë për faktin se është ndërtuar në Krujë, ku është e përhapur një banesë me tipare krejt të ndryshme nga kjo. Madje ajo nuk lidhet as me qendrat përreth Krujës. Ky fakt duhet shpjeguar, ashtu si dhe shumë të tjerë me përkatësinë klasore të përdoruesve të saj. Duke qënë se banesa tradicionale kryetane nuk përmbushte dot kërkesat e veçanta të kësaj familjeje feudale, ajo për shtëpi miqsh ndërtoi një banesë që duhet konsideruar si bashkim i banesës me gjysmëkat perpendikulare, me qoshkun karakteristik në odën e miqve dhe asaj me çardak në gjithë ballin, ndërsa për banesë të familjes variantin e njohur me çardak në një krah të ndërtuar në Berat dhe Elbasan gjatë kësaj kohe.

Ky kompleks banesash është një fakt shumë kuptimplotë për të treguar se të paktën përgjatë shek. XVIII dhe aqë më tepër më parë, edhe në shtresat më të larta të shoqërisë, në klasën e feudalëve të mëdhenj, më të predispozuar për të huazuar modele tipesh nga jashtë, nuk ndeshim në një fenomen të tillë. Kështu të dy banesat që përbëjnë kompleksin e banimit të kësaj familjeje janë tipet e njohur dhe përdorur gjerësisht në truallin tonë. Ndikimi i mënyrës turko-orientale të jetesës shfaqet në ndarjen e këtij kompleksi, në shtëpi miqsh dhe banesën e mirëfilltë, por tipi i këtyre banesave është i lidhur me tiparet vendase. Për vetë pozitën shoqërore të përdoruesve të saj, këtyre banesave i bëhet një trajtim dekorativ i veçantë dhe i pasur. Kështu përveç orna-

DO NOT COPY

mentikës së pasur të odës së miqve në banesën me çardak të mbyllur, si rast shumë të rrallë në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut kemi pikturimin nga jashtë të pjesës së sipërme të ballit të dhomës kryesore të shtëpisë së miqve (fig. 15). Krahas këtij përpunimi dekorativ dhe veçantive që përmendëm më sipër, në këtë banesë ruhen akoma shumë elemente që i hasim në banesat e këtij tipi të shtresave të mesme. Kështu mafili i ambientit nr. 7 (fig. 6), oxhaku i atij nr. 9 (fig. 7) tregojnë se në këtë banesë dhe në elementet arkitektonike nuk kemi një shkëputje të plotë nga shembujt e zakonshëm të të njëjtit tip, por vetëm një përpunim më të kujdeshëm të tyre veçanërisht në ambientet më përfaqësuese.

Konsideratat e mësipërme, e bëjnë kompleksin në fjalë dhe veçanërisht banesën me çardak të mbyllur, të zërë një vend të posaçëm në arkitekturën e banesës popullore shqiptare për vetë tipin, trajtimin e tij, kohën dhe vendin e ndërtimit e së fundi për përkatësinë klasore të përdoruesve të saj.

DO NOT COPY

TAB. I



DO NOT COPY



PRERJE GJATESORE A-A



PRERJE TERTHORE B-B

0 2 4 6M

DO NOT COPY

PAMJE KRYESORE



GJENDJA PARA RESTAURIMIT



GJENDJA MBAS RESTAURIMIT

0 2 4 6 M

DO NOT COPY

AMBIENTI Nr 7 - GJENDJA PARA DHE MBAS RESTAURIMIT



HAJATI - GJENDJA PARA DHE MBAS RESTAURIMIT



ÇARDAKU - GJENDJA PARA DHE MBAS RESTAURIMIT



DO NOT COPY

DO NOT COPY

AMBIENTI Nr. 6 – GJENDJA PARA DHE MBAS RESTAURIMIT



AMBIENTI Nr 9 – GJENDJA PARA DHE MBAS RESTAURIMIT



Emin RIZA

DO NOT COPY

ETUDE CONCERNANT LA RESTAURATION D'UNE MAISON A TCHARDAK DANS LA VILLE DE KRUJA

RESUME

A l'intérieur des murs d'enceinte de la citadelle de Kruje s'étend un quartier ayant les traits caractéristiques d'un centre urbain des XVIIIe-XIXe siècles. On y distingue particulièrement, quant à son traitement et à ses dimensions, une habitation à tchardak fermé qui se dresse dans la partie centrale de la citadelle. Celle-ci ne se rattache pas aux habitations construites à Kruje pendant les XVIIIe-XIXe siècles, qui, en général, appartiennent au type de maison fermé à un étage ou à demi-étage perpendiculaire. L'habitation en question fait part d'un complexe d'habitation, dont les vestiges conservés de nos jours encore indiquent qu'il comportait aussi une deuxième habitation au-dessus de la première et certaines autres constructions. Il n'est pas facile cependant de déterminer, à partir des ruines existantes, les fonctions de ces constructions. Ce complexe comportait l'habitation supérieure, soit la maison des amis («sellamlleku») (Fig. 1) et l'habitation inférieure à tchardak fermé, soit la maison où logeait la famille («haremlleku») (Fig. 2).

Etat de cette habitation avant l'exécution des travaux de restauration

Cette habitation a perdu avec le temps ses murs extérieurs, dont les restes indiquent qu'elle englobait un terrain plus vaste. Elle est à deux étages (Tab. I,II, III). Ces deux étages communiquent entre eux à travers un escalier extérieur en pierre, dont le volume ne fait pas part de la construction. L'étage au rez-de-chaussée comporte quatre pièces qui communiquent directement avec la galerie. En ce qui concerne les pièces N° 1 et N° 4, elles avaient été prévues vraisemblablement à être converties plus tard en chambres d'habitation, comme l'indique l'emplacement du foyer. Les deux autres pièces servaient de remise.

Les escaliers de pierre conduisent à un vestibule à travers une simple porte à un battant. Ce vestibule fait partie intégrante du tchardak, qui met en communication toutes les pièces de l'étage. Quant à la pièce N° 6 c'est la «chambre des amis», dont la composition ne fait que reproduire l'habituel schéma de cette pièce dans l'habitation urbaine albanaise des XVIIIe-XIXe siècles. Au fond de l'étage se trouve le volume caractéristique, divisé en deux pièces en hauteur (Fig. 4). Quant à sa partie supérieure, le «mafil», elle est fermée et illuminée par de petites ouvertures garnies de vitres. Les fenêtres, au nombre de huit, sont aménagées en face du «mafil», en deux rangées. En ce qui concerne les fenêtres de la rangée inférieure, elles sont garnies à l'extérieur de panneaux articulés verticalement et à l'intérieur par des «persiennes». Les fenêtres supérieures à deux vantaux sont fixées dans une charpente de platre renforcée de morceaux de verre. Entre les deux rangés de fenêtres, dans leur surface apparente, a été construit un deuxième auvent, chose vraiment rare dans l'architecture de l'habitation albanaise.

La pièce N° 7 est la plus caractéristique de cette habitation. Son «mafil» ouvert, et s'étendant sur une surface relativement grande, est garnie d'une balustrade caractéristique ayant l'aspect d'un balcon (Fig. 6). Le foyer de cette pièce a exercé les fonctions d'un bain, il est surmonté d'une coupole sphérique qui s'appuie sur quatre trompes (Tab. II). Quant à la pièce 4 N° 9, à ce qu'il apparait c'est la «maison du feu»; elle est illuminée par quatre fenêtres; les deux inférieures sont munies de grilles en bois et de panneaux, mais les deux autres sont immobiles. La pièce N° 5 est de dimensions relativement plus petites; dans sa partie supérieure, ses deux faces sont ornementées de peintures muraux. Cette pièce dispose d'une toilette débordant le contour planimétrique.

Modifications subies par cette habitation dans le temps

Au cours du temps, cette habitation a enregistré maintes modifications qui en ont affecté la composition planimétrique ainsi que différents éléments architectoniques et de construction. On relève dans ces modifications trois moments principaux: deux phases de reconstruction et le grave endommagement de la partie droite du tchardak et de la face S.–E. de la chambre des amis.

La première phase de reconstruction se rattache à la mise en place de la pièce N° 5 dans le «qoshk» du tchardak. Une telle hypothèse s'appuie sur les arguments suivants:

1. – En premier lieu il convient de considérer certaines caractéristiques de cette pièce, dont la présence s'explique par la surface limitée du «qoshk» improvisée. Ainsi cette chambre manque du complexe placard-mafil, élément indispensable à la nature même de cette pièce. Les annexes sanitaires sont des constructions plus tardives et l'on y accède d'une manière tout à fait inhabituelle, directement par la chambre.

2. – Les peintures muraux de cette pièce (Fig. 8) se caractérisent par une thématique complètement différente de celle de la chambre des amis et par un niveau artistique évidemment beaucoup moins élevé. Cela s'explique par le fait que ces peintures datent d'une époque plus récente. Par ailleurs, le travail, grossier des étagères ainsi que le traitement de la porte à deux battants se différencie de celui des autres pièces.

3. – La cloison de cette pièce limitant le tchardak (Fig. 9/c) est différente et plus récente que les charpentes des cloisons originales (Fig. 9/a,b). En plus la poutre, sur laquelle repose la cloison, a été renforcée ce qui empêche la circulation dans la galerie ouverte. Le traitement même de ces constructions montre clairement que nous sommes en présence d'une improvisation reflétant la nouvelle situation après la construction de cloison pour créer la pièce N° 5. En ce qui concerne le «qoshk», devenu plus tard la pièce N° 5, il est naturel de se poser la question s'il était fermé ou non dans sa partie frontale. A notre sens, ce «qoshk» était fermé dès le commencement, ce qui est confirmé par la division conservée à ce jour; par ailleurs, la fermeture même de l'autre partie du tchardak, ayant des fonctions de communication, exclue la possibilité d'un «qoshk» ouvert.

La deuxième phase de reconstruction se rattache au démolissement de l'intérieur de la pièce N° 10 et à la mise en place d'une nouvelle pièce contiguë. C'est ainsi qu'a été interrompue toute communication du tchardak avec cette pièce.

De pair à ces reconstructions, il convient de mentionner encore les graves dégats qu'ont subis, pendant la Lutte de libération nationale, la partie frontale et la partie S.–E. du tchardak. De certaines données obtenues à la suite des observations faites sur place, il y a lieu de supposer que le bain est une adjonction plus tardive. Malgré cela l'on ne peut rien affirmer avec certitude pour le moment.

Outre ces importantes transformations, chaque pièce de cette habitation a enregistré des modifications qui sont reproduites dans les Tab. IV, V.

La restauration

La restauration de ce monument, de grande valeur pour son genre, ne pouvait pas ne pas poser des problèmes d'ordre méthodique. Premièrement, il s'agissait de savoir s'il fallait conserver les adjonctions plus tardives qui en avaient modifié la structure compositionnelle. Par rapport à ce problème, il a été adopté une attitude différente selon les cas. Quand les adjonctions avaient gravement affecté la structure de l'habitation et que celles-ci ne représentaient pas en soi un objet de valeur, il fut décidé de procéder à leur élimination en vue de libérer le monument. Mais quand ces adjonctions étaient organiquement rattachées à l'habitation en question et conservaient en soi des valeurs dignes d'être conservées ou concernant directement son évolution architectonique, il fut décidé de ne pas les toucher. Deuxièmement, la reconstruction de certains éléments a été reconnue comme possible et utile dans les seuls cas lorsqu'on disposait de témoignages certains et minutieux sur l'état antérieur du monument.

C'est sur la base de ces principes qu'il a été décidé d'éliminer la pièce ajoutée à la pièce N° 10, du fait que celle-ci ne se rattachait pas à la structure de l'habitation et l'endommageait gravement. Par contre nous avons conservé la pièce N° 5, et cela non seulement parce que du point de vue fonctionnel elle n'affectait en aucune manière la formulation initiale de l'habitation, mais aussi du fait qu'elle constituait un témoignage de la tendance notoire à construire des pièces d'habitation sur la surface du tchardak. Malgré cela nous nous sommes prononcés en faveur de l'élimination de la partie supérieure de la toilette de la pièce N° 5, du fait que celle-ci portait gravement atteinte à l'aspect de l'habitation. Les éléments modifiés, entièrement ou partiellement, ont été reconstruits selon les traces existantes. On a également procédé à la reconstruction de la partie frontale du tchardak, et cela sur la base d'une photographie (Photo 14) prise antérieurement à sa destruction. En ce qui concerne la pièce N° 10, vu le manque de preuves documentaires, il a été décidé de le conserver telle quelle à l'état qu'elle se trouvait après sa reconstruction. Par les travaux de restauration effectués à ce jour il a été possible de réaliser presque entièrement le projet de restauration préétabli. Il reste encore à réaliser la reconstruction de la face S.E. de la pièce N° 6, la mise en place du lavabo du tchardak et d'autres travaux de moindre importance.

La maison des amis (Fig. 1), aujourd'hui détruite, et qui a été construite en 1764, est un des rares exemplaires d'habitation que l'on peut exactement attribuer au XIIIe siècle. Cette date doit servir de terminus ante quem pour la maison à tchardak de type fermé faisant partie de ce complexe. L'habitation en question, quant à son schéma compositionnel, est une variante du tchardak disposé sur une aile de l'habitation. La place même du tchardak, le traitement et les fonctions de ses différentes parties sont analogues à ceux des habitations de même type que l'on retrouve largement à Berat, Shkoder et dans une moindre mesure à Elbasan, depuis le XVIIIe siècle jusqu'à la moitié du XIXe. Ce qui constitue une particularité du tchardak de notre habitation est le

DOWNLOAD

fait qu'il soit fermé. Cette fermeture se réalise par la technique largement connue dans les habitations de Berat et de Gjirokaster jusqu'au premier quart du XIXe siècle. Quant à la raison de fermeture du tchardak, qui a caractérisé dès le début la construction de ce type d'habitation, elle s'explique par le fanatisme et la position même sociale de ses constructeurs, des grands propriétaires féodaux, qui ne pouvaient en aucune manière lui attribuer ses fonctions inhérentes.

Bien que sur le plan compositionnel cette maison n'ait aucun trait distinctif par rapport aux maisons de même type construites dans les autres villes du pays, elle se fait remarquer quand même par des caractéristiques relatives au traitement de certains éléments architectoniques. A citer notamment la présence de fenêtres à deux vantaux dans toutes les pièces habitables ou prévues à être réalisées de cette manière. Un élément architectonique particulier est la «vezullorja», une espèce d'auvent qui traverse, au-dessus des fenêtres de la rangée inférieure, l'aspect principal de la partie habitable de la maison. La construction du bain, que ce soit même celui de date relativement plus récente, constitue en soi une autre caractéristique de cette habitation. Sa datation relativement ancienne représente un important point de référence quant à la typologie et l'évolution de certains éléments architectoniques dans l'habitation urbaine albanaise. Le fait que différents éléments en bois du plafond, le placard, les niches, les portes et les armoires de la chambre des amis sont couverts de peintures, démontre on ne peut mieux que la gravure sur bois dans les maisons citadines est un phénomène postérieur à la peinture, et ses débuts se rattachent vers la fin du XVIIIe siècle.

Cette habitation revêt une importance particulière du fait qu'elle a été construite à Kruje, où l'on trouve en général un type de maison ayant des traits entièrement différents. Elle n'a pas non plus des liens avec les maisons des autres centres situés aux alentours de Kruje. Etant donné que l'habitation traditionnelle de Kruje n'était plus en mesure de satisfaire les exigences particulières de ses propriétaires, une famille féodale, celle-ci se vit obliger de se construire une maison destinée aux hôtes qui n'est autre qu'une réunion de la maison à demi-étage perpendiculaire, dotée du «qoshk» caractéristique dans la chambre des amis et d'un tchardak tout au long de sa partie frontale et de la maison traditionnele des villes de Berat et d'Elbasan, dotée d'un tchardak sur une aile de l'habitation, pour subvenir aux besoin de sa famille. Ce complexe d'habitation démontre on ne peut mieux que même parmi la classe des grands féodaux, généralement bien disposés à emprunter des types d'habitation de l'étranger, on ne rencontre pas un tel phénomène.

POOR COPY

DO NOT COPY

Burhan STRAZIMIRI

ARKITEKTURA DHE RESTAURIMI I BANESËS BIZBIQËVE [1]

DO NOT COPY

Një ndër banesat më me vlerë në qytetin e Beratit është ajo e Bizbiqëve. Në gjendjen para restaurimit, banesa paraqiste një sërë problemesh që kërkonin ndërhyrje, si nga pikëpamja konstruktive ashtu dhe nga ana arkitektonike. Për këtë arsye u krye studimi dhe në vitin 1974 u hartua projekti përkatës i restaurimit, që pati si synim kryesor mënjanimin tërësor të rrezikshmërisë së degradimit të mëtejshëm të banesës. Mbi bazën e tyre u ndërmorën dhe punimet restauruese.

Krahas studimit paraprak, vrojtimi i monumentit gjatë kryerjes së punimeve të restaurimit, na lejoi që të dallojmë ndryshimet që ai ka pësuar në kohë dhe të përcaktojmë fazën fillestare të tij. Paraqitja e këtyre rezultateve do të jetë dhe synimi i këtij artikulli.

Banesa e Bizbiqëve e ndërtuar në lagjen 1 Maj (fig. 1) që zë shpatin e një kodre, e njohur në të kaluarën me emrin Evel, është dykatëshe e tipit me çardak në njerin krah (Tab. 1). Duke iu përgjigjur pjerrësisë së terrenit, ajo është e shkallëzuar në volum, duke pasur në katin e sipërm sipërfaqe më të madhe.

Ndarja funksionale e kateve të kësaj banese nuk ndryshon nga ndarja funksionale e banesave të tjera të tipit me çardak, të përhapur si në Berat ashtu dhe në qendra të tjera të vendit. Në katin përdhe janë vendosur ambientet ndihmëse, ndërsa në katin e parë ato të banimit.

Kati përdhe përbëhet prej hajatit dhe dy katojve që ndriçohen me nga një dritare të vogël. Katojt, të pa shtruar dhe pa tavan, komunikojnë me hajatin me porta me hark, dykanatëshe. Hajatin nga para e kufizon një sistem prej pesë harqesh guri gjysmërrethorë (fig. 2). Ngjitur me këtë sistem jashtë konturit të hajatit, gjenden shkallët prej guri, të mbështetura mbi qemere



Fig. 1

gjysmë e çerekrrethorë. Shkallët, të vetme që ndërlidhin dy katet, përbëhen prej rampës kryesore dhe një bazamenti të ngritur mbi tri këmbë shkallë, në të cilat mbështetet rampa.

Banesa nuk ka sterrë të cilën e gjejmë shpesh në banesat beratase. Vendin e saj e zë një depozitë e vogël uji, në hapësirën e qemerit çerekrrethor të shkallës, e cila mbushet nga sipër me krahë (fig. 3).

Kati i sipërm përbëhet prej çardakut dhe pesë ambienteve, njëri prej të cilëve i rrënuar. Qendra e kompozimit të katit të sipërm është çardaku, me të cilin lidhen këto ambiente, në formën e një katërkëndëshi, me raport gjatësije ndaj gjerësisë 4 : 1, raport ky më i madh se në shumë banesa të tjera të të njëjtit tip, në të cilat kjo vlerë luhatet në kufijtë 2-3[2]). Ky raport për

1) Rilevimet dhe përpunimet janë: të F. Zarshatit e B. Penxhës, Fotografitë të R. Veselit e H. Çollakut. Punimet e restaurimit, nën udhëheqjen e autorit, u zbatuan nga A. Nallbani.
2) L. Lazimi, **Çardaku i banesës Beratase,** material i pabotuar në arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës.



Fig. 2



Fig. 3

mendimin tonë është diktuar kryesisht nga terreni i pjerrët, ku është vendosur. Të pesë ambientet nga të cilat tri janë në vargun fundor të çardakut e rrethojnë çardakun nga tri anë. Në qendër të vargut fundor ndodhet ambienti i shtëpisë së zjarrit, në formë katrori, i ndarë me dysheme druri në dy kate. Pjesa e poshtme komunikon drejtpërdrejtë me çardakun (fig. 4), ndërsa me të sipërmen komunikimi bëhet nëpërmjet një rugine prapa shtëpisë së zjarrit dhe një porte të harkuar, në të cilën kalohet me shkallë druri (fig. 5). Komunikimi i shtëpisë zjarrit me ambientet e krahëve të majtë e të djathtë, si dhe me pjesën e prapme, kryhen nëpërmjet portash që u gjetën të mbyllura. Të dy ndarjet ndriçohen respektivisht me nga dy dritare me kafaz druri. Shtëpia e zjarrit është e shtruar me pllaka guri dhe e suvatuar. Në katin e poshtëm ka oxhak, i cili gjendet në mesin e murit të krahut të djathtë, me dy shpatullat anësore prej guri të gdhendura në formë katërkëndëshi.

Ambienti i dytë i vargut fundor ka qenë ai i krahut të majtë, i cili sot ruhet në gjëndje rrënoj. Ambienti i tretë i vargut fundor, ai në të djathtë, ka formën e një katërkëndëshi (fig. 6). Në të hyhet nëpërmjet një korridori që të dërgon dhe në nyjen sanitare të ambientit. Në të dy krahët e korridorit, përpara hyrjes për në ambient, janë vendosur musandra, të cilat shfrytëzohen nga ana e korridorit. Ambienti ndriçohet nga katër dritare të vendosura në faqen përballë hyrjes, si dhe një tjetre të vendosur në murin e krahut të majtë, pranë faqes përballë. Në trajtimin e brendshëm të tij të bie në sy një oxhak me tambur të thjeshtë në formë gjysmë trungu koni, ndërsa në mesin e murit të krahut të majtë, minderë që përshkojnë të gjithë ballin prej çatmaje dhe murin e krahut të majtë dhe tre dollapë me kapakë të thjeshtë, të vendosur respektivisht dy në murin e krahut të djathtë dhe një në murin e krahut të majtë. Muri fundor, në mesin e të cilit ndodhet porta e komunikimit me koridorin, është trajtuar nga brenda me tri harqe pak të thelluar, nga të cilat dy anësore nuk arrijnë në nivelin e dyshemesë. Mbi portën e hyrjes brenda harkut të thelluar një dritare e vogël nga ana e ambientit është mbyllur me persione. Dyshemeja është prej dërrase, po kështu prej dërrase është dhe tavani me shirita mbi bashkimet. Në qendër të tavanit ndodhet një rozetë druri me formë elipsi, e realizuar me pjesë druri njëra mbi tjetrën në formë rrezesh. Porta e komunikimit të korridorit me çardakun sigurohet nga prapa me lloz druri, gjë që nuk e gjejmë në ambientet e tjera të kësaj banese.

Ambienti i katërt që ndodhet në krahun e djathtë, ka gjerësinë e çardakut dhe është një këmbë shkallë më i ngritur nga rafshi i dyshemesë së tij. Ky është një ambient i thjeshtë, i cili ndriçohet nga tri dritare të vendosura përballë hyrjes. Një oxhak pa tambur dhe një dollap me kapakë të papunuar ndodhen në vazhdimin e murit të çardakut. Në të djathtë gjenden një dollap me dy kapakë që të nxjerr në qoshk, dhe një portë që të fut në një kthinë në formë depoje (fig. 7).

DO NOT COPY



Fig. 4

Porta e hyrjes është e punuar me kujdes ka të njëjtin trajtim me portat e tjera të banesës.

Ambienti i fundit me mjaft rëndësi dhe që dallon nga të gjithë ambientet e tjera si nga funksioni e proporcionet, ashtu dhe nga trajtimi i brendshëm arkitektonik, është ai i dhomës së mirë. Ambienti të cilin vendasit e quajnë «bash oda» gjendet në krahun e majtë, në pjesën më të dalë të banesës. Ai ka formën e drejtëkëndëshit dhe ndahet në hapsirë në tri pjesë: në volumin e mbyllur musandër-mafil, në hapsirën qendrore dhe atë ballore, ku dy të fundit dallohen nga tavanet e veçanta (fig. 8) si dhe ndriçimi, i cili sigurohet me dritare vetëm në pjesën ballore.

Volumi i mbyllur (fig. 9) që zë pjesën fundore, ndahet në lartësi në dy pjesë. Në pjesën në qendër gjendet musandra, në të majtë të së cilës janë vendosur vertikalisht njëra mbi tjetrën tri kamare druri. Anash musandrës gjenden dy dyert që nëpërmjet parahyrjes të çojnë në çardak dhe në ambientin sanitar. Pjesa e sipërme, mafili, zgjerohet mbi të poshtmen duke u mbështetur mbi dy shtylla druri. Mafili është i mbyllur në ballin e tij dhe merr dritë nga dhoma nëpërmjet tri dritareve të harkuara, me persione. Mbas musandrës, shkallë të lehta druri ndërlidhin parahyrjen me mafilin.

Pjesa qendrore zë volumin kryesor të odës. Në krahun e djathtë të saj është ndërtuar oxhaku me tambur të dekoruar në reliev.

Tavani i kësaj pjese, si edhe i asaj ballore, qarkohet nga një bordurë e gjerë katërkëndëshe. E gjithë fusha brenda tavanit e përfshirë brenda bordurave mbulohet me një rrjet kuadratesh prej listelash të kryqëzuara. Në qendër të tyre ndodhen rozeta në formë gjashtëkëndëshe, zemra e të cilave paraqet një rreth të qarkuar nga gjashtë segmente rrethore. Fusha e rozetave mbulohet në mënyrë radiale me copëra në formë katërkëndëshi këndrejtë. Të dy tavanet të ngjyrosura me një ton të kuq nuk janë në të njëjtin nivel. Ndriçi-



Fig 5



Fig 6

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

mi i ambientit realizohet nga dritare të vendosura në dy rrjeshta, të poshtmet me qepenë e kafaz druri, të sipërmet prej allçie. Në këtë ambient gjejmë gjithashtu dollape muri. Të gjithë kapakët e dollapëve të murit, musandrës, si dhe portat e hyrjes për në ambient dhe nyjet sanitare, janë të dekoruara me pikturim me figura gjeometrike, brenda të cilave shihen motive floreale.

Banesa e Bizbiqëve ka qenë e përbërë nga një kompleks prej dy ndërtimesh me funksione të veçanta (Tab. I). Banesa që ne përshkruam i përket njërit prej këtyre ndërtimeve dhe ka kryer funksionin e shtëpisë për familjen, kurse atë të pritjes së miqve, e ka kryer ndërtimi tjetër, sot i transformuar që ndodhet përpara të parit. Sipas dëshmive gojore, këtë funksion ai e ka ruajtur deri në gjysmën e parë të shekullit tonë. Në një ambient të këtij ndërtimi ruhet një tavan i gdhendur me interes të veçantë (Tab. I).

Materialet kryesore të ndërtimit të kësaj banese janë guri dhe druri. Në katin përdhes muret janë prej guri me llaç balte. Nga jashtë nuk shihen breza druri. Në katin mbi të gjithë muret konstruktive janë prej guri me llaç balte e breza druri. Me mur prej skeleti druri të mbushur me gurë është balli kryesor i odës së mirë, muri kufizues me ambientin e jashtëm i ambientit të çardakut si dhe muri ndarës i odës së zjarrit me ambientin e rrënuar. Me mur çatmaje është ndërtuar vetëm faqja ballore e ambientit të krahut të djathtë të vargut fundor të ambienteve. Me dysheme dërrase janë ndërtuar çardaku, oda e mirë dhe ambienti i krahut të djathtë. Çatia është me konstruksion vendi dhe mbuluar me tjegulla. Shenja shkurtimi të strehës shihen nga përpara. Vetëm streha e faqes ballore të ambientit të krahut të djathtë është e trajtuar me kornizë të suvatuar, ndërsa nga prapa streha, e dalë nga faqet anësore rreth 60 cm mbahet nga pajante druri.

Në gjendjen para hartimit të projektit të restaurimit një pjesë e mirë e murit fundor të katoit ishte mbufatur, kishte ikur nga vertikaliteti dhe rrezikohej të shembej. Shtyllat e drurit të ballit të odës së mirë qenë kalbëzuar, në rrezik të shkëputeshin krejtësisht, po kështu dhe gurët që mbushnin skeletin qenë mjaft të shkëputur. Në këtë gjendje paraqiteshin muri ndarës i shtëpisë së zjarrit me ambientin e rrënuar, si dhe muri lindor i banesës. Po kështu qenë dekompozuar çatija, dyshemetë e odës së mirë, çardakut dhe qoshkut si dhe tavanet e odës së mirë të shtëpisë së zjarrit dhe qoshkut.

Së fundi mungonin ose qenë dekompozuar shumë elemente të veçanta prej druri. Duke qenë monumenti në gjendjen e më sipërme, për ta kthyer atë në gjendje të mirë konstruktive e arkitektonike, lindi domosdoshmëria e kryerjes së punimeve të restaurimit.

DO NOT COPY



Fig. 9

Duke vrojtuar banesën dhe duke e krahasuar për nga kompozimi planimetrik me banesat e tjera të qytetit, vërejmë se ajo ka pësuar disa ndryshime në kohë. Zgjidhja dhe përcaktimi i këtyre ndryshimeve do të ndihmonte mjaft që ato të reflektoheshin në projektin e restaurimit. Për t'ia arritur kësaj, ishte e nevojshme të përcaktonim: Në se kemi të bëjmë me një banesë, e cila në fazën fillestare ka qenë me çardak në gjithë ballin apo me çardak në njërin krah, çfarë konfiguracioni planimetrik ka pasur ambienti i krahut të djathtë i vargut fundor që në fillim të ndërtimit, a është e njëkohshme mbyllja e çardakut nga ana lindore dhe kthimi i tij në ambient banimi me vetë ndërtimin e banesës, apo i përket një faze të mëvonshme, si ka qenë në fazën fillestare shtëpia e zjarrit, dhe së fundi a i përgjigjet pamja e sotme e jashtme e banesës pamjes së saj fillestare. Për të sqaruar këto pika përpara fillimit të punimeve, si dhe gjatë praktikës së punimeve restauruese kryem një sërë sondazhesh. Në sondazhet e kryera në dy vendtakimet e mureve anësore me murin e çardakut, vumë re se kemi të njëjtën teknikë ndërtimi, lidhje të mirë dhe vazhdimësi të brezave të drurit. Këto të dhëna tregojnë që pjesa më e dalë e banesës i përket fazës fillestare të ndërtimit, rrjedhimisht se kemi të bëjmë me një banesë me çardak në një krah.

Arsyet që na shtyjnë të themi që ambienti i krahut të djathtë nuk i përgjigjet gjendjes së saj fillestare janë:

Shkallëzimi prej 10 cm., tërthor i ambientit, në rruginën përpara portës së hyrjes, qenia e një dollapi me dy kapakë në mur brenda musandrës së krahut të majtë, e cila praktikisht mbetet e pashfrytëzuar, në gjendjen e sotme, ekzistenca e një kamare në mur brenda musandrës së krahut të djathtë, që gjithashtu në gjendjen e sotme është e pashfrytëzueshme.

Këto të dhëna, trajtimi i përgjithshëm planimetrik i këtij ambienti, si dhe krahasimi i tij me ambiente të njëjta të banesave të të njëjtit tip, tregojnë se në pje-

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11

DO NOT COPY

sën prapa ndarjes së trajtuar me harqe ka qenë mafili, kufiri më i shtyrë i të cilit ka qenë shkallëzimi prej 10 cm. Pra dollapi i krahut të djathtë dhe kamarja në krahun e majtë kanë qenë brenda ambientit. Në ndihmë të këtij përfundimi na vjen edhe ky fakt. Zhveshja e suvatimeve rreth dollapit në krahun e majtë ndërmjet oxhakut të sotëm dhe ndarjes me harqe tregon se dollapi është një ndërtim i mëvonshëm, i arritur nga mbyllja e një oxhaku tjetër. Pra është e kuptueshme që oxhaku ekzistues i përket fazës së ndryshimeve të mëvonshme të këtij ambienti.

Ndryshimet në këtë ambient për mendimin tonë janë shoqëruar dhe me rikonstruksionin e ballit të dhomës, i cili në gjendjen e sotme është prej skelet druri të veshur me rripa dërrase, një ndërtim ky me një teknikë krejt të ndryshme nga balli i odës së mirë, dhe nga muri i hollë lindor i ambientit të çardakut që, siç i kemi përshkruar, janë prej skeleti druri të mbushur me gurë.

Në ambientin e mbyllur në çardak sondimet përreth oxhakut dhe dollapit që ndodhet në të majtë të hyrjes, në vazhdim të murit të çardakut, treguan se si oxhaku ashtu dhe dollapi i murit janë plotësime të mëvonshme (fig. 10,11). Brenda këtij heqja e suvatimeve në murin e hollë ndarës me çardakun (fig. 12), tregoj gjithashtu se ndarja është me skelet druri të thurur me purteka, të suvatuara me llaç balte. E njëjta teknikë është përdorur dhe në ndarjen e krahut të djathtë, por që ndryshon nga teknika e murit ndarës me ambientin e jashtëm. Nga vrojtimet e mëtejshme brenda këtij ambienti shihen qartë se dritaret e vendosura në murin ndarës me ambientin e jashtëm nuk janë origjinale, por kanë lartësi më të vogël se të parat. Dritaret parësore në bazë të gjurmëve ekzistuese shihet se kanë qenë identike me ato të dritareve të rreshtit të poshtëm të ballit të dhomës së mirë. Përveç këtyre teknika e punimit të shtyllave si dhe trajtimi i tyre është i njëjtë dhe në vazhdim me ato të çardakut.

Duke u mbështetur në argumentat e mësipërme arritëm në përfundimin se ambienti i mbyllur nga ana lindore e çardakut ka qenë i hapur. Ai ka shërbyer për sofa dhe ndarja është realizuar vetëm mbi pjesën e shkallëzuar të saj.

Në ambientin qendror, sot hyhet direkt nga çardaku, nëpërmjet një porte të hapur në vendin e një dritareje të dikurshme. Përveç saj ndryshime në trajtim kanë pësuar dhe dy dritaret e rreshtit të parë, të cilave u mungojnë dhe kafazet e drurit. Punimet e restaurimit në ambientin qendror, «shtëpinë e zjarrit» treguan se ky ambient ka pësuar një rritje në lartësi, që shihet qartë në shtesat e mureve, rritje që është bërë për të ndarë shtëpinë e zjarrit në dy kate. Teknika e ndërti-

mit të shtesave në lartësi ndryshon nga muret e fazës fillestare. Mbi murin ndarës të këtij ambienti me ambientin e krahut të majtë, që është një mur i hollë me skelet druri të mbushur me gurë, është ndërtuar një mur me skelet druri, thurur me gardh (fig. 13). Mbi murin e gurit të çardakut është ndërtuar një mur i hollë me skelet druri po i thurur me gardh (fig. 14). Duke qenë se muri i çardakut është 75 cm i trashë, ky skelet, për të mënjanuar dhëmbëzimin, është ndërtuar në dy rreshta, në një rafsh me faqet e jashtme të murit. Shtesat në muret e tjera janë prej guri me llaç balte. Pas zhveshjes së mureve të gurit nga suvatimet, u vu re që ato ishin shumë të nxira nga tymrat. Kjo na shtyn të mendojmë që ambienti qendror, shtëpia e zjarrit e kësaj banese, ka shumë mundësi të ketë qenë me vatër zjarri pa oxhak. Për të vërtetuar këtë ne hoqëm suvanë në shpinë të oxhakut (nga korridori i hyrjes për në ambientin e krahut të djathtë). Meqë nga kjo nuk doli asgjë konkrete, ne nuk përjashtojmë mundësinë që dy kolonat anësore prej guri të oxhakut të sotëm (fig 15) të jenë vendosur pas ndarjes së shtëpisë, sepse dhe vetë ambienti i krijuar poshtë nuk mund të rrinte pa oxhak. Ndryshimet në lartësi të shtëpisë së zjarrit kanë sjellë si pasojë dhe ndryshime të konfiguracionit e konstruksionit të çatisë.

Teknika e ndërtimit të shtesave prej gardhi të shtëpisë së zjarrit, e njëjtë me atë të mbylljes së sofasë nga çardaku, tregon se këto rikonstruksione janë të njëkohshme. Të kësaj faze duhet të jenë dhe përshtatjet e ambientit të krahut të djathtë, porta e hyrjes e së cilës duhet të jetë ajo që është vënë në hyrjen e qoshkut, mendim të cilin na e përforcon vetë trajtimi i saj.

Gjurmët dhe hapi i testekëve të çardakut pranë mureve të dhomës së mirë, shenjat e shkurtimit të strehës, si dhe krahasimi i trajtimit arkitektonik të pamjes së jashtme të saj me banesa të tjera, flasin për një strejë shumë të dalë, të mbajtur nga testekë. Kokat e bishtave të çatisë kanë qenë veshur me një dërrasë të punuar në formë bordure. Për këtë flasin disa gjurmë në anën veriore, si dhe disa copëra bordure, që u gjetën në shtresën e çatisë gjatë rikonstruksionit të saj.

Trajtimi i strehës me kornizë të suvatuar nga ana veriore, në gjithë pjesën që ka përfshirë ballin e ambientit të krahut të djathtë, mendojmë se ka të bëjë me rikonstruksionin e vetë dhomës së krahut të djathtë.

Konkluzionet e arritura nga vrojtimet, krahasimet dhe sondazhet e kryera në banesën e Bizbiqëve gjatë punimeve restauruese na japin mundësinë të dallojmë këto momente kryesore:

Së pari banesa i përket një faze të ndërtimit. Mbi bazën e përfundimeve të arritura kemi mundësi të paraqesim rikonstruksionin e katit të I në fazën fillestare (fig. 16). Qenia e kësaj banese ndër realizimet më të shënuara të variantit me çardak në një krah, si dhe pranimi i fundit të shek. XVIII[3]) si kufi i shtyrë i ndër-



Fig. 12

3) Vexhi Buharaja, **Mbishkrimet turke-arabe të vendit tonë si dëshmi historike,** Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike. Volumi II Tiranë 1969, fq. 83. Simbas të dhënave gojore të vetë autorit, si datim i ndërtimit të banesës (fillimi i qindvjetit XIX) është konsideruar data e vdekjes së ndërtuesit të saj «Faslli Bizbiqi». Lidhur me këtë autori tregon se vitin 1816 e ka lexuar në gurin e varrit të tij, që ndodhet pranë banesës. Duke u nisur nga kjo e dhënë ekziston mundësia që kjo banesë të jetë ndërtuar nga fundi i shek. XVIII.

DO NOT COPY



Fig. 13



Fig. 14

timit të saj, dëshmojnë qartë se ky tip ka qenë i kristalizuar që në këtë kohë.

Së dyti ndryshimet që kjo ka pësuar, si ndarja në lartësi e shtëpisë së zjarrit, kthimi i sofasë në ambient banimi, prishja e mafilit në ambientin e krahut të djathtë e zëvëndësimi i saj me mur të hollë të trajtuar me harqe, nuk kanë prekur tërësinë e monumentit. Ato i mbajmë si dëshmi të fillimit të transformimeve të këtyre tipeve. Sipas mendimit tonë dhe të dhënave gojore, këto transformime, që nuk i kemi të datuara, duhet t'i përkasin gjysmës së dytë të shekullit XIX.

Së treti përsa i përket kohës së ndërtimit të selamllëkut ne nuk mund të shprehemi me saktësi, por duke u nisur nga ndërlidhje në mes dy banesave me shkallë druri njërampëshe, që i kanë qenë veshur krahut lindor të bashodasë, dhe teknikave të ndryshme me të cilat janë punuar dy tavanet e mira, ai i bashodasë dhe ai i shtëpisë miqve, jemi të bindur që dy banesat nuk janë ndërtime të njëkohshme.

* *
*

Duke u mbështetur në gjendjen teknike e konstruktive të monumentit, në të dhënat që na ofroi ai, si dhe duke gjykuar mbi vlerat arkitektonike të tij, u



Fig. 15

DO NOT COPY

hartua projekti i restaurimit, i cili do të zbatohej në dy faza. (tab. II)

Në fazën e parë, e cila është realizuar, u udhëhoqëm nga parimi që të rikonstruktoheshin të gjitha pjesët e dëmtuara, si dhe të plotësonim simbas gjurmëve elementet që mungonin (tab. III). Në lidhje me ndryshimet që ka pësuar banesa në kohë në projekt u mbajt një qëndrim i dyfishtë. Kështu kur shtesat apo rikonstruksionet e elementeve të veçanta arkitektonike paraqesin interes si dëshmi të kohës dhe janë lidhur organikisht me banesën, ato u ruajtën, ndërsa kur qenë shtesa pa vlerë, ato u hoqën. Mbi këto parime u vendos që ambienti qendror të mbahet në gjendjen e sotme i ndarë në lartësi, gjithashtu u parashikua të ruhet i pandryshuar ambienti i krahut të djathtë me trajtimin e tij të mëvonshëm, kurse u parashikua që qoshku të hapet për tu kthyer në fazën fillestare.

Në këtë kuadër u bë rikonstruksioni i përgjithshëm i çatisë me tjegulla vendi, në të cilën një vend të rëndësishëm zuri rindërtimi i strehëve mjaft të dala të mbështetura mbi testek të gjatë. Po kështu u rindërtua ambienti i rrënuar si për të plotësuar kuadrin e gjithë banesës ashtu edhe për të mbrojtur muret ekzistuese, të ekspozuara ndaj rreshjeve.

Krahasi u krye riforcimi i tavaneve si dhe plotësimi i elementeve të degraduara, ndërsa tavani i bashodasë, në gjendje shumë të dëmtuar, u plotësua mbi bazën e atyre elementeve që ekzistojnë. Këtu u ruajtën rozetat origjinale dhe një pjesë e mirë e fushës me rrjetë kuadratike së bashku me bordurat. Në çardak në vend të portës së hyrjes për në shtëpinë e zjarrit u ndërtua një dritare dhe tri dritaret e rreshtit të poshtëm të shtëpisë së zjarrit u pajisën me kafaze druri. Të



Fig. 16

tria dritaret e ambientit të sofasë, që simbas gjurmëve të tyre u gjetën të njëjta me dritaret e rreshtit të poshtëm të ballit të odës së mirë, u ribënë të reja dhe u pajisën me kafaz e kanata druri. Të tilla u ndërtuan dhe dritaret e rreshtit të poshtëm të ballit të bashodasë. Tri dritaret e rreshtit të sipërm, nga të cilat ruheshin vetëm hapësirat, u ribënë në analogji me dritaret e tjera të të njëjtit lloj. Punime u kryen dhe në shtresën e shtëpisë së zjarrit, në tavanin e saj si dhe suvatime etj.

Në të ardhmen, me kryerjen e punimeve të plota të restaurimit, monumenti do të fitojë në shumë aspekte vlera, të cilat më parë i kishte humbur.

PHOTOCOPY

TAB. I



PAMJE KRYESORE





KATI I I

0 2 4 m





G E N – P L A N I

1– SHTEPIA E MIQVE
2– SHTEPIA E FAMILJES

0 2 4 6



DO NOT COPY

GJENDJA PAS RESTAURIMIT



PAMJE KRYESORE



PAMJE NGA LINDJA



PLANIMETRI E KATIT I^H



PAMJE NGA PERENDIMI



KATI PERDHE



PAMJE NGA PRAPA

DO NOT COPY

TAB. III

GJENDJA PAS RESTAURIMIT













DO NOT COPY

Burhan STRAZIMIRI

DO NOT COPY

ARCHITECTURE ET RESTAURATION DE L'HABITATION DES BIZBIQ

RESUME

Parmi les monuments les plus importants du genre d'habitation se trouvant dans la ville-musée de Berat, figure aussi la maison des Bizhiq. Par suite de son état technique peu satisfaisant, il a été nécessaire de procéder à sa restauration. Les études préliminaires à la restauration, ainsi que les observations effectuées pendant l'exécution des travaux, ont permis de relever les modifications que ce monument a subies dans le temps et de déterminer, en conséquence, sa phase initiale. Cette habitation se situe dans le quartier «1 Maj», qui s'étend sur le flanc d'une colline. Elle comporte deux étages et fait part du type d'habitation à tchardak sur un de ses côtés. En raison du terrain escarpé, cette maison se caractérise par un volume échelonné. La répartition fonctionnelle des étages ne se différencie pas de celle des autres habitations du même type, du fait que les pièces auxiliaires se trouvent au rez-de-chaussée et les chambres d'habitation au premier étage. L'étage au rez-de-chaussée comporte deux pièces destinés au bétail et une veranda. Un système à cinq arcs limite par devant la veranda. A proximité de ce système se dresse les escaliers en pierre, s'appuyant sur des voûtes à plein cintre ou à quart de cercle. L'étage supérieur comportait le tchardak et cinq pièces dont une en ruines. Le centre compositionnel de l'étage destiné à l'habitation est constitué par le tchardak, qui met en communication toutes les autres pièces; il s'étend beaucoup en longueur en raison du terrain escarpé. Dans la partie terminale des pièces d'habitation se situe la «maison du feu», que le plancher répartit en deux pièces en hauteur. La meilleure pièce est la «chambre des amis», située sur le bras débordant l'habitation. De forme à angle droit, elle comporte trois parties: le volume fermé (armoire à mur-matil), l'espace central et celui frontal, ces deux derniers se distinguant par des plafonds particuliers. La partie centrale occupe le plus grand volume de cette pièce. Sur son côté gauche a été construit le foyer ayant des décorations en stuc. L'illumination de cette pièce est réalisée par des fenêtres aménagées en rangées, dont celles inférieures sont à volets ou grillagées en bois, tandis que celles supérieures sont immobiles en raison des cadres de plâtre.

Cette habitation comprenait autrefois un complexe d'habitations, soit la maison de la famille et la maison des amis. La description faite jusqu'à présent concerne la maison de la famille, tandis que la maison des amis a été modifiée mais on en conserve encore un plafond de valeur.

Cette maison a subi des modifications dans le temps. L'observation de ce monument avant les travaux de restauration et les sondages effectués plus tard ont permis de déterminer la nature de ces modifications. Les principaux problèmes qui se posaient en cette direction sont les suivants: sommes-nous en présence d'une maison qui avait un tchardak sur toute sa partie frontale ou bien sur un de ses bras seulement. Comment se présentait la configuration de la pièce actuellement en ruines? A quelle phase correspond la fermeture du tchardak sur le côté oriental de l'habitation et sa modification en pièce d'habitation? Comment se présentait dans sa phase initiale la «maison du feu»? L'éclaircissement de ces problèmes a été aussi facilité par les travaux même de restauration.

Grâce aux sondages effectués aux deux points de rencontre des murs latéraux avec le mur du tchardak, nous avons constaté la même technique de construction, soit des murs et des bandes de bois ininterrompus. Ce qui signifie que le tchardak de cette habitation était aménagé dès le commencement sur un de ses côtés seulement. Nombre de témoignages indiquent que la pièce située sur le côté droit a subi plus tard des transformations, qui en ont affecté l'intérieur. De même nombre d'arguments prouvent que le «qoshk» du tchardak était ouvert au commencement et que ce n'est que plus tard qu'il a été fermé, en improvisant de la sorte une pièce d'habitation. En ce qui concerne la «maison du foyer», surtout sur la base des traces mises à jour pen-

dant les travaux de restauration, il a été démontré que cette pièce a été agrandie plus tard en hauteur en vue de permettre la construction des deux étages. En relation aux auvents originaux de la façade principale, y compris celui du tchardak, sur la base des traces existantes il ressort qu'ils étaient très en saillie et soutenus par des tirants de bois longs. Des données indirectes laissent à supposer que la construction de cette habitation se rattache à la fin du XVIIIe siècle ou au début du XIXe. Les modifications apportées à la chambre aménagée sur le côté droit, ainsi que la modification du «qoshk» en pièce d'habitation marquent le commencement des transformations que subit ce type de maison vers la deuxième moitié du XIXe siècle, comme l'attestent les sources orales et les résultats de nos observations. Quant à la datation de la «maison des amis», faute de données, la confrontation de ses éléments architectoniques avec ceux de la maison de la famille, surtout celle des plafonds, montre que nous sommes en présence d'une construction plus récente.

C'est sur la base des données obtenues à la suite des observations et des sondages effectués sur place qu'a été élaboré le projet de restauration, prévoyant deux phases successives d'exécution. En relation aux modifications subies par cette habitation dans le temps, une attitude différenciée fut adoptée à leur égard. Ainsi, il fut décidé de ne pas toucher la pièce centrale séparée en hauteur plus tard en deux pièces, ainsi que l'état dans lequel se trouvait la pièce aménagée sur le côté droit de l'habitation par suite de sa modification. Quant à la pièce improvisée en «qoshk», elle devait être démolie, afin de lui faire regagner son état initial. Le projet de restauration prévoyait également la reconstruction des auvents renforcés de tirants. De même la pièce en ruines fut reconstruite en vue de compléter l'aspect original de l'habitation et de créer des conditions satisfaisantes du point de vue technique aptes à prévenir l'endommagement des pièces contingues. Les travaux de restauration de la première phase ont affecté une série d'éléments architectoniques et de construction, tels la toiture, les planchers, les portes, les fenêtres, etc. A l'avenir, par suite de l'exécution intégrale de tous les travaux prévus par le projet de restauration, ce monument finira par regagner sous plusieurs aspects les valeurs qui lui manquaient.

DO NOT COPY

Emin RIZA

DO NOT COPY

BANESA POPULLORE. NË KURVELESHIN E SIPËRM[1])

Zona e Kurveleshit të Sipërm bën pjesë në krahinën e Labërisë[2]). Ajo përfshin fshatrat Picar, Picar-Koronë, Kolonjë, Golem, Progonat, Lekdush, Gusmar, Rexhin, Nivicë, Salari dhe Vermik (fig. 1).

Kurveleshi i Sipërm zë pjesën më të ashpër malore të Labërisë. Formacionet gëlqerore janë të zhveshura dhe përshkohen nga gryka të thella, rrafshinat, me përjashtim të asaj të Nivicës, janë të pakta dhe jopjellore. Këto kushte natyrore kanë bërë që tradicionalisht blegtoria të jetë baza kryesore e banorëve të kësaj zone[3]).

Hani[4]) rreth mesit të shek. 19-të shkruan për Kurveleshin se pjesa më e madhe e popullsisë janë barinj, kurse «bujqësia është lënë pas dore, sepse tokat janë të pakta dhe të dobëta, prandaj Kurveleshi kur bëhet bereqeti mirë e siguron bukën për 8 muaj, kur nuk bëhet vetëm për 4 muaj».

Në Kurvelesh blegtoria ushtrohej në formë shtegtare. Diferencimi klasor që i theksuar, blegtorët e pasur me tufa të mëdha i blenin kullotat larg fshatit për gjithë vitin, ata të mesmët përgjithësisht shtegtonin në vendet e ulëta gjatë dimrit, ndërsa blegtorët e varfër i mbanin bagët të gjatë gjithë vitit në kullotat e fshatit. Një vend të rëndësishëm në ekonominë e Kurveleshit zinte Stani, një kompleks ngrehinash gjysmëprovizore, që shërben për strehimin e tufave dhe përpunimin e qumështit[5]).

Vendi kryesor i blegtorisë në ekonominë e kësaj zone, duket se është tepër i lashtë. Karakteri shtegtar i ekonomisë blegtorale kërkonte që thuajse të gjithë meshkujt të qëndronin pranë tufave, madje përgjithësisht gjatë periudhave të ngrohta e gjithë familja shpërngulej në stanet verore. Këta faktorë kanë ndikuar jo vetëm në karakterin e vendbanimeve, por dhe në atë të banesës dhe ndërtimeve ndihmëse të saj. Kjo mënyrë jetese ndryshoi edhe në këtë zonë të thellë malore vetëm mbas çlirimit të vendit.

Qëllimi i këtij artikulli është të japë një panoramë të banesës karakteristike të kësaj zone në variantet e ndryshme të saj, duke u bazuar në materialin e mbledhur gjatë ekspeditave të kryera në të gjithë fshatrat e Kurveleshit të Sipërm me përjashtim të Vermikut. Kjo krahinë ka pësuar në shekullin tonë shkatërrime dhe djegie masive, si gjatë luftës së parë botërore ashtu dhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare prandaj dhe numri i banesave të hershme është relativisht i vogël. Ato i përkasin kryesisht fundit të shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit tonë. Vlerë të veçantë për historinë e zhvillimit të banesës në këtë zonë kanë rrënojat e banesave të fshatit Picar që duhet t'i përkasë shekullit të 19-të, ndërsa disa prej tyre dhe gjysmës së dytë të shekullit të 18-të. Gjithashtu me mjaft interes janë disa trakte shumë të pakta banesash pranë fshatit Lekdush, në jug të tij.

Banesat e trajtuara kapin si kufi kohor shekullin e 18-të dhe të 19-të si dhe gjysmën e parë të shekullit tonë deri në vendosjen e marëdhënieve socialiste, me çlirimin e vendit.

Fshatrat janë ndërtuar në terrene të pjerrëta si Picari, Kolonja, Salaria, apo në rrafshe si Progonati, Gusmari, Rexhina dhe Nivica. Në të parët banesat ndjekin pjerrësinë e terrenit, i cili ka kushtëzuar dhe orientimin e tyre, ndërsa në të dytët nuk gjejmë orientim të përcaktuar qartë, mbasi ai varet nga raporti i banesës me rrugën, dhe nga forma e truallit. Karakteristikë kryeso-

---

1) Rilevimet janë të autorit, B. Penxhës, F. Zarshatit, vizatimet janë të B. Penxhës, fotot të autorit.
2) Rr. Zojzi, **Ndamja krahinore e popullit shqiptar,** «Etnografia shqiptare» I, Tiranë.
3) F. Haxhiu, **Ekonomia blegtorale në Kurvelesh gjatë shek. XIX dhe fillimit të shek. XX,** «Etnografia shqiptare» V, Tiranë 1974, 187.
4) **J. G. Hahn, Albanesische Studien,** Jena, 1854, I, 42.
5) F. Haxhiu, **Art. cit.** 187, 188.



Fig. 1

re e këtyre vendbanimeve fshatare është se ato janë të grupuara. Banesat ndërtohen pranë njëra-tjetrës, duke formuar njësi kompakte përgjithësisht me bazë fisi. Terreni i vështirë shkëmbor nuk ka lejuar ndërtimin e kopshteve pranë banesave, dhe gjelbërimi i pakët takohet vetëm në fshatrat e ndërtuara në rrafsh. Fshati më i përhapur i kësaj zone është Nivica; ajo ngrihet në një rrafshinë me tokë të punueshme. Ndërsa kompaktësinë më të madhe të ndërtimeve e gjejmë në fshatrat e Picarit dhe Salarisë. Rrugët në të gjitha fshatrat nuk ndjekin ndonjë kriter të përcaktuar. Ato janë të pashtruara dhe me gjerësi të ndryshme simbas rastit. Banesat shpesh dalin me faqet anësore apo të mbrapme në rrugë, dhe përgjithësisht kanë oborre të vogla rrethuar me mure. Karakteri i grupuar i fshatrave të Kurveleshit të Sipërm është tipari dallues kryesor i tyre, që siç duket është kushtëzuar dhe nga mbisundimi i blegtorisë në ekonominë e kësaj zone.

Materialin e mbledhur do ta parashtrojmë duke paraqitur së pari ndërtimet në fshatin e Picarit, të cilat kanë një interes të veçantë, për shkak se i përkasin një periudhe relativisht të hershme. Më poshtë do të parashtrojmë shembujt më tipikë të banesave të ndërtuara në fshatrat e tjera, duke pasur si kriter, në paraqitjen e tyre, rrugën evolutive nga e thjeshta në të zhvilluarën në planin kompozicional. Teknika e ndërtimit dhe karakterizimi arkitektoniko-konstruktiv do të shtrihet mbi të dy këto grupime, mbasi ato janë të së njëjtës natyrë.

Fshati i Picarit ka lëvizur gjatë kohës dy herë. Simbas të dhënash gojore së pari ai shtrihej në një pjerrësi shkëmbore në jug të fshatit Lekdush, fare pranë tij. Më vonë ai shpërngulet në verilindje të malit të Lisanit në një terren shumë të ashpër, duke zënë majën e një lartësie të zhveshur shkëmbore. Dëmet e mëdha që pësoi Picari gjatë vitit 1913, bënë që prej atëherë një pjesë e familjeve të zbresin poshtë në jug, duke krijuar fshatin e ri që mban emrin: «Picar — Koronë». Në vitet e pasçlirimit shpërngulja për në qendrën e re u bë më intensive dhe sot në Picar kanë mbetur shumë pak familje.

Në Picarin e vjetër, pranë Lekdushit, që nuk dihet se në ç'kohë dhe për ç'arsye është braktisur, thuajse nuk ka mbetur asgjë nga vendbanimi. Të vetmet gjurmë të banesave janë disa trakte të pakta muresh, me lartësi të vogël (fig. 2). Prej tyre është vështirë të krijosh ndonjë ide mbi formën e banesës. E vetmja e dhënë e saktë ka të bëjë me teknikën e mureve, të cilat janë ndërtuar pa lidhës, në të thatë. Trashësia e tyre është rreth 70 cm. Duke gjykuar nga vendosja e këtyre trakteve në një terren mjaft të pjerrët shkëmbor dhe nga mospërpunimi i tij shtyhemi të mendojmë se banesat kanë qenë kompozuar me gjysëm kat.

Fshati i Picarit ngrihet mbi një kupol shkëmbore, e cila përfundon me një pllajë me shpatin lindor të thikët. Në gjendjen e sotme kanë mbetur rrënojat e shumë banesave, nga të cilat disa ruajnë dhe trakte të katit të parë, gjithashtu takohen rrallë dhe mbeturina të mureve rrethuese. Banesat janë të vendosura pranë njera tjetrës, orientimi i tyre është i kushtëzuar nga terreni, por balli nga është hyrja kryesore nuk vendoset kurrë nga veriu. Nga sa kemi vërejtur në këtë fshat ka



Fig. 2

DO NOT COPY

mbizotëruar banesa me kat, por për shkak të terrenit ajo disa herë është kompozuar dhe me gjysmë kat. Karakteristike e banesave të kësaj qendre fshatare është përdorimi i gjerë i sterës si depozitë për sigurimin e ujit të pishëm për shkak se burimet mungojnë. Këtë element nuk e kemi hasur në fshatrat e tjera të kësaj zone. Ekzemplarët e banesave rrënojë në Picar ruhen në një masë të tillë, sa na japin mundësinë të krijojmë një ide deri diku të plotë të banesës në planin arkitektoniko-konstruktiv.

Nga rrënojat e banesave të Picarit po japim disa ekzemplarë që paraqesin interes, pse ruhen në gjendje relativisht të mirë dhe përmbledhin karakteristikat kryesore të mbarë ekzemplarëve që ruhen. Banesa Nr. 1 (Tab. I, fig. 3) është një shembull tipik i kompozimit me gjysmë kat. Kati përdhe, me sipërfaqe më të vogël se ajo e atij të banuar ka hyrjen e vetme nën sheshpushimin e vogël të shkallëve të jashtme prej guri që të çojnë në katin e banuar. Katoi ndriçohet nga hapësira të vogla në formë frengjie. Kati i banuar duket se ka pasur dy ambiente: «Magjerrinë»[6]), siç e emërtojnë vendasit shtëpinë e zjarrit dhe një ambient banimi. Për këtë tregojnë tymaret e dy oxhaqeve, ndërtuar përballë njëri-tjetrit në meset e dy faqeve të shkurtra. Pozicioni i derës përjashton mundësinë e një parahyrjeje për në të dy ambientet, kështu që kalimi në ambientin përbri magjerrisë duhet të jetë bërë nga ky i fundit, duke qenë ndarë të dy ambientet nga një perde e lehtë. Magjerria është thuajse krejtësisht përdhese, mbasi ajo ngrihet mbi një platformë që e krijon një mur mbajtës tërthor. Oxhaku zë ballin fundor të magjerrisë dhe ka anash dy kamaret e zakonshme. Përveç dy dollapëve në muraturë, ky ambient nuk ka ndonjë element tjetër për t'u vënë re. Mungesa e dritareve të shtyn të mendosh se ai ndriçohej me baxha. Ambienti tjetër ruan gjurmët e dy dritareve të mëdha në ballin e ngushtë, anash oxhakut. Lartësia e katit të banuar është 2 m. Banesa mbulohej me çati katërujshe, siç tregon fragmenti i strehës së gurtë në ballin e oxhakut të magjerrisë.

Interes të veçantë paraqesin dy banesa përngjitur njera tjetrës në njërin kënd të tyre (për lehtësi do t'i quajmë me emërtimin banesa Nr. 2) (Tab. I). Banesa e vendosur në aksin gjatësor në drejtim veri-jug ka të ndërtuar në katin përdhe dy ambiente: sterën e ujit, mbuluar me qemer cilindrik dhe katoin, me sipërfaqe më të vogël në zgjatim të sterës. Marrja e ujit të sterës ka qenë jashtë, ndërsa dritarja e pastrimit të saj del në katua, me një hyrje të vetme nga jashtë. Sipas dëshmish gojore, kati i banuar kishte dy hyrje të veçanta për në të dy ambientet e katit, njeri prej të cilëve ishte



Fig. 3

magjerria. Banesa e vendosur me aksin gjatësor normal me të parën ruan vetëm gjurmë të katoit.

Një zgjidhje disi të veçantë paraqet banesa nr. 3 (Tab. I, fig. 4). Karakteristike e saj është vendi i sterës, i cili është ndërtuar anash trupit të banesës. Krahu kryesor i banesës është kompozuar me gjysmë kat. Në një plan me katoin është ndërtuar stera, e cila ka një dritare të vogël pastrimi. Shkallët e jashtme të gurta, që të çojnë në katin e banuar, janë dyrampshe. Rampa e parë mbështetet mbi mur masiv, kurse e dyta ngrihet pjesërisht mbi mur masiv e pjesërisht mbi një qemer me seksion këndor. Mbi sterë duket se ka pasur ambient banimi, por nga rrënimi nuk mund të përcaktohet ra-



Fig. 4

6) «Magjerria» është ambienti kryesor i banesës. Në variantet e thjeshtë, me një kthinë banimi, aty zhvillohet jeta familjare në të gjitha aspektet e saj. Në variantet me dy dhe më shumë kthina, ky ambient humbet disa funksione. Etimologjikisht duket se ky term vjen nga **magje-ja,** orendi gatimi.

PO NOT COPY

porti i tij funksional me krahun kryesor të banesës. Vendosja e sterës në pozicion anësor, përballë trupit të banesës, nuk është një rast i veçantë, atë e kemi hasur edhe në banesa të tjera.

Në Picar ruhen dhe rrënojat e banesës së Çelo Picarit, e cila për nga përmasat dhe kompozimi i thjeshtë nuk dallon nga të tjerat. Në katin përdhe ruhen mirë gjurmët e sterës së saj.

Në Picar ruhet në gjendje të mirë një banesë që paraqet variantin më të zhvilluar në fshat, banesa Nr. 4 (Tab. I, fig. 5). Por në disa elemente të saj funksionale dhe arkitektonike duket ndikimi i arkitekturës së banesës gjirokastrite. Banesa rrethohet me mure guri, të cilat kufizojnë një oborr të vogël. Porta e jashtme është punuar me gurë të latuar. Në të një mbishkrim shënon datën 1825. Në oborr është ndërtuar një ambient, në të cilin është ndërtuar dhe furra, pra ai ka shërbyer si vendgatim veror. Banesa është kompozuar me gjysmë kat. Ajo ka formë katërkëndësh këndrejtë, duke pasur të vendosur anash saj, nga perëndimi, sterën e ujit, e cila del jashtë konturit. Hyrja për në katin përdhe të çon në një hajat të mbyllur, në të cilin kanë qenë ndërtuar shkallët që të çonin në katin e banuar. Në të djathtë të tij, një mur mbajtës ka krijuar platformën përdhese të magjerrisë, ndërsa në të majtë është katoi. Përballë është vendi i marrjes së ujit nga stera. Kati i banuar ka të njëjtën kompozim: në qendër një ambient ndërlidhës dhe anash tij magjerria përdhese, e përballë saj oda e miqve. Magjerria ka oxhakun në ballin nga veriu dhe komunikon, përveç me ambientin qendror ndërlidhës, edhe drejtpërdrejtë me ambientin e jashtëm, nëpërmjet dy hyrjesh në faqet perëndimore dhe lindore. Si ndikimi qytetar duhet mbajtur vendi i gatimit në oborr, ndërsa nga ana arkitektonike si të tilla duhen mbajtur dritaret dhe dyert mbuluar me hark gjysmë rrethor, si dhe porta e jashtme. Megjithëkëtë banesa ruan qartë konceptin kompozicional tradicional, duke qenë një shkallë e zhvilluar e banesës së kësaj zone.

Në gjendjen e sotme nuk gjejmë ndërtime ndihmëse pranë banesave, të vetmet që ruhen janë disa lëmenj. Më interesanti është ai i Çelo Picarit, pranë rrënojave të banesës së tij. Ai ka formë rrethore dhe është i shtruar me pllloça guri (fig. 6) të vendosura në ndërprerjen e një sërë rrathësh koncentrikë me një tufë rrezesh të baraslarguara.

Po kalojmë tani në dhënien e banesave më tipike të Kurveleshit të Sipërm, duke filluar nga variantet më të thjeshta. Nga sa kemi vrojtuar, në përgjithësi banesa rrethohet me mure. Oborri, për vetë natyrën shkëmbore të terrenit, është i vogël. Banesa, në shumicën e rasteve, del me një apo dy faqe në rrugë. Ndërtimet ndihmëse në të kaluarën kanë qenë shumë të pakta për vetë natyrën e ekonomisë së kësaj zone ku mbizotëronte blegtoria shtegtare.

Banesën e kësaj zone mund ta klasifikojmë në tri grupe me koncept shumë të afërt funksional dhe lidhje të qartë evolutive. Në grupin e parë do të përfshijmë banesat përdhese, në të dytin ato të kompozuara me gjysmë kat, ndërsa në grupin e fundit banesën me kat. Të tria këto grupe e sidomos i pari dhe i treti përfshijnë një numur variantesh që ndryshojnë ndërmjet tyre për nga numri i ambienteve. Banesat e të tria grupeve i gjejmë thuajse barazisht të shpërndara në të gjithë fshatrat, por siç do të shohim më poshtë banorët kanë parapëlqyer më shumë banesat e grupit të tretë.

Banesa përdhese është një nga shfaqjet më të hershme në këtë zonë. Ajo gjatë shek. XIX dhe më parë, siç tregojnë dhe ndërtimet e Picarit, duket se ka pasur një përhapje jo të madhe. Sot takohen rrallë shembuj të tillë, të cilat janë një dhe dykthinësh. Ekzem-



Fig. 5



Fig. 6

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

plari më tipik i banesës përdhese me një kthinë është banesa Nr. 5 (Tab; II, fig. 7), ndërtuar në fshatin Golem. Ambienti i vetëm i banesës e ka hyrjen të mbrojtur me një portik, mbulesa e të cilit mbështetet mbi dy kolona guri ngritur mbi dy zokolatura që të kujtojnë sofat e portave të jashtme në banesat qytetare. Brendësia e ambientit të vetëm të banesës është e thjeshtë. Në ballin e ngushtë nga e djathta e hyrjes (e majta e vrojtuesit) është ndërtuar oxhaku, pranë tij dy kamaret dhe pastaj dritaret që së jashtmi mbrohen me hekura, kurse nga brenda mbyllen me kapakë druri. Ambienti është pa tavan dhe shtruar me baltë. Megjithëse nuk ka asnjë ndarje, pjesa fundore e ambientit shërbente si depo, në të cilën gjejmë të vendosur dhe një lloj hambari të vogël. Në Nivicë ruhet një banesë e tillë, në të cilën prane hyrjes është vendosur një musandër, e cila krijon dhe parahyrjen për në ambient.

Banesa më e zhvilluar përdhese është ajo dykthinëshe, të cilën e gjejmë me një hyrje të vetme, apo me dy të tilla, një për secilin ambient. Shembulli i banesës me dy hyrje është ajo Nr. 6 (Tab. II, fig. 8) në fshatin Progonat. Të dy ambientet e saj ndahen me një perde të lehtë me thupra, që shkon deri në flegrat e çatisë. Ambienti i magjerrisë me ndriçim të pakët, ka në fundin e tij një musandër që shkon deri në lartësinë e trarëve të tavanit. Të dy ambientet kanë oxhaqe. Portiku karakteristik mbron dy hyrjet, ndërtuar pranë njëra-tjetrës.

Një banesë tjetër dykthinëshe, që paraqet një shkallë më të zhvilluar se shembulli i mësipërm, është banesa Nr. 7 (Tab. II), ndërtuar në fshatin Golem. Ndryshimi i kësaj banese me atë Nr. 6 qëndron në zgjidhjen më të përparuar të pjesës qëndrore të planimetrisë. Duke qënë se hyrja drejtpërdrejtë nga jashtë nuk është e përshtatshme, sidomos në stinët e ftohta, përbri portikut është ndërtuar një parahyrje e vogël, ku të çon hyrja e vetme e banesës. Me të njëjtën gjerësi me parahyrjen përbri saj, është kufizuar me ndarje të lehtë një volum, në të cilin janë vendosur musandrat që shërbenin të dy ambientet. Lartësia e katit në banesat përdhese është e vogël, ajo luhat rreth 2.2 m.

Ndërsa banesa përdhese në Kurveleshin e Sipërm ka pasur një përhapje të kufizuar, banesa me gjysmë kat takohet shpesh. Përhapjen e këtij kompozimi volumor e ka kushtëzuar terreni i pjerrët në të cilin janë ndërtuar mjaft banesa në këtë krahinë. Shembulli tipik i banesës me gjysmë kat është banesa Nr. 8 (Tab. II, fig. 9), ndërtuar në fshatin Golem. Banesa përbëhet prej tri ambientesh: katoit, magjerrisë dhe odës së miqve, përveç një ambienti të katërt ndërmjet magjerrisë dhe odës së miqve. Me interes janë shenjat që tregojnë se katoi ndërlidhej me shkallë druri drejtpërdrejtë me ambienitn qendror të katit të banuar. Anash hyrjes për në katua, janë ndërtuar dy mure që shërbejnë si mbështetje të platformës së mbrojtur me zgjatimin e flegrës së çatisë, e cila vendoset para hyrjes për në katin e banuar. Kjo zgjidhje takohet shpesh në këtë zonë.

Banesa me kat që, siç përmëndëm, ka pasur përhapjen më të gjerë në këtë krahinë, takohet përgjithësisht me dy kthina në katin e banuar, ndërsa shembujt me një kthinë janë shumë të rallë.

Një shembull tipik i banesës me kat me një kthinë të banuar është banesa Nr. 9 (Tab. III, fig. 10) në lagjen Elezaj të fshatit Salari. Banesa përfshin katoin në katin përdhe dhe ambientin e vetëm të banimit në katin e parë, me hyrje të veçanta nga jashtë. Ambienti i banimit ka në ballin e tij oxhakun, ndërsa jashtë konturit të tij në pjesën e prapme është ndërtuar ambienti



Fig. 9

sanitar. Shembulli tjetër i këtij varianti të banesës me kat është ajo Nr. 10 (Tab. III) në fshatin Rexhin. Kjo banesë ka pësuar një rikonstruksion, gjatë të cilit janë prishur shkallët e brendshme dhe janë ndërtuar shkallët e jashtme me portikun karakteristik mbi hyrjen për në katin e banuar, si dhe ndarjet e lehta në katin e banuar.

Shembull tipik i banesës me dy kthina në katin e banuar është ajo Nr. 11 (Tab. III, fig. 11) në lagjen Elezaj të fshatit Salari. Megjithëse kati i banuar është dykthinësh, kati përdhe mbetet një ambient i vetëm. Kati i banuar ndahet në magjerrinë dhe odën e miqve, secila me oxhak në ballin anësor. Hyrja kryesore e katit të çon në një parahyrje të ngushtë, prej të cilës kalon në të dy ambientet. Në fund të magjerrisë planimetria e saj thyhet duke krijuar përbri parahyrjes një këndë, në të cilën zakonisht vendosej hambari. Ngjitja në kat sigurohet me shkallë të jashtme guri. Platforma e vogël e mbuluar, përballë hyrjes së katit, mbrohet me mur në



Fig. 10

faqen veri-lindore. Në shumicën e rasteve banesat me kat pajisen me shkallë të jashtme, por kemi takuar dhe banesa me shkallë të brendshme, të cilat vendosen në pjesën qendrore të tyre.

Përpos banesave për një familje të vetme, kemi takuar dhe banesa të përngjitura, të cilat janë ndërtuar që në krye për dy familje, me lidhje gjinie, ose që mund të ndahen lehtësisht e barazisht më vonë. Banesa Nr. 12 (Tab. IV) në lagjen Elezaj të fshatit Salari është një shembull i rastit të dytë. Kati përdhe dhe ai i banuar kanë secili dy ambiente, me hyrje të veçanta nga jashtë. Kur rrethanat do të kërkonin ndarjen; atëherë mjafton të ndërtohet një rampe shkallësh, simetrike me atë ekzistuese, për të krijuar dy njesi të pavarura me një katua dhe një ambient secila.

Një zgjidhje mjaft interesante gjejmë te banesa Nr. 13 (Tab. V, fig. 12) në fshatin Gusmar. Ajo është ndërtuar në vitin 1882. Sot kompozimi origjinal është ndryshuar, por dhe mënyra se si është realizuar ky ndryshim është me interes. Fillimisht banesa kishte në plan formën e shkronjës U, pjesa qendrore kishte funksione ndërlidhëse dhe në të ishin ndërtuar shkallët e brendshme që ndërlidhin katet. Dy krahët anësore ishin trajtuar në mënyrë jo të njëllojtë. Krahu i majtë nuk kishte kat përdhe, siç duket pse një katua i vetëm plotësonte nevojat e familjes, dhe për më tepër se kërkohej që magjerria të ishte përdhese, duke qenë me «zjarr në mes». Kurse krahu i djathtë është dykatësh, në katin përdhe katoi, kurse sipër tij oda e miqve me oxhak në ballë dhe ambient sanitar. Në fakt kemi një bashkëlidhje të dy banesave të zakonshme me kat. Dhe vërtet, kur u prish pjesa qendrore, atëherë për të dy krahët u ndërtuan shkallët e zakonshme të jashtme prej guri, duke u krijuar kështu dy banesa krejt të veçanta, që në llojin e tyre janë një fenomen i zakonshëm në këtë zonë. Ky shembull është mjaft instruktiv për të treguar se si disa njësi kompozicionale, që në fakt përbëjnë në vetvete banesa të thjeshta, duke u ndërlidhur së bashku, krijojnë mundësi të reja dhe i japin shkas zhvillimit cilësor të banesës. Raste zgjidhjesh të tilla takohen dhe në banesën qytetare.

Shembujt e mësipërm janë ata më tipikët e varianteve të ndryshme të banesës së Kurveleshit të Sipërm, por krahas tyre takohen dhe zgjidhje të veçanta, dy prej të cilave mendojmë se kanë interes të paraqiten.

Banesa Nr. 14 (Tab. IV, fig. 13) në fshatin Nivicë, ndërtuar më 1891, paraqet një shembull mjaft të zhvilluar të banesës. Ajo ruan shumë elemente kompozicionale dhe arkitektonike të banesës tradicionale, por krahas kësaj aty gjejmë zgjidhje të veçanta dhe improvizime që e largojnë këtë banesë nga thjeshtësia dhe qartësia karakteristike e banesës së zakonshme.

Banesa është dykatshe, kati përdhe ka një ambient të banuar, një dhomë dimërore në të majtë të haja-

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 13

tit, nga ku një rampë shkallësh të çon në katin e parë. Tri ambientet e tjera janë ndihmëse. Nga një sallon i vogël qendror në katin e parë, ku të çojnë shkallët, bëhet ndërlidhja e të katër ambienteve, më i madhi prej të cilëve është magjerria. Salloni ndërlidhet me një lloj ballkoni të mbuluar. Ambienti më me interes i kësaj banese është magjerria, «me zjarr në mes» (siç shqiptohen vendasit, kur vatra ndërtohet larguar nga muret, diku rreth qendrës së ambientit). Magjerria me përmasa 4.00 x 6.75 e ka sipërfaqen të ndarë në dy pjesë, ajo nga balli është e shtruar me baltë, kurse pjesa tjetër me dërrasa. Në kufirin e tyre, duke u mbështetur mbi pjesën me baltë, është ndërtuar vatra (fig. 14). Ajo është e shtruar me pllaka guri, në ballin e saj dhe pak në të dy anët e rrethon një parapet në formë patkoi i lartë 20 cm. Kërraba e zjarrit lëshohet nga trarët e tavanit mbi vendin e zjarrit pranë parapetit. Dimensionet e përgjithshme të vatrës janë 150 x 157 cm. Kjo magjerri me «zjarr në mes» përbën sot shembullin e vetëm që ruhen në të gjithë Kurveleshin e Sipërm, por siç pohojnë të moshuarit, «lashtërisht zjarri bëhej në mes». Shembulli i mësipërm tregon se deri në fund të shekullit të kaluar vendosja e vatrës në qendër të shtëpisë së zjarrit ka qenë një shfaqje mjaft e zakonshme.

Një rast interesant është banesa nr. 15 (Tab. VI) në fshatin Picarr-Koronë. Ajo ruan skemën e zakonshme të banesës me kat, dykthinëshe, duke pasur ndërmjet



Fig. 12



Fig. 14

DO NOT COPY

tyre një hapësirë ndërlidhëse në të cilën janë ndërtuar shkallët. Banesa është trikatëshe, rast ky shumë i rrallë. Të dy ambientet e katit të parë janë paisur me oxhak. Ambientet sanitare dalin jashtë konturit të planimetrisë në formë kulle.

Materialet bazë ndërtimore guri, druri dhe gëlqerja gjenden në vendin e ndërtimit, ose në afërsi të tij. Sipas dëshmisë gojore, dikur dhe pyjet e kësaj zone kanë qenë të pasura me lëndë ndërtimi. Kështu që sigurimi i materialeve të ndërtimit nuk paraqiste vështirësi. Materiali kryesor ndërtimor guri është i llojit gëlqeror me shtresa, të cilat shpesh janë me trashësi të vogla, duke bërë të mundur nxjerrjen e rrasave për mbulimin e çatisë.

Muratura e banesave në Kurveleshin e Sipërm ndërtohet gjithmonë prej gurësh, ajo lidhet me llaç gëlqereje, ose me baltë, duke u lyer nga jashtë fugat me llaç gëlqereje. Muratura përforcohet me breza druri në brendësi. Guri i mirë shtresor ka lejuar që muratura të jetë në përgjithësi e rregullt me prirje rrjeshtimi, qoshet punohen mirë. Çatia është gjithmonë katërujshe, konstruksioni i saj është stropil. Mbulesa e çatisë përgjithësisht është me rrasa guri dhe rrallë me kashtë. Në rastin e parë mbi mahitë, të vendosura çdo 60 cm. vendosen thupra të rrumbullakta pranë e pranë, ose petavra dhe mbi to rrasat e gurit. Simbas të dhënave gojore mbi shtresën e petavrave vendosej fier ose baltë, për të rritur aftësinë termoizoluese të mbulesës. Kur mbulesa bëhet me kashtë, mbi mahitë vendosen arkareç, sipër tyre thupra dendur e pastaj brezat e kashtës që mbahen me thupra. Strehët prej guri me një apo dy korniza, janë të vogla dhe të mbyllura. Katojtë janë gjithmonë të pashtruara. Magjerria është zakonisht pjesërisht përdhese, por ka dhe raste, kur ajo është krejtësisht e tillë. Në ambientin mbi katua dyshemeja mbështetet mbi trarë, mbi ta vendosen dërrasa, ndërsa më parë përdorej një teknikë tjetër. Mbi trarët e dyshemesë vendoseshin «ashëra» (degë dushku të çara në mes me sëpatë) ngjitur njera tjetrës, mbi këtë shtresë hidhej argjilë me kashtë, pastaj mbi të shtrohej një shtresë e hollë balte. Magjerria nuk kishte tavan, ndërsa ambienti tjetër në disa raste kishte të tillë, të punuar me dërrasa. Banesa nuk suvatohet asnjëherë nga jashtë, ashtu si dhe katoi. Ndërsa ambientet e banimit suvatohen me llaç balte. Kemi takuar dhe raste, kur mbi shtresën e baltës hidhet një shtresë e hollë patinaturë gëlqereje.

Shkallët që ndërlidhin katet, janë përgjithësisht të jashtme, ato ngrihen mbi një masiv murature prej guri, ndërsa platforma përpara hyrjes në kat shtohet me dysheme dërrase ose me pllaka guri. Në rastin e dytë platforma mbahet nga një qemer karakteristik me seksion këndor. Shtyllat që mbajnë çatinë mbi platformë, janë prej druri, apo prej guri me seksion rrethor.

Oxhaku është një element i rëndësishëm në banesën. Ai ndërtohet përgjithësisht në ballët anësore të banesës. Tymari i oxhakut, në muraturën e gurit fillon me seksion katërkëndësh këndrejtë, pranë daljes në çati ai merr formën e katrorit, duke u mbyllur në ballë me dy gurë të vendosur pjerrtas apo me arkitra (fig. 15).

Katoi ndriçohet zakonisht nga disa hapësira të vogla që mbulohen me arkitra guri (fig. 16). Nga brenda këto hapësira zgjerohen anash dhe poshtë. Dritaret e ambienteve të banimit, kur janë të vogla, mbulohen dhe ato me arkitra guri (fig. 17), ndërsa kur hapësira e dritës rritet mbi arkitraun e gurit ndërtohet një hark guri, i cili shkarkon anash peshën e muraturës. Në disa raste mbi arkitraun prej guri vendoset një i dytë, me konfiguracion segmenti rrethor në pjesën e sipërme, i cili gjithashtu kryen funksionin e shkarkimit të peshave anash. Më rrallë takohet mbulimi i dritareve me hark gjysmërrethor. Dyert e banesave mbulohen me arkitra guri, mbi të cilin ndërtohet harku shkarkues, ose me hark gjysmë rrethor, apo segmenti rrethor. Pak ekzemplarë portash të jashtme që ruhen në gjendje të mirë, të kujtojnë ato të banesës gjirokastrite (fig. 18).

Mjeshtrit që kanë ndërtuar në Kurveleshin e Sipërm, janë ata të rretheve të Korçës që kanë punuar dhe në Gjirokastër[7]). Ata ndërmerrnin ndërtimin e banesës duke siguruar dhe transportin e materialeve me kafshët e tyre. Gëlqeren dhe lëndën e siguronte porositësi i banesës. Mjeshtrit punonin nga Maji deri në Shtator.

Në gjendjen e sotme pranë çdo banese gjejmë si ndërtim ndihmës kasollen. Por sipas dëshmisë së vendasve, ky është një fenomen i vonë që lidhet me mbajtjen e bagëtisë personale të kooperativistëve. Ndërsa në të kaluarën bagëtitë përgjithësisht qëndronin larg fshatit, kështu që ndërtimet ndihmëse që ne gjejmë sot pranë banesave, më parë ndërtoheshin zakonisht në stanet.

Kasollet janë dy llojesh. Njëri është ai me plan rrethor, që në volumin e tij formohet prej pjesës së poshtme cilindrike dhe asaj së sipërme në formën e trunkut të konit. Kjo kasolle (Tab. VI, fig. 19) thirret «Vllaqiko» dhe të kujton atë të ndërtuar nga blegtorët shëtitës arumunë. Konstruksioni i saj është i thjeshtë, strukturën formuese e përbëjnë thupra të ngulura në një anë në tokë, duke formuar kështu një skelet, i cili nga jashtë vishet me kashtë thekre që puthiset me skeletin me disa kordonë thuprash të holla. Në qendër të kasolles një shtyllë druri, mban pikën më të lartë të strukturës, ku ndërlidhen thuprat formuese. Kasollja ka një

7) E. Riza, **Banesa e fortifikuar gjirokastrite** «Monumentet» 1, 1971.

DOKUMENT

DO NOT COPY





Fig. 15

hyrje të vetme, ndërsa pranë kulmit lidhet një pjesë e vogël e hapur, nga e cila bëhet mbushja e kasolles me bar, i cili merret nga dera. Lloji i dytë i kasolles mjaft i përhapur është ai me formë këndrejtë në plan i mbuluar me çati dyujshe (Tab. VI). Kjo kasolle ndërtohet me dy teknika, teknika e parë është ajo me mur guri të thatë, ndërsa teknika tjetër është ajo me gardh, veshur nga jashtë me fier (fig. 20). Struktura e çatisë, në të dy rastet ndërtohet me lëndë të hollë apo thupra



Fig. 16

dhe mbulohet me kashtë. Kasollja e ka hyrjen në njerën nga faqet e ngushta. Në brendësi të saj, ndarje të lehta me gardh shënojnë sipërfaqet për qëndrimin e veçantë të kafshëve të ndryshme. Mbi trarët e strukturës së çatisë vendosen thupra për të formuar një platformë, mbi të cilën depozitohet bari. Ndërsa banesat ndërtoheshin nga mjeshtër profesionistë, kasollet e të dy formave ndërtohen nga vetë fshatarët.

Banesat e Kurveleshit të Sipërm, ndërtuar pranë njera tjetrës, formojnë fshatra kompaktë. Banesa ka një unitet të madh që gjen shprehje kryesisht në trajtimin e njëjtë të magjerrisë, odës së miqve dhe katoit, tri ambienteve të variantit të zhvilluar por ai shfaqet dhe



Fig. 17



Fig. 18

në përhapjen e gjerë të banesës me gjysmë kat dhe asaj me kat që përsa i përket numrit të ambienteve dhe funksioneve të tyre, janë të njëjta. Banesa përdhese, me një dhe më shumë ajo me dykthina, është një shfaqje jo e dendur. Karakteri blegtoral i ekonomisë ka ndikuar thellësisht në trajtimin e banesës në kuptimin më të gjerë të fjalës. Meqë në fshat nuk mbahej bagëti, bujqësia zinte një vend të dorës së dytë dhe meshkujt e rritur gjatë gjithë vitit rrinin me bagëti, banesa vetvetiu kishte më pakë funksione se ajo e një zone ku bujqësia luan rolin kryesor në ekonomi. Me anë tjetër bleg-



Fig. 19

toria bën të lehtë dhe ndarjen e familjes dhe nuk ndjen nevojën për familje të madhe patriarkale. Mundet që për këtë arsye banesa në Kurveleshin e Sipërm është me një numur të pakët ambientesh dhe këta përgjithësisht janë me përmasa jo të mëdha.

Banesa e kësaj zone është një banesë e mbyllur ku mungojnë krejtësisht ambiente të tilla si hajati apo çardaku. Në shumicën e rasteve banesat me kat ndërlidhen me shkallë të jashtme, por nuk mungojnë dhe banesat me shkallë të brendshme. Formulimi i tyre arkitektoniko-konstruktiv është i thjeshtë, pamja e tyre e ashpër, ku mbisundon masa e gurtë e muraturës dhe mbulesa prej rrasash guri është në unitet të ngushtë me terrenin e zhveshur shkëmbor, mbi të cilin ato ngrihen. Këto banesa kanë afëri të dallueshme deri në identitet në planin kompozicional me rrënojat e banesave të fshatit Kamenicë[8]), duke treguar kështu se kjo banesë pati një shtrirje të gjerë kohore në zonat malore të Shqipërisë së Jugut.



Fig. 20

Karakteri i mbyllur i banesës në fjalë, ndërtimi i saj me material të qëndrueshëm dhe hapësirat relativisht të vogla për ndriçim, sigurisht që u japin këtyre ndërtimeve tipare mbrojtëse. Por nuk na duket i saktë mendimi i M. Urbanit, i cili zmadhon tejmase karakterin mbrojtës të këtyre banesave[9]). Gjithashtu Hamondi[10]) thekson pa bazë karakterin fortesë të kësaj banese, duke sjellë si argument mungesën e dritareve në katin përdhe, mungesë e cila shpjegohet me arsye funksionale, mbasi katoi shërbente zakonisht për stallë të kafshëve të ngarkesës dhe atyre të punës. Në karakte-

8) A. Meksi, E. Riza, **Ndërtimet në fshatin – rrënojë të Kamenicës** «Monumentet» 7-8, 1974.
9) M. Urban, **Die Siedlungen Sud – Albaniens**
10) N.G.L. Hammond, **Epirus.**

DO NOT COPY

rin e mbyllur të banesës nuk duhet nënvleftësuar as kushti klimaterik i dimrit të ashpër.

Meqë studimi tipologjik i banesës popullore fshatare në Shqipërinë e Jugut ende nuk ka përfunduar, është e parakohshme të përcaktohet saktë se në ç'lidhje është banesa e jonë me atë të krahinave të tjera. Megjithatë, nga sa dimë, kjo banesë nuk është një karakteristikë lokale e zonës në fjalë, por ajo shtrihet dhe në mjaft zona të tjera të Shqipërisë së Jugut, ku në përgjithësi ka një unitet të dallueshëm të banesave. Nuk mund të mos përmendim afëritë e mëdha të banesës së Kurveleshit të Sipërm me atë të fushës së Mbishkodrës[11]) dhe me disa variante të banesës së Zadrimës[12]), që tani, për tani nuk jemi në gjendje t'i quajmë dy zhvillime të pavarura apo të lidhura ndërmjet tyre me marrëdhënie huazimi.

Në gjendjen e sotme në Kurveleshin e Sipërm nuk takojmë as kulla, as banesa me kulla. E vetmja e dhënë që flet se në Kurvelesh, si në Pilat dhe Gjirokastër, ka pasur banesa me kulla, është ajo e Hanit[13]) i cili na jep dhe skicën e një banese të madhe me kullë, më të lartë se vetë ajo, ndërtuar në fshatin Golem (fig. 21). Banesa në fjalë duket një banesë e zhvilluar, e cila duhet mbajtur si rast i veçantë, që sigurisht i përkiste ndonjë familjeje të pasur.

Llojet e ndryshme të banesave të paraqitura, shkallët e ndryshme të zhvillimit të tyre hedhin dritë të qartë mbi diferencimin e thellë klasor ndërmjet shtresave të popullsisë, kryesisht blegtorale të kësaj zone. Shumë rrëfyes në lidhje me këtë fakt, është krahasimi i dy skajeve: një kasolle e përdorur për banim nga një familje e varfër[14]) në të kaluarën, dhe banesën e fortifikuar, për të cilën bën fjalë Hani që në mesin e shekullin të kaluar.



Fig. 21

DO NOT COPY

11) V. Shtylla, **Banesa të vjetra të fushës së mbishkodrës,** «Monumentet», 4, 1972.
12) F. Zarshati, **Të dhëna mbi banesën e fushës së Zadrimës,** «Monumentet» 4, 1972.
13) J.G. Hahn, **Vep. Cit.** 205.
14) F. Haxhiu, **Kooperativa blegtorale-bujqësore «Asim Zeneli»** (1947-1959), Etnografia Shqiptare, II, 1963, 33.

TAB. I



DO NOT COPY

DO NOT COPY

BANESA Nr. 5



PAMJE KRYESORE



KATI PERDHE

BANESA Nr.6







PAMJE KRYESORE



PAMJE KRYESORE

BANESA Nr. 7

BANESA Nr 8



KATI I Ţ-RÉ



KATI PERDHE



TAB. III

BANESA Nr. 9



KATI PERDHE

KATI I Î-RE

BANESA Nr. 10



PAMJE KRYESORE

0 1 2 3 m.

BANESA Nr. 11



PAMJE KRYESORE



KATI PERDHE

KATI I Î-RE



KATI I Î-RE

KATI PERDHE

DO NOT COPY

DO NOT COPY

BANESA Nr 12



PAMJE KRYESORE

0 1 2 3m



KATI I Î-RE

0 2 4m

KATI PERDHE

BANESA Nr 14



KATI PERDHE

0 2 4m



KATI I Î-RE

BANESA Nr. 13



RIKONSTRUKSIONI



KATI PERDHE



KATI I Ï-RÉ

GJENDJA E SOTME



KATI PERDHE





KATI I Ï-RÉ

DO NOT COPY

BANESA Nr 15



PAMJE KRYESORE







KATI PERDHE





KATI I Ţ-RE







KATI I II-TE

0 2 4m

0 2 4 m

DO NOT COPY

Emin RIZA

DO NOT COPY

L'HABITATION POPULAIRE DANS LE HAUT KURVELESH

RESUME

La zone du haut Kurvelesh fait part de la région de la Laberi. Elle comporte les villages de Picarr, Picarr-Koronë, Kolonjë, Golem, Progonat, Lekdush, Gusmar, Rexhine, Nivice, Salari et Vermik. Le matériel constituant la base de cet article a été recueilli dans tous les villages susmentionnés, à l'exception de Vermik. Quant à son but, c'est celui de dresser un tableau de l'habitation caractéristique de cette zone dans ses différentes variantes.

Le haut Kurvelesh occupe la partie la plus escarpée des montagnes de la Laberi. Les formations calcaires complètement nues sont sillonnées par des gorges profondes; quant aux plateaux, à l'exception de celui de Nivice, ils sont peu nombreux et arides. Ces conditions naturelles ont fait traditionnellement de l'élevage la principale base économique des habitants de cette zone. L'élevage y avait un caractère transhumant. On y relevait également une profonde différenciation de classe. En effet, les éleveurs riches ayant de grands troupeaux affermaient les pacages loins du village pour toute l'année, les éléveurs moyens conduisaient leurs troupeaux dans des zone basses en hiver et les éléveurs pauvres faisaient paître leur bétail pendant toute l'année dans les pacages du village. Ces facteurs ont influé non seulement sur le caractère des aglomérations, mais encore sur celui de l'habitation et de ses constructions auxiliaires.

La zone du haut Kurvelesh a subi au cours de notre siècle de graves dévastations, aussi bien pendant la Première Guerre mondiale que pendant la Lutte de libération nationale. Aussi le nombre d'habitations anciennes est-il relativement restreint. Ils appartiennent principalement à la fin du XIXe siècle et au début du XXe.

Les villages se dressent sur des terrains escarpés comme à Picarr, Kolonje et Salari ou sur des zones plates comme Progonat, Gusmar, Rexhine et Nivice. Caractéristique principale de ces agglomérations rurales: elles ne sont pas dispersées mais se dressent l'une près de l'autre. Il en va de même des habitations, constituent en général des unités compactes à caractère tribal.

En ce qui concerne l'historique du développement de l'habitation dans cette région, une grande importance revêtent les ruines du village de Picarr dont une part, selon toute vraisemblance remontent à la deuxième moitié du XVIIIe siècle. Cette agglomération rurale s'élevait sur le faîte d'une coupole rocheuse, se terminant par un plateau dont le flanc oriental est escarpé. Partant des observations faites sur place, il semble que l'habitation à un étage est le type prédominant dans ce village. Vu l'aspérité du terrain, parfois sa composition est à demi-étage.

Une caractéristique commune au type d'habitation du village de Picarr est l'emploi presque généralisé de la citerne pour conserver l'eau potable. En vue de dresser un tableau caractéristique de l'habitation en question, examinons l'exemplaire N° 1 (Tab. I, fig. 3) qui en est le plus typique. Sa composition est à demi-étage. L'étage au rez-de-chaussée, d'une surface plus petite que celle de l'étage destiné à l'habitation proprement dite, constitue en soi une seule pièce où logent les bestiaux. L'étage destiné à l'habitation, comme l'indiquent les deux foyers, comportait deux pièces. La pièce dite «magjerrisë» ou salle de séjour, où l'on faisait également la cuisine, se trouvait au rez-de-chaussée. Le manque de fenêtres laisse à supposer que l'illumination était assurée par des lucarnes. Ce type d'habitation, à en juger par ses vestiges, était couverte par un toit à quatre pentes. Quant aux autres exemplaires reproduits dans cet article (Tab. I, fig. 4,5), ce ne sont que des variantes plus évoluées.

Puis il est question des habitations typiques du haut Kurvelesh, conservées de nos jours encore dans un bon état et en général de construction plus récente que celles de Picarr. On peut les classifier en trois groupes, caractérisées par une conception très proche compositionnelle et par des rapports d'évolution évidents. Le premier groupe comporte les habitations à rez-de-chaussée, le deuxième les habitations à demi-étage et le troisième celles

DO NOT COPY

à un étage. Les habitations de ces trois groupes connaissent une extension presque égale dans tous les villages de cette régions, mais il convient de relever que les habitants du pays préfèrent les habitations du troisième groupe.

L'habitation à rez-de-chaussée s'est manifestée la première dans cette région. Elle est à une seule pièce (Tab. II, fig. 7) ou à deux pièces avec deux entrées distinctes (Tab. II, fig. 8), ou bien avec une seule entrée (Tab. II). Son extension est plutôt limitée dans le haut Kurvelesh, où l'on rencontre plus souvent l'habitation à demi-étage. Exemple typique l'habitation reproduite dans le Tab. II, fig. 9. Quant à la maison, à un étage, elle comporte en général deux pièces dans l'étage destiné à l'habitation, tandis que la maison à une seule pièce se rencontre rarement (Tab. III, fig. 10). Un exemple typique de la maison à deux pièces, dans l'étage destiné à l'habitation. (Tab. III, fig. 11), est celui situé dans le village de Salari. Bien que l'étage destiné à l'habitation comporte deux pièces, l'étage au rez-de-chaussée constitue une seule pièce. Un escalier extérieur en pierre conduit à l'étage destiné à l'habitation. Il y a cependant d'autres exemplaires plus évolués, où la communication entre les étages est assurée par un escalier intérieur. Outre les maisons destinées au logement d'une seule famille, nous avons rencontré, des habitations contiguës construites dès le commencement à l'intention de deux familles ou pouvant être séparées facilement et de manière égale plus tard. (Tab. IV, habitation Nº 12).

Une solution intéressante constitue en soi l'habitation Nº 13 (Tab. V, fig. 12), dans le village de Gusmar, dont la construction remonte à 1882. Par suite des modifications apportées à sa composition originale, elle a été divisée en deux maisons analogues. Cet exemple édifiant illustre comment certaines habitations modestes, en se rattachant l'une à l'autre permettent de créer de nouvelles posibilités et contribuent au développement qualitatif de l'habitation. La maison Nº 14 (Tab. IV, fig. 13) dans le village de Nivice, construite en 1891, constitue un exemple d'habitation plus évolué. D'un grand intérêt est la pièce dite «magjerria», ayant en son milieu un foyer et constituant l'unique exemplaire conservé à ce jour dans cette région. Aux dires de la population locale, il ressort que la disposition du foyer au milieu de la pièce dite «magjerria» était dans le passé un phénomène commun.

Les murs de ces habitations sont généralement en pierres, renforcées par des bandes de bois et liées avec du mortier de chaux ou de la glaise. Quant à leurs toits, ils sont toujours à quatre pentes et couverts généralement de plaques de pierre et plus rarement de paille. Le sous-sol destiné aux bêtes est illuminé d'habitude par de petites ouvertures surmontées de linteaux en pierre. (Fig. 16). Quand les fenêtres sont petites, elles sont surmontées par des architraves de pierre (Fig. 17); et si elles sont grandes, l'architrave de pierre est couvert par un arc qui décharge latéralement le poids des murs. Les fenêtres surmontées d'un arc semi-circulaire. sont plutot rares. Il en est de même de la porte extérieure de cette habitation qui a une certaine ressemblance à celle des maisons types de Gjirokastra. (Fig. 18). Les maîtres-constructeurs du haut Kurvelesh sont originaires des environs de Korçe, ce sont les mêmes qui ont travaillé à Gjirokaster.

Actuellement, à proximité de chaque habitation l'on trouve comme construction auxiliaire une chaumière. Il s'agit là d'un phénomène récent pour le village du haut Kurvelesh, car auparavant cette chaumière était construite dans les pacages. On relève deux types de chaumière: le premier comporte un plan circulaire, dont le volume est formé par la partie inférieure cylindrique et par la partie supérieure en forme de cône tronqué. Les gens du pays l'appellent «Vllaqiko» (Fig. 19). Quant au deuxième type, il connait une plus grande extension et comporte un plan rectangulaire couvert d'un toit à deux pentes (Tab. IV).

L'habitation type du haut Kurvelesh se caractérise par une grande unité s'exprimant principalement dans le traitement identique de la «magjerri», de la «chambre des amis» et du «katoi» (la pièce destinée au logement des bêtes), qui constituent les trois pièces de la variante la plus répandue dans cette région. Nous avons affaire à une habitation de type fermé, où manquent des éléments comme la galerie ouverte et le tchardak. De formulation architectonico-constructive simple, ce type d'habitation présente un aspect rude, où la masse pierreuse des murs et la couverture en plaques de pierre sont en parfaite harmonie avec le terrain rocheux complètement nu. Ces maisons offrent sur le plan de la composition une similitude jusqu'à l'identité avec les ruines des habitations du village de Kamenice, attribuées aux XIVe-XVe siècles. Ce qui montre que ce type d'habitation a connu dans le temps une grande extension dans les zones montagneuses de l'Albanie du sud.

Le caractère fermé de l'habitation en question, sa construtions avec des matériaux résistants et la présence d'ouvertures relativement petites pour l'illumination sont autant d'éléments lui conférant des traits défensifs. Malgré cela nous ne pouvons partager le point de vue de M. Urban, qui dépasse la mesure quant au caractère défensif de ce type d'habitation, point de vue auquel s'est plus tard associé Hammond également.

L'étude typologique de ce type d'habitation rurale de l'Albanie du sud n'ayant pas été encore terminée, il n'est pas possible pour le moment de déterminer la place qu'occupe l'habitation du haut Kurvelesh par rapport à celle des autres régions de l'Albanie du sud, où l'habitation se caractérise en général par une unité bien nette. D'un grand intérêt sont aussi ses ressemblances avec l'habitation de la plaine de Mbishkoder et de la Zadrime.

DO NOT COPY

Fatos TARTARI

DO NOT COPY

GJURMË NDËRTIMESH— NË KËNETËN E DURRËSIT

Vitet e fundit punimet e bonifikimit, shpimet e bëra nga një ekspeditë e Institutit të Hidrometeorologjisë[1]), gërmimet arkeologjike dhe gjetjet e rastit, buzë teritorit që përfshinte këneta e dikurshme e Durrësit, kanë nxjerrë një material me interes për studimin e shtrirjes së qytetit të lashtë.

KËMBË TË UJËSJELLËSIT ROMAK

Për praninë e një ujësjellësi romak në Durrës bën fjalë Hezej[2]) i cili gjeti i pari edhe pllakën mbishkrimore që flet për ndërtimin dhe restaurimin e tij[3]), ndërsa ndjekjes së gjurmëve të këtij ujësjellësi i ka kushtuar një punim ing. J. Adami[4]). Në të ai shfaq mendimin se kjo trase që kishte gjurmë të dukshme gjer në fshatin Arapaj «ka vazhduar rrugën e kodrave gjer te Qafa e Rrashbullit dhe që këtu ka zbritur në kënetë për të arritur në qytet». Autori shton se nga pikëpamja teknike ky supozim është më i natyrtë[5]).

Punimet e mëdha bonifikuese të bëra në kënetën e dikurshme të Durrësit si dhe ndonjë gërmim i vogël i bërë në pika të veçanta të saj në ndjekje të gjurmëve të ndërtimeve antike, zbuluan edhe këmbët e ujësjellësit romak, në segmentin përmes kënetës, gjer në pikën ku ai futej në qytet. Në lagje të veçanta të qytetit janë gjetur edhe tubacione prej balte të seksioneve të ndryshme si dhe tuba plumbi, që i përkisnin, duke u nisur nga përmasat, tubacionit kryesor që e sillte ujin në qytet[6]).

Këmbët e këtij ujësjellësi[7]) (gjithsejt tri) u zbuluan rreth 250 m në veri lindje të depuratorit, në thellësinë 0,40-0,50 m. Ato kanë në seksion formën e një paralelogrami me përmasa 2,4 x 1,8 m. Lartësinë ekzistuese prej 0,50 m e formojnë nëntë rreshta tullash trekëndëshe të përmasave 0,28 x 0,4 m, të vendosura mbi një taban argjili. Tullat janë lidhur me shtresa të holla llaçi, duke formuar një kornizë rreth mbushjes prej gurësh dhe tullash të pjesës qendrore të këmbës (bërthamës). Në dy qoshe të bazamentit u gjetën edhe fragmentet e dy kolonave të rrumbullakta prej guri të bardhë gëlqeror me diametër 0,35 m. dhe lartësi ekzistuese 0,20 deri 0,45 m, funksioni i të cilave mbetet i papërcaktuar.

Këmbët kanë një largësi të barabartë njëra prej tjetrës 9,75 m. Rreth tyre u gjetën rrënime intensive tullash, provë se, ashtu si edhe në Butrint, harqet mbi të cilët kalonte rrjedha e ujit kanë qenë ndërtuar prej tullash.

Këmbët e zbuluara ndjekin drejtimin verilindje-jugperëndim me kënd 36° dhe hyjnë në qytet.

FRAGMENTI I NJË MURI MBROJTËS

Hezej, duke bërë fjalë për gjurmë të tjera rrethojash në Durrës, përmend edhe një rrethojë të tretë (muri verior) që i shtonte qytetit nga ana e veriut një lagje, të paktën të barabartë në shtrirje me

1) Instituti i Hidrometereologjisë pranë Akademisë së Shkencave të RPSH gjatë vitit 1973-1974 bëri disa shpime në intervale të ndryshme në sipërfaqen e kënetës së dikurshme. Sondat nr. 5, 7 dhe 15 së bashku me kampionet e dheut nxorën në sipërfaqe edhe një material të vlefshëm arkeologjik.
2) M. Heuzey – A. Daumet, **Mission archeologjique de Macedoine,** Paris, 1876, 387.
3) C I L; III, 709.
4) J. Adami, **«Pas gjurmëve të ujësjellësit antik të Durrësit,** Bul. Inst. Shkenc. I, 1950, 127.
5) J. Adami, **po aty,** 127.
6) V. Toçi, **Të dhëna mbi topografinë dhe elementin ilir të Dyrrahit në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike,** Konf. e parë e studimeve albanologjike, Tiranë, 1965, 462.
7) Dh. Budina, **Ujësjellësi i Butrintit,** Studime Historike, 2, 1967, 145-148, fig. 4.

atë të Exo Bazarit. Autori shton se nga lindja është mjaft e vështirë të përcaktohet se si këto vija të reja lidheshin me qendrën e fortifikimit. Sigurisht fjala këtu është për unazën e dytë ose të tretë të rrethojës bizantine, ndërtuar nga Anastasi i parë[8]). Kohët e fundit, gjatë hapjes së themeleve të një ndërtese pesëkatëshe, në truallin e ish punishtes së lëkurëve, u takua një fragment muri prej tullash, që ndodhej në krahun e djathtë të rrugës «A. Goga». Trakti në tërë gjerësinë e tij prej 3,60 m është i ndërtuar me tulla të përmasave 0,28 x 0,28 x 0,04 m, vendosur në rreshta horizontale mbi themele guri. Fugatura, e trashë 0,05 m., është e përbërë nga gëlqere të përzier me copra tullash e guriçkash si dhe në murin rrethues[9]). Për arsye të punimeve që po kryheshin, atë nuk mundëm ta ndjekim në më shumë se 5-6 m gjatësi. Duke parë edhe skicimin e Laluasë në veprën e Hezeit, vumë re se midis asaj që Hezeit e quan rrethojë e tretë dhe traktit të zbuluar ka përputhje të plotë si vendndodhje dhe drejtim.

MATERIALE NDËRTIMI DHE FRAGMENTE TË NJË AFRESKU MURAL

Nga kontrolli i materialeve përreth sondimeve të ekspeditës së Institutit të Hidrometereologjisë ndeshëm në një numër të madh tjegullash e tullash romake. Tjegullat ruajnë format e harkuara të kësaj periudhe[10]), ndërsa tullat katërkëndëshe e trekëndëshe kanë një trashësi prej 4 cm. (Tab. 1). Ndërmjet tyre gjetëm edhe copërat e një afresku mural. Shtresa mbi të cilën qe aplikuar piktura ishte 4 cm e trashë dhe përbëhej nga gëlqere e pastër hidraulike. Mbi sipërfaqen e sfondit dallohen brezat kryesorë koloristikë, të përbërë nga një e kuqe korali, një fushë e nuancës së bardhë si dhe një fushë e gjerë e ngjyrës së zezë. Në renditjen e brezave brenda fragmentit të zbuluar nuk dallohet ndonjë detaj artistik. Teknika e pikturimit e daton këtë afresk në kohën perandorake[11]). Për ne gjetja e një fragmenti të tillë afresku është e rëndësishme, pasi dëshmon praninë e një vile romake me pikturë murale, gjetje e vetme në qytetin e Durrësit deri tani, si dhe gjurma më e hershme e pikturës monumentale në këtë qytet.

KALLDRËM I LASHTË NË VARREZAT E DYSTA

Gërmimet e bëra në nekropolin e dystë, në një skaj të kënetës së dikurshme, në vitin 1971 dhe 1973, na dhanë forma të shumëllojta të varreve. Ndërmjet grumbullimit të varreve prej tulle apo tjegullash, vumë re edhe trakte të ulta muresh prej guri që, në disa raste, degëzoheshin njëri me tjetrin, si dhe kalldrëme në gjerësinë e mjaftueshme të një kalimi. Në kuadratin 7 të sektorit tonë të gërmimit, së bashku me varret u zbuluan edhe mure të përbëra prej gurësh shtufi të palidhur në gjerësinë 80-100 cm dhe të lartë deri në 50 cm. Në të dy anët e mureve, madje edhe mbështetur në to, gjenden varre të shumta prej tjegullash të harkuara romake të tipit në formë çatie[12]). Këto trakte, për mendimin tonë, kanë shërbyer si mure ndarës për parcela të veçanta funerare familjare, siç e dëshmojnë edhe gjetjet në Apolloni[13]). Veç mureve, në hapësira të veçanta është hetuar edhe një shtrojë, dysheme apo kalldrëm antik, i përbërë nga gurë të vegjël, copëra tjegullash, funde dhe parete amforash dhe pitosash të ngulur në tokë me lidhje të kufizuar llaçi. Vende-vende fragmentet e qeramikës janë mjaft të dendura. Këto kalldrëme janë pjesë të rrugëve, korridoreve të detyrueshme në sipërfaqen e gjerë të varrezës, që lejonin kalimin e pjestarëve të ceremonisë mortore, duke i dhënë edhe një fizionomi të përcaktuar nekropolit.

BAZAMENT I NJË VARRI MONUMENTAL ME URNË TË MUROSUR (fig. 1)

E veçantë në arkitekturën e përgjithshme të varrezës romake është një masë monolite guri që ngrihet dhe spikat në mes të varreve të shumtë prej tullash e

8) C. Capizi, **L'imperatore Anastasio I (491-518) Studie sulla vita, la sua opera e la sua personalita,** Roma, 1969, 206; K. Zheku **Zbulime epigrafike në muret rrethuese të kalasë së Durrësit** «Monumentet» III, 1972, 41.

9) K. Zheku, **vep cit.,** f. 41.

10) A. Mano, **Të dhëna mbi qeramikën masive të Apollonisë përdorur si material ndërtimi,** «Studime historike» 1, 1965, 66. Përmasat e tjegullave janë 0,67 x 0,35 m. (0,40 x 0,025 m; 0,80 x0,40 x 0,035; 0,80 x 0,40 x 0,02 cm, si dhe 0,40 x 0,20 x 0,02 cm.; 0,65 x 0,20 cm.

11) **Atti dell' Accademia nazionale del lincei** seria VIII, vol. XXIV. 1970, f. 14.

12) Shih dhe A. Mano **(Nekropoli i dystë i Apollonisë,** «Iliria» III, Tiranë 1974, 160), për varre të tillë gjetur në Apoloni.

13) A. Mano, **Po aty.**

PO NOT COPY



Fig. 1.

tjegullash. Blloku me formë paralelogrami, me përmasa: 2,50 x 2,40 x 1,20 m, është i ndërtuar nga gurë konglomeratë me llaç të fortë gëlqereje. Gjatë ndërtimit nga poshtë, në qoshet verilindore dhe juglindore të muraturës, janë murosur dy amfora balte 35 cm, të larta, të vëna në këmbë. Brenda tyre, me përjashtim të hirit dhe të një dheu të zi, nuk u gjet asnjë inventar. Pranë bllokut u gjet edhe një pllakë masive guri të bardhë me formë të rregullta, veçse e thyer në një brinjë. Në gjendjen ekzistuese ajo ka përmasa: 120 x 85 x 25 cm. Në të gjitha faqet e saj vihen re gropëza e të thelluara, të shkaktuara nga goditjet e daltës. Mendojmë se kjo pllakë ka qenë vendosur mbi masën e gurtë dhe mund të ketë qenë pjesë e një monumenti onorifik që rriste madhështinë e varrit. Urna që ruante hirin dhe kockat e të vdekurve, u gjet përsëri e murosur, por këtë radhë në qendër të bllokut. Trupin e urnës e përbën një cilindër i zgavruar guri me thellësi 45 cm dhe diametër 50 cm. Trashësia e pareteve është 5 cm. Atë e mbyll një kapak i dytë nga i njëjti gur, që vjen e harkohet nga sipër, duke formuar një lloj saçi. Kapaku është i plumbosur në tri-katër anë me trupin e urnës. Brenda zgavrës ishte vënë një enë e madhe qelqi me kapak, e mbushur me mbeturina të menusë së banketit mortor. Nga lëngu që përmbante ena, u nxorr një krëhër i punuar në dy anë, dy enë të vogla qelqi, një stilet kocke, si dhe një libër dylli, i përbërë nga pesë faqe të lidhura (Tabulae ceratae)[14]. Jemi të mendimit se kjo masë e çimentuar guri është ngritur me përmasa të rregullta gjeometrike për të marrë nën mbrojtje urnën e ndonjë matrone. Si e tillë, ajo formonte në sipërfaqen e varrezës një varr monumental, i cili mund të ketë pasur edhe ndonjë përmendore përkujtimore.

14) F. Tartari, Rezultatet e gërmimeve të vitit 1971 në skajin verilindor të qytetit të Durrësit, Bul. Arkeologjik, 1972, 103-119.

DO NOT COPY

Fatos TARTARI

DO NOT COPY

TRACES DE CONSTRUCTIONS DANS LE MARAIS DE DURRES

RESUME

LES PIEDS DE L'AQUEDUC ROMAIN

Les pieds de cet aqueduc (en tout trois) ont été découverts 0,40 – 0,50 m. de profondeur. Leur section se présente sous la forme d'un parallélogramme dont les dimensions sont de 2,4 x x 1,8 m. L'actuelle hauteur de 0,50 m. est constituée de neuf rangées de briques triangulaire (0,28 x 0,4 m.).

Les pieds de cet aqueduc sont équidistants, ils se trouvent à 9,75 m. l'un de l'autre. Dans l'espace environnant on a mis au jour une grande quantité de fragments de briques, ce qui prouve que les arcs, au-dessus desquels passait le courant d'eau, étaient construits de briques.

FRAGMENT D'UN MUR D'ENCEINTE

Récemment, lors des travaux effectués pour creuser les fondations d'un édifice a été identifié un fragment de mur en briques. Ce tronçon de mur, large de 3,60 m., est construit de briques d'une dimension de 0,28 x 0,28 x 0,04 m, disposées en rangées horizontales sur des fondements de pierres.

UN ANCIEN PAVE DANS LES CIMETIERES A CIEL OUVERT

Les fouilles effectuées dans la nécropole à ciel ouvert pendant les années 1971 et 1973, dans le territoire sur lequel s'étendait autrefois le marais, ont mis au jour également de nouveaux éléments. Parmi les nombreux tombeaux de briques et de tuiles, ont été identifiés des tronçons de murs peu élevés en pierres, souvent reliés les uns aux autres, ainsi que des pavés ayant la largeur d'un passage. Ces tronçons, à notre avis, constituent des murs séparant les divers tombeaux de famille, comme l'attestent les trouvailles d'Apollonie.

LE SOUBASSEMENT D'UN TOMBEAU MONUMENTAL A URNE MUREE

Ce bloc en forme de parallélograme, d'une dimension de 2,50 x 2,40 x 1,20 m., est construit de pierres onglomératicues liées solidement avec de la chaux. Pendant la construction depuis le bas, dans les angles nord-est et sud-est de la maçonnerie, ont été murées deux amphores de glaise hautes de 35 cm et disposées debout. Le corps de l'urne est constitué par un cylindre creux de pierre, ayant une profondeur de 45 cm. et un diamètre de 50 cm. Dans la cavité cylindre se trouve un grand récipient en verre à couvercle, renfermant des restes de victuailles du banquet funéraire, ainsi qu'un libre en cire comportant cinq feuilles reliées (Tabulae ceratae).

DO NOT COPY

Çmimi 10 lekë

I
M
K